

**LIGJ
PËR PROCEDURË PENALE**

**PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

SEKSIONI A: PARIME DHE SHPREHJE LIGJORE

**Kreu I
PARIME THEMELORE**

**Neni 1
Qëllimii i ligjit**

Ky ligji i përcakton rregullat me të cilat mundësohet udhëheqje e drejtë e procedurës penale, ashtu që asnjë i pafajshëm të mos dënohet, kurse kryerësit të veprës penale t'i shqiptohet sanksion penal me kushtet e parapara në Kodin penal dhe në bazë të procedurës së zbatuar ligjore.

**Neni 2
Prezumpcioni i pafajësisë**

(1) Personi i akuzuar për vepër penale do të konsiderohet si i pafajshëm derisa faji i tij nuk përcaktohet me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor.

(2) Organet shtetërore, mjetet për informim publik dhe subjektet tjera janë të obliguara që t'i përmbahen rregullës nga paragrafi (1) të këtij neni, kurse me deklaratat e veta publike për procedurën që është në rrjedhë nuk guxojnë t'i shkelin të drejtat e të akuzuarit dhe të dëmtuarit, si dhe pavarësinë dhe paanësinë gjyqësore.

**Neni 3
Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit**

(1) Para se të miratohet aktgjykim i plotfuqishëm, liritë dhe të drejtat e të akuzuarit dhe të personave të tjerë në mënyrë proporcionale me peshën e veprës penale dhe shkallën e dyshimit, mund të kufizohen vetëm në masë që është e domosdoshme dhe me kushte që i parashikojnë Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe ky ligj.

(2) Sanksionin penal kryerësit të veprës penale mundet me vendim t'ia shqiptojë vetëm gjykata kompetente, në procedurë të zbatuar sipas këtij ligji.

**Neni 4
Vendosja në mënyrë më të volitshme për të akuzuarin (*In dubio pro reo*)**

Për dyshimin në lidhje me ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve që e përbëjnë karakterin e veprës penale, apo nga të cilat varet zbatimi i ndonjëres nga dispozitat e Kodit penal, gjykata do të vendosë në mënyrë më të volitshme për të akuzuarin.

Neni 5

E drejta e gjykimit të drejtë

Personi i akuzuar për vepër penale ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe publik para gjykatës së pavarur dhe të paanshme, në procedurë kontradiktore të mund t'i kundërshtojë akuzat kundër tij dhe të propozojë dhe të nxjerrë dëshmi në mbrojtjen e vet.

Neni 6

E drejta e gjykimit në afat të arsyeshëm

(1) Personi kundër të cilit mbahet procedura ka të drejtë që në afat të arsyeshëm të nxirret para gjykatës dhe të gjykohet pa prolongim të paarsyeshëm.

(2) Gjykata është e obliguar që procedurën ta zbatojë pa prolongim dhe ta pamundësojë çdo keqpërdorim të të drejtave, të cilat u takojnë personave që marrin pjesë në procedurë.

(3) Me dënim me para prej 700 deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë do të dënohet personi fizik, kurse me dënim në lartësi prej 2 500 deri në 5 000 euro në kundërvlerë me denarë, do të dënohet personi juridik i cili do t'i keqpërdorë të drejtat që i takojnë në procedurë.

(4) Kohëzgjatja e paraburgimit dhe kufizimet tjera të lirisë personale, doemos duhet të reduktohen në kohën më të shkurtër të domosdoshme.

Neni 7

Ndalimi për gjykim apo ndëshkim të dyfishtë

Askush nuk mund të gjykohet apo dënohet sërish, për vepër penale për të cilën tanimë shtë gjykuar dhe për të cilën është miratuar vendim i plotfuqishëm gjyqësor.

Neni 8

Gjuha dhe alfabeti zyrtar

(1) Në procedurën penale gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

(2) Gjuhë tjetër zyrtare që e flasin së paku 20% nga qytetarët dhe alfabeti i saj, në procedurë përdoret në pajtim me ligjin.

Neni 9

E drejta për përkthyes, përkatësisht interpretues

(1) I akuzuari, i dëmtuari, paditësi privat, dëshmitarët dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë, që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja kanë të drejtë që në procedurë ta përdorin gjuhën dhe alfabetin e vet.

(2) Palët, dëshmitarët dhe pjesëmarrësit në procedurë para gjykatës kanë të drejtë në ndihmë falas të përkthyesit, përkatësisht interpretuesit, nëse nuk e kuptojnë apo flasin gjuhën në të cilën mbahet procedura.

(3) Organi që e mban procedurën do të sigurojë përkthim me gojë të asaj që personi dhe të tjerët e paraqesin, si dhe të dokumenteve dhe të materialit tjetër të shkruar të dëshmisë. Organi që e udhëheq procedurën do të sigurojë që me shkrim të përkthehet materiali i shkruar, që është me rëndësi për procedurën apo për mbrojtjen e të akuzuarit.

(4) Personi do të këshillohet për të drejtën e përkthyesit, përkatësisht interpretuesit. Në procesverbal do të shënohet se i është dhënë këshillë dhe deklarata e personit.

(5) Përkthimin e kryen përkthyesi, përkatësisht interpretuesi gjyqësor.

Neni 10

Parashtrimi i shkresave

(1) Padi të, ankesat dhe parashtrësata tjera parashtrihen në gjuhën në të cilën mbahet procedura.

(2) Qytetarët të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, parashtrësata mund t'i parashtrojnë në gjuhën dhe shkrimin e vet. Parashtrësata e këtilla përkthehen dhe dërgohen te palët në procedurë.

(3) Personat tjerë të cilët nuk e flasin apo kuptojnë gjuhën maqedonase dhe alfabetin a saj cirilik, parashtrësata mund t'i parashtrojnë në gjuhën dhe alfabetin e vet. Në ato raste veprohet si në paragrafin (2) të këtij neni.

(4) Të akuzuarit i cili nuk e kupton gjuhën në të cilën mbahet procedura, i dërgohet përkthimi nga akuza në gjuhën me të cilën është shërbyer në procedurë.

(5) Shtetasi i huaj i privuar nga liria apo i paraburgosur, parashtrësata mund ta parashtrojë në gjuhën e vet, kurse në raste tjera me kushte të reciprocitetit.

Neni 11

Dërgimi i shkresave

(1) Thirrjet, vendimet dhe shkresata tjera dërgohen në gjuhën në të cilën mbahet procedura.

(2) Qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, thirrjet, vendimet dhe shkresata tjera do t'u dërgohen edhe në atë gjuhë.

(3) Të akuzuarit i cili është në paraburgim, në mbajtjen e dënimit apo në shërimin e obligueshëm psikiatrik dhe ruajtjen në institucionin shëndetësor, do t'i dërgohet përkthimi nga parashtrësata nga paragrafi (1) të këtij neni, në gjuhën me të cilën është shërbyer në procedurë.

(4) Të akuzuarit i cili nuk e kupton gjuhën në të cilën mbahet procedura, i dërgohet përkthimi i aktgjykimit në gjuhën me të cilën është shërbyer në procedurë.

Neni 12

Ligjshmëria e provave

(1) Ndalohet që të arrihet me detyrim nga i akuzuari apo nga personi tjetër që merr pjesë në procedurë, pranim i fajit apo ndonjë deklaratë tjetër.

(2) Provat e marra në mënyrë joligjore apo me shkeljen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ligj dhe marrëveshje ndërkombëtare, si dhe provat e dala prej tyre, nuk mund të shfrytëzohen dhe në to nuk mund të bazohet vendimi gjyqësor.

Neni 13

E drejta e dëmit dhe rehabilitimit

Personi që në mënyrë të paligjshme është i privuar nga liria, apo në mënyrë të paligjshme i dënuar, ka të drejtë kompensimi të dëmit nga mjetet buxhetore, ka të drejtë të rehabilitohet, si dhe të drejta tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 14

Këshilla për të drejtat e palës së paditur

I akuzuari apo personi tjetër që merr pjesë në procedurë, i cili nga mosdija do të mund ta lëshojë ndonjë veprim në procedurë, apo për këtë shkak të mos i shfrytëzojë të drejtat e veta, organi që e mban procedurën do ta njoftojë për të drejtat që sipas këtij ligji i takojnë dhe për pasojat nga lëshimi i veprimit.

Neni 15

Parimi i objektivitetit

Gjykata dhe organet shtetërore janë të obliguara që me vëmendje të njëjtë t'i shqyrtojnë dhe t'i përcaktojnë si faktet që e ngarkojnë të akuzuarin, poashtu edhe ato që janë në dobi të tij.

Neni 16

Parimi i vlerësimit të lirë të provave

(1) E drejta e gjykatës dhe e organeve shtetërore që marrin pjesë në procedurën penale ta vlerësojnë ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve, nuk është e lidhur as e kufizuar me rregulla të posaçme provash formale.

(2) Gjykata dhe organet tjera shtetërore, janë të obliguara që në mënyrë të qartë t'i arsyetojnë shkaqet për vendimin që e kanë miratuar.

Neni 17

Parimi i akuzës dhe autorizimit

(1) Procedura penale ngritet dhe udhëhiqet vetëm me kërkesë të paditësit të autorizuar.

(2) Për vepra për të cilat ndiqet me detyrë zyrtare apo me propozim të të dëmtuarit, paditës i autorizuar është prokurori publik, kurse për vepra për të cilat ndiqet me padi private, paditës i autorizuar është paditësi privat.

Neni 18

Parimi i ligjshmërisë së ndjekjes penale

Prokurori publik është i obliguar që të ndërmarrë ndjekje penale nëse ekzistojnë prova se është e kryer vepra penale për të cilën ndiqet me detyrë zyrtare, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 19

Fillimi i procedurës penale dhe pasojat nga fillimi i procedurës

(1) Procedura penale fillon me lëshimin e urdhrit për zbatimin e procedurës hetimore, apo me ndërmarrjen e veprimit të parë hetimor para se të lëshohet urdhri për zbatimin e procedurës hetimore, me caktimin e seancës kryesore për propozimakuzën apo padinë private, me propozim për lëshimin e urdhërndëshkimit apo me propozim për caktimin e masës së sigurisë.

(2) Kur është përcaktuar se fillimi i procedurës penale ka për pasojë kufizimin e të drejtave të caktuara, ato ndodhin me miratimi e aktakuzës.

Neni 20

Çështje paraprake

(1) Nëse zbatimi i dispozitave të Kodit penal varet nga zgjidhja paraprake e ndonjë çështjeje juridike për zgjidhjen e së cilës është kompetente gjykata në ndonjë procedurë tjetër apo ndonjë organ tjetër shtetëror, ajo çështje do të zgjidhet sipas dispozitave që vlejnë për dëshmi në procedurën penale. Zgjidhja e kësaj çështjeje juridike nga ana e gjykatës penale, ka veprim vetëm për lëndën penale që e debaton kjo gjykatë.

(2) Nëse për çështjen e atillë paraprake gjykata në ndonjë procedurë tjetër apo ndonjë organ tjetër shtetëror tanimë ka miratuar vendim, vendimi i atillë nuk e lidh gjykatën penale lidhur me vlerësimin nëse është kryer veprë e caktuar penale.

Kreu II

KUPTIMI I SHPREHJEVE LIGJORE DHE DISPOZITA TJERA

Neni 21

Kuptimi i shprehjeve

Shprehjet e veçanta të përdorura në këtë ligj, e kanë kuptimin si vijojnë:

1. **I dyshuar** është personi kundër të cilit mbahet procedurë penale;

2. **I akuzuar** është personi kundër të cilit është vërtetuar aktakuza, është parashtruar propozimakuza, është parashtruar propozim për zbatimin e masës së sigurisë, është parashtruar padia private apo është parashtruar propozim për lëshim të urdhërdënimit;

Shprehja i akuzuar, në këtë ligj përdoret edhe si emër i përgjithshëm për të dyshuarin, të akuzuarin dhe të dënuarin;

3. **I dënuar** është personi për të cilin me aktgjykim të plotfuqishëm është përcaktuar, se është penalisht përgjegjës për veprën e caktuar penale;

4. **Viktimë** e veprës penale është secili person që ka pësuar dëm, duke i përfshirë lëndimin fizik apo mental, vuajtjen emocionale, humbjen materiale apo lëndimin tjetër apo kërcënimin e të drejtave dhe interesave të tij, si pasojë e kryerjes së veprës penale;

5. **I dëmtuar**, krahas viktimës është edhe personi tjetër e drejta personale apo pronësore e të cilit, është e cenuar apo rrezikuar me veprën penale dhe i cili merr pjesë në procedurën penale me përfshirje në ndjekje penale apo për realizimin e kërkesës juridiko-pronësore;

6. **Paditës privat** është personi i cili ka parashtruar padi private për ndjekjen e veprave penale të cilat ndiqen me padi private;

7. **Paditës** është prokurori publik dhe paditësi privat;

8. **Palë** janë paditësi dhe i akuzuari;

9. **Policia e jurisprudencës** janë nëpunësit policorë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe pjesëtarët e Policisë Financiare dhe persona të autorizuar me ligj të Drejtorisë Doganore, të cilët punojnë në zbulimin e veprave penale;

10. **Shprehja polici** në këtë ligj përdoret si emër i përgjithshëm për policinë e jurisprudencës sipas këtij ligji dhe për pjesëtarët e policisë sipas Ligjit për polici si dhe pjesëtarët e Policisë Ushtarake;

11. **Gjykatës i procedurës paraprake** është gjykatësi i cili gjatë procedurës paraprake, vendos për liritë dhe të drejtat e të akuzuarit në rast të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, me ligj dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe për punë tjera të përcaktuara me këtë ligj;

12. **Marrje në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë** është marrja në pyetje e dëshmitarit apo ekspertit nga pala, përkatësisht mbrojtësit të cilin e ka propozuar dëshmitari përkatësisht eksperti, që paraqet mënyrë të paraqitjes së këtyre provave gjatë seancës kryesore;

13. **Marrje në pyetje** në mënyrë të kryqëzuar është marrja në pyetje e dëshmitarit dhe ekspertit nga pala e kundërt, që paraqet mënyrë të paraqitjes së këtyre provave gjatë seancës kryesore;

14. **Bazat e dyshimit** janë njohuritë të cilat në bazë të njohurisë dhe përvojës kriminalistike, mund të vlerësohen si provë për veprën e kryer penale;

15. **Dyshimi i bazuar** është shkallë më e lartë e dyshimit të bazuar në provat e marra të cilat shpiejnë në përfundim se personi i caktuar ka kryer vepër penale;

16. **Kontrolli i personave, automjeteve, bagazhit dhe lokaleve**, paraqet autorizim në bazë të këtij apo ligji tjetër, i kufizuar në kontrole të jashtme të veshjes dhe sendeve tjera dhe bagazhit, me ndihmën e shqisave për shikim, dëgjim dhe nuhatje, por jo edhe të veprimeve me të cilat diçka që nuk është e dukshme bëhet e dukshme me hapjen, shpaketim e ngjashëm;

17. **Bastisje** është hetim i detajuar i personit, mjetit transportues, shtëpisë, në kushte të përcaktuara me ligj;

18. **Me inçizim** nënkuptohet inçizimi vizual-i zërit apo inçizim vizual apo inçizim i zërit dhe

19. **Këshilltarë teknikë** janë personat profesionalë nga regjistri i ekspertëve, të cilët palët i angazhojnë atëherë kur gjatë procedurës u nevojitet ndihma e ekspertëve nga fusha e caktuar.

Neni 22

Ndjekja me propozim dhe me leje paraprake

(1) Kur ndjekja për veprën penale varet nga propozimi i të dëmtuarit, prokurori publik nuk mund të ngritë procedurë hetimore, as të parashtrojë propozimakuze apo propozim për lëshim të urdhërdënimit derisa i dëmtuari nuk parashtron propozim.

(2) Kur me ligj është përcaktuar se për ndjekje të veprave të veçanta penale nevojitet leje paraprake nga organi kompetent shtetëror, prokurori publik nuk mund të ngritë procedurë hetimore, as të parashtrojë propozimakuze apo propozim për lëshim të urdhërdënimit, nëse nuk parashtron dëshmi se është dhënë leje.

Neni 23

Ndërprerja e procedurës penale në rast të vdekjes

Kur gjatë procedurës penale do të konfirmohet se i akuzuari ka vdekur, procedura penale do të ndërpritet me aktvendim.

SEKSIONI B. SUBJEKTET

Kreu III KOMPETENCA E GJYKATAVE DHE PËRJASHTIMI

1. Kompetenca reale dhe përbërja e gjykatës

Neni 24 Kompetenca reale

Gjykatat në lëndët penale gjykojnë në kufijtë e kompetencës së vet reale të përcaktuar me ligj.

Neni 25 Përbërja e gjykatës

(1) Në shkallë të parë gjykatat gjykojnë në këshilla të përbëra nga dy gjykatës dhe tre gjykatës-porotë për vepra penale për të cilët me ligj është përcaktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 vitesh, apo dënim me burgim të përjetshëm, kurse në këshilla të përbëra nga një gjykatës dhe dy gjykatës-porotë për vepra penale për të cilët me ligj është përcaktuar dënim më i lehtë. Për vepra penale për të cilat si dënim kryesor është përcaktuar dënim me para apo dënim me burgim deri në pesë vite, në shkallë të parë gjykon gjykatësi individual.

(2) Në shkallë të dytë gjykatat gjykojnë në këshilla të përbëra nga pesë gjykatës për vepra penale për të cilat me ligj është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 15 vitesh apo dënim me burg të përjetshëm, kurse në këshilla të përbëra nga tre gjykatës për vepra penale për të cilat është përcaktuar dënim më i lehtë. Kur gjykon në shkallë të dytë në shqyrtim, këshilli përbëhet nga dy gjykatës dhe tre gjykatës-porotë.

(3) Në shkallë të tretë gjykatat gjykojnë në këshilla të përbërë nga pesë gjykatës.

(4) Gjykatësi i procedurës paraprake, gjykatësi, përkatësisht këshilli për vlerësim të aktakuzës, kryetari i gjykatës dhe kryetari i këshillit, vendosin në rastet e parapara në këtë ligj.

(5) Gjykatat e shkallës së parë, në këshill të përbërë nga tre gjykatës, vendosin për ankesat kundër vendimeve të gjykatësit të procedurës paraprake dhe kundër zgjidhjeve të tjera kur kjo është e përcaktuar me ligj, miratojnë vendime në shkallë të parë jashtë seancës kryesore, miratojnë aktgjykime sipas dispozitave për zbatimin e aktgjykimit të huaj penal, të përcaktuara me ligj të posaçëm dhe paraqesin propozime në rastet e parapara në këtë apo në ligj tjetër.

(6) Me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë gjykata vendos në këshill të përbërë nga pesë gjykatës, e nëse kërkesa është parashtruar kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, për kërkesën Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë vendos në mbledhje të përgjithshme.

(7) Nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, gjykatat nga shkalla më e lartë vendosin në këshill të përbërë nga tre gjykatës, në rastet që nuk janë të parapara në nenet prej (1) deri në (6) të këtij neni.

(8) Nëse në gjykatën e shkallës së parë për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjykatësve nuk mund të formohet këshilli i paraparë në paragrafin (5) të këtij neni, me kërkesë nga kryetari i asaj gjykatei, kryetari i gjykatës së drejtpërdrejtë më të lartë, do të delegojë gjykatës nga gjykata tjetër nga sfera e vet.

2. Kompetenca vendore dhe bartja e kompetencës vendore

Neni 26

Kompetenca vendore

(1) Kompetenca vendore, sipas rregullës, është gjykata në rajonin e së cilës është kryer apo tentuar vepra penale.

(2) Padia private mund të parashtrohet edhe në gjykatën në rajonin e së cilës i akuzuari ka vendbanim apo vendqëndrim.

(3) Nëse vepra penale, është kryer apo tentuar në rajonin e gjykatave të ndryshme apo në kufirin e atyre rajoneve apo është e pasigurtë se në cilin rajon është kryer apo tentuar, kompetente është ajo nga gjykatat që me kërkesë nga paditësi i autorizuar e para e ka filluar procedurën, e nëse procedura ende nuk ka filluar, gjykata në të cilën së pari herë është parashtruar kërkesa për ngritjen e procedurës.

(4) Nëse vepra penale është kryer në anijen vendase apo në mjetin vendas fluturues derisa gjendet në portin vendas, kompetent është organi në rajonin e të cilit gjendet ai port. Në raste tjera kur vepra penale është kryer në anijen vendase apo në mjetin vendas fluturues, kompetente është gjykata në rajonin e së cilës gjendet porti amë i anijes, përkatësisht i mjetit vendas fluturues, përkatësisht i mjetit fluturues apo portit vendas në të cilën anija, përkatësisht mjetin fluturues për herë të parë do të ndalet.

(5) Nëse vepra penale është kryer nëpërmjet shtypit, kompetente është gjykata në sferën e së cilës është shtypur dokumenti. Nëse ai vend nuk është i njohur ose dokumenti është shtypur jashtë vendit, kompetente është gjykata në rajonin e së cilës shpërndahet dokumenti i shtypur. Nëse në pajtim me ligjin përgjegjës është hartuesi i dokumentit, kompetente është edhe gjykata e vendit në të cilin hartuesi ka vendbanim ose gjykata e vendit ku ka ndodhur ngjarja për të cilën ka të bëjë dokumenti.

(6) Dispozitat nga paragrafi (5) të këtij neni, në mënyrë përkatëse do të zbatohen edhe në rast se dokumenti ose deklarata është publikuar nëpërmjet radios, televizionit ose internetit.

(7) Nëse nuk është i njohur vendi i kryerjes së veprës penale ose nëse ai vend ndodhet jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë, kompetente është gjykata në rajonin e së cilës i akuzuari ka vendbanim ose vendqëndrim.

(8) Nëse gjykata në rajonin e së cilës i akuzuari ka vendbanim ose vendqëndrim veç tanimë e ka filluar procedurën mbetet kompetent, edhe pse është zbuluar vendi i kryerjes së veprës penale.

(9) Nëse nuk dihet vendi i kryerjes së veprës penale, as vendbanimi ose vendqëndrimi i të akuzuarit ose të dy ndodhen jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë, kompetente është gjykata në rajonin e së cilës i akuzuari do të kapet ose vetë do të paraqitet.

(10) Nëse ndonjë person ka kryer vepër penale në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit, kompetente është gjykata e cila është kompetente për veprat penale në Republikën e Maqedonisë.

(11) Nëse sipas dispozitave të këtij ligji nuk mund të konstatohet cila gjykatë është kompetente vendore, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë do ta përcaktojë njëzën nga gjykatat kompetente reale, para së cilës do të zbatohet procedura.

Neni 27

Bartja e kompetencës vendore

(1) Nëse gjykata kompetente për shkaqe juridike ose reale është e penguar të veprojë, obligohet që ta njoftojë për të këtë, gjykatën më të lartë në mënyrë të drejtpërdrejtë e cila pas hetimeve të prokurorit publik, kur procedura udhëhiqet me kërkesë të prokurorit publik, do të përcaktojë gjykatë tjetër kompetente reale të rajonit të vet.

(2) Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e veçantë.

(3) Gjykata më e lartë e drejtpërdrejtë e përbashkët, për udhëheqjen e procedurës mund të përcaktojë gjykatë tjetër kompetente reale në rajonin e vet, nëse është evidente se kështu më lehtë do të zbatohet procedura ose nëse ekzistojnë shkaqe tjera juridike ose reale.

(4) Aktvendimin sipas paragrafit (3) të këtij neni, gjykata mund ta miratojë me propozim të gjykatësit të procedurës paraprake, gjykatësit individual os e kryetarit të këshillit, ose me propozim të prokurorit publik i cili vepron para gjykatës e cila vendos për bartjen e kompetencës vendore, kur procedura penale udhëhoqet me kërkesë të prokurorit publik.

3. Bashkimi dhe ndarja e procedurës

Neni 28

Bashkimi i procedurës

(1) Nëse personi i njëjtë është i akuzuar për më shumë vepra penale, kompetente është ajo gjykatë e cila me kërkesë të paditësit të autorizuar e para e ka filluar procedurën, e nëse procedura akoma nuk ka filluar, gjykata të e cila së pari është parashtruar kërkesa për ngritjen e procedurës.

(2) Sipas paragrafit (1) të këtij neni përcaktohet kompetenca edhe në rast se i dëmtuari njëkohësisht ka kryer vepër penale ndaj të akuzuarit.

(3) Për bashkëkryerësit sipas rregullës kompetente është gjykata e cila si kompetente për njërin pre tyre, e para e ka filluar procedurën.

(4) Gjykata që është kompetente për kryerësin e veprës penale sipas rregullës është kompetente edhe për bashkëkryerësit, fshehësit, personat të cilët i kanë ndihmuar kryerësit pas kryerjes së veprës penale, si dhe për personat të cilët nuk e kanë denoncuar përgatitjen e veprës penale dhe kryerjen e veprës penale ose kryerësin.

(5) Në të gjitha rastet nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni, sipas rregullës do të zbatohet procedurë e vetme dhe do të miratohet një aktgjykim.

(6) Gjykata mundet me propozim të prokurorit publik të vendosë që të zbatohet një procedurë e vetme dhe të miratohet një aktgjykim edhe në rastin kur janë akuzuar më shumë persona për më tepër vepra penale, por vetëm nëse ndërmjet veprave penale të kryera ekziston lidhje e ndërsjellë dhe nëse ekzistojnë prova të njëjta.

(7) Gjykata mund të vendosë që të zbatohet procedurë e vetme dhe të miratohet një aktgjykim, nëse para gjykatës së njëjtë mbahen procedura të

veçanta kundër personit të njëjtë për më shumë vepra penale dhe kundër më shumë personave për të njëjtën vepër penale.

(8) Për bashkimin e procedurave vendos gjykata e cila është kompetente për zbatimin e procedurës së vetme. Kundër aktvendimit me të cilin është përcaktuar bashkimi i procedurave ose me të cilin është refuzuar propozimi për bashkim, nuk lejohet ankesë e veçantë.

Neni 29

Ndarja e procedurës

(1) Gjkata e cila është kompetente në pajtim me nenin 28 të këtij ligji mundet që për shkaqe të rëndësishme ose për shkaqe të përputhshmërisë së plotë, ose në rast të pranimit të fajit në lidhje me një pjesë të veprave penale të përfshira në akuzë, përkatësisht pranimit të fajit nga disa nga të bashkëakuzuarit, deri në përfundimin e seancës kryesore të vendosë që procedura për vepra penale të veçanta ose kundër të akuzuarve të veçantë, të ndahet dhe në mënyrë të veçantë të përfundohet ose t'i dorëzohet gjykatës tjetër kompetente.

(2) Aktvendimin për ndarjen e procedurës e miraton gjykata kompetente pas hetimit të prokurorit publik, kur procedura penale udhëhiqet me kërkesë të tij.

(3) Kundër aktvendimit me të cilin është përcaktuar ndarja e procedurës ose me të cilin është refuzuar propozimi për ndarje të procedurës, nuk lejohet ankesë e veçantë.

4. Pasojat nga jokompetenca dhe konflikti i kompetencës

Neni 30

Jokompetenca e gjykatës

(1) Gjkata është e obliguar që të ketë kujdes për kompetencën e vet dhe menjëherë kur do të konstatojë se nuk është kompetente, do të shpallet si jokompetente dhe pas plotfuqishmërisë së aktvendimit do ta dërgojë lëndën të gjykata kompetente.

(2) Pasi që aktakuza do të hyjë në fuqi juridike, gjykata mund të shpallet si jokompetent vendor, as palët nuk mund të parashtrojnë ankesë për jokompetencë vendore.

(3) Gjkata jokompetente është e obliguar që t'i ndërmarrë ato veprime në procedurë, për të cilat ekziston rreziku nga prolongimi.

Neni 31

Konflikti i kompetencave

(1) Nëse gjykata të cilës i është kaluar lënda si kompetente konsideron se është kompetente gjykata e cila ia ka kaluar lëndën ose ndonjë gjykatë tjetër, do të ngritë procedurë për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës.

(2) Kur me rastin e ankesës kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë me të cilin është shpallur si jokompetent ka marrë vendim gjykata e shkallës së dytë, për atë vendim është i lidhur me çështjen e kompetencës edhe gjykata të cilës i është kaluar lënda, nëse gjykata e shkallës së dytë është kompetente për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës ndërmjet atyre gjykatave.

Neni 32

Procedura për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës

(1) Konfliktin e kompetencës ndërmjet gjykatave e zgjidh bashkërisht gjykata e drejtpërdrejtë më e lartë.

(2) Para se të marrë vendim në lidhje me konfliktin e kompetencës, gjykata do të kërkojë mendim nga prokurori publik i cili është kompetent që të veprojë para asaj gjykate, kur procedura penale mbahet me kërkesë të prokurorit publik. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e veçantë.

(3) Gjatë vendosjes për konfliktin e kompetencës, gjykata mundet njëkohësisht me detyrë zyrtare të marrë vendim për bartjen e kompetencës vendore, nëse janë plotësuar kushtet nga neni 27 të këtij ligji.

(4) Derisa nuk zgjidhet konflikti i kompetencës ndërmjet gjykatave, secili prej tyre është i obliguar që t'i ndërmarrë ato veprime në procedurë për të cilat ekziston rrezik nga prolongimi.

5. Përgjashtimi

Neni 33

Shkaqet e përjashtimit

(1) Gjykatësi ose gjykatësi - porot nuk guxon të ushtrojë veprimtari gjyqësore:

1) nëse është i dëmtuar me veprën penale;

2) nëse i akuzuari, mbrojtësi i tij, paditësi, i dëmtuari, përfaqësuesi i tij ligjor ose i autorizuari, është shoku i tij martesor përkatësisht jashtëmartesor, ose farefis nga gjaku në vijë të drejtë deri në cilëndo shkallë, në vijën anësore deri në shkallën e katërt, ndërsa sipas krushqisë deri në shkallën e katërt;

3) nëse me të akuzuarin, mbrojtësin e tij, paditësin ose me të dëmtuarin është në lidhje tutorësie, person nën kujdestari, mbajtës ose i mbajtur;

4) nëse në të njëjtën lëndë penale ka marrë pjesë si gjykatës i procedurës paraprake, ka marrë pjesë në hetimin e të akuzuarit para seancës kryesore, ose ka marrë pjesë në procedurë si paditës, mbrojtës, përfaqësues ligjor ose i autorizuar i të dëmtuarit, përkatësisht paditësit, ose është marrë në pyetje si dëshmitar ose si ekspert dhe

5) nëse në të njëjtën lëndë ka marrë pjesë në miratimin e vendimit të gjykatës më të ulët, ose nëse në të njëjtën gjykatë pa marrë pjesë në miratimin e vendimit i cili refuzohet me ankesë.

(2) Gjykatësi ose gjykatësi - porot mund të përjashtohet nga ushtrimi i veprimtarisë së gjykatësit, krahas rasteve të theksuara në paragrafin (1) të këtij neni, nëse ekzistojnë rrethana të cilat shkaktojnë dyshime në paanshmërinë e tij.

Neni 34

Procedura për përjashtim

Gjykatësi ose gjykatësi-porotë, menjëherë kur do të njoftohet se ekziston ndonjë nga shkaqet për përjashtim nga neni 33 paragrafi (1) të këtij ligji, është i obliguar që ta ndërpresë çdo punë për atë lëndë dhe për këtë ta njoftojë kryetarin e gjykatës, i cili do t'i përcaktojë zëvendësim. Nëse bëhet fjalë për përjashtimin e kryetarit të gjykatës, ai vetë do ta përcaktojë zëvendësin nga radhët e gjykatësve të asaj gjykate, e nëse kjo nuk është e

mundur do të kërkojë nga kryetari i gjykatës më të lartë të drejtpërdrejtë të përcaktojë zëvendësim.

Neni 35

Përjashtimi me kërkesë të palëve

- (1) Përjashtim mund të kërkojnë edhe palët.
- (2) Palët mund të parashtrojnë kërkesë për përjashtim deri në fillimin e seancës kryesore, e nëse për shkakun e përjashtimit nga neni 33 paragrafi (1) të këtij ligji kanë marrë vesh më vonë, kërkesën e parashtrojnë menjëherë pas njoftimit.
- (3) Kërkesën për përjashtim të gjykatësit të gjykatës më të lartë, pala mund ta paraqesë në ankesë ose në përgjigjen e ankesës.
- (4) Pala mund të kërkojë përjashtimin e gjykatësit të emëruar vetëm emër për emër ose gjykatësit - porotë i cili vepron me lëndën, përkatësisht gjykatësit të gjykatës më të lartë.
- (5) Për kryetarin e gjykatës nuk mund të parashtrohet kërkesë për përjashtim, përveç kur ai vepron si gjykatës, ndërsa për përjashtimin e tij vendos kryetari i gjykatës më të lartë të drejtpërdrejtë.
- (6) Pala është e obliguar që në kërkesën t'i theksojë rrethanat për të cilat konsideron se ekziston ndonjë nga bazat ligjore për përjashtim.
- (7) Nuk lejohet kërkesa për përjashtim nëse bazohet në të njëjtat shkaqe, përkatësisht rrethana për të cilat tanimë është vendosur. Kundër aktvendimit me të cilin kërkesa për përjashtim është refuzuar nuk lejohet ankesë e veçantë.

Neni 36

Vendimmarrja për kërkesën për përjashtim

- (1) Për kërkesën për përjashtim nga neni 35 të këtij ligji vendos kryetari i gjykatës.
- (2) Nëse kërkohet përjashtim vetëm i kryetarit të gjykatës, ose i kryetarit të gjykatës dhe gjykatësit ose gjykatësit-porotë, vendimin për përjashtim e miraton kryetari i gjykatës më të lartë të drejtpërdrejtë, e nëse kërkohet përjashtimi i kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, vendimin për përjashtim e miraton mbledhja e përgjithshme e asaj gjykate.
- (3) Nëse është parashtruar kërkesë për përjashtim në pajtim me nenin 33 paragrafi (1) të këtij ligji, procedura ndërpritet, ndërsa për kërkesën për përjashtim vendos kryetari i gjykatës menjëherë, e më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.
- (4) Nëse është parashtruar kërkesë për përjashtim sipas nenit 33 paragrafi (2) të këtij ligji, procedura nuk ndërpritet, ndërsa aktvendim për kërkesën për përjashtim miraton kryetari i gjykatës menjëherë, e më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.
- (5) Para se të merret vendim për përjashtim do të merret deklaratë nga gjykatësi, nga gjykatësi - porotë, përkatësisht nga kryetari i gjykatës e sipas nevojës do të zbatohen edhe veprime tjera.
- (6) Nëse kryetari i gjykatës përjashton gjykatës, do të përcaktojë që për lëndën të veprojë gjykatësi i radhës sipas orarit të brendshëm të punës.
- (7) Kundër aktvendimit me të cilin miratohet kërkesa për përjashtim, nuk lejohet ankesë e veçantë. Aktvendimi me të cilin refuzohet kërkesa për

përrjashtim mund të kundërshtohet me ankesë të veçantë në afat prej tri ditësh nga dita e miratimit të aktvendimit, e nëse aktvendimi i këtillë është miratuar me akuzë të vërtetuar, atëherë vetëm me ankesë për aktgjykimin.

(8) Nëse kërkesa për përrjashtim në pajtim me nenin 33 paragrafi (2) të këtij ligji është parashtruar në fillim të seancës kryesore, seanca kryesore nuk do të ndërpritet. Kryetari i gjykatës lidhur për kërkesën do të vendosë menjëherë, e më së voni tri ditë nga dita e parashtrimit të kërkesës për përrjashtim. Nëse merret vendim për lëndën para se kryetari të vendosë për kërkesën për përrjashtim, pala mundet shkaqet dhe provat për përrjashtim t'i parashtrojë në ankesën e vendimit.

(9) Kundër aktvendimit nga paragrafi (8) të këtij neni, nuk lejohet ankesë e veçantë.

Neni 37

Vlefshmëria e veprimeve të ndërrmarra për kërkesën për përrjashtim

Kur gjykatësi ose gjykatësi-porot njoftohet se është parashtruar kërkesë për përrjashtimin e tij, është i obliguar që menjëherë ta ndërpresë punën e tij me lëndën, e nëse bëhet fjalë për përrjashtim nga neni 33 paragrafi (2) të këtij ligji, deri në miratimin e aktvendimit për kërkesën mund t'i ndërrmarrë vetëm ato veprime për të cilat ekziston rreziku i prolongimit.

Neni 38

Përrjashtimi i prokurorëve publikë dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë

(1) Dispozitat për përrjashtim të gjykatësve dhe gjykatësve - porotë në mënyrë përkatëse do të zbatohen edhe për prokurorët publikë, përveç në rastet kur ekziston baza nga neni 33 paragrafi (1) pikat 4 dhe 5 të këtij ligji.

(2) Dispozitat për përrjashtim të gjykatësve dhe gjykatësve - porotë në mënyrë përkatëse do të zbatohen edhe për mbajtësit e procesverbalit, përrkthyesit, përrkatësisht interpretuesit dhe personat profesionalë, si dhe për ekspertët, nëse për ata nuk është përrcaktuar diçka tjetër (neni 238 i këtij ligji).

(3) Prokurori publik i prokurorisë publike vendos për përrjashtimin e prokurorëve publikë në prokurorinë publike. Për përrjashtimin e prokurorit publik në prokurorinë publike, vendos prokurori publik i prokurorisë publike drejtpërrdrejt më të lartë.

(4) Për përrjashtimin e mbajtësve të procesverbaleve, përrkthyesve, përrkatësisht interpretuesve dhe ekspertëve, vendos organi i cili e udhëheq procedurën.

Kreu IV

PROKURORI PUBLIK DHE POLICIA E JURISPRUDENCËS

1. Prokurori publik

Neni 39

Të drejtat dhe obligimet e prokurorit publik

(1) E drejta dhe obligimi themelor i prokurorit publik është që t'i ndjekë kryerësit e veprave penale për të cilët ndjekja ndërmerret me detyrë zyrtare.

(2) Në lëndët e veprave penale për të cilat ndjekja ndërmerret me detyrë zyrtare, prokurori publik ka të drejtë dhe obligim:

- t'i drejtojë veprimet e organeve kompetente për zbulimin dhe paraqitjen e veprave penale dhe kryerësve të tyre,
 - të propozojë ose japë urdhër për ndërmarrjen e masave të veçanta hetimore, nën kushte dhe mënyrë të përcaktuara me këtë ligj,
 - të japë urdhra dhe të zbatojë procedurë hetimore,
 - të gjejë, propozojë dhe të sigurojë prova, nën kushte dhe mënyrë të përcaktuara me këtë ligj,
 - të propozojë masa të përkohshme për sigurimin e pronës ose sendeve të marra me veprën penale ose për zbatimin e masës së konfiskimit;
 - të vendosë për prolongimin e ndjekjes penale nën kushtet dhe mënyrat e përcaktuara me këtë ligj,
 - të propozojë lëshimin e urdhëndëshkimit nën kushtet të përcaktuara me këtë ligj,
 - të negociojë dhe të merret vesh me të akuzuarin për pranimin e fajit, në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me këtë ligj,
 - të parashtrijë dhe përfaqësojë aktakuza para gjykatës kompetente;
 - të parashtrijë ankesa kundër vendimeve gjyqësore jo të plotfuqishme dhe mjete juridike të jashtëzakonshme kundër vendimeve gjyqësore të plotfuqishme,
 - të vendosë për ankesën e të dëmtuarit dhe
 - të ndërmarrë edhe veprime tjera të përcaktuara me ligj.
- (3) Prokurori publik ngrit procedura të veçanta dhe merr pjesë në to kur kjo është përcaktuar me ligj të posaçëm.

Neni 40

Kompetenca e prokurorit publik

- (1) Kompetenca reale e prokurorit publik është përcaktuar në pajtim me dispozitat të cilat vlejné për kompetencën e gjykatës për rajonin për të cilin është zgjedhur prokurori publik dhe me Ligjin për prokurori publike.
- (2) Kompetenca vendore e prokurorit publik përcaktohet në pajtim me dispozitat të cilat vlejné për kompetencën e gjykatës për rajonin në të cilën është zgjedhur prokurori publik.
- (3) Konfliktin e kompetencës ndërmjet prokurorëve publikë e zgjidh në prokurori publik drejtpërdrejt më i lartë.
- (4) Kur ekziston rreziku i prolongimit, veprimet në procedurë do t'i ndërmarrë edhe prokuror publik jokompetent, por për këtë doemos duhet menjëherë ta lajmërojë prokurorin publik kompetent.

Neni 41

Roli udhëheqës i prokurorit publik në procedurën parahetimore

- (1) Për shkak realizimin e funksionit të ndjekjes penale, prokurori publik udhëheq me procedurën parahetimore dhe e ka në disponim policinë gjyqësore.
- (2) Prokurori publik mundet vet ta ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm për zbulimin e veprës penale dhe zbulimin dhe ndjekjen e kryerësit të saj për të cilën me ligj është e autorizuar Ministria e Punëve të Brendshme, Policia Financiare dhe Drejtoria Doganore.

Neni 42

Heqja dorë e prokurorit publik nga ndjekja penale

Prokurori publik në raste të përcaktuara me ligj mund të heq dorë nga ndjekja penale deri në përfundim të procedurës penale.

Neni 43

Prolongimi i kushtëzuar i ndjekjes penale

(1) Prokurori publik në pajtim me të dëmtuarin mundet me aktvendim ta prolongojë ndjekjen penale për veprën penale për të cilën është përcaktuar dënim me burgim deri në tre vjet, nëse i dyshuari është i gatshëm që të sillet në pajtim me udhëzimet e prokurorit publik dhe t'i plotësojë obligimet e përcaktuara me të cilat zvogëlohen ose mënjanojnë pasojat e dëmshme të veprës penale, i vihet fund shqetësimit që është rezultat i veprës penale, përkatësisht ndikohet me qëllim që të riintegrohet i dyshuari. Obligime të këtilla mund të jenë:

1) mënjanimi ose kompensimi i dëmit;
2) kthimi i sendeve të konfiskuara;
3) pagimi i kontributit me para në dobi të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, ose institucionit i cili kryen autorizime publike ose për qëllime humanitare;

4) plotësimi i obligimeve në lidhje me mbajtjen;
5) nënshtrimi në trajtim për heqjen e varshmërive;
6) nënshtrimi i terapisë psiko-sociale për heqjen e sjelljes së dhunshme;

7) ndalimi për vizitë ose kontakt me viktimat e veprës penale si dhe me persona të tretë të përcaktuar nga ana e prokurorit publik, në periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj;

8) përcaktimi i punës me dobi të përgjithshme në kohëzgjatje prej 40 - 120 orë ose

9) kur janë plotësuar kushtet për lirim për shkak të kompensimit të dëmit të përcaktuara me Kodin penal.

(2) Në lidhje me obligimet nga paragrafi (1) pikat: 1, 2, 3, 4, 7, 8 dhe 9 të këtij neni, nëse i dyshuari në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj e plotëson detyrimin, përkatësisht i është përmbajtur ndalimit, prokurori publik do të marrë vendim me të cilin nuk ndërmerret ndjekje penale kundër të dyshuarit të veprës penale nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Në lidhje me obligimet nga paragrafi (1) pikat 5 dhe 6 të këtij neni, kohëzgjatjen e prolongimit të kushtëzuar prokurori publik e përcakton në konsultim me institucionin e specializuar për mjekimin e varësive, përkatësisht me qendër kompetente për punë sociale. Kohëzgjatja e prolongimit të kushtëzuar nuk mund të jetë më e gjatë se një vit.

(4) Nëse kryerësi i ka filluar por nuk i ka përfunduar detyrat e imponuara në afatin e përcaktuar, prokurori publik parashtron propozim për ngritjen e procedurës së shkurtuar, me ç'rast merret parasysh pjesa e detyrave të realizuara.

Neni 44

Mosndërmarrja e ndjekjes penale

Prokurori publik nuk është i obliguar që të ndërmerret ndjekje penale, përkatësisht mund të heq dorë nga ndjekja:

1) nëse në Kodin penal është përcaktuar se gjykata kryerësin e veprës penale mund ta lirojë nga dënimi dhe nëse prokurori publik duke pasur parasysh rrethanat konkrete të rastit, do të vlerësojë se vet aktgjykimi pa sanksion penal nuk është i nevojshëm;

2) nëse në Kodin penal për veprë penale është përcaktuar dënim me para ose dënim burg deri në tre vjet, ndërsa i dyshuari për shkak të pendimit të vërtetë e ka penguar shkaktimin e pasojave të dëmshme ose e ka kompensuar të gjithë dëmin, edhe nëse prokurori publik duke pasur parasysh rrethanat konkrete të rastit do të vlerësojë se sanksioni penal nuk është i bazuar ose

3) nëse i dyshuari si anëtar i grupit të organizuar, bandës ose ndonjë bashkimi tjetër kriminal vullnetarisht bashkëpunon para ose pas zbulimit, ose gjatë procedurës penale dhe nëse bashkëpunimi i atillë dhe deklarata e atij personi është me rëndësi esenciale për procedurën penale.

Neni 45

Qendrat hetimore të Prokurorisë Publike

(1) Për nevojat e procedurës penale, për rajonin e një ose më tepër prokurorive publike formohen qendra hetimore të prokurorisë publike.

(2) Qendrat hetimore nga paragrafi (1) të këtij neni, formohen me vendim të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë.

(3) Numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të policisë së jurisprudence në qendrat hetimore të prokurorisë publike përcaktohet me vendim të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë, me mendim paraprak të marrë nga ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave.

(4) Punët në qendrën hetimore i kryejnë të punësuarit nga njësitë organizative nga neni 48 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji, të cilët zgjidhen për kryerjen e punëve në kohë të caktuar, me anë të konkursit të shpallur të brendshëm, si dhe personat e punësuar në prokurorinë publike në pajtim me Ligjin për prokurori publike.

(5) Personat nga paragrafi (4) të këtij neni mund të marrin pjesë në ndërmarrjen e veprimeve hetimore, në mënyrë që do ta përgatisin realizimin e tyre, të marrin deklarata dhe propozime, si dhe mëvetësisht të ndërmarrin veprime hetimore të caktuara, të ngarkuara nga ana e prokurorit publik. Procesverbalin për veprimin e këtillë e miraton prokurori publik në afat prej 48 orësh nga ndërmarrja e veprimit.

(6) Punëtorët të cilët janë zgjedhur që të punojnë në qendrën hetimore i janë në dispozicion prokurorit publik, punojnë nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e tij, i respektojnë dhe i zbatojnë urdhrat e tij, punojnë në pajtim me udhëzimet dhe drejtimet e tij dhe për punën i përgjigjen prokurorit publik.

(7) Për kohën derisa punëtorët janë zgjedhur që të punojnë në qendrën hetimore, nuk mund të sistemohen në vend tjetër të punës në organet shtetërore prej nga vijnë ose të largohen me punë nga rasti i lëndës, pa miratim të prerë të prokurorit publik.

2. Policia e jurisprudencës

Neni 46

Detyrat e policisë së jurisprudencës

(1) Policia e jurisprudencës me detyrë zyrtare ose me urdhër të prokurorit publik ndërmerr masa dhe aktivitete me qëllim të zbulimit dhe hetimit kriminalistik të veprave penale, parandalimit të pasojave të mëtutjeshme të veprave penale, kapjes dhe denoncimit të kryerësve të tyre, sigurimit të provave dhe masave dhe aktiviteteve tjera të cilat mund të shfrytëzohen për realizimin e papenguar të procedurës penale.

(2) Policia e jurisprudencës zbaton hetim dhe veprime të urdhëruara ose të ngarkuara nga gjykata dhe prokuroria publike.

(3) Detyrat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, i kryejnë eprorët dhe nëpunësit e policisë së jurisprudencës.

Neni 47

Autorizimet e Drejtorisë së Policisë Financiare dhe Drejtorisë Doganore

(1) Autorizimet të cilat me këtë ligj u janë dhënë policisë së jurisprudencës, Drejtoria e Policisë Financiare i kanë në rastet kur bëhet fjalë për zbulimin dhe hetimin e veprave penale: larje parash dhe të hyrash tjera nga vepra penale nga neni 273, tregti e palejuar nga neni 277, kontrabandë nga neni 278, fshehje e tatimit nga neni 279, të gjitha nga Kodi penal, si dhe vepra tjera penale me dobi joligjore pronësore me vlerë të konsiderueshme.

(2) Autorizimet të cilat me këtë ligj u janë dhënë policisë së jurisprudencës, Drejtoria e Policisë Financiare i ka në rastet kur bëhet fjalë për zbulimin dhe hetimin e veprave penale: prodhim dhe lëshim në qarkullim të mjeteve të dëmshme për mjekim nga neni 212, prodhim dhe lëshim në qarkullim të produkteve ushqimore dhe produkteve tjera të dëmshme nga neni 213, prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në treg i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekurzorëve nga neni 215, furnizim dhe disponim i palejuar me materie nukleare nga neni 231, futje e materieve të rrezikshme në vend nga neni 232, nxjerrje, përkatësisht eksportim në vende të huaja, të të mirave të cilat janë nën mbrojtje të përkohshme ose trashëgimi kulturore ose rariteteve natyrore nga neni 266, larje parash dhe të hyrash tjera nga vepra penale nga neni 273, kontrabandë nga neni 278, mashtrim doganor nga neni 278-a, fshehje e mallit lëndë e kontrabandës dhe mashtrimit doganor nga neni 278-b, fshehje tatimi nga neni 279, mbajtje pa leje e armëve dhe materieve shpërthyes nga neni 396, tregti me njerëz nga neni 481-a, të gjitha nga Kodi penal; vepra penale nga Ligji për akciza dhe vepra tjera penale të lidhura me importin, eksportin dhe transitimin e mallrave nëpërmjet vijës kufitare.

Neni 48

Përbërja e policisë së jurisprudencës

Detyrat e policisë së jurisprudencës sipas këtij ligji i kryejnë:

1) nëpunësit policorë në njësitë organizative në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Drejtorinë e Policisë Financiare dhe Drejtorinë Doganore të cilët në pajtim me fushëveprimin e punës së përcaktuar me ligj, ndërmarrin masa dhe aktivitete për zbulimin e veprave penale, kapjen dhe paraqitjen e

kryerësve të veprave penale, sigurimin e provave nga vepra penale dhe masa tjera me të cilat mundësohet realizimi i papenguar i procedurës penale;

2) pjesëtarët e policisë së jurisprudence në qendrat hetimore të prokurorisë publike dhe

3) nëpunësit të ndarë prokurorit publik në pajtim me nenin 50 të këtij ligji.

Neni 49

Eprorët dhe nëpunësit e policisë së jurisprudence

(1) Eprorë të policisë së jurisprudence janë udhëheqësit e njësive organizative nga neni 48 paragrafi (1) pika 1 të këtij ligji, të cilët janë në lidhje të drejtpërdrejtë me prokurorin publik.

(2) Nëpunës të policisë së jurisprudence janë nëpunësit policorë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pjesëtarët e Drejtorisë së Policisë Financiare dhe personat e autorizuar me ligj të Drejtorisë Doganore, nga njësiti organizative të cekura në nenin 48 pikat 1 dhe 3 të këtij ligji, si dhe pjesëtarët e policisë së jurisprudence në qendrat hetimore të prokurorisë publike nga neni 48 pika 2 të këtij ligji.

Neni 50

Nëpunësit e ndarë për prokurorin publik sipas nevojës

(1) Sipas nevojës, për zbatimin efikas të procedurës penale të prokurorit publik me urdhër të tij, do t'i ndahen për punë nëpunës nga neni 48 pika 1 të këtij ligji.

(2) Nëpunësit e ndarë për prokurorin publik i janë në dispozicion vetëm prokurorit publik, punojnë nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e tij, i respektojnë dhe realizojnë urdhrat e tij, punojnë në pajtim me sugjerimet dhe udhëzimet e tij dhe për punën e vet i përgjigjen vetëm prokurorit publik.

(3) Për kohën derisa punëtorët janë ndarë të punojnë në qendrën hetimore nuk mund të sistemohen në vend tjetër të punës në organet shtetërore prej nga vijnë ose të përjashtohen të punojnë me rastin lëndor, pa miratim të prerë nga prokurori publik.

Neni 51

Disponimi funksional me policinë e jurisprudence

(1) Policia e jurisprudence punon me urdhër të prokurorëve publikë kompetentë.

(2) Për veprimin e vet në pajtim me dispozitat e këtij ligji, policia e jurisprudence përgjigjet para prokurorit publik kompetent.

(3) Eprorët dhe nëpunësit e policisë së jurisprudence janë të obliguar që t'i kryejnë detyrat të cilat u janë ndarë. Pjesëtarët e policisë së jurisprudence nuk mund të largohen nga detyra e cila u është ngarkuar në kuadër të hetimeve për veprën penale, përveç me vendim të prokurorit publik kompetent.

Neni 52

Përgjegjësia disiplinore e policisë së jurisprudence

(1) Për përgjegjësinë disiplinore të pjesëtarëve të policisë së jurisprudence lidhur me realizimin e funksionit në pajtim me këtë ligj, prokurori publik kompetent mund të parashtrojë iniciativë për ngritjen e

procedurës disiplinore te organi kompetent ku janë të punësuar pjesëtarët e policisë së jurisprudencës, në pajtim me ligjin.

(2) Për rezultatet e iniciativës së parashtruar sipas paragrafit (1) të këtij neni, organi është i obliguar që pa prolongim ta njoftojë parashtruesin e propozimit.

(3) Nëse në organin përkatës nuk është ngritur procedurë disiplinore ose nëse prokurori publik nuk është i kënaqur me rezultatin nga procedura disiplinore ose me mënyrën në të cilën është zbatuar, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë do ta njoftojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

Kreu V VIKTIMA, I DËMTUARI DHE AKUZUESI PRIVAT

1. Viktima

Neni 53

Të drejtat e viktimës

(1) Viktima e veprës penale i ka të drejtat në vijim:

1) të marrë pjesë në procedurë penale si i dëmtuar me përfshirje në ndjekje penale ose për mënjanimin e kërkesës për dëmin juridiko-pronësor;

2) në kujdes dhe vëmendje të veçantë nga ana e organeve dhe subjekteve të cilët marrin pjesë në procedurën penale dhe

3) ndihmë efikase psikologjike dhe ndihmë tjetër profesionale dhe mbështetje nga ana e organeve, institucioneve dhe organizatave për ndihmë viktimave për vepra penale.

(2) Policia, prokurori publik dhe gjykata veprojnë me kujdes të veçantë ndaj viktimave të veprave penale, duke u dhënë këshilla nga paragrafi (1) të këtij neni dhe nenet 54 dhe 55 të këtij ligji dhe kujdeset për interesat e tyre gjatë miratimit të vendimeve për ndjekje penale kundër të akuzuarit, përkatësisht gjatë marrjes së veprimeve në procedurën penale në të cilën viktima doemos duhet personalisht të marrë pjesë, për çfarë hartohet një shënim zyrtar ose procesverbal.

(3) Në pajtim me rregullat e veçanta, viktima e veprës penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg prej së paku katër vitesh ka të drejtë për:

1) këshilltar në llogari të mjeteve buxhetore para dhënies së dëshmisë, përkatësisht deklaratës ose parashtrimin të kërkesës për të drejtën juridikopronësore, nëse ka lëndime të rënda psikofizike ose pasoja më të rënda nga vepra penale dhe

2) kompensim të dëmit material dhe jomaterial nga fondi shtetëror në kushte dhe mënyrë të përcaktuar me ligj të veçantë, nëse kompensimi i dëmit nuk mund të sigurohet nga i dënuari.

Neni 54

Të drejtat e veçanta për kategoritë e cenuara të viktimave

(1) Viktimat e kanë të drejtën e masave të veçanta në mbrojtjen procesore gjatë dhënies së dëshmisë dhe hetimit në të gjitha fazat e procedurës:

1) nëse në kohën e dhënies së dëshmisë janë në moshë nën 18 vjet;

2) nëse me dhënien e dëshmisë ose përgjigjes në pyetje të caktuar, do ta ekspozojë vetveten ose personin e afërt në rrezik për jetën, shëndetin ose integritetin fizik (viktima të rrezikuara) dhe

3) nëse për shkak të moshës, natyrës dhe pasojave të veprës penale, invaliditetit fizik ose psikik ose gjendjes tjetër shëndetësore me rëndësi, të kaluarës shoqërore dhe kulturore, rrethanave familjare, bindjeve fetare dhe përkatësisë etnike të viktimës, sjellja e të akuzuarit, anëtarëve të familjes ose miqve të të akuzuarit ndaj viktimës, do të ketë pasoja të dëmshme për shëndetin e tyre psikik ose fizik ose negativisht do të ndikojë mbi cilësinë e dëshmisë së dhënë (viktima veçanërisht të ndjeshme).

(2) Masat e posaçme të mbrojtjes së procesit i përcakton gjykata me propozim të prokurorit publik ose viktimës ose me vlerësimin e vet kur është e nevojshme të mbrohen viktimat e rrezikuara dhe viktimat veçanërisht të ndjeshme.

(3) Gjatë vendosjes për përcaktimin e masave të posaçme për mbrojtje të procesit nga paragrafi (2) të këtij neni, gjykata duhet ta marrë parasysh vullnetin e viktimës.

(4) Gjkata doemos duhet të përcaktojë masë të posaçme për mbrojtje të procesit në rastet nga paragrafi (1) pika 1 të këtij neni, si vijonë:

1) kur fëmija viktimë ka nevojë për përkujdesje dhe mbrojtje të veçantë ose

2) kur fëmija është viktimë e tregtisë me njerëz, dhunës ose abuzimit seksual.

(5) Në rastet nga paragrafi (4) të këtij neni, gjykata doemos duhet të përcaktojë, veç e veç ose së bashku me masë tjetër të posaçme, video incizim ose të zërit për dëshminë dhe hetimin e fëmijës që të përdoret si provë në procedurë. Në raste ekskluzive, për shkak të rrethanave të reja të rastiit, gjykata mund të urdhërojë që hetimi të përsëritur të fëmijës viktimë, më së shumti edhe një herë nëpërmjet shfrytëzimit të mjeteve teknike për komunikim.

(6) Zbatimi i masave të posaçme për mbrojtjen e procesit të fëmijëve viktimat, është rregulluar me ligj të posaçëm.

Neni 55

Të drejtat e veçanta të viktimave të veprës penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare

(1) Viktima e veprës penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare, përpos të drejtave nga neni 53 të këtij ligji, i ka edhe këto të drejta:

1) para hetimit të bisedojë me këshilltar pa pagesë ose me person të autorizuar, nëse në procedurë merr pjesë si i dëmtuar;

2) të merret në pyetje nga personi i të njëjtës gjini në polici dhe në prokurorinë publike;

3) të mos përgjigjet në pyetjet të cilat kanë të bëjnë me jetën personale të viktimës, ndërsa nuk janë të lidhura me veprën penale

4) të kërkojë marrjen në pyetje me ndihmën e mjeteve vizuale - të zërit në mënyrën të përcaktuar me ligj dhe

5) të kërkojë mënjanimin e publikut nga seanca kryesore.

(2) Gjkata, prokuroria publike dhe policia janë të obliguara që ta këshillojnë viktimën për të drejtat e saj nga paragrafi (1) të këtij neni, më së

voni para marrjes në pyetje për herë të parë për çfarë hartojnë shënim zyrtar ose procesverbal.

Neni 56

Viktima e cila nuk është njoftuar për të drejtën e saj që në procedurë të marrë pjesë si e dëmtuar

(1) Viktima e cila nuk është e njoftuar për të drejtën e saj që të marrë pjesë në procedurën si e dëmtuar, ka të drejtë të paraqitet në polici ose prokurori publike si e dëmtuar deri në parashtrimin e aktakuzës, ndërsa para gjykatës deri në përfundim të seancës kryesore.

(2) Fletëparaqitja e viktimës si e dëmtuar do të refuzohet nëse është e evidente se nuk është e arsyeshme ose se është parashtruar me vonesë.

2. I dëmtuari dhe paditësi privat

Neni 57

Të drejtat e të dëmtuarit

Në procedurën penale i dëmtuari i ka të drejtat në vijim:

- 1) të njoftohet me të drejtat e tij;
- 2) ta përdorë gjuhën e tij dhe alfabetin dhe të drejtën e ndihmës së përkthyesit, përkatësisht interpretuesit nëse nuk e kupton gjuhën në të cilën realizohet procedura;
- 3) të propozojë realizimin e kërkesës juridiko - pronësore;
- 4) të ketë person të autorizuar;
- 5) të tregojë fakte dhe të propozojë prova;
- 6) të marrë pjesë në seancën e provave;
- 7) të marrë pjesë në seancën kryesore dhe në procedurën e dëshmimit, si dhe të deklarohet për kërkesën juridiko - pronësore edhe për ngjarjen juridiko - penale;
- 8) pas përfundimit të procedurës hetimore t'i shqyrtojë dokumentet dhe lëndët të cilat shërbejnë si prova;
- 9) të parashtrijë ankesë me kushtet e parapara me këtë ligj;
- 10) të parashtrijë propozim për ndjekje dhe aktpadi private në pajtim me dispozitat e Kodit penal;
- 11) të njoftohet për mosmarrjen ose për çdo heqje dore nga ndjekja penale nga ana e prokurorit publik;
- 12) të parashtrijë ankesë deri te prokurori publik më i lartë kundër vendimit të prokurorit publik me të cilin ai ka hequr dorë nga ndjekja penale, nën kushtet e parapara me këtë ligj;
- 13) të kërkojë kthimin në gjendjen e mëparshme;
- 14) t'i respektohet e drejta e privatësisë dhe
- 15) të marrë pjesë në procedurën e ndërmjetësimit, në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 58

Parashtrimi i propozimit dhe aktakuzës private

(1) Për veprat penale për të cilat ndiqet me propozim ose me aktakuzë private, propozimi ose aktakuza parashtrohen në afat prej tre muajsh nga dita kur personi i autorizuar për parashtrimin e propozimit ose aktakuzës private, është njoftuar për veprën penale dhe për kryerësin.

(2) Nëse është parashtruar aktakuzë private për vepër penale ofendim, i akuzuari deri në përfundim të seancës kryesore dhe pas skadimit të afatit nga paragrafi (1) të këtij neni, mund të parashtrorë aktakuzë kundër akuzuesit i cili njëkohësisht ja ka kthyer ofendimin (kundëraktadinë). Në rast të këtillë gjykata miraton një aktgjykim.

(3) Propozim për ndjekje parashtrorhet te prokurori publik kompetent, ndërsa aktpadia private te gjykata kompetente.

(4) Nëse vet i dëmtuari parashtron kallëzim penal ose paraqet propozim për realizimin e kërkesës juridiko - pronësore në procedurën penale, do të konsiderohet se me këtë ka paraqitur propozim për ndjekje.

(5) Kur i dëmtuari ka parashtruar kallëzim penal ose propozim për ndjekje, ndërsa gjatë procedurës do të konstatohet se bëhet fjalë për vepër penale për të cilën ndiqet me aktakuzë private, kallëzimi, përkatësisht propozimi do të konsiderohet si aktpadi penale private e parashtruar me kohë, nëse është parashtruar në afatin e paraparë për aktakuzë private. Aktpadia private e parashtruar me kohë do të konsiderohet si propozim i parashtruar me kohë i të dëmtuarit, nëse gjatë procedurës konstatohet se bëhet fjalë për vepër penale për të cilën ndiqet me propozim.

Neni 59

Propozimi për ndjekje penale ose aktakuzë private të parashtruar në emër të personit të mitur

(1) Për persona të mitur dhe persona të cilët janë të privuar tërësisht nga aftësia punuese, propozim për ndjekje penale ose padi private parashtron përfaqësuesi ligjor i tyre.

(2) Personi i mitur i cili i ka mbushur 18 vjet mundet edhe vet të parashtrorë propozim ose aktakuzë private.

Neni 60

Ngritja dhe vazhdimi i procedurës pas vdekjes së viktimës

Nëse viktima e veprës penale vdes gjatë afatit për parashtrimin e propozimit ose aktakuzës private ose gjatë procedurës, bashkëshorti i tij martesor, përkatësisht jashtëmartesor, fëmijët, prindërit, të adoptuarit, adoptuesit, vëllezërit dhe motrat munden në afat prej tre muajsh pas vdekjes së tij të parashtrorë propozim ose aktakuzë, përkatësisht të japin deklaratë se e vazhdojnë procedurën.

Neni 61

Më shumë persona të dëmtuar

Nëse me veprën penale dëmtohen më shumë persona, ndjekja do të ndërmerret, përkatësisht do të propozohet me propozim ose aktakuzë private prej secilit nga të dëmtuarit.

Neni 62

Heqje dorë nga propozimi përkatësisht aktpadia private

(1) I dëmtuari dhe paditësi privat munden me deklaratën e tyre në gjykatën para së cilës mbahet procedura, të heqin dorë nga propozimi, përkatësisht aktakuza private deri në përfundimin e seancës kryesore. Në atë rast ata e humbin të drejtën që mpërsëri të parashtrorë propozim, përkatësisht aktpadi private.

(2) Nëse i dëmtuari heq dorë nga propozimi, përkatësisht aktpadia private deri në fillim të seancës kryesore, gjykata merr aktvendim për ndërprerjen e procedurës, ndërsa nëse heq dorë nga fillimi deri në përfundim të seancës kryesore, gjykata merr vendim aktgjykim refuzimi (neni 402 paragrafi (3)).

Neni 63

Mosardhja e akuzuesit privat në seancën kryesore

(1) Nëse akuzuesi privat nuk vjen në seancën kryesore edhe pse në mënyrë të rregullt është ftuar, ose ftesa nuk ka mundur t'i dorëzohet për shkak të mosparaqitjes në gjykatë të ndryshimit të adresës së vendbanimit përkatësisht vendqëndrimit, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga padia.

(2) Kryetari i këshillit ose gjykatësi individual do t'i lejojë kthim në gjendjen e mëparshme akuzuesit privat i cili për shkaqe të arsyeshme nuk ka pasur mundësi të vijë në seancën kryesore, ose me kohë ta njoftojë gjykatën për ndryshimin e adresës së vendbanimit përkatësisht vendqëndrimit, nëse në afat prej tetë ditësh pas evitimit të pengesës parashtron lutje për kthimin në gjendjen e mëparshme.

(3) Pas skadimit të tre muajve nga dita e lëshimit nuk mund të kërkohej kthimi në gjendjen e mëparshme.

(4) Kundër aktvendimit me të cilin lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme, nuk lejohet ankesë e veçantë.

Neni 64

E drejta për të propozuar prova, shikimi i dokumenteve dhe të drejta tjera

(1) I dëmtuari dhe paditësi privat kanë të drejtë gjatë procedurës t'i tregojnë të gjitha faktet dhe të propozojnë prova të cilat janë me rëndësi për përcaktimin e përgjegjësisë penale dhe kërkesën juridiko - pronësore.

(2) Në seancën kryesore ata kanë të drejtë të propozojnë prova, t'i parashtrojnë pyetje të akuzuarit, dëshmitarëve dhe ekspertëve, të nxjerrin shënime dhe sqarime lidhur me dëshmitë e tyre, të japin deklaratata tjera dhe të paraqesin propozime tjera.

(3) I dëmtuari dhe akuzuesi privat kanë të drejtë që t'i shqyrtojnë dokumentet dhe lëndët të cilat shërbejnë si provë. Të dëmtuarit mund t'i shkurtohet e drejta e shqyrtimit të dokumenteve, derisa nuk merret në pyetje si dëshmitar.

(4) Prokurori publik dhe gjykata do ta njoftojnë të dëmtuarin dhe akuzuesin privat me të drejtat e theksuara në paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni.

Neni 65

Të drejtat e paditësit privat

Paditësi privat sipas dispozitave të këtij ligji i ka të drejtat e njëjta që i ka prokurori publik, përveç ato që i përkasin prokurorit publik si organit shtetëror.

Neni 66

I mituri si i dëmtuar

(1) Nëse i dëmtuari është i mitur ose person plotësisht i privuar nga

aftësia afariste, përfaqësuesi i tij ligjor është i autorizuar që t'i japë të gjitha deklaratat dhe t'i ndërmarrë të gjitha veprimet për të cilat sipas këtij ligji i autorizuar është i dëmtuari.

(2) I dëmtuari i cili i ka mbushur 18 vjet është i autorizuar që vet të japë deklaratat dhe të marrë veprime në procedurë.

Neni 67

I autorizuari i paditësit privat dhe i të dëmtuarit

Paditësi privat dhe i dëmtuari si dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, të drejtat e tyre në procedurë mund t'i kryejnë edhe nëpërmjet të autorizuarit.

Neni 68

Obligimi për njoftim për ndryshimin e adresës

Paditësi privat dhe i dëmtuari, si dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë dhe të autorizuarit, janë të obliguar që për secilin ndryshim të adresës ose të vendqëndrimit, gjegjësisht të vendbanimit ta njoftojnë gjykatën.

Kreu VI

I AKUZUARI DHE MBROJTËSI

Neni 69

Të drejtat e personit të thirrur, të arrestuar ose të privuar nga liria

(1) Personi i thirrur, i arrestuar ose i privuar nga liria patjetër duhet menjëherë të jetë i njoftuar, në gjuhë që e njeh, për arsyet për thirrjen, arrestimin ose privimin nga liria, për çfarëdo qoftë dyshimi për vepër penale të bërë kundër tij, si dhe për të drejtat e tij, dhe nga personi nuk mund të kërkohej deklaratë.

(2) I akuzuari së pari në mënyrë të qartë patjetër duhet të këshillohet për të drejtën të heshtë, për të drejtën që vet të këshillohet me avokat dhe të ketë mbrojtës sipas zgjedhjes së tij gjatë kohës së pyetjes.

(3) Personi i arrestuar ose i privuar nga liria do të këshillohet edhe për të drejtën që të njoftojë anëtar të familjes së tij ose person të afërt të tij, gjegjësisht përfaqësinë diplomatike-konsullore të shtetit i të cilit është shtetas personi, për arrestimin ose privimin e tij nga liria. Sipas nevojës ose me kërkesë të personit të arrestuar ose të privuar nga liria do t'i sigurohet ndihmë përkatëse mjekësore.

(4) Personi i privuar nga liria patjetër duhet menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh nga momenti i privimit nga liria, të nxirret para gjyqit, i cili pa shtyrje do të vendosë për ligjshmërinë e privimit nga liria.

(5) Publikimi i fotografive ose incizimeve të personave të arrestuar ose të privuar nga liria, kryhet me fshehjen e pamjes së fytyrës.

Neni 70

Të drejtat e të akuzuarit

Secili i akuzuar i ka të drejtat themelore si vijojnë:

- të jetë në kohë dhe detalisht i informuar, në gjuhën që e njeh, për veprat për të cilat ngarkohet dhe për argumentet kundër tij,
- të ketë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, e posaçërisht të ketë shikim në dokumente dhe të njoftohet me provat kundër

tij dhe në dobi të tij, si dhe të komunikojë me mbrojtës sipas zgjedhjes personale,

- të gjykohet në prezencë të tij dhe të mbrohet personalisht ose me ndihmën e mbrojtësit sipas zgjedhjes së vet, e nëse nuk ka mjete të paguajë mbrojtës, të marrë mbrojtës falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë,
- ta paraqesë mbrojtjen e vet,
- të mos jetë i detyruar që të japë deklaratë kundër vetvetes ose të afërmve të tij ose tapranojë fajin,
- të ketë mundësi që të deklarohet për faktet dhe provat që e ngarkojnë dhe t'i paraqesë të gjitha faktet dhe provat që i shkojnë në dobi,
- vet ose nëpërmjet mbrojtësit t'i marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij, si dhe t'i sigurohet prania dhe marrja në pyetje e dëshmitarëve në dobi të tij nën kushte të njëjta si të dëshmitarëve kundër tij dhe
- gjatë seancës kryesore të këshillohet me mbrojtësin e vet, por nuk mund të merret vesh se si do të përgjigjet në pyetjen e parashtruar.

Neni 71

E drejta për mbrojtës

(1) Secili person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtë për mbrojtës gjatë gjithë procedurës penale kundër tij.

(2) I akuzuari para marrjes së parë në pyetje ose para veprimi tjetër për të cilin ai obligim është paraparë me këtë ligj, patjetër duhet të këshillohet se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së vet me të cilin mundet vet të këshillohet dhe se mbrojtësi mund të marrë pjesë në pyetjen e tij.

(3) Mbrojtës të akuzuarit mund t'i sigurojnë edhe përfaqësuesi i tij ligjor, shoku martesor, përkatësisht jashtëmartesor, farefisi nga gjaku në vijë të drejtë, adoptuesi i adoptuari, vllau, motra dhe mbajtësi, përveç nëse i akuzuari këtë nuk e kundërshton në mënyrë të prerë.

(4) Mbrojtës mund të jetë vetëm avokati.

(5) Për vepra penale për të cilat mund të shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku dhjetë vitesh, mbrojtës mund të jetë avokati me përvojë prej së paku pesë vitesh pas dhënies së provimit të jurisprudencës.

(6) Mbrojtësi është i obliguar që të parashtrorë autorizim te organi para të cilit mbahet procedura. I akuzuari mund t'i japë mbrojtësit edhe autorizim me gojë në procesverbal para organit para të cilit mbahet procedura.

Neni 72

Mbrojtësi i përbashkët për më shumë të akuzuar dhe më shumë mbrojtës për një të akuzuar

(1) Më shumë të akuzuar mund të kenë mbrojtës të përbashkët vetëm nëse kjo nuk është në kundërshtim me interesat e mbrojtjes së tyre. Nëse organi që e mban procedurën konsideron se të akuzuarit nuk mund të kenë mbrojtës të njëjtë, do t'i thirrë që në afat të caktuar të emërojnë mbrojtës tjetër, kurse në rast të mbrojtjes së domosdoshme do të veprojnë në pajtim me nenin 74 të këtij ligji.

(2) Një i akuzuar mund të ketë më shumë mbrojtës, ndërsa mbrojtja konsiderohet e siguruar kur në procedurë merr pjesë së paku një prej mbrojtësve.

Neni 73

Persona të cilët nuk mund të jenë mbrojtës

(1) Mbrojtës nuk mund të jetë viktimë, i dëmtuari, shoku martesor përkatësisht jashtëmartesor i viktimës, i të dëmtuarit ose i paditësit, as farefis i tyre sipas gjakut në vijë të drejtë.

(2) Mbrojtës nuk mund të jetë personi që është thirrur si dëshmitar në procedurë, përveç nëse sipas këtij ligji është liruar nga detyra për të dëshmuar dhe ka deklaruar se nuk do të dëshmojë ose nëse mbrojtësi dëgjohej si dëshmitar në rastin nga neni 213 pika 2 të këtij ligji.

(3) Mbrojtës nuk mund të jetë personi i cili në lëndën e njëjtë është bashkëpaditur, as personi i cili ka vepruar si gjykatës, prokuror publik ose nëpunës policor.

Neni 74

Mbrojtja e domosdoshme me mbrojtës dhe mbrojtësi sipas detyrës zyrtare

(1) Nëse i akuzuari është memec, shurdh ose i paaftë që vet të mbrohet me sukses, ose nëse kundër tij mbahet procedurë penale për veprë penale për të cilën në ligj është përcaktuar dënimi me burg të përjetshëm, patjetër duhet të ketë mbrojtës që gjatë pyetjes së parë.

(2) I akuzuari patjetër duhet të ketë mbrojtës nëse kundër tij është caktuar paraburgim gjatë kohës derisa zgjat paraburgimi.

(3) Për aktakuzën e parashtruar për veprën penale për të cilën me ligj është përcaktuar dënim me burg prej dhjetë vitesh ose dënim më i rëndë me burg, i akuzuari patjetër duhet të ketë mbrojtës në kohën e dorëzimit të aktakuzës.

(4) Gjatë procedurës për negociatë dhe marrëveshje me prokurorin për pranimin e fajit, i akuzuari patjetër duhet të ketë mbrojtës.

(5) I akuzuari të cilit i gjykohej në mungesë patjetër duhet të ketë mbrojtës menjëherë pas vendimit të marrë për gjykim në mungesë.

(6) Nëse i akuzuari në rastet e mbrojtjes së domosdoshme nga paragrafët paraprakë të këtij neni nuk merr mbrojtës vet, kryetari i gjykatës do t'i përcaktojë mbrojtës sipas detyrës zyrtare, për rrjedhën e mëtutjeshme të procedurës penale deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Kur të akuzuarit do t'i përcaktohet mbrojtës sipas detyrës zyrtare për aktakuzën e parashtruar, për këtë do të informohet i akuzuari së bashku me dorëzimin e aktakuzës.

Neni 75

Mbrojtja e të varfërve

(1) Kur nuk ekzistojnë kushte për mbrojtje të domosdoshme, nëse sipas gjendjes së vet pronësore nuk mund t'i bartë shpenzimet e mbrojtjes, të akuzuarit mundet me kërkesë të tij t'i caktohet mbrojtës kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë, e veçanërisht pesha e veprës penale dhe ndërlikueshmëria e rastiit. Në kërkesë i akuzuari mendte vet të caktojë avokat të caktuar për mbrojtës, nga lista e avokatëve nga bashkësia përkatëse e avokatëve.

(2) Për kërkesën nga paragrafi (1) të këtij neni vendos gjykatësi i procedurës paraprake, gjegjësisht kryetari i këshillit, kurse mbrojtësin e cakton kryetari i gjykatës.

(3) Shpenzimet për mbrojtje nga paragrafi (1) të këtij, neni bien në ngarkesë të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 76

Revokimi dhe heqja e autorizimit

(1) Të drejtat dhe detyrat e mbrojtësit ndërpriten kur i akuzuari do ta revokojë autorizimin.

(2) Kur i akuzuari e revokon autorizimin e mbrojtësit të vet, për atë do ta njoftojë gjykatën menjëherë, e më së voni në afat prej tri ditësh.

(3) Nëse i akuzuari nuk e njofton gjykatën se ka autorizuar mbrojtës të ri, gjykata në afat prej tri ditësh do t'i caktojë mbrojtës sipas detyrës zyrtare, duke llogaritur prej ditës kur i akuzuari e ka njoftuar, përkatësisht ka qenë i detyruar që ta njoftojë gjykatën.

(4) Mbrojtësit të cilit i është revokuar autorizimi është i detyruar që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet në procedurë në dobi të të akuzuarit deri te njoftimi se është autorizuar mbrojtës i ri, por jo më gjatë se 15 ditë prej ditës së revokimit të autorizimit.

(5) Kur mbrojtësi e ka anuluar autorizimin e të akuzuarit, i akuzuari është i detyruar që menjëherë, e më së voni në afat prej tri ditësh ta njoftojë gjykatën për revokimin e autorizimit dhe nëse i akuzuari nuk ka caktuar mbrojtës të ri, gjykata në afat prej tri ditësh do t'i caktojë mbrojtës sipas detyrës zyrtare.

(6) Nëse i akuzuari e njofton gjykatën se vet ka autorizuar mbrojtës, gjykata do ta revokojë aktvendimin për caktim të mbrojtësit sipas detyrës zyrtare.

(7) Nëse dorëheqja ose revokimi është kryer në seancën e shqyrtimit kryesor, mbrojtësi është i detyruar që t'i marrë të gjithë veprimet në dobi të të akuzuarit deri te mbarimi i asaj seance.

(8) Nëse gjykata vlerëson se heqja e autorizimit nuk përmban arsye të bazuara dhe është dhënë me qëllim që të zgjatet procedura, për atë do ta njoftojë Odën e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë.

(9) Për veprimet e marra Oda e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë është e detyruar që ta njoftoj gjykatën, më së voni në afat prej tre muajsh.

Neni 77

Shkarkimi i mbrojtësit të caktuar

(1) Në vend të mbrojtësit të emëruar nga nenet 74 dhe 75 të këtij ligji, i akuzuari mundet vet të marrë mbrojtës tjetër. Në këtë rast mbrojtësi i emëruar do të shkarkohet.

(2) Mbrojtësi i caktuar vetëm nga shkaqe të arsyeshme mund të kërkojë që të shkarkohet.

(3) Për shkarkim të mbrojtësit në rastin nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, para seancës kryesore vendos gjykatësi i procedurës paraprake, përkatësisht kryetari i këshillit, në shqyrtimin kryesor vendos këshilli, ndërsa në procedurën e ankesës kryetari i këshillit të shkallës së parë, përkatësisht këshilli kompetent për vendosje në procedurë për ankesën. Kundër këtij aktvendim nuk lejohet ankesë e posaçme.

(4) Kryetari i gjykatës, me kërkesë të kryetarit të këshillit apo të akuzuarit ose me pajtim të tij mund ta shkarkojë mbrojtësin e caktuar, nëse në

mënyrë të parregullt ose pandërgjegjshme e kryen detyrën. Në vend të mbrojtësit të shkarkuar, kryetari i gjykatës do të caktojë mbrojtës tjetër. Për shkarkimin e mbrojtësit kryetari i gjykatës do të njoftojë Odën e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë.

Neni 78

Të drejtat e mbrojtësit

(1) Mbrojtësi është i autorizuar që në dobi të të akuzuarit t'i marrë të gjitha veprimet që mund t'i marrë i akuzuari.

(2) Për përgatitjen e mbrojtjes, mbrojtësi mund të kërkojë njoftime nga qytetarët në pajtim me nenin 307 e këtij ligji.

Neni 79

Shikimi i mbrojtësit në dokumente

(1) Gjatë procedurës penale, mbrojtësi ka të drejtë që t'i shikojë dokumentet dhe provat, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Mbrojtësi ka të drejtë të kryejë shikim dhe të marrë përshkrim nga procesverbalet dhe a dokumentet tjera nga veprimet në të cilat mbrojtja ka pasur të drejtë të jetë e pranishme, e të cilat ruhen në prokurorinë publike.

Neni 80

Komunikimi ndërmjet mbrojtësit dhe të akuzuarit në paraburgim

Nëse i akuzuari gjendet në paraburgim, mbrojtësi mundet me atë lirisht dhe pa mbikëqyrje të këmbëjë letra dhe të bisedojë. Me Me përjashtim, gjykatësi i procedurës paraprake këtë të drejtë mund ta vë vetëm në mbikëqyrje vizuale, nëse paraburgimi është caktuar në bazë të nenit 165 paragrafi (1) pika 2) të këtij ligji, dhe ekzistojnë gjasa që i akuzuari do t'i keqpërdorë kontaktet me mbrojtësin.

Kreu VII

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDIHMA JURIDIKE

Neni 81

Obligimi për dhënie të ndihmës

(1) Policia gjyqësore, prokurori publik dhe gjykata për nevojat për mbajtjen e procedurës penale mund të kërkojnë ndihmë nga gjykatat, prokuroria publike, organet e administratës shtetërore dhe organet tjera shtetërore, institucionet që kryejnë autorizime publike dhe nga organet e njësive të vetadministrimit lokal. Ato organe janë të detyruara që t'i përgjigjen kërkesës në afat më të shkurtër, ndërsa pengesat e mundshme t'i evitojnë pa prolongim. Sipas nevojës atyre mund tu dorëohet kopja nga dokumentet ndëshkuese.

(2) Organet e administratës shtetërore dhe organet tjera shtetërore mund ta refuzojnë kërkesën nga paragrafi (1) të këtij neni, me vendim të arsyetuar në pajtim me kompetencat e tyre ligjore, nëse në atë mënyrë shkelet obligimi për ruajtjen e informatave të klasifikuara, derisa organi kompetent nuk e heq obligimin e atillë.

Neni 82

Realizimi i seancës së provave me ndihmën e konferencës me video-zë

(1) Jashtë rasteve të veçanta të përcaktuara me këtë ligj, gjykata mundet me urdhër me shkrim të për caktojë që seanca e provave të zbatohet me ndihmën e pajisjes së mbyllur teknike për lidhje me largësi (konferencë me video-zë).

(2) Urdhri përmban të dhëna për vendin dhe kohën e marrjes së konferencës me video-zë, si dhe për emrin dhe adresën e personit pyetja e të cilit kërkohet. Thirrjet dëshmitarëve dhe të akuzuarve u dërgohen sipas dispozitave nga Kreu XIII të këtij ligji.

(3) Në urdhër mund të caktohet që personi tek i cili gjenden sendet të cilat sipas Kodit penal duhet të konfiskohen ose mund të përdoren për përcaktimin e fakteve në procedurën penale, me kërkesë nga gjykata t'i tregojë gjatë konferencës me video-zë, e pastaj t'ia dorëzojë gjykatës sipas dispozitave të nenit 195 të këtij ligji.

Neni 83

Realizimi i konferencës me video-zë

(1) Palët mund të jenë prezente në konferencën me video-zë dhe të marrin pjesë në të, në pajtim me dispozitat për paraqitjen e provave në seancën kryesore. Të akuzuarit i cili gjendet në paraburgim në mënyrë adekuate do t'i mundësohet ndjekja e konferencës me video-zë, si dhe parashtrimi i pyetjeve dhe paraqitja e shënimeve.

(2) Në konferencën me video-zë patjetër duhet të jetë prezent edhe personi profesional që do të manipulojë me pajisjet.

Neni 84

Procesverbali për konferencën me video-zë

(1) Gjkata që e udhëheq procedurën penale përpilon procesverbal nga konferenca me video-zë në të cilin shënohen koha dhe vendi i veprimeve, personat që kanë qenë të pranishëm, lloji dhe gjendja e pajisjes teknike për lidhje në largësi, si dhe personi profesional që ka manipuluar me pajisjen. Procesverbalin e mban këshilltari gjyqësor.

(2) Organi që e mban procedurën penale mund t'i përmbushë edhe kërkesat e posaçme në lidhje me formën dhe përmbajtjen e konferencës me video-zë, në pajtim me dispozitat nga ligjet e posaçme ose marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Neni 85

Konferenca telefonike

Prokurori publik ose policia, alibinë dhe faktet tjera të rëndësishme për ngritjen dhe mbajtjen e procedurës penale mund t'i kontrollojnë me përdorimin e lidhjes telefonike, e cila personave të pyetur u mundëson komunikim të njëkohësishëm (konferenca telefonike).

Neni 86

Procesverbali dhe incizimi nga konferenca telefonike

(1) Procesverbali për konferencën telefonike doemos duhet të përmbajë të dhëna për identitetin e personave në konferencën telefonike, të dhënë për atë se në cilën cilësi personi e jep deklaratën, e varësisht nga ajo cilësi dhe të dhënat adekuate personale.

(2) Incizimi nga konferenca telefonike nga paragrafi (1) të këtij neni, mund të përdoret në procedurën penale:

1) nëse personi, që është pyetur si dëshmitar, është këshilluar sipas nenit 219 e këtij ligji dhe është paralajmëruar për incizimin;

2) nëse i akuzuari paraprakisht është këshilluar për të drejtat sipas nenit 206 e këtij ligji dhe

3) nëse në pyetjen e të akuzuarit është i pranishëm mbrojtësi i tij.

SEKSIONI V. VEPRIME TË PROCESIT

Kreu VIII

PARASHTRESA DHE PROCESVERBALE

Neni 87

Parashtresa

(1) Paditë private, aktakuzat, propozimakuzat, propozimet, mjetet juridike dhe deklaratat dhe njoftimet tjera (parashtresat) parashtrohen me shkrim ose jepen gojarisht në procesverbal ose parashtrohen në formë elektronike te seksioni pranues i organit kompetent.

(2) Parashtresat nga paragrafi (1) të këtij neni, patjetër duhet të jenë të kuptueshme dhe ta përmbajnë gjithçka që është e nevojshme që të mund të procedohet për to. Parashtresat e parashtruara nga avokatë, organe të administratës shtetërore, persona juridikë dhe persona të cilët kryejnë autorizime publike, duhet të përmbajnë edhe të dhëna për kutinë elektronike për dërgimin e shkresave të regjistruar në pajtim me ligjin.

(3) Nëse me këtë ligj nuk është përaktuar ndryshe, organi që e mban procedurën do ta thirr parashtruesin e parashtresës që është e pakuptueshme ose nuk përmban gjithçka që është e nevojshme, ta përmirësojë parashtresën përkatësisht ta plotësojë që të mundet për të të procedohet, e nëse ai nuk e bënë atë në afatin e caktuar, do ta hedh poshtë parashtresën.

(4) Në thirrjen për përmirësimin, përkatësisht për plotësimin e parashtresës, parashtruesi do të paralajmërohet për pasojat nga lëshimi.

(5) Parashtresat të cilat sipas këtij ligji dorëzohen te pala e kundërt, i dorëzohen organit që e mban procedurën në numër të mjaftueshëm të ekzemplarëve për organin dhe për palën tjetër. Nëse parashtresa të tilla nuk janë dorëzuar në numër të mjaftueshëm të ekzemplarëve, do të shumëzohen me shpenzime të parashtruesit.

Neni 88

Dënimi për shkak të ofendimit të gjykatës

(1) Gjykata do ta dënojë me dënim me para prej 200 deri në 1 200 euro në kundërvlerë me denarë, pjesëmarrësin në procedurën i cili në parashtresën ose gojarisht, përkatësisht në mënyrë tjetër e ofendon gjykatën

ose personin që merr pjesë në procedurë. Aktvendimin për dënim e miraton gjykata para së cilës është dhënë deklarata, e nëse kjo është bërë në parashtresë, gjykata që duhet të vendosë për parashtresën.

(2) Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesë, për të cilën vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji,

(3) Për dënimin e prokurorit publik, gjykata do ta njoftojë prokurorin publik kompetent të prokurorisë publike.

(4) Për dënimin e avokatit, gjykata do ta njoftojë Odën e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë.

(5) Kur prokurori publik e mban procedurën paraprake dhe gjatë kësaj vlerëson se pjesëmarrësi në procedurë në deklaratë ose parashtresë e ofendon gjykatën, prokurori publik ose personi tjetër që merr pjesë në procedurë, do t'ia dorëzojë kopjen nga parashtresa ose deklarata gjykatës kompetente, e cila mund të miratojë aktvendim për dënim nga paragrafi (1) të këtij neni.

(6) Dënimi sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk ndikon mbi ndjekjen dhe shqiptimin e dënimit për veprën penale të kryer me ofendim.

(7) Nëse sipas paragrafit (1) të këtij neni ofendimi i gjykatës edhe krahas dënimit të shqiptuar me para përsëritet, gjykata mund të shqiptojë dënim me para edhe deri në shumë të dhjetëfishtë nga dënimi nga paragrafi (1) të këtij neni.

Neni 89

Procesverbali

(1) Për secilin veprim të ndërmarrë gjatë procedurës penale përpilohet procesverbali njëkohësisht kur kryhet veprimi, e nëse kjo nuk është e mundur, menjëherë pas kësaj.

(2) Procesverbalin e përpilon mbajtësi i procesverbalit. Vetëm kur kryhet bastisje e shtëpisë ose e personit, ose veprimi ndërmerret jashtë lokaleve zyrtare të organit, e nuk mundet të sigurohet mbajtësi i procesverbalit, procesverbalin mund ta përpilojë personi që e ndërmerr veprimin.

(3) Procesverbalin që e përpilon mbajtësi i procesverbalit, përpilohet në atë mënyrë që personi i cili e ndërmerr veprimin, i tregon me zë mbajtësit të procesverbalit se çka do të fus në procesverbal.

Neni 90

Përmbajtja e procesverbalit

(1) Në procesverbalin futet emri i organit shtetëror para të cilit kryhet veprimi, vendi ku kryhet veprimi, dita dhe ora kur veprimi ka filluar dhe mbaruar, emrat dhe mbiemrat e personave prezentë dhe në cilën cilësi janë prezentë, si dhe emërimi i lëndës penale sipas të cilit ndërmerret veprimi.

(2) Procesverbali duhet t'i përmbajë të dhënat thelbësore për rrjedhën dhe përmbajtjen e veprimit të ndërmarrë. Nëse gjatë ndërmarrjes së veprimit janë konfiskuar lëndë ose dokumente, kjo do të shënohet në procesverbal, e lëndët e konfiskuara do të përfshihen në procesverbal ose do të shënohet ku janë në rruajtje.

(3) Gjatë ndërmarrjes së veprimeve siç është inspektimi bastisja e shtëpisë ose personit, ose rinjohja e personave ose lëndëve, në procesverbal do të futen edhe të dhëna që janë të rëndësishme duke marrë parasysh

natyrën e veprimit të atillë, ose për përcaktimin e identitetit të sendeve të veçanta (përshkrimi, masa dhe madhësia e sendeve ose gjurmëve, vënia e shenjave në sendet etj.) e nëse janë bërë skica, vizatime, plane, fotografi, shënime në pajisje elektronike, mekanike dhe pajisje tjera për incizim të zërit ose incizim vizuel-të zërit dhe shënime stenografike, kjo do të shënohet në procesverbal dhe të përfshihet në procesverbal.

Neni 91

Mbajtja e procesverbalit

(1) Procesverbali patjetër duhet të mbahet në mënyrë të rregullt, në të nuk guxon asgjë të fshihet, të shtohet ose ndryshohet. Vendet e shlyera patjetër duhet të mbeten të lexueshme.

(2) Të gjitha modifikimet, ndryshimet dhe shtesat futen në fund të procesverbalit dhe menjëherë u paraqiten palëve dhe mbrojtësit dhe ato patjetër duhet të verifikohen nga personat që e nënshkruajnë procesverbalin.

Neni 92

Shikimi në procesverbal dhe nënshkrimi i procesverbalit

(1) Personat të cilët në mënyrë të obligueshme janë të pranishëm në veprimet në procedurën, si dhe palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari, nëse janë të pranishëm, kanë të drejtë që ta lexojnë procesverbalin ose të kërkojnë që tu lexohet. Për këtë është i obliguar që të paralajmërojë personi që e ndërmerr veprimin, e në procesverbalin do të shënohet nëse paralajmërimi është ryer dhe nëse është lexuar procesverbali. Procesverbali çdoherë lexohet, nëse nuk ka mbajtës të procesverbalit në procesverbalin dhe kjo do të shënohet.

(2) Në fund të procesverbalit do të nënshkruhen përkthyesi, përkatësisht interpretuesi nëse ka pasur, e gjatë bastisjes edhe personi që bastiset ose shtëpia e të cilit bastiset. Nëse procesverbalin nuk e shkruan mbajtësi i procesverbalit, procesverbalin e nënshkruajnë personat që janë të pranishëm në veprim. Nëse persona të atillë nuk ka ose nuk janë në gjendje që ta kuptojnë përmbajtjen e procesverbalit, procesverbalin e nënshkruajnë dy dëshmitarë, përveç nëse nuk është e mundur që të sigurohet prania e tyre.

(3) Personi analfabet në vend të nënshkrimit vendos gjurmë nga gishti tregues nga dora e djathtë, kurse mbajtësi i procesverbalit nën gjurmën do ta shënojë emrin dhe mbiemrin e tij. Nëse për nga pamundësia që të vendosë gjurmë nga gishti tregues i djathtë, vendoset gjurmë nga ndonjë gisht tjetër ose gjurmë nga gishti i dorës së majtë, në procesverbal do të shënohet nga cili gisht dhe nga cila dorë është marrë gjurma.

(4) Nëse veprimi nuk ka mundur të kryhet pa ndërprerje, në procesverbal do të shënohet dita dhe ora kur është bërë ndërprerja, si dhe dita dhe ora kur vazhdon veprimi.

(5) Nëse ka pasur kundërshtim për përmbajtjen e procesverbalit, në procesverbal do të shënohen edhe ato kundërshtime.

(6) Procesverbalin në fund e nënshkruan personi që e ka ndërmarrë veprimin dhe mbajtësi i procesverbalit.

Neni 93

Ndarja e provës

(1) Kur në këtë ligj është përcaktuar se në ndonjë provë nuk mund të bazohet vendimi gjyqësor, gjykatësi i procedurës paraprake, sipas detyrës

zyrtare ose me propozimit të palëve, do të miratojë aktvendim për ndarje të asaj prove nga dokumentet, më së voni deri në mbarimin e procedurës hetimore. Pas ngritjes së aktakuzës, aktvendim për ndarje të provës miraton këshilli për vlerësim të aktakuzës. Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesë e veçantë, për të cilën vendos gjykata më e lartë.

(2) Pas plotfuqishmërisë së aktvendimit, provat e ndara ruhen te gjykatësi i procedurës paraprake, ndaras nga dokumentet tjera, dhe nuk mund të shqyrtohen as nuk mund të shfrytëzohen në procedurë. Procesverbalet e ndara mbyllen në mbështjellëse të posaçme dhe ruhen te gjykatësi i procedurës paraprake.

Neni 94

Incizimi i veprimeve hetimore

(1) Realizimi i veprimeve hetimore ose të tjera incizohet me aparate për incizim vizual-të zërit kur është përcaktuar me këtë ligj. Organi i cili e zbaton veprimin, paraprakisht e njofton për këtë personin i cili hetohet.

(2) Incizimi doemos duhet t'i përmbajë të dhënat nga neni 90 paragrafi (1) i këtij ligji, të dhënat e nevojshme për identifikimin e personit deklarata e të cilit incizohet dhe e dhëna se në çfarë cilësie ai person e jep deklaratën. Kur incizohen deklarata të më shumë personave, doemos duhet të sigurohet që nga incizimi të mund të njihet qartë se kush e ka dhënë deklaratën.

(3) Në procesverbal për veprimin hetimor do të shënohet se është bërë incizim, kush e ka kryer incizimin, se personi që pyetet paraprakisht është njoftuar për incizimin, nëse është riprodhuar incizimi dhe ku ruhet, nëse nuk l është bashkëngjitur shkresave të lëndës.

(4) Kur me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, organi i cili e realizon veprimin hetimor, mund të përcaktojë që incizimi tërësisht ose pjesërisht të përshkruhet dhe t'i dorëzohet palës, me kërkesë të saj. Përshkrimi do të kontrollohet dhe do të verifikohet me nënshkrim nga personi i cili e ka realizuar veprimin dhe do t'i bashkëngjitet procesverbalit për ndërmarrjen e veprimit hetimor.

(5) Incizimi i bërë sipas paragrafëve (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni, ruhet në gjykatë derisa të ruhen edhe shkresat në lëndë.

(6) Incizimet e bëra sipas dispozitave nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni, nuk mund të paraqiten publikisht pa pajtimin me shkrim të palëve dhe pjesëmarrësve në veprimin hetimor.

Neni 95

Procesverbali për shqyrtimin kryesor

Për procesverbalin e shqyrtimit kryesor vlejné dispozitat nga nenet 374 dhe 375 të këtij ligji.

Neni 96

Procesverbali për këshillim dhe votim

(1) Për këshillimin dhe votimin hartohet procesverbal i veçantë.

(2) Procesverbali për këshillim dhe votim i përmban rrjedhën e votimit dhe vendimin që është marrë.

(3) Këtë procesverbal e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e këshillit dhe mbajtësi i procesverbalit. Mendimet e ndara do të përfshihen në procesverbal për këshillim dhe votim, nëse nuk janë futur në procesverbal.

(4) Procesverbali për këshillimin dhe votimin do të mbyllet në mbështjellës të veçantë. Këtë procesverbal mund ta shqyrtojë vetëm gjykata më e lartë kur vendos për mjetin juridik dhe në këtë rast obligohet që procesverbalin ta mbyllë përsëri në mbështjellës të veçantë dhe në mbështjellës të shënojë se e ka shqyrtuar procesverbalin.

Kreu IX AFATET

Neni 97

Afatet për dhënien e deklaratës dhe dorëzimin e parashtresës

(1) Afatet e parapara me këtë ligj nuk mund të vazhdohen, përveç nëse ligji prerazi këtë e lejon. Nëse bëhet fjalë për afat që me këtë ligj është përcaktuar për shkak të mbrojtjes së të drejtës për mbrojtje dhe të drejtave tjera procesore të të akuzuarit, ky afat mund të shkurtohet nëse këtë e kërkon i akuzuari me shkrim ose me gojë në procesverbal para gjykatës.

(2) Kur deklarata është e lidhur me afat konsiderohet se është dhënë në afat nëse para se të skadojë afati i është dorëzuar atij i cili është i autorizuar ta pranojë.

(3) Kur deklarata është dërguar me postë me dërgesë të rekomanduar, me postë elektronike ose në formë telegrafike, dita e dorëzimit në postë, përkatësisht dita e dorëzimit me postë elektronike, konsiderohet si ditë e dorëzimit atij të cilit i drejtohet. Dorëzimi i postës ushtarake në vende ku nuk ekziston postë e rregullt konsiderohet si dorëzim i dërgesës së rekomanduar në postë. Konsiderohet se dërguesi i deklaratës nuk e ka lëshuar afatin nëse pranuesi deklaratën e dërguar nuk e ka marrë me kohë, për shkak të punës së gabuar të pajisjes për dërgim ose pranim të deklaratës, e për të cilën dërguesi nuk ka ditur.

(4) I dyshuari i cili ndodhet në paraburgim deklaratën e cila është e lidhur me afat mund ta japë në procesverbal te organi i cili e mban procedurën ose ta dorëzojë në drejtorinë e burgut, ndërsa personi i cili ndodhet në vuajtje të dënimit ose ndodhet në institucion për shkak të zbatimit të masës së sigurisë ose masës edukuese, deklaratën e tillë ta dorëzojë në drejtorinë e institucionit në të cilin është vendosur. Dita dhe ora kur është hartuar procesverbali i tillë, përkatësisht kur deklarata i është dorëzuar drejtorisë së institucionit, konsiderohet si ditë e dorëzimit në organin i cili është kompetent për ta pranuar.

(5) Nëse parashtresa që është e lidhur me afat për shkak të mosdijes ose gabimit të dukshëm të parashtruesit i është dorëzuar ose dërguar prokurorit publik jokompetent ose gjykatës jokompetente para skadimit të afatit, e te prokurori publik kompetent ose gjykata kompetente do të arrijë pas skadimit të afatit, do të konsiderohet se është parashtruar me kohë.

Neni 98

Llogaritja e afateve

(1) Afatet llogariten me orë, ditë, muaj dhe vite.

(2) Ora ose dita kur është bërë dorëzimi ose njoftimi, përkatësisht në të cilën bie ngjarja prej kur duhet të llogaritet kohëzgjatja e afatit, nuk llogaritet në afat, por si fillim i afatit merret ora e parë e ardhshme, përkatësisht dita e

parë e ardhshme. Në një ditë llogariten 24 orë, ndërsa muaji llogaritet sipas kohës kalendarike.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, afatet për llogaritjen e arrestimit, mbajtjes dhe paraburgimit, fillojnë të rrjedhin nga momenti i privimit nga liria.

(4) Afatet e përcaktuara me muaj përkatësisht me vite përfundojnë me skadimin e asaj dite të muajit të fundit, përkatësisht të vitit që sipas numrit të tij i përgjigjet ditës kur ka filluar afati. Nëse nuk është ajo ditë në muajin e fundit, afati përfundon në ditën e fundit të atij muaji.

(5) Të shtunat, të dielat dhe festat shtetërore llogariten në afat. Nëse dita e fundit të afatit bie në festë shtetërore, të shtune, të diele ose ditë tjetër në të cilën organi shtetëror nuk ka punuar, afati skadon me skadimin e ditës së parë të ardhshme të punës.

Neni 99

Kthimi në gjendjen e mëparshme

(1) Të akuzuarit i cili për shkaqe të arsyeshme do ta lëshojë afatin për paraqitjen e ankesës për aktgjykimin ose aktvendimin për zbatimin e masave të sigurisë ose masës edukative ose për konfiskimin e dobisë pronësore, gjykata do t'i lejojë kthim në gjendjen e mëparshme për shkak të paraqitjes së ankesës, nëse në afat prej tetë ditësh pas pushimit të shkakut për të cilin e ka lëshuar afatin, parashtron lutje për kthim në gjendjen e mëparshme dhe nëse njëkohësisht me lutjen dorëzon edhe ankesë.

(2) Pas skadimit të tre muajve nga dita e lëshimit, nuk mund të kërkohet kthim në gjendjen e mëparshme.

Neni 100

Vendimmarrja për kthim në gjendjen e mëparshme

(1) Për kthim në gjendjen e mëparshme vendos gjykata e cila e ka miratuar aktgjykimin ose aktvendimin i cili përgënjeshtrohet me ankesë.

(2) Kundër aktvendimit me të cilin lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme, nuk lejohet ankesë.

(3) Kur i akuzuari ka paraqitur ankesë për aktvendimin me të cilin nuk lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme, gjykata obligohet që këtë ankesë, bashkë me ankesën e aktgjykimit ose të aktvendimit për zbatimin e masës së sigurisë, ose të masës edukative ose për konfiskimin e dobisë pronësore, si dhe me përgjigjen e ankesës dhe me të gjitha shkresat ta dorëzojë në gjykatën më të lartë për zgjidhje.

Neni 101

Veprimi i lutjes për kthim në gjendjen e mëparshme

Lutja për kthim në gjendjen e mëparshme sipas rregullës nuk e ndalon zbatimin e aktgjykimit, përkatësisht aktvendimit për zbatimin e masës së sigurisë ose masës edukative ose për konfiskimin e dobisë pronësore, por gjykata kompetente për zgjidhjen e lutjes mund të vendosë që zbatimi të ndërpritet derisa të merret vendimi për lutjen.

Kreu X

SHPENZIMET PËR PROCEDURËN PENALE

Neni 102

Përmbajtja e shpenzimeve për procedurë penale

(1) Shpenzimet e procedurës penale janë shpenzimet e bëra me rastin e procedurës penale, nga ngritja e saj deri në përfundimin e saj dhe shpenzimet për veprimet e ndërmarra hetimore para procedurës hetimore.

(2) Shpenzimet për procedurë penale i përfshijnë:

1) shpenzimet për dëshmitarë, ekspertë, përkthyes, interpretues dhe persona profesionistë, shpenzimet për incizimet audio-vizuele dhe përshkrimin e incizimeve, si dhe shpenzimet e inspektimit;

2) shpenzimet e transportit të të akuzuarit;

3) shpenzimet për arrestimin e të akuzuarit, përkatësisht të personit të privuar nga liria;

4) shpenzimet e transportit dhe të rrugës të personave zyrtarë;

5) shpenzimet për mjekimin e të akuzuarit gjatë kohës deria gjendet në paraburgim, si dhe shpenzimet për lindje, përveç shpenzimeve të cilat arkëtohen nga fondi për sigurim shëndetësor;

6) shuma e paushallit;

7) shpërblimin dhe shpenzimet e domosdoshme të avokatit mbrojtës, shpenzimet e domosdoshme të paditësit privat dhe të përfaqësuesit të tij ligjor, si dhe shpërblimin dhe shpenzimet e domosdoshme të të autorizuarve të tij dhe

8) shpenzimet e domosdoshme të të dëmtuarit dhe të përfaqësuesit të tij ligjor, si dhe shpërblimin dhe shpenzimet e detyrueshme të të autorizuarit të tij;

(3) Shuma e paushallit përcaktohet në kuadër të shumave të përcaktuara me dispozitë, duke e marrë parasysh kohëzgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës dhe gjendjen pronësore të personit i cili obligohet që ta paguajë atë shumë.

(4) Shpenzimet nga pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të paragrafit (2) të këtij neni, si dhe shpenzimet e domosdoshme të avokatit mbrojtës të caktuar dhe të të autorizuarit të caktuar, në procedurën për veprat penale për të cilat ndiqet me detyrë zyrtare, paguhen paraprakisht nga mjetet e organit i cili e udhëheq procedurën penale, ndërsa arkëtohen më vonë nga personat të cilët janë të obliguar që t'i kompensojnë sipas dispozitave të këtij ligji. Organi i cili e udhëheq procedurën obligohet që të gjitha shpenzimet të cilat janë paguar paraprakisht t'i fusë në regjistrimin i cili do t'i bashkëngjitet shkresave.

(5) Shpenzimet për përkthim të cilat do të bëhen me zbatimin e dispozitave të këtij ligji, nuk paguhen nga personat të cilët sipas dispozitave të këtij ligji obligohen që t'i kompensojnë shpenzimet e procedurës penale.

Neni 103

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Në çdo aktgjykim dhe aktvendim me të cilin ndërpritet procedura penale, do të vendoset se kush do t'i bartë shpenzimet e procedurës dhe sa do të jenë ato.

Neni 104

Bartja e shpenzimeve të bëra me fajin e vet

(1) I akuzuari, i dëmtuari, paditësi privat, avokati, përfaqësuesi ligjor, i autorizuari, dëshmitari, eksperti, përkthyesi, interpretuesi dhe personi zyrtar, pa marrë parasysh rezultatin e procedurës penale, i bartin shpenzimet për sjelljen e tyre, për prolongimin e seancës kryesore dhe shpenzimet tjera të procedurës që i kanë bërë me fajin e vet.

(2) Për shpenzimet nga paragrafi (1) i këtij neni miratohet aktvendim i veçantë, përveç nëse për shpenzimet të cilat i bart paditësi privat dhe i akuzuari vendoset në vendimin për punën kryesore.

(3) Për ankesën kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) i këtij ligji.

Neni 105

Vendimmarrja për shpenzimet në aktgjykimin ndëshkues

(1) Kur gjykata do ta shpallë të akuzuarin fajtor, në aktgjykim do të theksojë se obligohet që t'i kompensojë shpenzimet e procedurës penale.

(2) Personi i cili akuzohet për më shumë vepra penale nuk do të ndëshkohet që t'i kompensojë shpenzimet në lidhje me veprat për të cilat është i liruar nga akuza, nëse mund të ndahen ato shpenzime nga shpenzimet e përgjithshme.

(3) Në aktgjykimin në të cilin janë shpallur fajtorë më shumë të akuzuar, gjykata do të vendosë se cilën pjesë të shpenzimeve do ta bartë secili prej tyre, e nëse kjo nuk është e mundur, do t'i ndëshkojë që të gjithë të akuzuarit t'i bartin shpenzimet në mënyrë solidare. Pagesa e shumës së paushallit do të përcaktohet për çdo të akuzuar në veçanti.

(4) Në vendimin në të cilin vendoset për shpenzimet, gjykata mund ta lirojë të akuzuarin nga obligimi që t'i kompensojë pjesërisht ose tërësisht shpenzimet e procedurës penale nga neni 102, paragrafi (2), pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij ligji, nëse me pagesën e tyre do të vihej në pikëpyetje mbajtja e të akuzuarit ose e personave të cilët ai obligohet që t'i mbajë. Nëse vërtetohen këto rrethana pas marrjes së vendimit për shpenzimet, kryetari i këshillit me aktvendim të veçantë mund ta lirojë të akuzuarin nga obligimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale.

Neni 106

Vendimmarrja për shpenzimet gjatë ndërprerjes së procedurës penale dhe gjatë miratimit të aktgjykimit lirues ose refuzues

(1) Kur të ndërpritet procedura penale ose kur të merret aktgjykim me të cilin i akuzuari do të lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, në aktvendim, përkatësisht në aktgjykim do të theksohet se shpenzimet e procedurës penale nga neni 102 paragrafi (2) pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij ligji, shpenzimet e domosdoshme të të akuzuarit, shpenzimet e domosdoshme dhe shpërblimi i avokatit të tij, bijnë në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, përveç në rastet e caktuara në paragrafët (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni.

(2) Personi i cili me vetëdije ka parashtruar fletëparaqitje të rrejshme do t'i bartë shpenzimet e procedurës penale.

(3) Paditësi privat obligohet që t'i kompensojë shpenzimet e procedurës penale nga neni 102 paragrafi (2) pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij

ligji, shpenzimet e domosdoshme të të akuzuarit, shpenzimet e domosdoshme dhe shpërblimin e avokatit mbrojtës të tij nëse procedura përfundon me aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza, ose me aktgjykim me të cilin refuzohet akuza ose me aktvendim për ndërprerjen e procedurës, përkatësisht nëse është marrë aktgjykim me të cilin refuzohet akuza për shkak të vdekjes së të akuzuarit ose për shkak të sëmundjes nga ndonjë sëmundje shpirtërore të përhershme, ose për shkak se ka fillimuar parashkrimi i ndjekjes penale për shkak të prolongimit të procedurës, e cila nuk mund t'i përshkruhet në faj të paditësit privat.< Nëse procedura është ndërprerë për shkak të tërheqjes nga akuza, i akuzuari dhe paditësi privat mund të barazohen në lidhje me shpenzimet e tyre të ndërsjella. Nëse ekzistojnë më shumë paditës privatë, shpenzimet do t'i bartin të gjithë solidarisht.

(4) I dëmtuari i cili do të tërhiqet nga propozimi për ndjekje, për çfarë procedura është ndërprerë, do t'i bart shpenzimet e procedurës penale nëse i akuzuari nuk deklaron se ai do t'i paguajë.

(5) Kur gjykata do ta refuzojë akuzën për shkak të jokompetencës, vendim për shpenzimet do të marrë gjykata kompetente.

Neni 107

Shpenzimet e mbrojtësit dhe të autorizuarit

(1) Shpërblimin dhe shpenzimet e domosdoshme të mbrojtësit dhe të të autorizuarit të paditësit privat ose të dëmtuarit, obligohet që t'i paguajë personi i përfaqësuar, pa marrë parasysh atë që sipas vendimit të gjykatës obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale, përveç nëse sipas dispozitave të këtij ligji shpërblimin dhe shpenzimet e domosdoshme të avokatit mbrojtës janë në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë. Nëse të akuzuarit i është caktuar mbrojtës, ndërsa me pagesën e shpërblimit dhe shpenzimeve të domosdoshme do të vihej në pikëpyetje ekzistenca e të akuzuarit ose ekzistenca e personit për të cilin ai është i obliguar të kujdeset, shpërblimi dhe shpenzimet e domosdoshme do të paguhet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(2) Personi i autorizuar i cili nuk është avokat nuk ka të drejtë për shpërblim, përveç për kompensim të shpenzimeve të domosdoshme.

Neni 108

Vendimmarrja për shpenzimet e shkaktuara në procedurë para gjykatës më të lartë

Për obligimin për pagesën e shpenzimeve të cilat do të shkaktohen në gjykatën më të lartë, përfundimisht vendos ajo gjykatë në pajtim me dispozitat nga nenet 102, 103, 104, 105, 106 dhe 107 të këtij ligji.

Neni 109

Miratimi i dispozitave më të afërta për shpenzimet e procedurës penale

Lartësinë dhe mënyrën e përcaktimit të shpenzimeve të bëra reale në procedurën penale, i përcakton Kryetari i Gjykatës Supreme me mendimin e marrë paraprakisht nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë.

Kapitulli XI KËRKESA JURIDIKE PRONËSORE

Neni 110

Shqyrtimi i kërkesës juridike pronësore dhe lënda e saj

(1) Kërkesa juridike pronësore e krijuar për shkak të kryerjes së veprës penale do të shqyrtohet me propozim të personave të autorizuar në procedurë penale, nëse me këtë në mënyrë të konsiderueshme nuk do të prolongohej kjo procedurë.

(2) Kërkesa juridike pronësore mund t'i përkasë kompensimit të dëmit, kthimit të sendeve ose shfuqizimit të çështjes së caktuar juridike.

(3) Kërkesën juridike pronësore nga paragrafi (2) i këtij neni, në rast të sigurimit, i dëmtuari mund ta parashtojë edhe ndaj shoqatës së sigurimit.

Neni 111

Personat e autorizuar për parashtrimin e kërkesës juridike pronësore

(1) Kërkesë juridike pronësore në procedurë penale mund të parashtojë personi i cili është i autorizuar që ta realizojë kërkesën e tillë në kontest.

(2) Kur kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni e parashtron viktimi e veprës penale, në kërkesë do të theksojë nëse ka realizuar kompensim ose ka parashtruar kërkesë në pajtim me nenin 53 paragrafi (1) të këtij ligji.

Neni 112

Parashtrimi i kërkesës juridike pronësore

(1) Kërkesa juridike pronësore në procedurë penale i parashtrohet organit të cili parashtrohet kallëzimi penal ose gjykatës para të cilës mbahet procedura.

(2) Kërkesa mund të parashtrohet më së voni deri në përfundimin e seancës kryesore para gjykatës së shkallës së parë.

(3) Personi i autorizuar obligohet që ta shënojë kërkesën e tij sipas llojit dhe lartësisë dhe të parashtojë fakte.

(4) Nëse personi i autorizuar nuk parashtron kërkesë juridike pronësore në procedurën penale deri në parashtrimin e akuzës, do të njoftohet se këtë propozim mund ta parashtojë deri në përfundimin e seancës kryesore.

Neni 113

Heqja dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës juridike pronësore

(1) Personat e autorizuar nga neni 111 paragrafi (1) i këtij neni, deri në përfundimin e seancës kryesore mund të heqin dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës juridike pronësore në procedurën penale dhe ta realizojnë nëpërmjet kontestit. Në rast të heqjes dorë nga propozimi, propozim i tillë nuk mund të parashtrohet përsëri

(2) Nëse kërkesa juridike pronësore pas propozimit të parashtruar, ndërsa para përfundimit të seancës kryesore ka kaluar te personi tjetër, sipas rregullave të së drejtës pronësore, ai person do të thirret të deklarohet nëse i përmbahet propozimit. Nëse i thirruri në mënyrë të rregullt nuk paraqitet, konsiderohet se është tërhequr nga propozimi i parashtruar.

Neni 114

Vendimmarrja për kërkesën juridike pronësore

(1) Për kërkesën juridike pronësore vendos gjykata.

(2) Me aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata vendos plotësisht për kërkesën juridike pronësore ose pjesërisht, ndërsa për shumën e mbetur të kërkesës juridike pronësore e udhëzon personin e dëmtuar që ta realizojë në kontest. Nëse dëshmitë në procedurën penale nuk japin bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë ose të pjesëshëm të kërkesës juridike pronësore, ndërsa për sigurimin e tyre plotësues ekziston rreziku i prolongimit të paarsyeshëm të procedurës penale, gjykata do ta udhëzojë të dëmtuarin që kërkesën juridike pronësore ta realizojë në kontest.

(3) Kur gjykata do të miratojë aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza ose kur me aktvendim do ta ndërpresë procedurën penale, do ta udhëzojë të dëmtuarin që kërkesën juridike pronësore mund ta realizojë në kontest. Kur gjykata do të shpallet jokompetente për procedurën penale, do ta udhëzojë të dëmtuarin se kërkesën juridike pronësore mund ta paraqesë në procedurën penale që do ta fillojë ose vazhdojë gjykata kompetente.

Neni 115

Dorëzimi i sendeve

Nëse kërkesa juridike pronësore ka të bëjë me kthimin i sendit, ndërsa gjykata do të konstatojë se sendi i takon të dëmtuarit dhe se ndodhet te i akuzuari ose te ndonjëri nga pjesëmarrësit në veprën penale ose te personi të cilit ia kanë dhënë që ta ruajë, në aktgjykim do të përcaktojë që sendi t'i dorëzohet të dëmtuarit.

Neni 116

Shfuqizimi i punës juridike

Nëse kërkesa juridike pronësore ka të bëjë me shfuqizimin e punës së caktuar juridike, ndërsa gjykata heton se kërkesa është e bazuar, do të shqiptojë në aktgjykim shfuqizim të plotë ose të pjesëshëm të asaj pune juridike, me pasojat që dalin nga ajo, duke mos i prekur për të drejtat e personave të tretë.

Neni 117

Ndryshimi i aktgjykimit të plotfuqishëm me të cilin është vendosur për kërkesën juridike pronësore

(1) Aktgjykimin e plotfuqishëm me të cilin është vendosur për kërkesën juridike pronësore, gjykata në procedurën penale mund ta ndryshojë vetëm në rast të mjetit të jashtëzakonshëm juridik.

(2) Jashtë këtij rasti i akuzuari, përkatësisht trashëgimtarët e tij mund të kërkojnë vetëm në kontest që aktgjykimi i plotfuqishëm i gjykatës penale me të cilin është vendosur për kërkesën juridike pronësore që të ndryshohet, dhe atë nëse ekzistojnë kushte për përsëritje sipas dispozitave që vlejné për procedurën kontestimore.

Neni 118

Masat e përkohshme për sigurimin e kërkesës juridike pronësore

(1) Me propozim të prokurorit publik dhe të personave të autorizuar në procedurën penale sipas dispozitave me të cilat rregullohet realizimi, mund të caktohen masat e përkohshme për sigurimin e kërkesës juridike pronësore që është bërë për shkak të kryerjes së veprës penale.

(2) Aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, e miraton gjatë procedurës hetimore gjykatësi i procedurës paraprake. Pas ngritjes së akuzës, aktvendimin e miraton jashtë seancës kryesore kryetari i këshillit, ndërsa në seancën kryesore këshilli.

(3) Ankesa ndaj aktvendimit për masa të përkohshme nuk e pengon zbatimin e aktvendimit.

Neni 119

Kthimi i sendeve

(1) Nëse janë në pyetje sende të cilat padyshim i përkasin të dëmtuarit, ndërsa nuk shërbejnë si dëshmi në procedurën penale, sendet do t'i dorëzohen të dëmtuarit edhe para përfundimit të procedurës.

(2) Nëse më shumë të dëmtuar kontestohen për pronësinë e sendeve, do të udhëzohen në kontest, ndërsa gjykata në procedurën penale do të përcaktojë vetëm ruajtjen e sendeve si masë të përkohshme për siguri.

(3) Sendet të cilat shërbejnë si dëshmi do të konfiskohen përkohësisht dhe pas përfundimit të procedurës do t'i kthehen pronarit. Nëse gjësendi i i tillë domosdo i duhet pronarit, ai mund t'i kthehet edhe para përfundimit të procedurës, me obligim që me kërkesë ta kthejë atë.

Neni 120

Siguria e përkohshme ndaj personit të tretë

(1) Nëse i dëmtuari ka kërkesë ndaj personit të tretë sepse te ai ndodhen sendet e marra me veprën penale, ose pasi që me veprën penale ai ka ardhur te dobia pronësore, gjykata në procedurën penale me propozim të personave të autorizuar nga neni 111 paragrafi (1) të këtij ligji, sipas dispozitave që vlejné për përmbarim mund të përcaktojë masa të përkohshme sigurie edhe ndaj personit të tretë. Dispozitat nga neni 118 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji vlejné edhe në këtë rast.

(2) Në aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata ose do t'i shfuqizojë masat nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse më herët nuk janë shfuqizuar, ose do ta udhëzojë të dëmtuarin në kontest me atë që do të shfuqizohen këto masa, nëse nuk ngritet kontest në afatin e përcaktuar nga gjykata.

Kreu XII

MIRATIMI DHE KUMTIMI I VENDIMEVE

Neni 121

Llojet e vendimeve në procedurën penale

(1) Në procedurën penale vendimet miratohen në formë të aktgjykimit, aktvendimit, urdhrorit dhe urdhëresës ndëshkuese.

(2) Aktgjykim dhe urdhëresë ndëshkuese miraton vetëm gjykata, ndërsa aktvendime dhe urdhra miratojnë edhe organet tjera të cilat marrin pjesë në procedurën penale.

Neni 122

Këshillimi dhe votimi

(1) Vendimet e këshillit miratohen pas këshillimit me gojë dhe votimit. Vendimi miratohet kur për të kanë votuar shumica e anëtarëve të këshillit.

(2) Kryetari i këshillit udhëheq me këshillimin dhe votimin dhe voton i fundit. Ai obligohet të kujdeset që të shqyrtohen të gjitha çështjet në të gjithanshëm dhe plotësisht.

(3) Nëse në lidhje me çështjet e caktuara për të cilat votohet, votat ndahen në më shumë mendime të ndryshme, ashtu që asnjë nga ato nuk ka shumicë, çështjet do të ndahen dhe votimi do të përsëritet derisa të arrihet shumica. Nëse në këtë mënyrë nuk arrihet shumica, vendimi do të miratohet ashtu që votat të cilat janë më të pavolitshme për të akuzuarin do t'u bashkëngjiten votave që janë më pak të volitshme nga ato, derisa të arrihet shumica e nevojshme.

(4) Anëtarët e këshillit nuk mund të refuzojnë të votojnë për çështjet të cilat do t'i parashtrojë kryetari i këshillit, por nëse anëtari i këshillit i cili ka votuar që i akuzuari të lirohet ose që aktgjykimi të shfuqizohet dhe ka mbetur në pakicë, nuk obligohet që të votojë për sanksionin. Nëse nuk voton, do të merret sikur të jetë pajtuar me votën e cila është më e volitshme për të akuzuarin.

Neni 123

Radhitja e çështjeve për të cilat votohet

(1) Gjatë vendimmarrjes së pari votohet nëse gjykata është kompetente, nëse është e nevojshme që të plotësohet procedura, si dhe çështje tjera paraprake. Kur do të merret vendimi për çështjet paraprake, kalohet në zgjidhjen e punës kryesore.

(2) Gjatë vendimmarrjes për punën kryesore së pari do të votohet nëse i akuzuari ka kryer veprë penale dhe a është përgjegjës penal, e pastaj do të votohet për dënimin, për sanksionet tjera penale, për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesat juridike pronësore dhe për çështjet tjera për të cilat duhet të merret vendim.

(3) Nëse personi i njëjtë është i akuzuar për më shumë vepra penale, do të votohet për përgjegjësinë penale dhe për dënimin për çdonjërin prej këtyre veprave, e pastaj për dënimin e vetëm për të gjitha veprat.

Neni 124

Fshehtësia e votimit

(1) Këshillimi dhe votimi kryhet në mbledhje të fshehtë.

(2) Në lokalin ku bëhet këshillimi dhe votimi mund të marrin pjesë vetëm anëtarët e këshillit dhe mbajtësi i procesverbalit. Rezultatet e votimit janë të fshehta.

Neni 125

Shpallja e vendimeve gjyqësore

(1) Nëse vendimi është njoftuar me gojë, kjo do të shënohet në procesverbal ose në shkresë, ndërsa personi të cilit i është dhënë njoftimi do ta verifikojë këtë me nënshkrimin e tij. Nëse palët deklarojnë se nuk do të ankohen, përshkrimi i vërtetuar i vendimit të kumtuar me shkrim nuk do t'u dorëzohet, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Përshkrimet e vendimeve kundër të cilave lejohet ankesë dorëzohen me udhëzimin për të drejtën e ankesës. Ankesa e parashtruar në dobi të të akuzuarit do të konsiderohet me kohë kur është parashtruar në afatin e theksuar në udhëzim për të drejtën e ankesës, nëse në udhëzim është theksuar afat i cili është më i gjatë se afati i përcaktuar me ligj.

(3) Gjykatat obligohen që vendimet e miratuara në afat prej dy ditësh nga përgatitja t'i shpallin në ueb-faqen e gjykatës, në mënyrë të përcaktuar me ligj.

Neni 126

Qasja në vendimet gjyqësore

(1) Të gjitha aktgjykimet gjyqësore janë publike dhe të arritshme në ekzemplarë elektronikë ose të shtypur, përveç në rastet kur publiku është i përjashtuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, këtë ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

(2) Vendimet tjera gjyqësore janë të arritshme për shikim dhe përshkrim për çdo person të interesuar, përveç në raste kur publiku është i përjashtuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

Kreu XIII

DORËZIMI I DOKUMENTEVE DHE SHQYRTIMI I SHKRESAVE

Neni 127

Mënyrat e dorëzimit të dokumenteve

(1) Dokumentet dorëzohen me postë, në formë elektronike, nëpërmjet personit zyrtar të organit shtetëror i cili e dërgon letrën ose drejtpërdrejt te ai organ, ose nëpërmjet personit juridik me autorizime të veçanta të përcaktuara me ligj.

(2) Gjykata mund t'i kumtojë ndëshkim me para në lartësi prej 700 deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë personit nga paragrafi (1) i këtij neni, i cili nuk do të ndërmarrë veprime për realizimin e dorëzimit të dokumentit ose pa ndërgjegje do ta realizojë dërgimin e dokumentit, dhe me

(3) Pala të cilës personi nga paragrafi (1) i këtij neni me kryerjen e pandërgjegjshme të detyrës së dërgimit i shkakton shpenzime shtesë në procedurë, në afat prej 15 ditësh nga dita e njoftimit për mosrealizimin, përkatësisht për realizimin e pandërgjegjshëm të dërgimit, në procedurën e njëjtë nga gjykata mund të kërkojë që personi nga paragrafi (1) i këtij neni t'ia kompensojë shpenzimet e zmadhuara në pajtim me rregullat e përgjithshme për kompensim të dëmit. Gjykata për kërkesën do të vendos me aktvendim në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të saj. Kjo nuk e përjashton të drejtën e palës që në procedurë tjetër me padi në pajtim me ligjin të kërkojë

kompensim të dëmit të shkaktuar me realizimin e pandërgjegjshëm të dërgimit, nga personi nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Gjykata mban evidencë për ndëshkimet e shqiptuara nga paragrafi (2) i këtij neni për personat nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Tri ndëshkime me para të shqiptuara për personin e njëjtë në pajtim me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, paraqet bazë për ngritjen e procedurës disiplinore në pajtim me këtë dhe me ligj tjetër. Kryetari i gjykatës me detyrë zyrtare i njofton administratorin e gjykatës, Odën e Noterëve të Republikës së Maqedonisë, Odën e Përmbaruesve dhe personin përgjegjës të personi juridik për ngritjen e procedurës disiplinore.

(6) Ftesën për seancën kryesore ose ftesat tjera gjykata mund t'ia kumtojë edhe me shkrim personit i cili ndodhet para gjyqit, me këshillën për pasojat e mosardhjes. Thirrja e bërë në këtë mënyrë do të shënohet në procesverbal të cilin personi i thirrur do ta nënshkruajë, përveç nëse kjo thirrje është shënuar në procesverbalin e seancës kryesore. Konsiderohet se me këtë është bërë dorëzimi i plotfuqishëm.

Neni 128

Vendi i dorëzimit të dokumenteve

(1) Organi i cili e ka përgatitur dokumentin ia dorëzon personit të cilit i dedikohet (pranuesit) në adresën e vendbanimit ose vendqëndrimit të tij ose në adresën ku punon, ndërsa mund të dorëzohet edhe në adresë tjetër në të cilën mund të gjendet pranuesi ose në adresën e kutisë elektronike të pranuesit.

(2) Dërgimi i dokumenteve të avokatët, personat juridikë, organet e administratës shtetërore dhe të personat juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë autorizime publike, bëhet në formë elektronike në kutinë elektronike të regjistruar në pajtim me ligjin. Dërgimi në formë elektronike bëhet nëpërmjet sistemit informativ të organit kompetent në adresën e kutisë elektronike të pranuesit të dërgesës.

(3) Nëse i akuzuari, i dëmtuari, dëshmitari, eksperti ose personat tjerë fizikë të cilët marrin pjesë në procedurë, në seancën kryesore, të këshilluar nga gjykata, pajtohen që dërgimi t'u bëhet në formë elektronike dhe të dërgojnë adresën e postës elektronike, dërgimi të këta persona do të vazhdojë të bëhet në formë elektronike, nëpërmjet sistemit informativ të gjykatës.

(4) Nëse nuk ekzistojnë mundësi teknike, dërgimi i dokumenteve të avokatët, personat juridikë, organet e administratës shtetërore dhe të personat juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë autorizime publike, bëhet në adresën e regjistruar në regjistër. Nëse dorëzimi nuk ka sukses në atë adresë, dokumenti do të paraqitet në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe pas skadimit të tetë ditëve nga dita e paraqitjes konsiderohet se është kryer dorëzimi i rregullt.

(5) Personave ushtarakë, pjesëtarëve të policisë dhe policisë gjyqësore, pjesëtarëve të rojës në institucionet në të cilat janë vendosur persona të privuar nga liria dhe punëtorëve të komunikacionit tokësor, ujor dhe ajror, dorëzimi i dokumenteve u bëhet personalisht, dhe me njoftimin e eprorit të drejtpërdrejtë.

(6) Për personat e privuar nga liria dorëzimi bëhet në gjykatë ose në drejtorinë e institucionit ku janë vendosur.

(7) Për personat të cilët kanë imunitet diplomatik në Republikën e Maqedonisë, nëse marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë nuk e përcaktojnë ndryshe, dorëzimi bëhet nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

(8) Dorëzimi për shtetasit e Republikës së Maqedonisë jashtë vendit, nëse nuk zbatohet procedura e paraparë në dispozitat për bashkëpunim ndërkombëtar në lëndën penale, bëhet me postë, në formë elektronike ose me ndërmjetësimin e përfaqësisë diplomatike ose konsullore të Republikës së Maqedonisë në shtetin e huaj, me kusht që shteti i huaj të mos e kundërshtojë mënyrën e tillë të dorëzimit dhe personi për të cilin bëhet dorëzimi të pajtohet vullnetarisht që ta pranojë dokumentin. Punëtori i autorizuar në përfaqësinë diplomatike ose konsullore e nënshkruan dërgesën si dërgues, nëse dokumenti është dorëzuar në përfaqësi, e nëse letra është dorëzuar me postë, këtë e verifikon në dërgesë. Dorëzimi për personin juridik i cili ka seli jashtë vendit, mund të bëhet nëpërmjet përfaqësisë së tij në Republikën e Maqedonisë.

(9) Për personat e përfshirë në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve dorëzimi bëhet nëpërmjet organit i cili e realizon mbrojtjen.

Neni 129

Dorëzimi i dokumentit

(1) Dokumenti i dorëzohet drejtpërdrejt personit të cilit i është dërguar, ndërsa ai obligohet që ta pranojë. Nëse personi nuk gjendet aty ku duhet të bëhet dorëzimi, dorëzuesi do t'ia dorëzojë ndonjërit prej anëtarëve të amvisërisë së tij më të moshuar se 16 vjet, të cilët obligohen që ta pranojnë dokumentin. Nëse ata nuk janë në shtëpi, letra i dorëzohet kujdestarit ose fqinjit nëse ata pajtohen që ta pranojnë. Nëse dorëzimi bëhet në vendin e punës të personit të cilit duhet t'i dorëzohet dokumenti, ndërsa ai person nuk gjendet aty, dorëzimi mund t'i bëhet personit të autorizuar për pranimin e postës i cili obligohet që ta pranojë letrën ose personit i cili është i punësuar në vendin e njëjtë, nëse ai pajtohet që ta pranojë letrën. Nëse personi nuk gjendet në adresën në të cilën duhet t'i kryhet dorëzimi, personi njoftohet që të vijë vijë në ditën dhe orën e caktuar, lokal të organit kompetent, për marrjen e dokumentit. Nëse personi nuk vepron sipas njoftimit konsiderohet se dorëzimi është kryer në ditën dhe orën e shënuar nënjoftim. Me këtë konsiderohet se dokumenti është dorëzuar.

(2) Nëse konstatohet se personi të cilit duhet t'i dorëzohet dokumenti mungon dhe se personat nga paragrafi (1) i këtij neni për këtë shkak nuk mund t'ia dorëzojnë dokumentin me kohë, dokumenti do të kthehet me shënimin se ku ndodhet personi i cili mungon.

(3) Nëse dorëzimi nuk kryhet sipas paragrafit (1) të këtij neni, organi i cili e udhëheq procedurën do ta paraqesë letrën në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe pas skadimit të tetë ditëve nga dita e paraqitjes konsiderohet se është bërë dorëzimi i rregullt.

Neni 130

Dorëzimi të i akuzuari

(1) Nëse organi i cili e udhëheq procedurën e të akuzuarit nuk mund t'ia dorëzojë dokumentin sepse nuk e ka paraqitur ndryshimin e adresës ose haptazi në mënyrë tjetër i ik pranimin të dokumentit, dokumenti dhe aktgjykimi

përveç në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni, do të paraqitet në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe pas skadimit të tetë ditëve nga dita e paraqitjes konsiderohet se është bërë dorëzimi i rregullt.

(2) Nëse të akuzuarit i cili nuk ka mbrojtës duhet t'i dorëzohet aktgjykimi me të cilin i është kumtuar dënim me burg ose urdhëresë e dhënë ndëshkuese, ndërsa dorëzimi nuk mund të bëhet në adresën e tij të paraqitur, gjykata me detyrë zyrtare do t'i caktojë avokat i cili do ta kryejë këtë detyrë derisa të zbulohet adresa e të akuzuarit. Avokatit të caktuar do t'i përcaktohet afat i nevojshëm për njoftim me shkresat, i cili nuk mund të jetë më i shkurtë se tetë ditë, e pastaj aktgjykimi do t'i dorëzohet avokatit të caktuar dhe procedura do të vazhdojë.

(3) Nëse i akuzuari ka avokat, aktakuzën, propozim-akuzën, padinë private dhe të gjitha vendimet tjera nga dorëzimi i të cilave rrjedh afati për ankesë, si dhe ankesë të palës kundërshtarë e cila i dorëzohet për përgjigje, do t'i dorëzohen edhe avokatit edhe të akuzuarit, sipas nenit 127 të këtij ligji. Në këtë rast afati për paraqitjen e mjetit juridik, përkatësisht përgjigje të ankesës, rrjedh nga dita e dorëzimit për të akuzuarin. Nëse të akuzuarit i është kumtuar masa e paraburgimit ose është në vuajtje të dënimit me burgim, afati rrjedh nga dita e dorëzimit avokatit.

(4) Nëse dokumenti duhet t'i dorëzohet avokatit të të akuzuarit, ndërsa ai ka më shumë avokatë, mjafton që t'i dorëzohet njërit prej tyre.

(5) Kur të akuzuarit i gjykohet në mungesë, dokumentet i dorëzohen avokatit të tij dhe me këtë konsiderohet se është bërë dorëzim i rregullt.

Neni 131

Vërtetimi për dorëzimin e kryer

(1) Vërtetimin për dorëzimin e kryer e nënshkruajnë pranuesi dhe dërguesi. Pranuesi do ta shënojë vet në dërgesë ditën e pranimit.

(2) Nëse pranuesi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë, dorëzuesi do të nënshkruajë vet, do ta shënojë ditën e pranimit dhe të shënojë se pse nuk e ka nënshkruar pranuesi.

(3) Nëse pranuesi ose personi i cili obligohet që ta pranojë dokumentin refuzon ta pranojë letrën ose ta nënshkruajë dërgesën, dërguesi dokumentin do ta lë në vendin në të cilin e ka takuar pranuesin ose personin i cili obligohet që ta pranojë dokumentin dhe këtë do ta shënojë në dërgesë dhe do ta shënojë ditën, orën dhe vendin e lënies së dokumentit dhe me këtë dorëzimi është kryer.

(4) Dorëzimi në formë elektronike në postë elektronike konsiderohet e kryer në ditën e pranimit të letrës në formë elektronike.

(5) Sistemi informatik i organit kompetent njëkohësisht me dërgimin e dokumentit të pranuesi i dërgesës, në adresën e tij elektronike dërgon edhe njoftim se nga sistemi informatik të organit kompetent është dërguar dokument me shkrim të cilin poseduesi i adresës doemos duhet ta marrë.

(6) Posta elektronike nag sënduku elektronik doemos duhet të merret më së voni tetë ditë nga dita e dërgimit të saj.

(7) Në njoftimin nga paragrafi (5) të këtij neni, pranuesi i dërgesës paralajmërohet se nëse postën elektronike nga sënduku elektronik nuk merret në afatin nga paragrafi (6) të këtij neni, dërgimi do të konsiderohet i kryer.

(8) Pranuesi i postës elektronike me nënshkrimin e vet elektronik e dëshmon identitetin e vet, kryen shikim në sëndukun e vet elektronik dhe në

mënyrë elektronike e nënshkruan dokumentin që e dërgon te organi kompetent, përkatësisht e konfirmon pranimin e postës elektronike.

(9) Nëse dokumenti që dorëzohet në mënyrë elektronike përmban shtojca për të cilat nuk ka mundësi teknike të dorëzohet në mënyrë elektronike, organi kompetent në dokumentin që e dorëzon do ta njoftojë pranuesin selia, vendbanimi apo vendqëndrimi i të cilit gjenden selinë e organit kompetent, se shtojcat duhet t'i marrë menjëherë të organi kompetent në afat prej tri ditësh nga dita e njoftimit, e nëse në atë afat nuk i merr, konsiderohet se shtojcat janë dorëzuar.

(10) Dorëzimi i shtojcave nga paragrafi (9) të këtij neni te pranuesi selia, vendbanimi dhe vendqëndrimi i të cilit është jashtë selisë së organit kompetent, kryhet në njërën nga mënyrat e përcaktuara në nenin 128 paragrafi (1) të këtij ligji.

Neni 132

Dorëzimi nëpërmjet pjesëmarrësit në procedurë, përfaqësuesit ligjor dhe të autorizuarit

(1) Ftesat për personat të cilët marrin pjesë në procedurë, mund t'i dorëzohen pjesëmarrësit në procedurë i cili pajtohet t'ia dorëzojë atij të cilit i dedikohet, nëse organi konsideron se në këtë mënyrë është siguruar pranimi i tyre.

(2) Për ftesën për seancën kryesore ose për ftesë tjetër, si dhe për vendimin për prolongimin e seancës kryesore ose të veprimeve tjera të caktuara, personat e theksuar në paragrafin (1) të këtij neni mund njoftohen me telegram, postë elektronike ose me telefon, nëse sipas rrethanave mund të supozohet se njoftimin e bërë në këtë mënyrë do ta pranojë personi të cilit i dedikohet.

(3) Dispozitat nga nenet (1) dhe (2) të këtij neni kanë të bëjnë edhe me të akuzuarin, nëse me këtë pajtohet prerazi në procesverbal para gjykatës.

(4) Për thirrjen dhe dorëzimin e vendimit të kryera në mënyrën e paraparë në paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, do të hartohet vërejtje zyrtare në shkresë.

(5) Ndaj personit i cili është njoftuar sipas paragrafëve (1), (2) ose (3) të këtij neni, përkatësisht të cilit i dedikohet vendimi, mund të paraqiten pasoja të dëmshme të parapara për lëshimin vetëm nëse konstatohet se ai e ka pranuar me kohë ftesën, përkatësisht vendimin dhe se është këshilluar për pasojat e lëshimit.

(6) Gjykata obligohet që në lokalet e gjykatës çdo ditë pune të gjithë pjesëmarrësve në procedurë në formë elektronike ose në mënyrë tjetër t'u mundësojë qasje në evidencën e seancave të konvokuara.

(7) Nëse i dëmtuari, ose paditësi privat ka përfaqësues ligjor ose të autorizuar, dorëzimi do t'i bëhet përfaqësuesit ligjor, përkatësisht të autorizuarit, e nëse ka më shumë, vetëm njërit prej tyre.

Neni 133

E drejta e të dëmtuarit dhe viktimës për shqyrtimin e shkresave dhe sendeve

Të drejtë të shqyrtimit të shkresave dhe sendeve të cilat shërbejnë si dëshmi në procedurë kanë viktimat, i dëmtuari dhe i autorizuari i tyre pasi që

viktima, përkatësisht i dëmtuari janë marrë në pyetje, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Kreu XIV ZBATIMI I VENDIMEVE

Neni 134

Plotfuqishmëria dhe zbatimi i vendimeve

(1) Aktgjykimi dhe aktvendimi bëhen të plotfuqishme kur nuk mund të përgënjeshtrohen me ankesë ose kur nuk lejohet ankesë.

(2) Aktgjykimi i plotfuqishëm zbatohet kur është kryer dorëzimi i tij dhe kur për zbatim nuk ekzistojnë pengesa ligjore. Nëse nuk është paraqitur ankesë ose palët janë tërhequr ose kanë hequr dorë nga ankesa, aktgjykimi është zbatues me skadimin e afatit për ankesë, përkatësisht nga dita e tërheqjes ose heqjes dorë nga ankesa e paraqitur.

(3) Nëse gjykata e cila e ka miratuar aktgjykimin në shkallë të parë nuk është kompetente për zbatimin e tij, do t'ia dorëzojë organit i cili është kompetent për zbatim përshkrim të verifikuar të aktgjykimit me vërtetimin për zbatueshmëri.

(4) Nëse oficeri më i ri rezerv, oficeri ose nëpunësi ushtarak është i gjykuar me dënim, gjykata do t'i dorëzojë përshkrim të vërtetuar të aktgjykimit të plotfuqishëm organit kompetent për çështjet e mbrojtjes.

(5) Nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, aktvendimet zbatohen kur do të bëhen të plotfuqishme. Urdhrat zbatohen menjëherë nëse organi i cili e ka dhënë urdhrin nuk urdhëron ndryshe.

(6) Aktvendimet dhe urdhrat, nëse nuk është përcaktuar ndryshe, i zbatojnë organet të cilat i kanë marrë ato vendime. Nëse gjykata me aktvendim vendos për shpenzimet e procedurës penale, arkëtimi i këtyre shpenzimeve bëhet sipas dispozitave të nenit 135 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji.

Neni 135

Zbatimi i aktgjykimit në pjesën e shpenzimeve të procedurës penale, konfiskimit të dobisë pronësore dhe kërkesave juridike pronësore

(1) Zbatimin e aktgjykimit në pjesën e shpenzimeve të procedurës penale, të konfiskimit të dobisë pronësore dhe kërkesave juridike pronësore e kryen organi kompetent i përcaktuar me ligj.

(2) Arkëtimi i detyrueshëm i shpenzimeve të procedurës penale, në dobi të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë bëhet me detyrë zyrtare. Shpenzimet e arkëtimit të detyrueshëm paraprkishtë paguhen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(3) Nëse me aktgjykim nuk është caktuar afati për plotësimin vullnetar të obligimit, obligimi doemos duhet të plotësohet në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. Me skadimin e këtij afati aktgjykimi në këtë pjesë bëhet zbatues.

(4) Personi të cilit me aktgjykim i është urdhëruar pagesa e shpenzimeve të procedurës penale ose të cilit i është konfiskuar dobia pronësore, me fillimin e zbatueshmërisë së aktgjykimit, gjykata e cila e ka miratuar aktgjykimin do ta thirr që të dorëzojë dëshmi për plotësimin e obligimeve me kohë.

(5) Nëse personi nga paragrafi (4) i këtij neni nuk e plotëson obligimin në afatin e paraparë, gjykata e cila e ka miratuar aktgjykimin me detyrë zyrtare do t'ia dorëzojë aktgjykimin, me vërtetimin për zbatueshmërinë e tij, organit kompetent për zbatim nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Nëse nga personi nga paragrafi (4) i këtij neni, përkohësisht janë konfiskuar para ose vlera tjera të cilat gjenden në gjykatë, sekretari i gjykatës do të urdhërojë arkëtimin e kërkesave nga paragrafi (1) i këtij neni, nga këto mjete. Nga kjo shumë së pari arkëtohet kërkesa juridike pronësore, pastaj dobia e konfiskuar pronësore, pastaj shpenzimet e procedurës. Nëse nga paratë e konfiskuara nuk mund të paguhen plotësisht këto kërkesa, për pjesën e papaguar do të veprohet sipas dispozitave nga paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni.

(7) Nëse në aktgjykim është shqiptuar masë e veçantë konfiskim i sendeve, gjykata e cila e ka shqiptuar aktgjykimin në shkallë të parë do të vendosë nëse sendet e tilla do të shiten sipas dispozitave të cilat vlejnë për zbatimin ose do t'u dorëzohen organeve shtetërore, muzeve kriminalistike ose institucioneve tjera ose do të shkatërrohen. Paratë e fituara me shitjen e sendeve futen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

(8) Dispozita nga paragrafi (7) i këtij neni në mënyrë adekuate do të zbatohet edhe kur do të merret vendim për konfiskimin e sendeve në bazë të nenit 529 të këtij ligji.

(9) Vendimi i plotfuqishëm për konfiskimin e sendeve, përveç në procedurë për mjet juridik të jashtëzakonshëm, mund të ndryshohet me vendim në procedurë kontestimore nëse paraqitet kontest për pronësinë e sendeve të konfiskuara.

Neni 136

Dyshimi për lejimin e zbatimit

(1) Nëse paraqitet dyshim për lejimin e zbatimit të vendimit gjyqësor ose llogaritjen e dënimit, ose nëse në aktgjykimin e plotfuqishëm nuk është vendosur llogaritja e paraburgimit ose e dënimit të vuajtur më herët, ose llogaritja nuk është kryer me rregull, për këtë do të vendosë me aktvendim të veçantë kryetari i këshillit të gjykatës i cili ka gjykuar në shkallë të parë, përkatësisht gjykatësi individual. Ankesa nuk e ndalon zbatimin e aktvendimit, përveç nëse gjykata nuk e ka përcaktuar ndryshe.

(2) Nëse paraqitet dyshim për interpretimin e vendimit gjyqësor, për këtë vendos gjykata që e ka miratuar vendimin e plotfuqishëm.

Neni 137

Përshkrimi i vendimit për kërkesën juridike pronësore

Kur vendimi me të cilin është vendosur për kërkesë juridike pronësore është bërë i plotfuqishëm, i dëmtuari mund të kërkojë që gjykata që ka vendosur në shkallë të parë t'i japë përshkrim të verifikuar të vendimit me shënimin që vendimi është zbatues.

Neni 138

Miratimi i dispozitave për evidencën ndëshkuese

Mënyrën e udhëheqjes, rregullimit dhe ruajtjes së evidencës ndëshkuese e përcakton ministri i Drejtësisë.

Kapitulli XV MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 139

Përpunimi i të dhënave personale për nevojat e procedurës penale

(1) Gjykata, prokuroria dhe organet tjera me autorizime të veçanta sipas këtij ligji, grumbullojnë, përpunojnë dhe ruajnë të dhëna personale për nevojat e procedurës penale, duke mbajtur llogari, që natyra dhe vëllimi i të dhënave të jetë adekuat me nevojat në rastin konkret.

(2) Përmbledhjet të cilat përmbajnë të dhëna personale për nevojat e procedurës penale themelohen me ligj.

(3) Shpallja e aktgjytimeve në formë elektronike mund të bëhet vetëm në internet ose rrjet tjetër komunikues, me ç'rast nuk guxon të ekzistojë mundësi për kërkim digjital sipas kategorive të të dhënave personale, kategorive të personave ose për të dhëna të individuale personale.

(4) Aktgjykimet e shpallura në formë elektronike në internet ose rrjet tjetër komunikativ shlyhen, pas skadimit të afatit për shlyerjen e gjykitimit sipas dispozitave të Kodit penal.

Neni 140

Saktësia, ndryshimi, shlyerja dhe ruajtja e të dhënave personale

(1) Të dhënat personale të cilat nuk janë të sakta ose të cilat janë grumbulluar në kundërshtim me ligjin, doemos duhet menjëherë që të ndryshohen ose shlyhen.

(2) Saktësia e të dhënave në përmbledhjen e të dhënave personale kontrollohet çdo pesë vjet , në mënyrë të përcaktuar me ligjin me të cilin është themeluar përmbledhja.

(3) Afatet për ruajtjen dhe shlyerjen e të dhënave personale nga përmbledhjet, përcaktohen me ligjin me të cilin është themeluar përmbledhja.

Neni 141

Dhënia e të dhënave personale shfrytëzuesve

(1) Të dhënat personale të grumbulluara për nevojat e procedurës penale mund t'u jepen për shfrytëzim organeve shtetërore dhe personave tjerë juridikë dhe fizikë vetëm nëse kjo lejohet me ligj.

(2) Të dhënat personale nga paragrafi (1) i këtij neni mund të shfrytëzohen, në pajtim me ligjin, në procedura tjera penale në procedurë për bashkëpunim ndërkombëtar në materie penale dhe bashkëpunim policor ndërkombëtar, ndërsa në procedura tjera gjyqësore mund të shfrytëzohen vetëm nëse lënda në procedurën tjetër gjyqësore është e lidhur drejtpërdrejt me lëndën në procedurën penale.

(3) Të dhënat personale të grumbulluara kryesisht në bazë të përcaktimit të identitetit, kontrollimit trupor ose analizës gjenetike molekulare, pas përfundimit të procedurës penale mund të shfrytëzohen në pajtim me ligjin, vetëm për zbulimin ose parandalimin e veprave penale.

Neni 142

E drejta e informimit të subjektit të të dhënave personale

(1) Nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe, prokuroria publike ose gjykata, do ta informojnë subjektin e të dhënave personale me kërkesë të tij,

për atë nëse të dhënat e tij personale janë grumbulluar, përpunuar ose ruajtur për nevojat e procedurës penale.

(2) Prokuroria publike ose gjykata nuk mund ta informojnë subjektin për të dhënat personale nga paragrafi (1) i këtij neni, para skadimit të një viti nga dita e miratimit të urdhrin për zbatimin e procedurës hetimore.

Neni 143

Mbikëqyrja e përpunimit të të dhënave personale

(1) Mbikëqyrjen e përpunimit të të dhënave personale dhe mbrojtjen e tyre të përcaktuar me këtë dhe me ligj tjetër, e kryen Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

(2) Nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, për grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale për nevojat e procedurës penale, në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale dhe dispozitat tjera.

SEKSIONI G. MASAT DHE VEPRIMET E PROCESIT PËR SIGURIMIN E PERSONAVE DHE DËSHMIVE

Kreu XVI

MASAT PËR SIGURIMIN E PREZENCËS SË PERSONAVE DHE PËR UDHËHEQJEN PA PENGESA TË PROCEDURËS PENALE

1. Dispozita e përbashkët

Neni 144

Masat për sigurimin e prezencës së të akuzuarit

(1) Masat të cilat mund të ndërmerren ndaj të akuzuarit për sigurimin e prezencës së tij dhe për udhëheqjen pa pengesë të procedurës penale janë ftesa, masat parandaluese, të garancisë, arrestimit, heqjes së lirisë, mbajtjes, paraburgimit afatshkurtër, paraburgimit shtëpiak dhe paraburgimit.

(2) Gjatë vendimmarrjes se cilën nga masat do ta zbatojë, organi kompetent do të përmbahet kushteve të përcaktuara për zbatimin e masave të vezanta, duke mbajtur llogari që të mos zbatohet masë më e rëndë nëse mundet që qëllimi i njëjtë të arihet me masë më të butë. Gjkata ndaj të akuzuarit mund të përcaktojë njëkohësisht më shumë masa nga paragrafi (1) i këtij neni, përveç kur do ta përcaktojë masën paraburgim.

(3) Këto masa do të hiqen me detyrë zyrtare kur do të pushojnë kushtet ligjore për përcaktimin e masave ose do të zëvendësohen me masë tjetër kur do të fillojnë kushtet për këtë.

(4) Kur i akuzuari nuk i përmbahet masës së përcaktuar për sigurimin e prezencës, gjykata mund të përcaktojë masa për sigurimin e prezencës.

(5) Për arrestimin, heqjen e lirisë dhe mbajtjen, i akuzuari ka të drejtë ta njoftojë familjen ose personin tjetër të afërt.

2. Ftesa

Neni 145

Përmbajtja dhe dërgimi i ftesës

(1) I akuzuari dhe personat tjerë të cilët marrin pjesë në procedurën penale ftohen me ftesë. Ftesën e dërgon personi i cili e udhëheq procedurën.

(2) Thirrja bëhet me dorëzimin e ftesës së mbyllur me shkrim e cila l përmban: emrin emrin e organit që bën thirrje, emrin dhe mbiemrin e personit të thirrur, emrin e veprës penale që i ngarkohet, vendin ku personi i thirrur duhet të vijë, ditën dhe orën kur duhet të vijë, shënimin se në çfarë cilësie thirret dhe paralajmërimin se në rast të mosardhjes mund të arrestohet, vulën dhe nënshkrimin zyrtar të personit përgjegjës, në organin i cili e thirr personin përkatësisht të gjykatës kompetente dhe gjykatësit i cili e thirr.

(3) Kur i akuzuari thirret për herë të parë do të këshillohet në ftesë që të marrë avokat dhe se avokati mund të marrë pjesë në marrjen e tij në pyetje.

(4) Personi i thirrur obligohet që menjëherë ta njoftojë organin i cili e ka thirrur për adresën e ndryshuar, si dhe për qëllimin për ta ndryshuar vendbanimin ose vendqëndrimin. Për këtë do të këshillohet personi i thirrur gjatë marrjes në pyetje për herë të parë, përkatësisht gjatë dorëzimit të propozimkuzës ose padisë private, me atë që do të paralajmërohet për pasojat e përcaktuara me këtë ligj.

(5) Nëse personi i ftuar nuk është në gjendje që t'i përgjigjet thirrjes për shkak të sëmundjes ose pengesës tjetër të paevitueshme, ai mund të merret në pyetje në vendin ku ndodhet, ose për të do të sigurohet transport deri te selia e organit i cili e thirr ose deri në vendin tjetër ku ndërmerret veprimi.

(6) Sipas nevojës gjykata mund të urdhërojë kontrollim trupor ose ekspertizë për kontrollin e rrethanave nga paragrafi (5) i këtij neni.

3. Masat e parandalimit

Neni 146

Llojet e masave të parandalimit

(1) Për realizimin e qëllimit të paraparë në nenin 144 paragrafi (1) i këtij ligji, gjykata mund ta përcaktojë ndonjërin nga masat e parandalimit si vijojnë:

- 1) ndalim për lëshimin e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin;
- 2) obligim të të akuzuarit që të lajmërohet kohëpaskohe te personi i caktuar zyrtar ose te organi shtetëror kompetent;
- 3) konfiskim i përkohshëm i dokumentit të udhëtimit ose tjetër për kalimin e kufirit shtetëror, përkatësisht ndalim për dhënien e tij;
- 4) konfiskim i përkohshëm i patentë shoferit, përkatësisht ndalim për lëshimin e tij;
- 5) ndalim për vizitën e vendit ose zonës së caktuar;
- 6) ndalim për afrimin ose vendosjen e kontakteve ose lidhjeve me persona të caktuar dhe
- 7) ndalim për ndërmarrjen e aktiviteteve të caktuara të punës të cilat janë të lidhura me veprën penale.

(2) Masat e parandalimit mund të zgjasin derisa ekziston nevoja, ndërsa më së gjati deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

(3) Gjykata me detyrë zyrtare në çdo dy muaj rishqyrton nëse ka nevojë për zgjatjen e masës së parandalimit dhe ajo mund të hiqet edhe para afatit nga paragrafi (2) i këtij neni, nëse ka pushuar nevoja ose më nuk ekzistojnë baza ligjore për zbatim.

(4) Me masat e parandalimit nuk mund të kufizohet e drejta e të akuzuarit për komunikim papengesë me avokatin e tij.

(5) Masat e parandalimit me propozimin e prokurorit publik gjatë procedurës hetimore i përcakton gjykatësi në procedurën paraprake, ndërsa pas hyrjes së akuzës në fuqi juridike ose pas parashtrimit të propozim akuzës deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, gjykata para të cilës udhëhiqet procedura.

(6) Kundër aktvendimit me të cilin përcaktohen ose hiqen masat e parandalimit, palët kanë të drejtë anekese në afat prej tri ditësh. Për ankesën e aktvendimit të cilin e ka miratuar gjykatësi i procedurës paraprake ose gjykatësi individual, vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) i këtij ligji, ndërsa për ankesën e aktvendimit të cilin e ka miratuar këshilli gjyqësor, vendos këshilli në gjykatën më të lartë të drejtpërdrejtë.

Neni 147

Përmbajtja e aktvendimit për përcaktimin e masës së parandalimit

(1) Me aktvendimin me të cilin përcaktohet masa e parandalimit ndalim i lëshimit të vendqëndrimit, përkatësisht vendbanimit, gjykata do ta përcaktojë vendin në të cilin i akuzuari duhet doemos të qëndrojë derisa zgjat masa, si dhe kufijtë jashtë të cilëve nuk mund të largohet.

(2) Me aktvendimin me të cilin përcaktohet masa e parandalimit që i akuzuari kohëpaskohe të lajmërohet te personi i caktuar ose organi kompetent shtetëror, gjykata do të përcaktojë person zyrtar të cilit i akuzuari doemos duhet t'i lajmërohet dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës së lajmërimit.

(3) Aktvendimin me të cilin përcaktohet masa e parandalimit konfiskim i përkohshëm i dokumentit për udhëtim ose dokumentit tjetër për kalimin e kufirit shtetëror, përkatësisht ndalimit për dhënien e tij, gjykata e miraton nëse ekziston rreziku për ikje. Në aktvendim shënohen të dhënat për dokumentin e udhëtimit. Dokumenti i konfiskuar i udhëtimit ruhet te organi i cili e ka konfiskuar dhe kthehet me vendim të gjykatës kur do të pushojnë shkaqet për të cilat është konfiskuar. Ndalimi për dhënien e dokumentit të udhëtimit pushon me vendim të gjykatës. Ankesa kundër konfiskimit të dokumentit të udhëtimit ose ndalimit për dhënien e tij, nuk e pengon zbatimin e aktvendimit.

(4) Me aktvendimin me të cilin përcaktohet masa e parandalimit ndalim i vizitës së vendit ose zonës së caktuar, gjykata do ta përcaktojë vendin ose zonën si dhe pikën në të cilën nuk guxon të afrohet.

(5) Me aktvendimin me të cilin përcaktohet masa e parandalimit ndalim për afrimin ose vendosjen, përkatësisht mbajtjen e kontakteve ose lidhjeve me persona të caktuar, gjykata do ta përcaktojë largësinë, vendin ose zonën deri në të cilën i akuzuari nuk guxon të afrohet, përkatësisht do të theksojë të dhëna më të afërta për personin ose personat me të cilët ndalohet vendosja ose mbajtja e kontakteve ose lidhjeve.

(6) Me aktvendimin me të cilin përcaktohet masa e parandalimit ndalim për ndërmarrjen e aktiviteteve të caktuara të punës të cilat janë të lidhura me veprën penale, gjykata më hollësisht do ta përcaktojë llojin dhe lëndën e atyre aktiviteteve të punës.

Neni 148

Dorëzimi dhe zbatimi i aktvendimit

(1) Aktvendimin me të cilin përcaktohen masat e parandalimit, organi kompetent ia dorëzon organit kompetent për zbatimin e tyre.

(2) Masat e parandalimit i zbaton policia.

(3) Masën e parandalimit obligimi i të akuzuarit që kohëpaskohe t'i paraqitet personit të caktuar zyrtar ose organit shtetëror kompetent, e zbaron policia ose organ tjetër shtetëror kompetent të cilit i akuzuari duhet t'i paraqitet.

Neni 149

Kontrolli i përmbartimit

(1) Gjykata në çdo kohë mund të urdhërojë kontrollimin e zbatimit të masës së parandalimit dhe të kërkojë raport nga policia, ose nga organi tjetër shtetëror kompetent i cili i zbaton masat. Raporti menjëherë i dorëzohet gjykatës e cila e ka caktuar masën e qëndrueshmërisë.

(2) Për veprimin e të akuzuarit në kundërshtim me ndalimet ose mosplotësimin e obligimeve të përcaktuara me masat e parandalimit, organi shtetëror kompetent i cili e realizonin zbatimin e masave menjëherë e njofton gjykatën.

(3) Personit i cili i shkel masat e parandalimit të përcaktuara ndaj personit të akuzuar, organi kompetent me aktvendim të veçantë do t'ia ndalojë aktivitetet. Nëse personi vepron në kundërshtim me aktvendimin, do të ndëshkohet me dënim me para nga neni 88 paragrafi (1) i këtij ligji.

4. Garancia

Neni 150

Përcaktimi i garancisë

(1) Gjykata me propozimin e palëve, mund të përcaktojë garanci kundër personit për të cilin është miratuar urdhër për zbatimin e procedurës hetimore nëse vlerëson se ekziston dyshim i bazuar se ka kryer veprën penale, dhe kur ekzistojnë:

1) rrethana të cilat paraqesin rrezik për ikje ose

2) rrethana të cilat e arsyetojnë frikën se i akuzuari do ta përsërisë ose përfundojë veprën penale, ose do ta kryejë veprën penale me të cilën kërcënohet.

(2) Garanci mund të japë i akuzuari personalisht për vete ose për të akuzuarin garanci mund ta japë ndonjë person tjetër.

(3) Lartësinë e garancisë e përcakton gjykata me detyrë zyrtare dhe ajo gjithmonë është shumë me para e cila përcaktohet varësisht nga pesha e veprës penale, rastet personale dhe familjare dhe gjendja pronësore e të akuzuarit.

(4) Garancia sipas rregullës përbëhet nga depozitimi i parave të gatshme, letrave me vlerë, sendeve të çmueshme ose sendeve tjera të tundshme me vlerë më të madhe të cilat lehtë mund të shndërrohen në para dhe të ruhen, ose në detyrim personal të një apo më tepër qytetarëve se në rast arratisjeje, përsëritjeje, kryerje plotësuese ose kryerje të veprës me të cilën kërcënohet e akuzuari, do ta paguajnë shumën e përcaktuar të garancisë. Me përjashtim, garancia përbëhet edhe me vënien në hipotekë për

shumën e garancisë të sendeve të patundshme të personit që jep garanci, të cilat lehtë mund të shndërrohen në para. Garancia në para të gatshme jepet në llogari të veçantë të gjykatës.

(5) Gjatë përcaktimit të garancisë gjykata mund të caktojë një ose më shumë masa të parandalimit me të cilat sigurohet prania e të akuzuarit.

Neni 151

Ndryshimi i lartësisë së garancisë

Lartësia tanimë e caktuar e garancisë mund të ndryshohet në rast të zgjerimit të procedurës hetimore, si dhe nëse gjatë procedurës mësohen rrethanat plotësuese në lidhje me gjendjen pronësore të të akuzuarit, e të cilat ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së garancisë.

Neni 152

Heqja dhe kthimi i garancisë

(1) Garancia i kthehet personit që e ka dhënë nëse është miratuar aktgjykim lirues, nëse akuza refuzohet ose nëse procedura është ndërprerë.

(2) Nëse me aktgjykim është shqiptuar masa burgim, garancia shfuqizohet kur i akuzuari do të fillojë ta vuajë dënimin.

(3) Në rastet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, mjetet dhe sendet e dhëna kthehen, ndërsa hipoteka hiqet.

Neni 153

Dështimi i garancisë

(1) Garancia e dhënë do të dështojë dhe të akuzuarit do t'i caktohet paraburgim:

- nëse nuk vjen në ftesën e dorëzuar sipas rregullës dhe për këtë nuk e arsyeton mungesën,

- nëse ik dhe

- nëse e përsërit ose përfundon veprën penale, ose e kryen veprën penale me të cilën kërcënohet.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni garancia e dhënë dështon dhe me aktvendim do të vendoset që vlera e dhënë si garanci të futet si e hyrë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

Neni 154

Organi kompetent për miratimin e aktvendimit për garanci

(1) Aktvendim për garancinë miraton gjatë procedurës hetimore gjykatësi në procedurë paraprake, ndërsa pas vërtetimit të aktakuzës ose parashtrimit të propozimkuzës, aktvendimin për garanci e miraton këshilli nga neni 25 paragrafi (5) i këtij ligji.

(2) Aktvendimi me të cilin caktohet garancia dhe aktvendimi me të cilin hiqet garancia, miratohet me propozimin e palëve.

Neni 155

Ankesa ndaj aktvendimit për garanci

Kundër aktvendimit për caktimin, shfuqizimin ose dështimin e garancisë lejohet ankesë në gjykatën e drejtpërdrejtë më të lartë.

Neni 156

Propozimi i garancisë me ankesën e aktvendimit për paraburgim

Kur në ankesën e aktvendimit me të cilin është përcaktuar masa paraburgim i akuzuari ka parashtruar edhe propozim për përcaktimin e garancisë, gjykata kompetente për vendosje për ankesën është e obliguar që të vendosë edhe për garancinë.

5. Arrestimi

Neni 157

Bazat dhe procedura e arrestimit

(1) Urdhër për arrestimin e të akuzuarit mund të japë gjykata nëse ekzistojnë baza për paraburgim nga neni 165 i këtij ligji, nëse tanimë është miratuar vendim për paraburgim ose nëse i akuzuari i ftuar sipas rregullës nuk vjen, ndërsa mungesën e tij nuk e arsyeton ose nëse nuk ka mundur të kryhet dorëzimi i rregullt i ftesës, ndërsa nga rrethanat dukshëm del se i akuzuari i ik pranimi të ftesës.

(2) Urdhrin e arrestimit e zbaton policia.

(3) Urdhri i e arrestimit jepet me shkrim. Urdhri duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit i cili duhet të arrestohet, emrin e veprës penale që i ngarkohet me theksimin e dispozitës së ligjit, bazën për shkak të së cilës urdhërohet arresti, vulën dhe nënshkrimin zyrtar të gjykatësit i cili e urdhëron arrestimin.

(4) Personi të cilit i është ngarkuar realizimi i urdhrin të akuzuarit ia dorëzon urdhrin dhe e thirr që vullnetarisht të shkojë me të. Nëse i akuzuari refuzon të shkojë me të vullnetarisht do ta arrestoj me detyrim. Me përjashtim, kur pritet rezistencë aktive, arrestimi do të bëhet pa dhënien paraprake të urdhrin nga paragrafi (1) i këtij neni.

6. Privimi nga liria

Neni 158

Bazat dhe procedura e privimit nga liria pa urdhëresë të gjykatës

(1) Personin i cili haset në kryerje të veprës penale për të cilën ndiqet me detyrë zyrtare, mund ta privojë nga liria secili nëse ekziston rreziku për ikje me ç'rast menjëherë njoftohet policia. Personi i privuar nga liria mbahet deri në ardhjen e policisë, e cila për këtë doemos duhet të njoftohet menjëherë.

(2) Personi i hasur në kryerjen e veprës penale është personi i cili është vërejtur gjatë kryerjes së veprës, përkatësisht personi i cili drejtpërdrejt pas kryerjes së veprës penale është hasur në rrethana të cilat tregojnë se ka kryer vepër penale.

(3) Policia e jurisprudencës mund ta privojë nga liria pa vendimin e gjykatës edhe personin për të cilin ekzistojnë baza të dyshimit se ka kryer vepër penale për të cilën ndiqet me detyrë zyrtare, vetëm nëse ekziston rreziku për prolongim, nëse ekziston njëri nga shkaqet për paraburgim nga neni 165 paragrafi (1) i këtij ligji, por obligohet që menjëherë e më së voni në

afat prej 6 orësh nga heqja e lirisë ta nxjerrin personin para gjykatësit kompetent të procedurës paraprake dhe për këtë ta njoftojë prokurorin publik. Për shkaqet dhe për kohën e heqjes së lirisë policia e jurispruencës e njofton gjykatësin e procedurës paraprake me ç'rast harton shënim zyrtar. Nëse nuk është hartuar shënim zyrtar, gjykatësi i procedurës paraprake njoftimin e dhënë do ta fusë në procesverbal.

(4) Gjatë privimit nga liria personi menjëherë do të njoftohet me shkaqet e privimit nga liria dhe do të këshillohet për të drejtat nga neni 69 i këtij ligji, menjëherë pasi që për këtë do të krijohen kushtet.

7. Mbajtja

Neni 159

Bazat për mbajtje dhe këshilla për të drejtat e personit të mbajtur

(1) Policia e jurispruencës, me përjashtim, personin e privuar nga liria në pajtim me nenin 158 të këtij ligji mund ta mbajë, nëse mbajtja është e nevojshme për përcaktimin e identitetit, kontrollin e alibisë ose për shkaqe tjera është e nevojshme që të grumbullohen të dhëna të domosdoshme për mbajtjen e procedurës kundër atij personi.

(2) Personi i privuar nga liria që mbahet doemos duhet të njoftohet për heqjen e lirisë dhe për mbajtjen si dhe për veprën me të cilën ngarkohet, do të këshillohet për të drejtën e heshtjes, të drejtën e informimit të familjes ose personit tjetër sipas zgjedhjes së tij, të drejtën e avokatit dhe kontrollit mjekësor. Në këto të drejta personi mund të thirret menjëherë ose në çfarëdo kohe derisa mbahet.

Neni 160

Dërgimi i personit të ndaluar para nëpunësit për pranim

(1) Personi i privuar nga liria doemos duhet që në afat prej më së shumti gjashtë orësh të sillet para nëpunësit për pranim në stacionet policore të caktuara të veçanta, i cili me aktvendim të veçantë të shkruar dhe të arsyetuar do të vendosë nëse personi do të mbahet për shkaqet nga neni 159 paragrafi (1) i këtij ligji, ose do të lëshohet në liri. Çdo vonesë doemos duhet të arsyetohet.

(2) Për personat e privuar nga liria mbahet regjistër i posaçëm në sistemin informatik të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Mbikëqyrje dhe kontroll në këtë regjistër rregullisht kryen prokurori publik kompetent. Shikim në këtë regjistër kryen edhe Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë.

(3) Nëpunësi për pranim e njofton prokurorin publik menjëherë pas pranimit të personit të privuar nga liria. Njoftimi shënohet në procesverbalin për mbajtje.

(4) Zyrtari për pranim i shënon në procesverbal edhe pranimin e sendeve të konfiskuara nga personi i privuar nga liria. Kopja e këtij procesverbali i dorëzohet prokurorit publik, personit të privuar nga liria dhe nëpunësit policor që e ka sjellë.

(5) Nëpunësi për pranim urdhëron bastisje të personit të privuar nga liria gjatë dërgimit të tij në stacionin policor ose vend tjetër të caktuar për mbajtje në pajtim me nenin 161 paragrafin (4) të këtij ligji. Sendet dhe gjurmët të cilat mund të shërbejnë si dëshmi ose të cilat mund ta rrezikojnë sigurinë e

personit të privuar nga liria ose ndonjë personi tjetër, përkohësisht do të merren me vërtetim.

(6) Sipas nevojës do të urdhërohet edhe kontrolli mjekësor i personit të privuar nga liria. Kontroll mjekësor do të bëhet çdoherë nëse personi ankohet për lëndim, dhimbje ose sëmundje. Nëpunësi për pranim çdoherë do të pyesë nëse personi lëngon nga ndonjë sëmundje dhe a ndodhet nën ndonjë trajtim mjekësor përkatësisht barna.

Neni 161

Procedura me personat e mbajtur

(1) Personi i privuar nga liria mund të këshillohet vet me avokatin në çdo moment, pa marrë parasysh a është ditë ose natë. Nëse nuk ka avokat të e vet ose nuk mund kontaktojë me të, personi i privuar nga liria mund të kërkojë ta shohë listën e avokatëve kujdestarë. Avokati mundet në çdo kohë të vijë që ta vizitojë stacionin e policisë. Në kohën prej orës 20 në mbrëmje deri në ora 8 në mëngjes, personi ka të drejtë të marrë avokat nga lista e avokatëve kujdestarë, të cilën e përpilon Dhoma e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë. Harxhimet për avokatin kujdestar si mbrojtës gjatë kohës së mbajtjes natën bien në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

(2) Personi i cili është shtetas i huaj ka të drejtë që të kontaktojë me përfaqësitë diplomatike konsullore të vendit të tij. Policia do t'i ndihmojë që të kontaktojë me përfaqësitë diplomatike-konsullore apo me ndonjë përfaqësues tjetër me status diplomatik i cili i përfaqëson interesat e vendit të tij.

(3) Mbajtja mund të zgjasë më së shumti 24 orë nga momenti i privimit nga liria dhe në këtë afat personi doemos duhet të nxirret para gjykatësit kompetent. Pas skadimit të këtij afati personi i mbajtur doemos duhet të lëshohet në liri.

(4) Personi mbahet në stacione policore të veçanta të rregulluara apo për atë dedikim lokale të veçanta të rregulluara të Drejtorisë Doganore dhe Drejtorisë së Policisë Financiare, të përcaktuara me akt të Ministrisë së Punëve të Brendshme përkatësisht Ministrisë së Financave. Për çdo person të mbajtur, nëpunësi për pranim përpilon procesverbal të veçantë në të cilin futen të dhënat për: ditën dhe orën e privimit nga liria; shkaqet për privim nga liria; shkaqet për mbajtje; kohën kur është këshilluar për të drejtat e tij; shenjat e lëndimeve të dukshme, sëmundjes, çrregullimit psikik e ngjashëm; kur ka kontaktuar me familjen, mbrojtësin, mjekun, përfaqësinë diplomatike-konsullore e ngjashëm; të dhënat kush dhe kur ka biseduar me të; nëse është bartur në stacion tjetër policor; lirim dhe nxjerrjen para gjykatës dhe të dhëna tjera të rëndësishme. Personi i mbajtur do të nënshkruhet në shënimin lidhur me orën dhe datën e privimit nga liria, orën dhe datën e lëshimit në liri dhe këshillës për të drejtën e mbrojtësit, si dhe në procesverbalin në tërësi. Mungesën e nënshkrimit të personit të mbajtur nëpunësi për pranim doemos duhet ta arsyetojë. Personit të mbajtur i dorëzon ekzemplar nga procesverbali gjatë lëshimit të tij në liri apo dorëzimit të gjykatësi në procedurën paraprake. Nëse personi është transferuar në stacion tjetër policor apo në vend tjetër të përcaktuar për mbajtje, dorëzohet kopje nga procesverbali të nëpunësi i atjeshëm për pranim.

(5) Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, përfaqësues të Komitetit Evropian për Preventivë nga Tortura apo Sjellja Nënçmuese apo Ndëshkimi të Këshillit të Evropës, përfaqësues nga Nënkomiteti për

Preventivë nga Tortura dhe Lloji Tjetër i Veprimit Jonjerëzor dhe Ndëshkimit në Komitetin për Parandalimi e Torturës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, kanë të drejtë që pa leje dhe pëlqim t'i vizitojnë dhe pa mbikëqyrje të bisedojnë me personat e mbajtur.

Neni 162

Kontrolli i ligjshmërisë për privim nga liria

Nëse personi i privuar nga liria, përkatësisht personi i mbajtur është nxjerrë para gjykatësit të procedurës paraprake, gjykatësi i procedurës paraprake sipas detyrës zyrtare e heton ligjshmërinë e privimit nga liria dhe mbajtja, është i detyruar që atë ta përcaktojë me aktvendim (neni 69 paragrafi (4) i këtij ligji). Personi i privuar nga liria, përkatësisht personi i mbajtur i cili nuk është nxjerrë para gjykatësit të procedurës paraprake, mundet që në afat prej 30 ditësh nga dita e lëshimit në liri, të kërkojë nga gjykatësi në procedurë paraprake të gjykatës kompetente ta hetojë ligjshmërinë dhe këtë ta përcaktojë me aktvendim të veçantë. Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesë e veçantë në afat prej 48 orësh në këshillin nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji, i cili vendos në afat prej tri ditësh.

8. Arresti shtëpiak

Neni 163

Caktimi i arrestit shtëpiak

(1) Nëse ekziston dyshim i bazuar se personi i caktuar ka kryer vepër penale dhe ka kushte për caktimin e arrestit nga neni 165 paragrafi (1) të këtij ligji, gjykata mund të përcaktojë masë arresti shtëpiak dhe t'i urdhërojë atij personi që të mos e lëshojë shtëpinë për një kohë të caktuar.

(2) Personit kundër të cilit është përcaktuar arresti shtëpiak mundet me përjashtim t'i lejohet që të largohet për një kohë të caktuar nga banesa apo lokali tjetër:

1) nëse kjo nuk është e nevojshme për mjekim apo

2) nëse atë e kërkojnë rrethana të veçanta për të cilat mund të shkaktohen pasoja të dëmshme për jetën, shëndetin apo pasurinë e personit apo të afërmeve të tij.

(3) Në aktvendimin me të cilin përcaktohet arresti shtëpiak, krahas ndalimit për largim nga shtëpia apo lokali tjetër, gjykata mund t'i caktojë ndalim për komunikim me persona apo ndalim për përdorimin e mjeteve për komunikim, përkatësisht obligim për respektimin e masave të mbikëqyrjes video dhe elektronike, apo të urdhërojë zbatim të masave tjera në pajtim me nenin 146 të këtij ligji.

(4) Nëse personi kundër të cilit është caktuar arresti shtëpiak largohet nga shtëpia apo lokali tjetër në kundërshtim me ndalimin e gjykatës, apo në kohë të caktuar nuk kthehet në shtëpi apo në lokalin tjetër të përcaktuar, apo nuk i përmbahet ndalimit të komunikimit me persona apo ndalimit për përdorimin e mjeteve për komunikim apo e shmangë apo pengon realizimin e masave të mbikëqyrjes video dhe elektronike, kundër atij personi do të caktohet arrest. Personi për këtë do të marrë vërejtje me aktvendim për arrest shtëpiak.

(5) Gjkata kryen mbikëqyrje mbi arrestin shtëpiak, ndërsa mbikëqyrjen mund t'ia ngarkojë policisë, duke e përcaktuar mënyrën e realizimit të saj.

(6) Gjashtë caktimit të arrestit shtëpiak në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat lidhur me përcaktimin e masës së arrestit, nëse me këtë ligj nuk është e përcaktuar ndryshe.

9. Paraburgimi

Neni 164

Caktimi i paraburgimit

(1) Paraburgimi mund të caktohet vetëm nën kushte të parapara me këtë ligj.

(2) Kohëzgjatja e paraburgimit mund të reduktohet në mënyrë të nevojshme në kohë sa më të shkurtër. Detyrë është e të gjitha organeve që marrin pjesë në procedurën penale dhe e organeve që ofrojnë ndihmë juridike të veprojnë me urgjencë të veçantë nëse i akuzuari gjendet në paraburgim.

(3) Gjatë vendosjes së paraburgimit, veçanërisht për kohëzgjatjen e tij, do të mbahet llogari e veçantë për përpjesëtimin ndërmjet peshës së veprës së kryer penale, dënimit i cili mund të pritët sipas të dhënave me të cilat disponon gjykata dhe nevojat për përcaktim dhe kohëzgjatje të paraburgimit.

(4) Gjatë tërë procedurës paraburgimi do të anulohet menjëherë pasi që të ndërpriten shkaqet në bazë të të cilave është përcaktuar.

Neni 165

Baza për përcaktimin e paraburgimit

(1) Nëse ekziston dyshim i bazuar se person i caktuar ka kryer vepër penale, nëse paraburgimi është i domosdoshëm për udhëheqje të papenguar të procedurës penale, kundër atij personi mund të përcaktohet paraburgim:

1) nëse fshihet, nëse nuk mund të vërtetohet identiteti i tij apo nëse ekzistojnë rrethana tjera që sugjerojnë për rrezik nga ikja;

2) nëse ekziston frikë e bazuar se do të fshihet, falsifikohen apo shkatërrohen gjurmët e veprës penale, apo nëse rrethana të veçanta sugjerojnë se do ta pengojnë procedurën penale me ndikim mbi dëshmitarët, ekspertët, bashkëpjesëmarrësit apo fshehësit;

3) nëse rrethanat e veçanta e arsyetojnë frikën se do ta përsëritë veprën penale, apo do ta përfundojë veprën penale në tentim apo se ka bërë vepër penale me të cilën kërcohet ose

4) nëse i akuzuari i thirrur në mënyrë të rregullt në mënyrë evidente i shmanget ardhjes në seancën kryesore, ose nëse gjykata ka bërë dy tentime në mënyrë të rregullt ta thërrasë të akuzuarin, ndërsa rrethanat sugjerojnë se i akuzuari në mënyrë evidente i shmanget pranimit të thirrjes.

(2) Në rastin nga paragrafi (1) pika 1 të këtij neni, paraburgimi që është përcaktuar vetëm për shkak se nuk mund të vërtetohet identiteti i personit, zgjatderisa ky identitet të vërtetohet.

(3) Në rastin nga paragrafi (1) pika 2 të këtij neni, paraburgimi do të ndërpritet menjëherë pasi që të sigurohen provat për të cilat është përcaktuar paraburgimi.

(4) Në rastin nga paragrafi (1) pika 4 të këtij ligji, paraburgimi zgjat deri në shpalljen e aktgjykimit, e më së voni 30 ditë.

(5) Paraburgimi nuk do të caktohet në bazë të paragrafit (1) pika 2 të këtij neni, nëse i akuzuari ka dhënë deklaratë me të cilën e ka pranuar fajin.

Neni 166

Organi për caktimin e paraburgimit në procedurën paraprake

Paraburgim në procedurën paraprake cakton gjykata me propozim me shkrim dhe të arsyetuar të paditësit të autorizuar dhe vetëm në bazat që i ka theksuar paditësi i autorizuar në propozim.

Neni 167

Elementet e aktvendimit për paraburgim

(1) Paraburgimi caktohet me aktvendim me shkrim. Shqiptimi i aktvendimit për caktimin e paraburgimit, i përmban:

- 1) emrin dhe mbiemrin e personit që privohet nga liria;
- 2) veprën penale për të cilën akuzohet;
- 3) të dhënat për urdhrin për zbatimin e procedurës hetimore;
- 4) bazën ligjore për caktimin e paraburgimit;
- 5) afatin në të cilin në procedurën hetimore është caktuar paraburgimi;
- 6) dispozitën për matjen e kohës për të cilën personi që arrestohet ka qenë i privuar nga liria para miratimit të aktvendimit për paraburgim;
- 7) emrin e institucionit në të cilin shpallet masa e paraburgimit dhe
- 8) këshillën për të drejtën e ankesës ndaj aktvendimit për paraburgim.

(2) Në arsyetimin e aktvendimit për paraburgim detyrimisht do të shënohen:

- 1) të gjitha faktet dhe dëshmitë prej të cilave del dyshim i bazuar se i akuzuari ka bërë vepër penale;
- 2) shkaqet e arsyetuara të cilat e arsyetojnë secilën bazë veç e veç sipas të cilës është përcaktuar paraburgimi dhe
- 3) shkaqet për të cilat gjykata konsideron se qëllimi i paraburgimit nuk mund të realizohet me ndonjë masë për sigurimin e pranisë.

(3) Aktvendimi vërtetohet me vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjykatësit i cili e cakton paraburgimin.

(4) Me aktvendimin me të cilin përcaktohet paraburgimi nga shkaqe të arsyeshme mund të përcaktohet që kryerja e paraburgimit të realizohet në seksionin e paraburgimit në institucion tjetër ndëshkues përmirësues.

(5) Nëse i akuzuari nuk ka përcaktuar mbrojtës, së bashku me aktvendimin do t'i caktohet mbrojtës me detyrë zyrtare (neni 74 paragrafi (1), (2), dhe (6)). Në rast të pengesës së kryetarit të gjykatës, mbrojtësi do ta vendosë gjykatësin e procedurës paraprake.

Neni 168

Nxjerrja para gjykatësit dhe caktimi i mbrojtësit

(1) Gjykatësi në procedurën paraprake do t'i hetojë të dyja palët dhe mbrojtësin për rrethanat me rëndësi për caktimin e paraburgimit, ndërsa personit të privuar nga liria i cili i është sjellë, menjëherë do t'i kumtohet se mund të marrë mbrojtës i cili mund të marrë pjesë në hetimin e tij dhe nëse është e nevojshme do t'i ndihmojë që të gjejë mbrojtës.

(2) Nëse personi i privuar nga liria deklaron se nuk dëshiron të marrë mbrojtës, gjykatësi në procedurë paraprake është i obliguar që ta marrë në pyetje pa shtyerje.

(3) Nëse në rast të mbrojtjes së obligueshme (neni 74 paragrafët (1) dhe (2)) personi i privuar nga liria nuk merr mbrojtës në afat prej 12 orësh nga

ora kur është këshilluar për këtë të drejtë apo deklaron se nuk dëshiron të marrë mbrojtës, do t'i caktohet mbrojtës sipas detyrës zyrtare.

(4) Menjëherë pas marrjes në pyetje gjykatësi në procedurën paraprake do të vendos nëse personin e privuar do ta arrestojë ose lëshojë në liri.

Neni 169

Dorëzimi i aktvendimit për paraburgim dhe e drejta e ankesës

(1) Aktvendimi për paraburgim i dorëzohet personit për të cilin ka të bëjë menjëherë, por jo më gjatë se gjashtë orë nga nxjerrja e tij para gjykatësit në procedurë paraprake. Në dokumente doemos duhet të shënohet ora e nxjerrjes para gjykatësit edhe ora e dorëzimit të aktvendimit.

(2) Kundër aktvendimit me të cilin caktohet paraburgimi, personi i arrestuar mund të ankohet në këshillin nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji në afat prej 24 orësh nga ora e dorëzimit të aktvendimit. Nëse personi i arrestuar për herë të parë merret në pyetje pas skadimit të këtij afati, mund të parashtrijë ankesë gjatë marrjes në pyetje. Ankesën me përshkrim nga procesverbali për marrje në pyetje, nëse personi i arrestuar është marrë në pyetje dhe aktvendimin për paraburgim dorëzohen menjëherë te këshilli. Aktvendimi nuk e ndalon zbatimin e aktvendimit.

(3) Kundër aktvendimit të gjykatësit në procedurë paraprake me të cilën refuzohet propozimi për caktimin e paraburgimit, lejohet ankesë në afat prej 24 orësh te këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji. Ankesa nuk e ndalon zbatimin e aktvendimit. Kundër aktvendimit të këshillit nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji me të cilin caktohet paraburgimi, i akuzuari ka të drejtë ankesë në afat prej 24 orësh, për të cilën vendos këshilli i Gjykatës më të lartë.

(4) Në rastet nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, këshilli që vendos për ankesë është i obliguar që të miratojë vendim në afat prej 48 orësh.

(5) Prokurori publik dhe mbrojtësi mund të kërkojnë të informohen për mbledhjen e këshillit dhe në mbledhje gojariht t'i nxjerrin dhe t'i arsyetojnë propozimet e veta. Mosardhja e tyre nuk e pengon mbajtjen e mbledhjes.

Neni 170

Paraburgimi afatshkurtër

(1) Gjykatësi në procedurën paraprake mundet me propozim të prokurorit publik me shkrim dhe aktvendim të arsyetuar, t'i caktojë personit të privuar nga liria paraburgim afatshkurtër deri në 48 orë nga sjellja e personit të privuar nga liria para gjykatësit në procedurë paraprake, në rast kur do të konstatojë se ekziston dyshim i bazuar se personi e ka bërë veprën penale e cila i ngarkohet dhe se ekzistojnë baza për përcaktimin e masës së paraburgimit nga neni 165 paragrafi (1) pikat 1, 2 dhe 3 të këtij ligji, nëse prokurori publik kundër personit ende nuk ka sjellë urdhër për realizimin e procedurës hetimore.

(2) Nëse prokurori publik pas skadimit të afatit prej 48 orësh nuk parashtron propozim për caktimin e masës së paraburgimit nga neni 165 pikat 1), 2) dhe 3) të këtij ligji, i akuzuari do të lëshohet në liri.

(3) Në raste me numër më të madh të personave të akuzuar apo raste tjera veçanërisht të ndërlikuara, pas kërkesës së arsyetuar të prokurorit

publik, gjykatësi në procedurë paraprake afatin nga paragrafi (1) të këtij neni mund të vazhdojë më së shumti edhe për 48 orë.

(4) Aktvendimi për paraburgim afatshkurtër nga paragrafi (1) të këtij neni, i dorëzohet personit kundër të cilit është i përcaktuar dhe dorëzohet te prokurori publik kompetent.

(5) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij neni lejohet ankesë në afat prej pesë orësh nga dorëzimi te këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji i cili është i obliguar që të vendos për ankesën në afat prej tri orësh.

Neni 171

Kohëzgjatja e paraburgimit në procedurën hetimore

(1) Paraburgimi i caktuar me vendimin e gjykatësit në procedurë paraprake apo paraburgim i cili për herë të parë është caktuar gjatë procedurës hetuese me vendim të këshillit, mund të zgjatë më së shumti 30 ditë nga dita e privimit nga liria. Në kohëzgjatjen e paraburgimit llogaritet çdo privim nga liria.

(2) Pas propozimit të arsyetuar të prokurorit publik, këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji mundet paraburgimin gjatë procedurës hetuese ta vazhdojë më së shumti edhe për 60 ditë.

(3) Nëse procedura hetuese udhëhiqet si vepër penale për të cilën sipas ligjit mund të shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku katër vitesh, pas propozimit të arsyetuar të prokurorit publik, këshilli i gjykatës drejtpërdrejt më të lartë mundet pas skadimit të afati nga paragrafi (2) të këtij neni, paraburgimin ta vazhdojë më së shumti edhe për 90 ditë.

(4) Kohëzgjatja e plotë e paraburgimit në procedurën hetuese, duke e llogaritur edhe kohëzgjatjen e privimit nga liria para miratimit të aktvendimit për paraburgim, nuk mund të jetë më e gjatë se 180 ditë, dhe me skadimin e atij afati i paraburgosuri menjëherë do të lëshohet në liri.

(5) Para marrjes së propozimit të prokurorit në procedurë të shkurtër, paraburgimi mund të zgjasë aq sa është e nevojshme që të kryhen veprimet hetimore, por jo më shumë se tetë ditë.

(6) Kundër aktvendimit të këshillit për vazhdimin e paraburgimit lejohet ankesë në afat prej 48 orësh, në gjykatën drejtpërdrejt më të lartë. Ankesa nuk e shtyn zbatimin.

Neni 172

Kohëzgjatja e paraburgimit pas miratimit të aktakuzës

(1) Pas miratimit të aktakuzës deri në përfundimin e debatit kryesor, në propozim të palëve, paraburgimi mund të caktohet, vazhdohet apo hiqet vetëm me aktvendim të këshillit (neni 25 paragrafi (1) apo paragrafi (5)).

(2) Pas plotfuqishmërisë së akuzës paraburgimi mund të zgjasë më së shumti:

1) deri në një vit për vepra penale për të cilat mund të shqiptohet dënim me burgim deri në 15 vjet dhe

2) deri në dy vite për vepra penale për të cilat mund të shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm.

(3) Me propozim të palëve dhe sipas detyrës zyrtare, këshilli është i obliguar që pas skadimit të tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e aktvendimit të fundit për paraburgim, të hetojë nëse ende ekzistojnë shkaqe për paraburgim dhe të marrë aktvendim për vazhdimin e ndërprerjes së paraburgimit.

(4) Ankesa kundër aktvendimit nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, nuk e ndalojnë zbatimin e aktvendimit.

(5) Kundër aktvendimit të këshillit me të cilin refuzohet propozimi për caktimin apo ndërprerjen e paraburgimit nuk lejohet ankesë e veçantë.

(6) Nëse i akuzuari ikën nga paraburgimi, afatet për paraburgim nga ky nen do të fillojnë të vijojnë përsëri.

Neni 173

Ndërprerje e paraburgimit

(1) Paraburgimi ndërpritet me aktvendim dhe i akuzuari do të lëshohet në liri kur gjykata do të vlerësojë se e plotëson ndonjë nga këto kushte:

1) kur të pushojnë shkaqet për të cilat paraburgimi është caktuar përkatësisht vazhduar;

2) nëse paraburgimi i mëtejshëm nuk do të jetë në proporcion me peshën e veprës së kryer penale;

3) kur qëllimi i njëjtë për të cilin është caktuar paraburgimi mund të arrihet me ndonjë masë tjetër;

4) kur ndërprerjen e paraburgimit e ka propozuar prokurori publik para ngritjes së aktakuzës;

5) nëse i akuzuari është liruar nga akuza apo është shpallur fajtor ndërsa është liruar nga dënimi apo i dënuar vetëm me dënim në para, ose i shqiptuar vërejtje gjyqësore ose dënim me kusht, ose për shkak të llogaritjes së paraburgimit dënimin tanimë e ka vuajtur apo nëse akuza është refuzuar, përveç në rast kur është refuzuar për shkak moskompetencës së gjykatës;

6) kur të skadojnë afatet për kohëzgjatje të paraburgimit apo

7) kur paraburgimi është caktuar sipas nenit 165 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji, ndërsa i akuzuari ka dhënë deklaratë për pranimin e fajit apo pasi që të grumbullohen të gjitha provat sipas të cilave në këtë bazë paraburgimi është përcaktuar, e më së voni deri në mbarimin e debatit kryesor.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij neni lejohet ankesë në afat prej 24 orësh te këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji, përkatësisht këshilli i gjykatës më të lartë, i cili në afat prej 48 orësh doemos duhet të vendosë për ankesën.

(3) Ankesa e shtyn zbatimin e aktvendimit.

Neni 174

Paraburgimi pas shpalljes së aktgjyqimit

(1) Kur të shqiptojë aktgjykim me të cilin i akuzuari gjykohet me dënim me burg, këshilli gjyqësor mund të caktojë paraburgim nëse i akuzuari tanimë nuk gjendet në paraburgim.

(2) Për caktimin apo ndërprerjen e paraburgimit nga përfundimi i debatit kryesor deri në shpalljen e aktgjyqimit, kompetent është këshilli gjyqësor, ndërsa nga shpallja e aktgjyqimit deri në plotfuqishmërinë e tij, kompetent është këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji.

(3) Para miratimit të aktvendimit me të cilin caktohet apo ndërpritet paraburgimi në raste të paragrafëve (1) dhe (2) të këtij ligji, do të pyetet prokurori publik kur procedura mbahet me kërkesë të tij.

(4) Nëse i akuzuari tashmë gjendet në paraburgim ndërsa këshilli konstaton se ende ekzistojnë shkaqe për të cilat është caktuar paraburgimi, do të miratojë aktvendim të veçantë për vazhdimin e paraburgimit. Aktvendim

të veçantë këshilli miraton edhe kur duhet të caktohet apo ndërpritet paraburgimi. Gjatë vendimmarrjes për paraburgim, do të kihet kujdes i veçantë për dëmin e pasojave të veprës penale dhe fuqinë e rrezikimit apo c të së mirës së mbrojtur.

(5) Paraburgimi që është caktuar apo vazhduar sipas dispozitave të këtij neni, mund të zgjasë deri në fillimin e vuajtjes së dënimit, përkatësisht deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por më së shumti derisa nuk skadon kohëzgjatja e dënimit të shqiptuar me burgim.

(6) Kur gjykata do të shqiptojë dënim me burgim, i akuzuari i cili gjendet në paraburgim me aktvendim të kryetarit të këshillit, mund të dërgohet në institucion për vuajtjen e dënimit edhe para plotfuqishmërisë së aktgjykimit nëse ai kët e kërkon.

10. Procedura me të paraburgosurit

Neni 175

Informimi i familjes

(1) Gjykata është e obliguar që në afat prej 24 orësh për paraburgimin ta informojë familjen e personit të paraburgosur, përveç nëse personi këtë e kundërshton. Për paraburgimin do të informohet organi kompetent për punë sociale, nëse është e nevojshme që të ndërmerren masa për kujdesin e fëmijëve dhe anëtarëve tjerë të familjes për të cilët kujdeset personi i paraburgosur.

(2) Nëse personi i paraburgosur është shtetas i huaj, gjykata është e obliguar që në afat prej 24 orësh ta informojë për paraburgimin përfaqësinë diplomatike-konsullore të shtetit shtetas i të cilit është personi.

Neni 176

Respektimi i personalitetit dhe dinjitetit

(1) Gjatë mbajtjes në paraburgim nuk guxon të ofendohet personaliteti dhe dinjiteti i të akzuarit.

(2) Ndaj të paraburgosurit mund të zbatohen vetëm kufizimet që janë të nevojshme që të pengohet ikja dhe marrëveshja që do të mund jetë e dëmshme për udhëheqjen e suksesshme të procedurës.

(3) Në lokalin e njëjtë nuk mund të burgosen persona që nuk janë të e së njëjtës gjini. Sipas rregullës, në lokalin e njëjtë nuk mund të vendosen persona që kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës së njëjtë penale e as persona të cilët janë në vuajtje të dënimit me personat në paraburgim. Nëse kjo është mundur, personat të cilët kanë kryer vepër penale në përsëritje nuk do të vendosen në lokal të njëjtë me persona të privuar nga liria të cilët do të mund të ndikojnë dëmshëm.

(4) Personi i paraburgosur ka të drejtë të kërkojë që paraburgimin ta kryejë në lokal individual.

Neni 177

Të drejtat e të paraburgosurit

(1) I paraburgosuri ka të drejtë në tetë orë pushim pa ndërprerë në kohë prej 24 orësh. Krahas kësaj atij do t'i sigurohet lëvizje në vend të hapur në burg së paku dy orë në ditë.

(2) I paraburgosuri ka të drejtë të ushqehet me shpenzime të veta, të mbajë veshje të vet dhe të shërbehet me mbulesa të veta, me shpenzime të veta të blejë libra, gazeta dhe sende tjera që i përgjigjen nevojave të tij të rregullta, nëse kjo nuk është e dëmshme për udhëheqjen e suksesshme të procedurës. Për këtë vendos organi që e zbaton procedurën hetimore.

(3) I paraburgosuri e mban pastërtinë në lokalet në të cilën qëndron. Nëse i paraburgosuri kërkon të punojë, gjykatësi i procedurë paraprake, përkatësisht kryetari i këshillit, në marrëveshje me drejtorinë e burgut, mund të lejojë që ai punojë në rrethin e burgut në punë që i përgjigjen aftësive të tij psiko-fizike, me kusht që kjo të mos jetë e dëmshme për udhëheqjen e procedurës.

(4) Mënyra e pranimit dhe sistemimit të të paraburgosurve në burgje si dhe organizimi i punës së të paraburgosurit nga paragrafi (3) të këtij neni i përcakton ministri i Drejtësisë.

Neni 178

Vizita e të paraburgosurit

(1) Me leje të gjykatësit të procedurës paraprake gjatë procedurës hetimore dhe me mbikëqyrje të tij apo nën mbikëqyrje të personit të cilin ai do ta caktojë, i paraburgosuri, në kuuadër të rendit shtëpiak, mund ta vizitojnë familjarë të afërt, e me kërkesë të tij - mjeku dhe persona tjerë.

(2) Shefat e përfaqësive diplomatike-konsullore të Republikës së Maqedonisë me leje të gjykatësit të procedurës paraprake i cili e realizon procedurën hetimore, kanë të drejtë që ta vizitojnë edhe pa mbikëqyrje dhe të bisedojnë me personat e paraburgosur shtetas të shtetit të tyre. Leja për vizitë kërkohet nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.

(3) Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, përfaqësuesit e Komitetit Evropian për Preventivë nga Tortura apo Sjellja Nënçmuese apo Ndëshkimi të Këshillit Evropian, përfaqësuesit nga Nënkomiteti për Preventive nga Tortura dhe Lloji Tjetër i Veprimit Jonjerëzor dhe Ndëshkimit në Komitetin për Preventivë nga Tortura në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, kanë të drejtë që pa leje dhe pëlqim t'i vizitojnë dhe pa mbikëqyrje të bisedojnë me personat e paraburgosur.

(4) Përfaqësues të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq kanë të drejtë që me leje të gjykatësit të procedurës paraprake, t'i vizitojnë dhe pa mbikëqyrje të bisedojnë me personat e paraburgosur.

(5) I paraburgosuri mund të këmbëjë letëra me persona jashtë burgut me njoftim dhe nën mbikëqyrje të organit që e zbaton procedurën hetimore. Ky organ mund ta ndalojë dërgimin dhe pranimin e letrave dhe dërgesave tjera të dëmshme për udhëheqjen e procedurës. Dërgimi e lutjes, parashtresës apo ankesës nuk mund të ndalohet asnjëherë.

(6) Pas akuzës apo padisë private të dorëzuar deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, autorizimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, i kryen kryetari i këshillit.

Neni 179

Përgjegjësia disiplinore e të paraburgosurit

(1) Për kundërvajtje disiplinore të të paraburgosurit, gjykatësi i procedurës paraprake, përkatësisht kryetari i këshillit mund të kumtojë dënim

disiplinor kufizim të vizitave. Ky kufizim nuk ka të bëjë me komunikimin e të paraburgosurit me mbrojtësin.

(2) Kundër aktvendimit për dënimin e shqiptuar sipas paragrafit (1) të këtij neni lejohet ankesë në këshillin nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji të gjykatës kompetente në afat prej 24 orësh nga pranimi i aktvendimit. Ankesa nuk e ndalon zbatimin e aktvendimit.

Neni 180

Mbikëqyrja e të paraburgosurve

(1) Mbikëqyrjen e të paraburgosurve e kryen gjykata kompetente e shkallës së parë.

(2) Kryetari i gjykatës nga paragrafi (1) të këtij neni apo gjykatësi që ai do ta caktojë është i obliguar së paku një herë në javë t'i vizitojë të paraburgosurit pa praninë e mbikëqyrësit apo rojeve dhe nëse konstaton se është e nevojshme të informojë edhe si ushqehen të paraburgosurit, si furnizohen me nevoja tjera dhe si veprohet me ata. Kryetari, përkatësisht gjykatësi të cilin ai e cakton është i obliguar që të marrë masa të nevojshme të evitohen parregullsitë e hetuara gjatë vizitës në burg. Gjykatësi i caktuar nuk mund të jetë gjykatësi i procedurës paraprake.

(3) Kryetari i gjykatës, gjykatësi i procedurës paraprake dhe Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë mund ta vizitojnë personin e arrestuar në cilëndo kohë, të bisedojnë me të pa praninë e personave zyrtarë dhe të pranojnë parashtrës nga ai.

Kreu XVII

MASAT PËR GJETJEN DHE SIGURIMIN E PERSONAVE DHE SENDEVE

1. Bastisja

Neni 181

Nocioni

(1) Bastisje është vepër e hulumtimit të lokaleve, personave dhe sendeve në kushte dhe mënyrë të përcaktuar me ligj.

(2) Bastisjen e shtëpisë dhe kërkimin në kompjuter e urdhëron gjykatësi me urdhëresë me shkrim dhe të arsyetuar, me kërkesë të prokurorit publik ndërsa në rast të rrezikut nga shtyrja edhe me kërkesë të policisë së jurispruencës.

Neni 182

Baza për bastisje

(1) Bastisja e shtëpisë së personit të akuzuar dhe personave tjerë, mund të bëhet kur është e sigurt se do të gjetet i akuzuari i cili kërkohet për arrestim apo do të gjeten gjurmë të veprës penale apo sende me rëndësi për procedurën penale.

(2) Bastisje e zyrës së avokatit mund të ndërmerret vetëm në procedurë kundër avokatit, dhe atë lidhur me lëndën, shkresën apo dokumentin të përcaktuara në veçanti në urdhrin për bastisje.

(3) Bastisja e personit mund ndërmerret kur është e sigurt se tek ai do të gjenden gjurmë apo sende të rëndësishme për procedurën penale.

Neni 183

Bastisja e shtëpisë

(1) Gjatë bastisjes së shtëpisë kontrollohet një ose më shumë lokale të cilat personi i shfrytëzon si shtëpi të tij dhe lokalet të cilat janë të lidhura me shtëpinë dhe kanë qëllim të njëjtë për shfrytëzim.

(2) Bastisja e shtëpisë përfshin edhe bastisje të sendeve të luajtshme të personit që gjenden në shtëpi dhe lokalet tjera, kur kjo është e shënuar në urdhëresën për bastisje, ose kur lidhur me personin e gjetur ekzistojnë kushte për bastisje pa urdhëresë.

Neni 184

Kërkimi i sistemit kompjuterik dhe të dhënave kompjuterike

(1) Me kërkesë të zbatuesit të urdhrit, personi i cili e përdor kompjuterin apo ka qasje te ai apo te pajisja apo mbajtësi tjetër i të dhënave, është i obliguar që të mundësojë qasje te ato dhe t'i japë informatat e nevojshme për realizimin pa pengesë të qëllimit të bastisjes.

(2) Me kërkesë të zbatuesit të urdhrit, personi që e përdorë kompjuterin ose ka qasje te ai ose te pajisja tjetër apo mbajtës i të dhënave, është i obliguar që menjëherë të ndërmarrë masa me të cilat pengohet shkatërrimi apo ndryshimi i të dhënave.

(3) Personi i cili e përdor kompjuterin apo ka qasje te ai apo te pajisja tjetër apo mbajtës i të dhënave, e i cili nuk do të veprojë sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, ndërsa për këtë nuk ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, gjykatësi i procedurës paraprake do ta dënojë sipas dispozitës nga neni 88 paragrafi (1) të këtij ligji.

Neni 185

Bastisja e personit

(1) Bastisja e personit i përfshin bastisjen e veshjes, mbathjes, sipërfaqes së trupit, sendeve të luajtshme që personi i mban apo janë në posedimin e tij, lokaleve në të cilat është gjetur personi gjatë kohës së ndërmarrjes së bastisjes dhe mjetit për transport i cili shfrytëzohet gjatë bastisjes.

(2) Bastisjen e kryen personi nga gjinia e njëjtë, përveç nëse kjo nuk është e mundur nga rrethanat në të cilat kryhet. Rrethanat për shkak të cilave bastisjen e kryejnë persona nga gjinia tjetër do të shënohen në procesverbalin e bastisjes.

(3) Bastisja e cila e përfshin zhveshjen e pjesëve të veshjes çdo herë e kryen person i gjinisë së njëjtë.

(4) Për kontrollin e pjesëve intime të trupit apo vrimave trupore është e domosdoshme leje në mënyrë të prerë nga gjykata. Kontrollin e kryen personi mjekësor.

Neni 186

Kërkesa për lëshimin e urdhrit për bastisje

(1) Kërkesa për lëshimin e urdhëresës për bastisje parashtrohet gojarisht apo me shkrim. Nëse kërkesa është parashtruar me shkrim, atëherë ajo doemos duhet të jetë e përpiluar, nënshkruar dhe vërtetuar në mënyrën e përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni.

(2) Kërkesa për lëshimin e urdhëresës për bastisje doemos duhet t'i përmbajë:

- emrin e gjykatës, si dhe emrin dhe funksionin e parashtruesit të kërkesës,

- faktet që e sugjerojnë probabilitetin se personi, përkatësisht sendet e shënuara në nenin 182 paragrafi (1) të këtij ligji, do të gjehen në vendin e shënuar ose të përshkruar ose te personi i caktuar dhe

- kërkesën që gjykata të lëshojë urdhëresë për bastisje për gjetjen e personit apo konfiskimin e sendeve.

Neni 187

Kërkesa gojore për lëshimin e urdhrit për bastisje

(1) Kërkesa për lëshimin e urdhrit për bastisje mund të parashtrohet gojarisht kur ekziston rreziku për shtyrje. Kërkesa gojore mundet t'i shqiptohet gjykatësit të procedurës paraprake edhe me telefon, radiolidhje apo me mjet tjetër të komunikimit elektronik.

(2) Kur është parashtruar kërkesë gojore për lëshimin e urdhëresës për bastisje, gjykatësi i procedurës paraprake rrjedhën e mëtejme të bisedës do ta shënojë. Në rast kur shfrytëzohet shënimi i zërit apo stenografik, gjykatësi i procedurës paraprake është i obliguar që ta japë procesverbalin për përshkrim, që ta vërtetojë përputhshmërinë e përshkrimit dhe ta dorëzojë procesverbalin origjinal dhe përshkrimin në gjykatë në afat prej 24 orësh nga lëshimi i urdhëresës. Në rast të shënimit të bisedës fjalë për fjalë, gjykatësi i procedurës paraprake do ta nënshkruajë kopjen e procesverbalit dhe do ta dorëzojë në gjykatë në afat prej 24 orësh nga lëshimi i urdhëresës.

Neni 188

Vendimmarrja për kërkesën për lëshimin e urdhrit për bastisje

Për Për kërkesën për lëshimin e urdhëresës për bastisje gjykatësi me procedurë paraprake vendos menjëherë, e më së voni në afat prej 12 orësh nga pranimi i kërkesës.

Neni 189

Përmbajtja e urdhrit për bastisje

Urdhri për bastisje i përmban:

- emrin e gjykatës që e jep urdhrin,

- nëse urdhri për bastisje jepet në bazë të kërkesës gojore, ajo do të shënohet së bashku me shënimin e emrit të gjykatësit të procedurës paraprake që e lëshon urdhëresën, kohën dhe vendin e lëshimit,

- organin për të cilin ka të bëjë urdhri,

- qëllimin e bastisjes,

- emrin dhe mbiemrin, e sipas nevojës edhe përshkrimin e fytyrës së personit që duhet të gjehet ose përshkrimin e sendeve të cilat duhen të gjehen gjatë bastisjes,

- përcaktimin ose përshkrimin e vendit që duhet të bastiset apo personit që duhet të gjehet, me shënimin e adresës, të dhënave për pronarin përkatësisht poseduesin e sendeve ose shtëpisë dhe lokaleve tjera dhe të dhëna tjera për vërtetimin e identitetit,

- udhëzimin se urdhri duhet të kryhet ndërmjet orës 5 dhe 21, ose autorizimin se urdhri mund të kryhet në cilëndo kohë nëse këtë gjykata e përcakton në mënyrë të prerë,

- autorizimin e zbatuesit të urdhëresës se mundet pa dorëzimin e urdhrit të hyjë në lokalet që duhen të bastisen nëse këtë gjykata e përcakton në mënyrë të prerë,

-udhëzimi, urdhri dhe sende e konfiskuara t'i dorëzohen gjykatës pa shtyrje,

- këshillën se i akuzuari ka të drejtë ta informojë mbrojtësin dhe se bastisja mund të kryhet edhe pa praninë e mbrojtësit nëse këtë e krijojnë rrethanat e jashtëzakonshme dhe

- nënshkrimin e gjykatësit të procedurës paraprake i cili e lëshon urdhrin dhe vulën zyrtare të gjykatës.

Neni 190

Koha e kryerjes së bastisjes

(1) Urdhri për bastisje mund të zbatohet në afat prej 15 ditësh nga dita e lëshimit të tij, pas skadimit të së cilit pa prolongim duhet t'i kthehet organit që e ka lëshuar urdhrin, i cili do ta shfuqizojë.

(2) Urdhri për bastisje mund të zbatohet në cilëndo ditë të javës.

(3) Bastisja kryhet ditën. Bastisja mund të vazhdohet edhe natën nëse ka filluar ditën dhe nuk ka përfunduar. Me përjashtim, bastisja mund të kryhet natën nëse ekziston rreziku për prolongim.

Neni 191

Rregullat për bastisje

(1) Para fillimit të bastisjes, zbatuesi i urdhrit duhet të legjitimohet dhe t'ia dorëzojë urdhrin për bastisje personit tek i cili ose ndaj të cilit do të kryhet bastisja. Para bastisjes personi të cilit i përket urdhri për bastisje do të thirret që vullnetarisht ta dorëzojë personin, përkatësisht sendet që kërkohen.

(2) Personi do të këshillohet se ka të drejtë të marrë mbrojtës, i cili mund të marrë pjesë në bastisje. Kur personi të cilit i përket urdhri për bastisje kërkon prani të mbrojtësit, fillimi i bastisjes prolongohet deri në ardhjen e tij, por më së gjati dy orë. Nëse është e sigurt se mbrojtësi i zgjedhur në atë afat nuk mund të vijë, personit do t'i mundësohet të marrë mbrojtës nga lista e avokatëve kujdestarë. Nëse personi nuk merr mbrojtës ose mbrojtësi i thirrur në atë kohë nuk vjen, bastisja mund të kryhet edhe pa praninë e mbrojtësit.

(3) Gjatë zbatimit të urdhrit për bastisje me të cilin caktohet bastisja e shtëpisë që në mënyrë të dukshme është e lëshuar, zbatuesi i urdhrit nuk është i obliguar që të informojë për shkaqet e bastisjes, por mundet të hyjë menjëherë në shtëpinë ose në lokalitetin tjetër nëse ato janë të zbrazëta ose nëse me arsye konsideron se janë të zbrazëta, ose nëse me urdhrin në mënyrë të prerë është i autorizuar që të hyjë pa lajmërim paraprak.

(4) Bastisja mund të fillojë edhe pa dorëzimin paraprak të urdhrit, pa ftesë paraprake për dorëzimin e personit ose sendeve dhe pa këshillë për të drejtën e mbrojtësit:

- nëse supozohet kundërshtim i armatosur ose fizik,

- nëse është e domosdoshme gjatë dyshimit se është kryer veprë e rëndë penale që e ka kryer grupi ose organizata ose shoqata kriminale, bastisja të kryhet papritmas,

- nëse bastisja duhet të kryhet në lokale publike dhe
- nëse druhet nga shkatërrimi ose fshehja e gjurmëve të veprës penale ose sendeve të vlefshme për procedurën penale.

(5) Mbajtësi i shtëpisë ose i lokaleve tjera do të thirret të jetë i pranishëm gjatë bastisjes, e nëse ai mungon do të thirret përfaqësuesi i tij ose ndonjë nga personat më të moshuar të shtëpisë ose fqinjët. Në qoftë se personi tek i cili duhet të kryhet bastisja nuk është i pranishëm, urdhri lëshohet në lokalet ku kryhet bastisja, ndërsa bastisja do të kryhet edhe pa praninë e tij.

(6) Kur bastisja kryhet në lokalet e organeve shtetërore, institucione që kryejnë autorizime publike ose persona juridikë, do të thirret eprori i tyre që të marrë pjesë në bastisje.

(7) Kur bastisja kryhet në objekt të ushtrisë, urdhri me shkrim për bastisje i dorëzohet pushtetit ushtarak, të cilët do të caktojnë person ushtarak të jetë i pranishëm gjatë bastisjes.

(8) Kur bastisja kryhet në zyrat e avokatëve në prani të avokatit të cilit ajo i përket, do të thirret përfaqësues nga Oda e Avokatëve, ndërsa nëse ajo nuk është e mundur, avokat tjetër. Nëse avokati i thirrur nuk vjen në afat prej tri orëve nga thirrja, bastisja mund të kryhet edhe pa praninë e tij.

(9) Lokalet e mbyllura, mobilitet ose sendet tjera do të hapen me forcë vetëm nëse mbajtësi i tyre nuk është i pranishëm ose nuk do vullnetarisht t'i hap. Gjatë hapjes do t'i iket dëmtimit të panevojshëm.

(10) Bastisja e shtëpisë, të lokaleve tjera ose personave duhet të kryhet me kujdes, me respektimin e dinjitetit të personit dhe të drejtën e intimitetit dhe prishjen e panevojshme të rendit shtëpiak.

(11) Gjatë bastisjes do të konfiskohen përkohësisht vetëm ato sende dhe dokumente që janë në lidhje me qëllimin e bastisjes në rastin e dhënë.

(12) Nëse gjatë bastisjes gjenden sende që nuk kanë lidhje me veprën penale për të cilën është urdhëruar bastisja, por të cilat bëjnë me dije në vepër tjetër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, ato përkohësisht do të konfiskohen, ndërsa për konfiskimin menjëherë do të lëshohet vërtetim dhe menjëherë do të njoftohet prokurori publik për ngritjen e procedurës penale. Nëse prokurori publik konstaton se nuk ka bazë për ngritjen e procedurës penale, ndërsa nuk ekziston ndonjë bazë tjetër ligjore sipas të cilës do të duhej të konfiskohen sendet, ato menjëherë do të kthehen.

Neni 192

Procesverbali për bastisje

(1) Për çdo debat përpilohet procesverbal. Procesverbalin e nënshkruajnë zbatuesi i urdhrit që e kryen bastisjen, personi tek i cili ndaj të së cilit kryhet bastisja dhe personat pranie e të cilëve është e detyrueshme. Rrjedha dhe mënyra e kryerjes së bastisjes mund të incizohet me aparat për incizim vizuel-me zë, me çka veçanërisht duhet të kihet kujdes në vendet ku janë gjetur persona dhe sendet të caktuara. Vendi i bastisjes dhe pjesët e tij të veçanta, si dhe personat dhe sendet e gjetura gjatë bastisjes mund të fotografohen. Incizimet video dhe me zë dhe fotografitë i bashkëngjiten procesverbalit dhe mund të shërbejnë si prova.

(2) Në procesverbal futen dhe saktësisht përshkruhen sendet dhe dokumentet që konfiskohen, ndërsa kjo do të bëhet edhe në vërtetimin për

konfiskimin e sendeve i cili menjëherë i lëshohet personit nga i cili janë konfiskuar sendet, përkatësisht dokumentet.

Neni 193

Hyrja në shtëpi në bazë të pëlqimit ose urdhrin për arrest

(1) Pa urdhrin për bastisje mund të hyhet në shtëpi:

- nëse mbajtësi i shtëpisë pajtohet për këtë,
- nëse atje gjendet personi që sipas urdhrin të gjykatës duhet të paraburgoset ose me detyrim të arrestohet,
- për shkak të privimit nga liria të kryerësit që është gjetur gjatë kryerjes së veprës penale i cili ndiqet sipas detyrës zyrtare ose
- në vendin ku është kryer vepra penale kryerjen e kontrollit.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) të këtij neni nuk do të përpilohet procesverbal, por mbajtësit të shtëpisë menjëherë do t'i lëshohet vërtetim, në të cilin do të theksohet shkakun për hyrjen në shtëpi dhe të gjitha vërejtjet e mbajtësit. Nëse në shtëpi është kryer edhe bastisje atëherë do të përpilohet procesverbal në pajtim me nenin 192 nga ky ligj, i cili duhet t'i përmbajë shkaqet për bastisje pa urdhër.

(3) Kur është kryer bastisje pa urdhër për bastisje, realizuesi i bastisjes doemos duhet menjëherë ta njoftojë prokurorin publik.

2. Sigurimi dhe konfiskimi i përkohshëm i sendeve ose pronës

Neni 194

Urdhri për konfiskim të përkohshme të sendeve

(1) Sendet që sipas Kodit penal duhet të konfiskohen ose që mund të shërbejnë si prova në procedurën penale përkohësisht do të konfiskohen dhe do t'i dorëzohen në ruajtje prokurorit publik ose organit të përcaktuar me ligj të veçantë ose në mënyrë tjetër do të sigurohet ruajtja e tyre.

(2) Urdhrin për konfiskim të përkohshme të sendeve e lëshon gjykata me propozim të policisë së jurispruencës ose prokurorit publik.

(3) Urdhri për konfiskimin e përkohshëm të sendeve i përmban: emrin e gjykatës, bazën juridike për konfiskimin e përkohshëm të sendeve, përcaktimin dhe përshkrimin preciz të sendeve që duhet përkohësisht të konfiskohen, emrin dhe mbiemrin e personit nga i cili përkohësisht duhet të konfiskohen sendet, vendin në të cilin, përkatësisht në të cilin përkohësisht duhet të konfiskohen sendet, afatin në të cilin duhet të konfiskohen dhe këshilla për mjetin juridik.

Neni 195

Rregullat për konfiskim të përkohshëm të sendeve

(1) Secili që mban sende nga neni 194 paragrafi (1) të këtij ligji është i obliguar që t'i dorëzojë. Gjykatësi i procedurës paraprake sipas propozimit të arsyetuar të prokurorit publik do ta dënojë personin i cili do të refuzojë t'i dorëzojë sendet me dënim në para sipas dispozitave të nenit 88 paragrafi (1) të këtij ligji, e nëse personi edhe mëtej refuzon t'i dorëzojë sendet do të dënohet sipas dispozitës nga neni 88 paragrafi (7) të këtij ligji. Për ankesën kundër aktvendimit me të cilin është shqiptuar dënim me para, vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji. Ankesa nuk e ndalon realizimin e aktvendimit. Në të njëjtën mënyrë do të veprohet edhe për personin zyrtar ose

përgjegjës në organin shtetëror, institucionin që kryen autorizime publike ose personin juridik.

(2) Gjatë konfiskimit të sendeve do të shënohet ku janë gjetur dhe do të përshkruhen, e sipas nevojës dhe në mënyrë tjetër do të sigurohet vërtetimi i njëjtësisë së tyre. Për sendet e konfiskuara lëshohet vërtetim.

(3) Dënimet nga paragrafi (1) të këtij neni nuk mund të zbatohen ndaj të dyshuarit.

(4) Drogat e konfiskuara dehëse, substancat psikotropike, prokurzorët dhe sendet tjera qarkullimi i të cilave është i ndaluar ose i kufizuar dhe nuk janë të mbajtura si mostër për ekspertizë, me vendim të gjykatës kompetente mund të shkatërrohen edhe para plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Neni 196

Konfiskimi i përkohshme i sendeve pa urdhër

(1) Sendet nga neni 194 paragrafi (1) të këtij ligji mundet përkohësisht të konfiskohen edhe pa urdhër nga gjykata nëse ekziston rrezik nga prolongimi dhe për të cilat ekzistojnë baza për dyshim se janë lëndë të veprës penale. Nëse personi i cili bastiset në mënyrë të prerë kundërshton në konfiskimin e sendeve, prokurori publik në afat prej 72 orëve nga bastisja e realizuar do të parashtrojë kërkesë te gjykatësi në procedurën paraprake për konfiskimin e sendeve.

(2) Nëse gjykatësi i procedurës paraprake e refuzon kërkesën e prokurorit publik, sendet e konfiskuara nuk mund të shfrytëzohen si prova në procedurën penale. Sendet e konfiskuara përkohësisht menjëherë do t'i kthehen personit nga i cili janë marrë.

Neni 197

Sendet që nuk mund të konfiskohen

(1) Me urdhër gjyqësor nuk mund të konfiskohen:

1) shkresa ose dokumente tjera të organeve shtetërore me publikim e të cilave do të shkelej ruajtja e sekretit shtetëror ose ushtarak, derisa organi kompetent ndryshe nuk vendos;

2) paraqitjet me shkrim të të akuzuarit të mbrojtësi ose personat nga neni 215 paragrafi (1) të këtij ligji, përveç nëse i akuzuari vullnetarisht nuk i dorëzon;

3) incizimet teknike që gjenden te personat nga neni 214 paragrafi (1) të këtij ligji, e të cilat ata i kanë bërë për faktet për të cilët janë liruar nga detyra për dëshmim;

4) shënimet, ekstraktet nga regjistri dhe dokumente të ngjashme të cilat gjenden tek personat nga neni 214 paragrafi (1) të këtij ligji, e të cilat i kanë bërë për faktet për të cilat ato në kryerjen e profesionit të vet i kanë mësuar nga i akuzuari dhe

5) shënimet për faktet që i kanë bërë gazetarët ose redaktorët e tyre në mjetet për informim publik nga burimi i informimit dhe të dhënat të cilat i kanë mësuar në kryerjen e profesionit të vet dhe të cilat janë përdorur gjatë redaktimit të mjeteve për informim publik, të cilat gjenden nën zotërimin e tyre ose në redaksinë në të cilën janë punësuar.

(2) Ndalimi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohet:

1) në lidhje me mbrojtësin ose personin e liruar nga detyra e dëshmimit në pajtim me nenin 214 paragrafi (1) të këtij ligji, nëse ekziston dyshim i

bazuar se të akuzuarit i ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale, ose i kanë dhënë ndihmë pas kryerjes së veprës penale ose kanë vepruar si fshehës, ose

2) nëse bëhet fjalë për sende që duhet të konfiskohen sipas Kodit penal.

(3) Ndalimi për konfiskim të përkohshëm të sendeve, dokumenteve dhe incizimeve teknike nga paragrafi (1) të këtij neni, nuk zbatohet edhe lidhur me veprat penale në dëm të fëmijëve dhe të të miturve.

Neni 198

Konfiskimi i përkohshëm i të dhënave kompjuterike

(1) Dispozitat nga neni 194 paragrafi (1), neni 195 paragrafi (1) dhe neni 197 të këtij ligji, i përkasin edhe të dhënave të ruajtura në kompjuter dhe pajisje të ngjashme për përpunim automatik, përkatësisht përpunim elektronik të të dhënave, pajisje të cilat shërbejnë për grumbullimin dhe transmetimin e të dhënave, bartës të të dhënave dhe informacioneve parapaguese me të cilat disponon dhënësi i shërbimeve. Me kërkesë me shkrim të prokurorit publik, këto të dhëna duhet t'i dorëzohen prokurorit publik në afatin që ai e përcakton. Në rast të refuzimit të dorëzimit, do të veprohet sipas nenit 196 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Gjykatësi i procedurës paraprake me propozim të prokurorit publik mundet me aktvendim të përcaktojë mbrojtje dhe ruajtje të të dhënave kompjuterike nga neni 185 të këtij ligji, derisa ajo është e nevojshme, ndërsa më së voni 6 muaj. Pas skadimit të kësaj periudhe të dhënat do të kthehen, përveç nëse nuk janë të përfshira në realizimin e veprës penale Dëmtim dhe depërtim në sistemin kompjuterik nga neni 251, Mashtrim kompjuterik nga neni 251-b dhe Falsifikim kompjuterik nga neni 379-a, të gjitha nga Kodi penal, nëse nuk janë të përfshira në realizimin e veprës tjetër penale me ndihmën e kompjuterit dhe nëse nuk shërbejnë si provë për vepër penale.

(3) Kundër aktvendimit të gjykatësit të procedurës paraprake me të cilën janë përcaktuar masat nga paragrafi (2) të këtij neni, personi që e shfrytëzon kompjuterin dhe personi që është dhënësi i shërbimeve kanë të drejtë ankese në afat prej 24 orësh. Për ankesën vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji. Ankesa nuk e ndalon realizimin e aktvendimit.

Neni 199

Konfiskimi i përkohshëm i letrave, telegrameve dhe dërgesave tjera

(1) Përkohësisht mund të konfiskohen letrat, telegramet dhe dërgesat tjera të dërguara te i akuzuari ose ato që ai i ka dërguar, e të cilat gjenden te personat juridikë në lëmin e komunikimeve postare, telegrafike dhe komunikim tjetër, nëse ekzistojnë rrethana për të cilat mund të pritet se ato do të shërbejnë si dëshmi në procedurë.

(2) Urdhrin për marrje të përkohshme të dërgesave nga paragrafi (1) të këtij neni, e lëshon gjykatësi i procedurës paraprake me propozim të prokurorit publik.

(3) Urdhrin për konfiskim të përkohshëm të dërgesave mund ta lëshojë edhe prokurori publik nëse ekziston rrezik nga prolongimi, me atë që ky urdhër duhet të jetë i vërtetuar nga ana e gjykatësit të procedurës paraprake në afat prej 72 orëve nga konfiskimi i përkohshëm i dërgesave.

(4) Nëse urdhri nuk vërtetohet sipas paragrafit (3) të këtij neni, ato dërgesa nuk mund të shfrytëzohen si prova në procedurën penale.

(5) Urdhri nga paragrafi (2) i këtij neni i përmban:

- të dhënat për personin të cilit i përket urdhri,
- mënyrën e kryerjes së urdhrit dhe kohëzgjatjen e masës dhe
- personin juridik i cili duhet ta zbatojë urdhrin.

(6) Masat e ndërmarra mund të zgjasin më së shumti tre muaj, ndërsa gjykatësi i procedurës paraprake me propozim të arsyetuar të prokurorit publik mund ta vazhdojë kohëzgjatjen edhe tre muaj, me atë që masat e ndërmarra do të ndërpriten menjëherë porsa të ndërpriten shkaqet për marrje të mëtejme të tyre.

(7) Dërgesat e dorëzuara i hap prokurori publik në prani të dy dëshmitarëve. Gjatë hapjes kihet kujdes të mos dëmtohen vulat, ndërsa mbështjellësit dhe adresa do të ruhen. Për hapjen përpilohet procesverbal.

(8) Nëse interesat e procedurës lejojnë, për masat e ndërmarra nga paragrafi (1) i këtij neni mund të informohet personi kundër të cilit janë ndërmarrë këto masa.

(9) Nëse interesat e procedurës lejojnë, përmbajtja e dërgesës në tërësi ose pjesërisht mund t'i kumtohet personit të cilit i është drejtuar, ndërsa mund t'i dorëzohet edhe dërgesa ose pjesë e saj. Nëse personi nuk është i pranishëm, dërgesa do t'i kumtohet ose do t'i dorëzohet ndonjërit prej të afërmeve të tij, ndërsa nëse nuk ka të afërm, do t'i dorëzohet dërguesit, nëse ajo nuk është në kundërshtim të interesave të procedurës.

(10) Masat e ndërmarra në pajtim me këtë nen nuk mund të zbatohen për letra, telegrame dhe dërgesa tjera të shkëmbyera ndërmjet të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.

Neni 200

Veprimi me të dhënat të cilat janë fshehtësi bankare, prona në arkën bankare, ndjekja e qarkullimit pagesor dhe transaksionet e llogarive dhe ndërprerja e përkohshme e realizimit të transaksioneve të caktuara financiare

(1) Nëse ekziston dyshim i bazuar se personi i caktuar i llogarive të veta bankare pranon, ruan, transmeton ose në mënyrë tjetër disponon me të ardhura nga vepra ndëshkuese, e ajo e ardhur është e rëndësishme për procedurën hetuese të asaj vepre penale ose sipas ligjit i nënshtrohet konfiskimit me detyrim, me kërkesë të arsyetuar nga prokurori publik, gjykata mund të lëshojë aktvendim me të cilin bankës ose institucioneve tjera financiare do t'i urdhërojë që t'i dorëzojnë dokumentacion dhe të dhënat për llogaritë bankare dhe transaksionet tjera financiare dhe punët e atij personi, si dhe për personat për të cilët në mënyrë të bazuar besohet se janë të përfshirë në ato transaksione financiare ose punë të të dyshuarit, nëse të dhënat e atilla do të mund të jenë prova në procedurën penale.

(2) Kërkesa e prokurorit publik i përket të dhënave të personit juridik ose fizik, për të gjitha të ardhurat që i pranon, ruan, transmeton ose në mënyrë tjetër disponon me to.

(3) Nëse personi nga paragrafi (1) i këtij neni ruan në arkë bankare, ose në mënyrë tjetër disponon me të ardhura nga vepra ndëshkuese, ndërsa ajo e ardhur është e rëndësishme për procedurën hetuese për atë vepër penale ose sipas ligjit i nënshtrohet konfiskimit me detyrim, me kërkesën e

arsyetuar nga prokurori publik, gjykata mund të lëshojë aktvendim me të cilin do t'i urdhërohet bankës që t'i mundësojë prokurorit publik qasje te arka.

(4) Në aktvendimet nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni do të përcaktohet edhe afati në të cilin banka ose institucioni tjetër financiar doemos duhet të veprojnë sipas tyre.

(5) Para fillimit dhe gjatë procedurës hetuese vendimi sipas kërkesës së prokurorit publik nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, miraton gjykatësi i procedurës paraprake, ndërsa pas ngritjes së akuzës gjykata para të cilës do të mbahet shqyrtimi. Gjykatësi i procedurës paraprake vendos sipas kërkesës së prokurorit publik menjëherë, e më së voni në afat prej 12 orësh nga pranimi i kërkesës. Nëse gjykatësi i procedurës paraprake nuk e pranon kërkesën e prokurorit publik, pa prolongim do të kërkojë që vendimin ta miratojë këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji. Këshilli miraton vendim në afat prej 24 orësh nga pranimi i kërkesës.

(6) Nëse ekzistojnë rrethanat nga paragrafi (1) të këtij neni, me propozim të arsyetuar të prokurorit publik, gjykatësi i procedurës paraprake mundet me aktvendim ta detyrojë bankën ose institucionit tjetër financiar që t'i hetojë qarkullimin pagesor, transaksionet e llogarive ose punët tjera të personit të caktuar dhe rregullisht ta njoftojë prokurorin publik për kohën e përcaktuar në aktvendim.

(7) Me propozimin e arsyetuar të prokurorit publik, gjykata me aktvendim mund ta urdhërojë institucionin financiar ose personin juridik që përkohësisht ta ndërpresin realizimin e transaksionit të caktuar financiar ose punës, ndërsa prona përkohësisht konfiskohet.

(8) Në raste urgjente prokurori publik mund t'i shqiptojë masat nga paragrafët (1), (3), (6) dhe (7) të këtij neni edhe pa urdhër gjyqësor. Për masat e ndërmarra prokurori publik menjëherë e njofton gjykatësin e procedurës paraprake, i cili në afat prej 72 orësh duhet ta lëshojë urdhrin. Në rast se gjykatësi i procedurës paraprake nuk lëshon urdhër, prokurori publik do t'i kthejë të dhënat pa i hapur paraprakisht.

Neni 201

Regjistrimi i shkresave, dokumenteve dhe incizimeve teknike përkohësisht të konfiskuara

(1) Nëse kryhet konfiskim i përkohshëm i shkresave ose dokumenteve që mund të shërbejnë si provë, do të bëhet regjistrimi i tyre. Nëse ajo nuk është e mundur, dokumentet do të vendosen në mbështjellës dhe do të vulosen. Pronari i shkresave ose dokumenteve mund të vendos edhe vulë të vet në mbështjellës.

(2) Mbështjellësin e hap prokurori publik. Gjatë kontrollit të shkresave ose dokumenteve doemos duhet të kihet kujdes që përmbajtjen e tyre të mos e kuptojnë persona të paautorizuar. Për hapjen e mbështjellësit përpilohet procesverbal.

(3) Personi nga i cili janë konfiskuar shkresat ose dokumentet do të thirret që të marrë pjesë gjatë hapjes së mbështjellësit. Nëse ai nuk lajmërohet në ftesë ose nuk është i pranishëm, mbështjellësi do të hapet, shkresat ose dokumentet do të kontrollohen dhe do të nënshkruhen në mungesë të tij.

(4) Nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, në mënyrën e përcaktuar në paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, njëjtë do të veprohet

edhe te konfiskimi i përkohshëm i incizimit teknik i cili mund të shërbejë si provë.

Neni 202

Konfiskimi i përkohshëm i pronës ose sendeve për shkak të sigurisë

(1) Gjykata mundet në çfarëdo kohe gjatë procedurës penale ta miratojë me kërkesë të prokurorit publik, masën e përkohshme konfiskim të pronës ose sendeve të cilat sipas Kodit penal duhet të konfiskohen, masën e konfiskimit ose masë tjetër të domosdoshme që të pengohet shfrytëzimi, tjetërsimi ose posedimi me atë pronë ose send.

(2) Kërkesa e prokurorit publik nga paragrafi (1) të këtij neni përmban:

- përshtkrim të shkurtër të veprës penale dhe emrin e saj ligjor,
- përshtkrimi të pronës ose sendeve që rrjedhin nga kryerja e vepër penale,
- të dhëna për personin që e posedon atë pronë ose sende,
- prova në të cilat bazohet dyshimi se prona, përkatësisht sendet, rrjedhin nga vepra penale dhe
- shkaqet e probabilitetit se deri në fund të procedurës penale do të jetë veçanërisht e rënduar ose e pamundur konfiskimi i pronës ose sendeve.

(3) Para fillimit edhe gjatë procedurës paraprake sipas kërkesës së prokurorit publik nga paragrafi (1) të këtij neni, vendim miraton gjykatësi i procedurës paraprake, ndërsa pas ngritjes së akuzës gjykata para të cilës do të mbahet shqyrtimi. Gjykatësi i procedurës paraprake vendos sipas kërkesës së prokurorit publik menjëherë, e më së voni në afat prej 12 orësh nga pranimi i kërkesës. Nëse gjykatësi i procedurës paraprake nuk e pranon kërkesën e prokurorit publik, pa prolongim do të kërkojë që vendim të miratojë këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji. Këshilli miraton vendim në afat prej 24 orësh nga pranimi i kërkesës.

(4) Në aktvendimin për shqiptimin e masave nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata do ta theksojë vlerën dhe llojin e pronës, përkatësisht sendit, dhe kohën për të cilën konfiskohet.

(5) Kundër aktvendimit të gjykatësit të procedurës paraprake me të cilën janë caktuar masat nga paragrafi (1) të këtij neni, mund të parashtrohet ankesë në afat prej 24 orësh. Për ankesën vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji. Ankesa nuk e ndalon zbatimin e aktvendimit.

(6) Nëse ekziston rrezik nga prolongimi, policia e jurisprudencës përkohësisht mund ta konfiskojë pronën ose sendet nga paragrafi (1) të këtij neni, t'i konfiskojë ose të ndërmarra masa tjera të domosdoshme që të pengohet çfarëdo shfrytëzimi, tjetërsimi ose posedimi i tyre. Për masat e marra duhet menjëherë të informohet prokurori publik, ndërsa masat e ndërmarra duhet të jenë të lejuara nga ana e gjykatësit të procedurës paraprake në afat prej 72 orësh nga marrja e tyre.

(7) Në qoftë se gjykatësi i procedurës paraprake nuk jep leje, masat e ndërmarra nga paragrafi (6) të këtij neni do të ndërpriten, ndërsa prona ose sendet e konfiskuara paraprakisht menjëherë do t'i kthehen personit nga i cili janë konfiskuar.

(8) Masat nga paragrafi (1) të këtij neni mund të zgjasin më së shumti deri në përfundimin e procedurës penale para gjykatës së shkallës së dytë.

(9) Nëse masat nga paragrafi (1) të këtij neni janë përcaktuar në procedurën paraprake, do të ndërpriten sipas detyrës zyrtare nëse procedura

hetuese nuk fillon në afat prej tre muajsh nga dita e miratimit të aktvendimit me të cilin janë përcaktuar.

(10) Para skadimit të afateve nga paragrafi (9) të këtij neni, masat mund të ndërpriten sipas detyrës zyrtare nga gjykata ose me kërkesë të prokurorit publik, përkatësisht personi i interesuar, nëse tregohet se nuk janë të nevojshme ose të arsyeshme duke marrë parasysh peshën e veprës penale, rastet pronësore të personit të cilat i përkasin ose rastet e personave të cilat sipas ligjit ky person është i obliguar që t'i mbajë edhe rrethanat të cilat tregojnë se konfiskimi i pronës ose sendeve nuk do të pamundësohet ose veçanërisht rëndohet deri në përfundimin e procedurës penale.

(11) Të gjitha veprimet mbi pronën dhe sendet që janë lëndë e sigurimit, e të cilat janë ndërmarrë pas parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni, janë të pavlefshme.

(12) Kërkesa nga paragrafi (1) të këtij neni dhe vendimi për shqiptimin e masave nga paragrafi (1) të këtij neni, pa prolongim dorëzohen në formë elektronike te të gjitha organet kompetente për evidencën e pronës dhe sendeve sigurimi i të cilave kërkohet edhe përcaktohet.

Neni 203

Kthimi i sendeve të konfiskuara përkohësisht

Sendet që gjatë procedurës penale janë konfiskuar përkohësisht do t'i kthehen pronarit, përkatësisht mbajtësit nëse ndërpritet procedura, ndërsa nuk ekzistojnë shkaqe për konfiskimin e tyre (neni 529 i këtij ligji).

Neni 204

Veprimi me sende të dyshimta

(1) Nëse gjendet tek i akuzuari send i huaj ndërsa nuk dihet i kujt është, organi që e mban procedurën do ta përshkruajë atë send dhe përshkrimin do ta publikojë në tabelën e organit të komunës në rajon e së cilës ai jeton dhe në rajonin së cilës është kryer vepra penale. Në shpallje do të thirren pronari të lajmërohet tek organi që e mban procedurën në afat prej një viti nga dita e publikimit të shpalljes, me ç'rast në të kundërtën sendi do të shitet. Parat e marra nga shitja futen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Nëse bëhet fjalë për sendet e vlerës më të lartë, shpallja do të kryhet edhe nëpërmjet gazetave ditore.

(3) Nëse sendi i nënshtrohet prishjes ose ruajtja e tij është e lidhur me shpenzime të rëndësishme, ai do të shitet sipas dispozitave që vlejné për procedurën përfundimtare, ndërsa paratë do të ruhen si depozitë gjyqësore.

(4) Sipas dispozitës nga paragrafi (3) të këtij neni do të veprohet edhe kur sendi i takon kryerësit në arrati ose të panjohur të veprës penale.

(5) Nëse në afat prej një viti nuk lajmërohet asnjë për sendin ose për para të fituara nga shitja e sendit, do të miratohet aktvendim me të cilin sendi bëhet pronë shtetërore, përkatësisht paratë do të futen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

(6) Pronari i sendit ka të drejtë që nëpërmjet kontestit të kërkojë kthimin e sendit ose të parave të fituara nga shitja e sendit. ParashkrParashkrimi i kësaj të drejte fillon të rrjedhë nga dita e publikimit të shpalljes.

Kreu XVIII MJETET DËSHMUESE

1. Dëshmia e të akuzuarit

Neni 205

Marrja e të dhënave personale nga i akuzuari

(1) Kur merret në pyetje i akuzuari së pari do të pyetet a e kupton gjuhën në të cilën mbahet procedura, për emrin dhe mbiemrin, për nofkën nëse ka, për emrin dhe mbiemrin e prindërve, për mbiemrin e vajzërisë së nënës, vendlindjen, vendbanimin, ditën, muajin dhe vitin e lindjes, numrin personal amë, për përkatësinë e bashkësisë, shtetësinë, profesionin, rrethanat familjare, arsimimin, gjendjen pronësore, nëse, kur dhe pse është gjykuar, nëse dhe kur e ka vuajtur dënimin e shqiptuar, nëse kundër tij mbahet procedurë për ndonjë vepër tjetër penale, e nëse është i mitur kush është përfaqësues i tij ligjor.

(2) I akuzuari do të këshillohet se është i obliguar që të lajmërohet në thirrje dhe menjëherë ta kumtojë çdo ndryshim të adresës ose qëllimit për ta ndryshuar vendbanimin përkatësisht vendqëndrimin, ndërsa do të paralajmërohet edhe për pasojat nëse nuk vepron sipas kësaj. Nëse i akuzuari nuk ka vendbanim të përhershëm përkatësisht vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë ose bëhet fjalë për të huaj, do të këshillohet se është i obliguar që në afat prej tetë ditëve të përcaktojë adresë ose person në Republikën e Maqedonisë për dorëzimin e shkresës dhe vendimeve, ndërsa do të paralajmërohet se nëse vet nuk përcakton adresë ose person për pranimin e shkresave, organi që e thirr do ta paraqesë shkresën në tabelën e shpallje në gjykatë dhe me skadimin e tetë ditëve nga dita e paraqitjes konsiderohet se është kryer dorëzimi.

Neni 206

Këshilla për të drejtat e të akuzuarit

(1) Para secilit hetim, i akuzuari patjetër do të informohet dhe këshillohet:

- 1) pse akuzohet dhe cilat janë bazat e dyshimit kundër tij;
- 2) se nuk është i obliguar që ta paraqesë mbrojtjen e vet, e as të përgjigjet në pyetjet e parashtruara, por nëse jep deklaratë ajo mundet të shfrytëzohet në procedurë kundër tij;
- 3) se mundet të marrë mbrojtës me zgjedhje të vet me të cilin mundet vet të këshillohet dhe i cili mund të marrë pjesë në hetim;
- 4) se mundet të deklarohet për veprën e cila i ngarkohet dhe t'i paraqesë të gjitha faktet dhe provat të cilat i shkojnë në dobi;
- 5) se ka të drejtë shikimi të shkresave dhe t'i shikojë sendet që janë konfiskuar;
- 6) se ka të drejtë ndihme pa pagesë të përkthyesit, përkatësisht interpretuesit nëse nuk e kupton ose fletl gjuhën që shfrytëzohet gjatë marrjes në pyetje dhe
- 7) se ka të drejtë kontrolli nga mjeku gjatë nevojës nga trajtimi mjekësor ose për shkak të përcaktimit të tejkalimeve eventuale policore.

(2) I akuzuari mundet vullnetarisht të heq dorë nga ndonjë e drejtë nga paragrafi (1) të këtij neni, por marrja në e tij pyetje nuk mund të fillojë nëse

deklarata se heq dorë nga ndonjë e drejtë nuk shënohet me shkrim dhe derisa nuk nënshkruhet nga ai. Personi nuk mund të heq dorë nga e drejta e mbrojtësit nëse mbrojtja është e obliguar në pajtim me ligjin.

(3) Nëse nuk ka avokat të vet ose nuk mund të kontaktojë me të, të akuzuarit do t'i dorëzohet lista e avokatëve kujdestarë të përgatitur nga Oda e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë.

(4) Nëse i akuzuari së pari nuk ka dashur mbrojtës, por më vonë ka shpreh dëshirë që të marrë mbrojtës, marrja në pyetje do të ndërpritet dhe do të fillojë përsëri kur i akuzuari do të marrë mbrojtës, me të cilin mundet të këshillohet.

(5) Nëse është vepruar në kundërshtim me dispozitat nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni, deklarata e të akuzuarit nuk mundet të shfrytëzohet gjatë procedurës gjyqësore.

(6) Para fillimit të marrjes në pyetje për herë të parë, i akuzuari do të informohet edhe për të drejtat e marrëveshjes për fajin me prokurorin publik në pajtim me nenet 489 deri 496 të këtij ligji.

Neni 207

Incizimi nga marrja në pyetje e të akuzuarit

(1) Marrja në pyetje e të akuzuarit nga ana e prokurorit publik ose në prani të tij mund të incizohet me aparat për incizim vizuel-me zë. Për incizimin i akuzuari do të këshillohet posaçërisht, me ç'rast do të jepet vërejtje për atë nëse deklaratat e incizuara mund të shfrytëzohen në procedurë.

(2) Për çfarëdo ndërprerje të marrjes në pyetje në incizimet do të theksohen shkaqet dhe kohëzgjatja e ndërprerjes, si dhe koha e vazhdimit dhe mbarimit të marrjes në pyetje.

(3) Për marrjen në pyetje do të përpunohen tre ekzemplarë, prej të cilëve një ekzemplar për prokurorin publik dhe të akuzuarin, dhe një ekzemplar shtypet dhe i dorëzohet gjykatësit të procedurës paraprake. Prokurori publik do të përpunojë kopje me shkrim nga incizimi, dhe ai përshtkrim i bashkëngjitet shkresave të lëndës.

(4) Incizimi nga paragrafi (3) të këtij neni nuk guxon të publikohet, emitohet dhe të shfrytëzohet për dedikime dhe qëllime jashtë procedurës penale.

(5) Mënyrën e kryerjes së incizimit e përcakton ministri i Drejtësisë me mendim të siguruar paraprakisht nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë.

Neni 208

Ndalimi për përdorimin e mashtrimit, pyetjeve sugjестive dhe kapcioze

Pasi që është këshilluar për të drejtën e heshtjes dhe të drejtat tjera nga neni 206 të këtij ligji, të akuzuarit duhet t'i parashtrohen pyetje të qarta, të kuptueshme dhe precize, ashtu që të mundet plotësisht t'i kuptojë. Gjatë marrjes në pyetje nuk guxon të nisët nga supozimi se i akuzuari ka pranuar diçka që nuk ka pranuar, e as nuk guxojnë t'i parashtrohen pyetje në të cilat përmbahet se si duhet në to të përgjigjet. Kundër të akuzuarit nuk guxon të përdoret mashtrimi që të vihet te deklarimin ose pranimit i tij.

Neni 209

Njohja e sendeve

Sendet që janë në lidhje me veprën penale ose që shërbejnë si provë do t'i tregohen të akuzuarit për njohje, pasi që paraprakisht do t'i përshkruajë. Nëse këto sende nuk mund të sillen, i akuzuari mund të çohet në vendin ku gjenden ato.

Neni 210

Mënyra e marrjes në pyetje të të akuzuarit

(1) Pas këshillës për të drejtat i akuzuari do të pyetet çka ka të paraqesë në mbrojtjen e tij. Gjatë marrjes në pyetje e të akuzuarit duhet t'i mundësohet në prononcimin e papenguar të shprehet për të gjitha rrethanat që e ngarkojnë dhe t'i paraqesë të gjitha faktet që i shërbejnë për mbrojtje.

(2) I akuzuari merret në pyetje me gojë. Gjatë marrjes në pyetje të të akuzuarit mund t'i lejohet t'i shfrytëzojë vërejtjet e veta.

(3) Kur i akuzuari do ta kryejë dëshminë e vet, do t'i parashtrohen pyetje nëse është e nevojshme që të plotësohen zbrazëtirat dhe të eliminohen kontradiktat ose moskuptimi në prononcimin e tij.

(4) Marrja në pyetje duhet të kryhet ashtu që do të respektohet personaliteti i të akuzuarit.

(5) Kundër të akuzuarit nuk guxojnë të përdoren forca, kërcënimet ose mjete tjera të ngjashme (neni 249 paragrafi (4)) që të vihet deri në deklaratën ose pranimin e tij.

(6) I akuzuari mund të merret në pyetje në mungesë të mbrojtësit vetëm nëse në mënyrë të prerë ka heq dorë nga ajo e drejtë, ndërsa mbrojtja nuk është e obliguar ose nëse në afat prej 24 orëve nga momenti kur është këshilluar për këtë të drejtë (neni 71 paragrafi (2)) vet nuk siguron mbrojtës, përveç në rast të mbrojtjes së detyruar.

(7) Nëse është vepruar në kundërshtim me dispozitat nga paragrafët (5) dhe (6) të këtij neni, deklarata e të akuzuarit nuk mundet të shfrytëzohet gjatë procedurës.

Neni 211

Marrja në pyetje e të akuzuarit nëpërmjet interpretuesit

(1) Marrja në pyetje e të akuzuarit do të kryhet nëpërmjet interpretuesit në rastet e parapara me këtë ligj.

(2) Nëse i akuzuari është i shurdhur, me shkrim do t'i parashtrohen pyetje, ndërsa nëse është memec, do të thirret që të përgjigjet me shkrim. Nëse marrja në pyetje nuk mundet të kryhet në këtë mënyrë do të thirret si interpretues personi i cili mund të merret vesh me të akuzuarin.

(3) Nëse interpretuesi nuk është i betuar më herët, do të betohet se besnikërisht do t'i transmetojë pyetjet që i drejtohen të akuzuarit dhe deklaratat që ai i jep.

(4) Dispozitat e këtij ligji që i përkasin ekspertëve në mënyrë përkatëse zbatohen edhe ndaj interpretuesve.

2. Dëshmitarët

Neni 212

Personat që mund të jenë dëshmitarë

(1) Si dëshmitarë thirren personat për të cilët është e sigurt se mundën të japin njoftim për veprën penale dhe kryerësin dhe për rrethanat tjera të rëndësishme.

(2) I dëmtuari dhe paditësi privat mund të merren në pyetje si dëshmitarë.

(3) Secili person i cili thirret si dëshmitar është i obliguar që të lajmërohet në ftesë, e nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe është i obliguar edhe të dëshmojë.

Neni 213

Personat që nuk mund të jenë dëshmitarë

Nuk mund të jetë dëshmitar:

1) personi i cili në deklaratën do ta cenojë detyrën e ruajtjes së sekretit shtetëror dhe ushtarak, derisa organi kompetent nuk e liron nga ajo detyrë;

2) mbrojtësi i të akuzuarit për atë që ia ka besuar i akuzuari si mbrojtës i tij, përveç nëse vet i akuzuari këtë e kërkon;

3) personi i cili me deklaratën e tij do ta cenojë detyrën për ruajtjen e fshehtësisë afariste në lidhje me atë që e ka mësuar në kryerjen e profesionit të vet (predikues fetar, avokat dhe mjek), përveç nëse është i liruar nga ajo detyrë me rregull të posaçme ose me shkresë, përkatësisht me deklaratën e dhënë në procesverbal të personit në dobi të të cilit është vendosur ruajtja e fshehtësisë, përkatësisht me deklaratë të atillë të pasardhësit të tij juridik;

4) personi i mitur i cili duke marrë parasysh moshën e tij dhe zhvillimin shpirtëror nuk është i aftë që ta kuptojë rëndësinë e të drejtës së tij se nuk duhet të dëshmojë përveç nëse vet i akuzuari e kërkon atë dhe

5) personi i cili për shkak të sëmundjes së vet shpirtërore ose trupore, përkatësisht moshës së vet aspak nuk është në gjendje që të dëshmojë.

Neni 214

Personat e liruar nga detyra që të dëshmojnë

(1) Të liruar nga detyra që të dëshmojnë janë:

1) shoku martesor dhe jashtëmartesor i të akuzuarit;

2) të afërmit e të akuzuarit sipas gjakut në vijës të drejtë, të afërmit në vijë anësore përfundimisht deri në shkallën e tretë dhe të afërmit sipas krushqisë përfundimisht deri në shkallën e dytë dhe

3) i birësuar dhe birësuesi i të akuzuarit.

(2) Organi që e mban procedurën është i obliguar që personat e cekur në paragrafin (1) të këtij neni, para marrjes së tyre në pyetje ose menjëherë sa të marrë vesh për lidhjen e tyre kundër të akuzuarit, t'i paralajmërojë se nuk janë të obliguar që të dëshmojnë. Paralajmërimi dhe përgjigja futen në procesverbal.

(3) Personi i cili ka bazë që ta shkurtojë dëshmimin ndaj njërit nga të akuzuarit është i liruar nga detyra që të dëshmojë edhe kundër të akuzuarve tjerë, nëse deklarata e tij sipas natyrës së punës nuk mundet të kufizohet vetëm te të akuzuarit tjerë.

Neni 215

Pasojat nga shkelja e rregullave të marrjes në pyetje të dëshmitarit

Nëse si dëshmitar është thirrur personi i cili nuk mund të jetë dëshmitar ose personi i cili nuk duhet doemos të dëshmojë, ndërsa për atë nuk është

paralajmëruar ose në mënyrë të prerë nuk ka heq dorë nga ajo e drejtë, ose nëse është marrë në pyetje i mitur i cili nuk mund ta kuptojë rëndësinë e të drejtës se nuk është i obliguar të dëshmojë, ose nëse deklarata e dëshmitarit është nxjerrë me dhunë, me kërcënim ose mjet tjetër të ngjashëm të ndaluar, në deklaratën e atillë të dëshmitarit nuk do të mund të bazohet vendimi gjyqësor.

Neni 216

E drejta e dëshmitarit të mos përgjigjet në pyetje të caktuara

Dëshmitari nuk është i obliguar që të përgjigjet në pyetje të veçanta nëse është e mundur që me këtë ta ekspozojë vetveten ose të afërmin e tij në turp të madh, dëm të konsiderueshëm material ose ndjekje penale.

Neni 217

Pyetje të cilat nuk guxojnë t'i parashtrohen të dëmtuarit dhe dëshmitarit

Ndalohet që të dëmtuarit dhe dëshmitarit t'i parashtrohen pyetje të cilat i përkasin jetës së tyre seksuale dhe prirjeve seksuale, përcaktimit politik dhe ideologjik, prejardhjes racore, nacionale dhe etnike, kritereve morale dhe rrethanave tjera të veçanta personale dhe familjare, vetëm me përjashtim, nëse përgjigjet e pyetjeve të tilla janë të drejtpërdrejta dhe në mënyrë të qartë të lidhura me shpjegimet e nevojshme dhe karakteristikat e rëndësishme të veprës penale e cila është lëndë e procedurës.

Neni 218

Thirrja e dëshmitarit

(1) Thirrja e dëshmitarit bëhet me dorëzimin e njoftimit me shkrim në të cilin do të shënohet emri dhe mbiemri dhe profesioni i të thirrurit, koha dhe vendi i ardhjes, lënda penale për të cilën thirret, shënimi se thirret si dëshmitar dhe paralajmërimi për pasojat nga mungesa e paarsyeshme (neni 224 paragrafi (1)).

(2) Thirrja si dëshmitar e personit të mitur i cili nuk i ka mbushur 18 vjet kryhet nëpërmjet prindërve të tij, përkatësisht nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor.

(3) Dëshmitarët të cilët për shkak të moshës, sëmundjes ose mangësive të rënda trupore nuk mund të lajmërohen në thirrje, mund të merren në pyetje në shtëpinë e vet ose në vend tjetër atje ku gjenden.

Neni 219

Mënyra e marrjes në pyetje të dëshmitarit

(1) Dëshmitarët merren në pyetje veç e veç. Dëshmitari sipas rregullës përgjigjet i jep me gojë.

(2) Dëshmitarit paraprkisht do t'i jepet vërejtje se është i obliguar të flasë të vërtetën dhe se nuk guxon të fshehë diçka çka ka dëgjuar, ndërsa do të paralajmërohet se dhënia e deklaratës së rrejshme paraqet vepër penale. Dëshmitari do të paralajmërohet edhe se nuk është i obliguar të përgjigjet në pyetjet e parapara në nenin 216 të këtij ligji dhe ky paralajmërim do të futet në procesverbal.

(3) Pastaj dëshmitari do të pyetet për emrin dhe mbiemrin, emrin e babait, profesionin, vendqëndrimin dhe vendbanimin, vendin e lindjes, vjetët dhe për lidhjen e tij me të akuzuarin dhe të dëmtuarin. Dëshmitari do të

paralajmërohet se është i obliguar organi që e mban procedurën ta njoftojë për ndryshimin e adresës ose të vendqëndrimit, përkatësisht vendbanimit.

(4) Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit nuk lejohet shërbimi me mashtrim e as parashtrimin e pyetjeve të atilla në të cilat tanimë përmbahet se si do të duhej të përgjigjej.

Neni 220

Njohja e personave ose sendeve nga ana e dëshmitarit

(1) Nëse është e nevojshme të përcaktohet nëse dëshmitari nje persona të caktuar ose sende, do të kërkohet nga ai së pari t'i përshkruajë dhe t'i shënojë shenjat me të cilat dallohen, e pastaj do t'i tregohet personi së bashku me persona tjerë për atë të panjohur të cilët sipas rregullës duhet të jenë ndërmjet pesë dhe tetë, karakteristikat bazë të të cilëve janë të ngjashme me ato që i ka përshkruar, përkatësisht me atë send, së bashku me sendet nga lloji i njëjtë ose i ngjashëm, pastaj do të pyetet të deklarojë nëse personin ose sendin mund ta njohë me siguri ose me shkallë të caktuar të probabilitetit dhe në rast të përgjigjes pohuese ta tregojë personin, përkatësisht sendin e njohur.

(2) Personave për të cilët kryhet njohja do të këshillohen në të drejtën e thirrjes së mbrojtësit me zgjedhje të vet, përkatësisht do t'u sigurohet mbrojtës dhe do të prolongohet njohja deri në ardhjen e mbrojtësit, por më së gjati në afat prej dy orëve nga koha kur është njoftuar mbrojtësi.

(3) Para miratimit të urdhrit për zbatimin e procedurës hetuese njohja kryhet në prani të prokurorit publik, në atë mënyrë që personi i cili është lëndë e njohjes nuk mund ta shohë dëshmitarin, e as dëshmitari nuk mund ta shohë atë person para se të fillojë njohja.

Neni 221

Marrja në pyetje e dëshmitarit nëpërmjet interpretuesit dhe marrja në pyetje e dëshmitarit i cili është memec ose i shurdhër

Nëse marrja në pyetje e dëshmitarit kryhet nëpërmjet interpretuesit ose nëse dëshmitari është memec ose i shurdhur, marrja në pyetje kryhet në mënyrën e paraparë në nenin 211 të këtij ligji.

Neni 222

Betimi i dëshmitarit

Nga dëshmitari mund të kërkohet ta bëjë betimin. Para seancës kryesore dëshmitari mund ta japë betimin vetëm nëse ekziston frika, se për shkak të sëmundjes ose shkak tjetër nuk do të mundet të vijë në seancën kryesore. Shkaku për të cilin është dhënë betimi do të theksohet në procesverbal. Betimi jepet në mënyrën e përcaktuar në nenin 392 paragrafi (2) të këtij ligji.

Neni 223

Personat të cilët nuk guxojnë ta japin betimin

Nuk guxojnë të japin betim:

1) personat të cilët në momentin e marrjes në pyetje nuk i kanë mbushur 18 vjet dhe

2) personat të cilët për shkak të gjendjes së vet shpirtërore nuk mund ta kuptojnë rëndësinë e betimit.

Neni 224

Moslajmërimi i dëshmitarëve në thirrje dhe refuzimi i dëshmimit

(1) Nëse dëshmitari i cili me rregull është thirrur nuk vjen, ndërsa nuk e arsyeton mungesën, ose pa leje ose shkak të arsyeshëm do të largohet nga vendi ku duhet të merret në pyetje, mundet me urdhër gjyqësor të silltet me detyrim, ndërsa gjykata mund ta dënojë me dënim në para të përcaktuar në nenin 88 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Nëse dëshmitari vjen edhe pa arsye ligjore nuk dëshiron të dëshmojë, edhe pse është paralajmëruar për pasojat, mund të dënohet në para me dënimin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, e nëse edhe më tej refuzon të dëshmojë, do të dënohet me dënim në para të përcaktuar në nenin 88 paragrafi (1) të këtij ligji. Nëse dëshmitari edhe pas dënimit të dytë në para refuzon të dëshmojë, ndërsa procedura mbahet para gjykatës, mund t'i shqiptohet dënim me burg deri në 30 ditë.

(3) Për ankesën kundër aktvendimit me të cilin është shqiptuar dënim me para vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji. Ankesa kundër aktvendimit nuk e ndalon zbatimin e aktvendimit.

Neni 225

Incizimi gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit me mjete vizuele-me zë

Me propozimin e palëve, organi që e udhëheq procedurën mund të vendosë që marrja në pyetje e dëshmitarit të incizohet me mjete vizuele-me zë.

Neni 226

Mbrojtja e dëshmitarëve

(1) Nëse ekziston probabilitet se me dhënien e deklaratës ose me përgjigje të pyetjeve të caktuara, dëshmitari, bashkëpunëtori i drejtësisë ose viktimë, përkatësisht i dëmtuari do të ekspozohet vet ose personi i tij të afërt në rrezik serioz për jetën, shëndetin, ose integritetin fizik, dëshmitari i kërcënuar mund ta shkurtojë dhënien e deklaratës ose paraqitjen e të dhënave nga neni 219 paragrafi (3) të këtij ligji, derisa nuk sigurohen kushtet për mbrojtjen e tij.

(2) Mbrojtja e dëshmitarit të kërcënuar përbëhet në mënyrën e veçantë të marrjes në pyetje dhe pjesëmarrjes në procedurë, të rregulluara me këtë ligj dhe me zbatimin e masave për mbrojtje jashtë procedurës të rregulluara me ligj të veçantë.

(3) Nëse prokurori publik vlerëson se frika nga rreziku nga paragrafi (1) të këtij neni është e bazuar, do ta ndërpresë marrjen në pyetje dhe do të ndërmarrë veprime të shpejta në pajtim me dispozitat për mbrojtje të dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe viktimave, të rregulluara me këtë ligj.

(4) Nëse gjatë procedurës dëshmitari i rrezikuar deklaron se nuk dëshiron mënyrë të posaçme të marrjes në pyetje, ai do të merret në pyetje sipas rregullave të përgjithshme për marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Deklarata e mëparshme e cila është dhënë sipas rregullës për mënyrë të posaçme të marrjes në pyetje të dëshmitarit të rrezikuar mund të shfrytëzohet

gjatë marrjes në pyetje, e pastaj do të ndahet nga dokumentet dhe do t'i dorëzohet gjykatësit të procedurës paraprake në ruajtje në zarf të vulosur.

(5) Nëse vlerëson se kërkesa nga paragrafi (1) të këtij neni është e pabazë, prokurori publik vepron në pajtim me nenin 219 të këtij ligji.

(6) Thirrja e dëshmitarit të rrezikuar në procedurën paraprake ose në seancën kryesore, kryhet nëpërmjet Seksionit për mbrojtjen e dëshmitarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Neni 227

Mbrojtja e dëshmitarit të rrezikuar në procedurën paraprake

(1) Menjëherë sapo të mësohet për mundësinë për ekzistimin e rrethanave nga neni 226 të këtij ligji, prokurori publik do të ndërmarrë masa për mbrojtjen e dëshmitarit të rrezikuar. Prokurori publik me këtë do ta njoftojë dëshmitarin e rrezikuar.

(2) Prokurori publik me aktvendim do ta përcaktojë nofkën e dëshmitarit të rrezikuar, si dhe mënyrën e posaçme të pjesëmarrjes në procedurë dhe në marrjen në pyetje. Në marrjen në pyetje të dëshmitarit të rrezikuar në procedurën paraprake nuk marrin pjesë i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, as i dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij ligjor.

(3) Të dhënat për dëshmitarin e rrezikuar prokurori publik do t'i vulosë në zarf të posaçëm dhe këtë do ta shënojë në dokument, duke e shfrytëzuar nofkën e dëshmitarit të rrezikuar. Zarfi i vulosur me të dhënat për dëshmitarin e rrezikuar mund t'i kërkojë dhe t'i hapë vetëm gjykata e shkallës së dytë kur vendos për ankesën. Në zarf do të shënohet se është hapur dhe do të shënohen emrat e anëtarëve të këshillit të cilët do të njoftohen me përmbajtjen e tij. Pasi që kur anëtarët e këshillit do të njoftohen me përmbajtjen e tij, zarfi prap do të vuloset dhe do t'i kthehet prokurorit publik.

(4) Dëshmitarit të rrezikuar nuk guxohet t'i parashtrohen pyetje me të cilat në mënyrë direkte ose indirekte do t'i zbulonte identitetin e vet, vendbanimin, punësimin dhe anëtarët e familjes.

(5) Personat të cilët në çfarëdo roli do t'i mësojnë të dhënat për dëshmitarin e rrezikuar, janë të obliguar që t'i ruajnë si informacione të klasifikuara.

Neni 228

Mbrojtja e dëshmitarit të rrezikuar në seancën kryesore

(1) Propozimi i arsyetuar me shkrim për mënyrën e posaçme të marrjes në pyetje të dëshmitarit të rrezikuar, prokurori publik në zarf të vulosur ia parashtron gjykatësit, përkatësisht këshillit për vlerësim të aktakuzës gjatë parashtrimit të aktakuzës.

(2) Gjykata vendos për propozimin e prokurorit publik me aktvendim, i cili është i obliguar që ta miratojë më së voni në afat prej 48 orëve nga pranimi i propozimit.

(3) Nëse gjykata e pranon propozimin e prokurorit publik, do ta përcaktojë me aktvendim nofkën e dëshmitarit të rrezikuar, nëse deri atëherë nuk ka qenë e përcaktuar, si dhe mënyrën e posaçme të pjesëmarrjes në procedurë dhe në marrjen në pyetje. Kundër aktvendimit të gjykatës nuk lejohet ankesë.

(4) Mënyra e posaçme e marrjes në pyetje mund të përbëhet nga fshehja e identitetit, ndërsa në raste të caktuara dhe pamjes së dëshmitarit të rrezikuar (nenet 229 dhe 230).

Neni 229

Marrja në pyetje nën pseudonim

(1) Nëse mënyra e posaçme e marrjes në pyetje të dëshmitarit i përket vetëm fshehjes së të dhënave personale, marrja në pyetje do të zbatohet nën nofkë pa theksimin e të dhënave tjera nga neni 219 paragrafi (3) të këtij ligji. Në pjesën tjetër marrja në pyetje do të zbatohet sipas dispozitave të përgjithshme për marrjen në pyetje të dëshmitarit.

(2) Pas mbarimit të marrjes në pyetje dëshmitari i rrezikuar e nënshkruan procesverbalin me pseudonim.

(3) Personat të cilët në çfarëdo roli do t'i mësojnë të dhënat për dëshmitarin e rrezikuar, janë të obliguar që t'i ruajnë si informacione të klasifikuara.

Neni 230

Marrja në pyetje me ndihmën e pajisjeve teknike për transmetim të fotografisë dhe zërit

(1) Nëse mënyra e posaçme e pjesëmarrjes në procedurë dhe marrja në pyetje e dëshmitarit të rrezikuar i përket përveç fshehjes së informatave nga neni 219 paragrafi (3) të këtij ligji edhe fshehjes së pamjes së dëshmitarit të rrezikuar, marrja në pyetje do të zbatohet me ndihmën e pajisjeve teknike për transmetim të fotografisë dhe zërit, me ç'rast fytyra e dëshmitarit të rrezikuar dhe zëri i tij janë të ndryshuar.

(2) Dëshmitari i rrezikuar gjatë marrjes në pyetje mund të gjendet në lokal të posaçëm, i cili është fizikisht është i ndarë nga lokali në të cilin gjenden gjykatësi dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë.

Neni 231

Të drejtat e mbrojtjes gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të rrezikuar në seancën kryesore

(1) Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit të rrezikuar në seancën kryesore posaçërisht do të kihet kujdes në të drejtën e të akuzuarit dhe të mbrojtësit të tij, që të kenë mundësi adekuate dhe të mjaftueshme t'i kontestojnë dhe t'i kontrollojnë dëshmitë e tyre.

(2) Aktgjykimi nuk mund të themelohet vetëm në bazë të deklaratës së dëshmitarit të rrezikuar, të marrë me zbatimin e dispozitave për fshehjen e identitetit të tij ose pamjes për shkak të mbrojtjes së tij dhe mbrojtjes së personave të afërm të tij.

Neni 232

Marrja në pyetje e viktimave dhe dëshmitarëve posaçërisht të cenuar

(1) I dëmtuari dhe dëshmitari për të cilin organi e mban procedurën do të përcaktojë se duke marrë parasysh moshën, gjendjen shëndetësore, natyrën ose pasojat nga vepra penale, përkatësisht për shkak të rrethanave tjera të rastit janë posaçërisht të cenuar, personi i mitur viktimë e tregtisë me njerëz, dhunës, ose keqpërdorimit seksual dhe se marrja në pyetje në lokalet e organit që e mban procedurën do të ketë pasoja të dëmshme për shëndetin

e tyre psikik ose fizik do të merren në pyetje në mënyrën e përcaktuar me këtë nen.

(2) Kur organi që e mban procedurën do të vlerësoj se ajo është e nevojshme për shkak të ndihmës së të dëmtuarit ose dëshmitarit nga paragrafi (1) të këtij neni do t'i parashtroj autorizues gjatë kohës së marrjes në pyetje.

(3) Pyetjet e të dëmtuarit dhe dëshmitarit nga paragrafi (1) të këtij neni mund të parashtrohen vetëm nëpërmjet organit që e mban procedurën, i cili kundër personit të tillë duhet të sillet me kujdes të veçantë që të tejkalohen pasojat e dëmshme të procedurës penale ndaj personalitetit të tij, shëndetit trupor dhe shpirtëror.

(4) Marrja në pyetje e të dëmtuarit dhe dëshmitarit nga paragrafi (1) të këtij neni mund të kryhet me ndihmën e psikologut, punëtorit social ose personit tjetër profesional, ndërsa organi që e mban procedurën mund të vendos që personi të merret në pyetje me përdorimin e mjeteve teknike për transmetim të fotografisë dhe zërit, pa praninë e palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë në lokalitete në të cilin gjendet i dëmtuari ose dëshmitari, kështu që palët, mbrojtësi dhe personat që kanë të drejtë t'i parashtrojnë pyetje, atë e bëjnë me ndërmjetësim të organit që e mban procedurën, psikologut, pedagogut, punëtorit social ose personit tjetër profesional.

(5) Gjatë marrjes në pyetje të të dëmtuarit ose dëshmitarit nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata mund ta përjashtojë publikun.

(6) I dëmtuari ose dëshmitari nga paragrafi (1) të këtij neni nuk guxojnë të ballafaqohen me të akuzuarin, ndërsa me dëshmitarët tjerë vetëm me kërkesë të tyre.

3. Kontrolli dhe rikonstruksioni

Neni 233

Ndërmarrja e inspektimit

(1) Inspektimin e ndërmerr prokurori publik, ndërsa me autorizim të tij edhe policia e jurisprudencës kur për verifikimin ose shpjegimin e ndonjë fakti të rëndësishëm në procedurë është i nevojshëm shënimi i drejtpërdrejt.

(2) I dyshuari, mbrojtësi dhe i dëmtuari mund të marrin pjesë gjatë inspektimit. Prania e tyre nuk e prolongon ndërmarrjen e inspektimit.

Neni 234

Rikonstruksioni i ngjarjes

(1) Për shkak të kontrollit të provave të siguruara ose përcaktimit të fakteve të cilat janë të rëndësishme për qartësimin e punëve, organi që e mban procedurën mund të caktoj rikonstruksion të ngjarjes, e cila kryhet ashtu që do të përsëriten veprimet ose situatat në kushtet nën të cilat sipas provave të siguruara ka ndodhur ngjarja. Nëse në deklaratat e dëshmitarëve ose të dyshuarve të veçantë, përkatësisht të akuzuarve, veprimet ose situatat janë paraqitur ndryshe, rikonstruksioni i ngjarjes, sipas rregullës, do të kryhet veç e veç me secilin prej tyre.

(2) Rikonstruksioni nga paragrafi (1) të këtij neni mund të zbatohet në tërësi ose me shfrytëzim të pjesshëm të simulimeve kompjuterike.

(3) Rikonstruksioni nuk guxon të kryhet në mënyrën me të cilën prishet rendi publik dhe morali ose vihet në rrezik jeta ose shëndeti i njerëzve.

(4) Gjatë rikonstruksionit sipas nevojës mundet përsëri të nxirren prova të veçanta.

Neni 235

Pjesëmarrja e personit profesional dhe ekspertit gjatë kryerjes së kontrollit dhe rikonstruksionit

(1) Organi që kryen kontroll ose rikonstruksion mund të kërkojë ndihmë nga person profesional nga teknika-kriminalistike, e komunikacionit ose profesionit tjetër, i cili sipas nevojës do të ndihmojë në gjetjen, sigurimin ose përshkrimin e gjurmëve, do të kryejë matje të nevojshme dhe incizime, do të bëjë skica dhe fotodokumentacion ose do të grumbullojë edhe të dhëna tjera.

(2) Në inspektim dhe rikonstruksion mund të thirret eksperti nëse prania e tij do të jetë në favor për dhënien e konstatimit ose mendimit.

4. Ekspertiza

Neni 236

Përcaktimi i ekspertizës

(1) Ekspertiza përcaktohet kur për vërtetimin ose vlerësimin e ndonjë fakti të rëndësishëm të sigurohet konstatimi dhe mendimi nga personi i cili disponon me diturinë e nevojshme profesionale. Ekspertizën sipas rregullës e kryejnë ekspertë të regjistruar në regjistrin e ekspertëve.

(2) Ekspertiza përcaktohet me urdhëresë me shkrim.

(3) Gjatë procedurës paraprake urdhëresën e miraton prokurori publik, ndërsa në seancën kryesore gjykata në pajtim me nenin 394 paragrafi (2) të këtij ligji.

(4) Në urdhëresë do të ceket në lidhje me cilat fakte kryhet ekspertiza dhe kujt i ngarkohet.

(5) Nëse për lloj të caktuar të ekspertizës ekziston institucion i lartë arsimor, institucion shkencor ose institucion profesional ose ekspertiza mund të kryhet në kundër të organit të administratës shtetërore, ekspertizat e tilla, e posaçërisht më të komplikuarat, do t'i ngarkohen sipas rregullës institucionit, përkatësisht organit të atillë. Nëse konstatimi ose mendimi i ekspertizës i organit të administratës shtetërore është parashtruar si provë nga ana e prokurorit publik, ndërsa mbrojtja e konteston të njëjtën, mund t'i propozojë gjykatës që të urdhërojë ekspertizë, të cilën do ta kryejë institucion ose organi tjetër.

(6) Sipas rregullës, për ekspertizën do të përcaktohet një ekspert, ndërsa nëse ekspertiza është e komplikuar, atëherë të përcaktohen dy ose më shumë ekspertë.

(7) Vetëm me përjashtim mund të përcaktohet për ekspert personi i cili ka vendbanim jashtë vendit ose institucioni i huaj profesional, të cilët sipas ligjeve të vendeve amë i plotësojnë kushtet për kryerjen e ekspertizës, në qoftë se në Republikën e Maqedonisë nuk ekziston institucion i lartë arsimor, institucion shkencor, ose institucion profesional, tregtar ekspert-individual ose shoqëri tregtare e regjistruar për kryerjen e ekspertizës, për lloj të caktuar të ekspertizës.

(8) Organi nga paragrafi (3) të këtij neni që e ka urdhëruar ekspertizën me mendim paraprak të siguar nga eksperti, e përcakton afatin për

ekspertizë dhe për dërgesën e konstatimit dhe mendimit dhe ai afat mund të vazhdohet vetëm me kërkesë të arsyetuar të ekspertit.

Neni 237

Detyrat e ekspertit

(1) Personi i cili është i thirrur si ekspert është i obliguar që të lajmërohet në thirrje dhe të japë konstatimin dhe mendimin e vet në afatin e përcaktuar në urdhëresë. Afati i përcaktuar në urdhëresë, nga shkaqe të arsyeshme, mund të vazhdohet.

(2) Eksperti është i obliguar që të organi që e ka urdhëruar ekspertizën nga neni 236 paragrafi (3) të këtij ligji, të dorëzojë raport i cili i përmban: pprovat që i ka kontrolluar, testet e realizuara, konstatimin dhe mendimin të cilët ka ardhur dhe të gjitha të dhënat tjera relevante që eksperti konsideron se janë të nevojshme për analizë të drejtë dhe objektive. Eksperti do të arsyetoj si ka ardhur te mendimi i caktuar.

(3) Nëse eksperti që është thirrur me rregull nuk vjen, kurse mungesën nuk e arsyeton, ose nëse refuzon që të bëjë ekspertizë ose nëse nuk vepron në afatin e caktuar në urdhëresë, mund të dënohet me para prej 500 deri në 1500 euro në kundërvlerë me denarë, ndërsa institucioni profesional 1000 deri në 3000 euro në kundërvlerë me denarë. Në rast të mungesës së paarsyeshme, eksperti mund të silllet edhe me detyrim.

(4) Për ankesën kundër aktvendimit me të cilin është shqiptuar dënim me para vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji.

Neni 238

Përrjashtimi i ekspertit

(1) Për ekspert nuk mund të merret personi i cili nuk mund të merret në pyetje si dëshmitar (neni 213) ose personi i cili është i liruar nga detyra që të dëshmojë (neni 214), si dhe personi kundër të cilit është kryer vepër penale, e nëse është marrë, në konstatimin dhe mendimin e tij nuk mund të bazohet vendimi gjyqësor.

(2) Arsyeja për përrjashtimin e ekspertit ekziston edhe në lidhje me personin i cili bashkë me të akuzuarin ose me të dëmtuarin është në marrëdhënie pune në organin e njëjtë ose person tjetër juridik, si dhe në lidhje me personin i cili është në marrëdhënie pune tek i dëmtuari ose i akuzuari.

(3) Për ekspert nuk mund të merret personi i cili është marrë në pyetje si dëshmitar.

(4) Kur lejohet ankesë e veçantë kundër aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa për përrjashtimin e ekspertit (neni 36 paragrafi (7)), ankesa e shtyn zbatimin e ekspertizës, nëse nuk ekziston rrezik nga shtyrja.

Neni 239

Procedura për ekspertizë

(1) Me ekspertizën udhëheq organi që e ka urdhëruar ekspertizën nga neni 236 paragrafi (3) i këtij ligji. Para se të fillojë ekspertiza do të thirret eksperti që me vëmendje ta shqyrtojë lëndën e ekspertizës, saktësisht të shënojë gjithçka që do të vërejë dhe gjejë dhe mendimin e tij ta paraqesë në mënyrë të paanshme dhe në pajtim me rregullat e shkencës ose shkathtësisë. Ai në veçanti do të paralajmërohet se dhënia e deklaratës së rrejshme paraqet vepër penale.

(2) Organi para të cilit udhëhiqet procedura ia tregon ekspertit lëndët që do t'i shqyrtojë, i parashtron pyetje dhe sipas nevojës kërkon shpjegim në aspekt të konstatimit dhe mendimit të dhënë.

(3) Ekspertit mund t'i jepen sqarime dhe mund t'i lejohet që t'i shqyrtojë shkresat. Eksperti mund të propozojë që të sigurohen argumente, lëndë dhe të dhëna që janë me rëndësi për dhënien konstatimit dhe mendimit. Nëse merr pjesë në inspektim, rikonstruksion ose në veprim tjetër hetues, eksperti mund të propozojë që të sqarohen rrethanat e veçanta ose t'i parashtrohen pyetje të veçanta personit që merret në pyetje.

Neni 240

Shqyrtimi i lëndës së ekspertizës

(1) Eksperti e shqyrton lëndën e ekspertizës në prezencë të organit që e udhëheq procedurën dhe në prezencë të mbajtësit të procesverbalit, përveç nëse ekspertizë nevojiten inspektime afatgjate ose nëse inspektimet kryhen në institucione ose në organin e administratës shtetërore ose për shkaqe të moralit.

(2) Nëse për qëllimet e ekspertizës nevojitet që të kryhet analizë e ndonjë materie, ekspertit do t'i vihet në dispozicion vetëm një pjesë e asaj materie, nëse kjo është e mundur, e pjesa e mbetur do të sigurohet në sasinë e nevojshme për rast të analizave plotësuese.

Neni 241

Procesverbali i ekspertizës dhe e drejta për shqyrtimin e tij

(1) Në procesverbalin e ekspertizës ose në konstatimin dhe mendimin me shkrim do të shënohet se kush e ka kryet ekspertizën, numrin e licencës së ekspertit dhe sfera për të cilën i është dhënë licenca.

(2) Pas ekspertizës së bërë, organi i cili e ka urdhëruar ekspertizën nga neni 236 paragrafi (3) i këtij ligji, do t'i njoftojë palët dhe mbrojtësin nëse ata nuk kanë marrë pjesë, se ekspertiza është kryer dhe se procesverbali i ekspertizës, respektivisht konstatimin dhe mendimin me shkrim mund t'i shqyrtojnë.

Neni 242

Ekspertiza në institucion profesional ose organ shtetëror

(1) Nëse ekspertiza i ngarkohet një institucioni të lartë arsimor, institucioni shkencor, ose institucioni profesional ose një shoqërie tregtare të regjistruar për kryerjen e ekspertizës ose një organi të administratës shtetërore, organi që e udhëheq procedurën do të përcaktojë se gjatë dhënies së konstatimit dhe mendimin nuk mund të marrë pjesë personi nga neni 238 i këtij ligji, ose personi për të cilin ekzistojnë arsye për përjashtim nga ekspertiza të parapara me këtë ligj, si dhe për pasojat nga dhënia e deklaratës së rrejshme.

(2) Subjekteve nga paragrafi (1) të këtij neni do t'u jepet në dispozicion materiali i nevojshëm për ekspertizë, dhe nëse kjo është e nevojshme, do të veprohet në pajtim me dispozitat nga neni 239 paragrafi (4) i këtij ligji.

(3) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni e dorëzojnë konstatimin dhe mendimin me shkrim të nënshkruar nga personat të cilët e kanë kryer ekspertizën.

(4) Dispozitat nga neni 239 paragrafët (1) dhe (3) të këtij ligji nuk zbatohen kur ekspertiza i është ngarkuar subjekteve nga paragrafi (1) i këtij neni. Organi para të cilit udhëhiqet procedura mund të kërkojë nga subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, sqarim në aspekt të konstatimit dhe mendimit të dhënë.

Neni 243

Mënjanimi i mangësive të ekspertizës

Nëse ekspertiza ose mendimi janë të paqarta, jo të plota ose janë në kundërshtim me vetveten, me urdhër të organit që e udhëheq procedurën, ekspertiza mund t'i kthehet ekspertëve të njëjtë për mënjanimin e mangësive të përcaktuara.

Neni 244

Emërimi i këshilltarëve teknikë

(1) Prokurori publik, si dhe i akuzuari dhe avokati i tij kanë të drejtë të emërojnë këshilltar teknik konform rregullës nga regjistri i ekspertëve, numri i të cilëve nuk mund të jetë më i madh se dy, me qëllim që t'u ndihmojnë në mbledhjen e të dhënave për çështje profesionale ose kontestimin e ekspertizës.

(2) I akuzuari dhe avokati i tij në raste dhe në rrethana të parapara me këtë ligj për mbrojtje të personave të varfër nga neni 75 i këtij ligji, kanë të drejtë në ndihmë nga këshilltari teknik në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

(3) Për këshilltar teknik nuk mund të emërohet personi i cili në pajtim me neni 238 të këtij ligji, nuk mund të jetë ekspert

Neni 245

Veprimet e këshilltarit teknik

(1) Me kërkesë të palëve, këshilltarët teknikë mund të marrin pjesë gjatë ekspertizës dhe ekspertëve t'u japin propozime dhe të japin vërejtje lidhur me ekspertizën, të cilat shënohen në raport.

(2) Nëse këshilltarët teknikë janë emëruar pas përfundimit të ekspertizës, mund ta shqyrtojnë konstatimin dhe mendimin dhe të kërkojnë nga organi që e udhëheq procedurën, të autorizohen që ta kontrollojnë lëndën ose vendin që janë lëndë e ekspertizës.

Neni 246

Kontrolli, obduksioni dhe identifikimi i kufomës

(1) Kontrolli dhe obduksioni i kufomës do të ndërmerret kur ekziston dyshim se vdekja është shkaktuar me vepër penale. Nëse trupi është i varrosur, do të përcaktohet zhvarrosja për shkak të kontrollit dhe obduksionit të tij.

(2) Gjatë obduksionit të kufomës do të ndërmerren masat e nevojshme që të vërtetohet identiteti i kufomës, dhe për atë qëllim është e nevojshme që të përshkruhen të dhënat për vetitë e jashtme dhe të brendshme të kufomës.

(3) Kur është e nevojshme do të zbatohen edhe metoda profesionale dhe shkencore të identifikimit: marrja dhe krahasimi i shenjave të gishtërinjve të kufomës, analiza e ekzemplarit të ADN-së dhe krahasimi i profilit të ADN-së me profilin e ADN-së të personit të zhdukur ose ndonjë personi tjetër,

familjarë gjaku të personit për të cilin supozohet se do të mund të identifikohet, e sipas nevojës dhe ndërmarrja e analizave tjera dhe zbatimi i metodave tjera profesionale dhe shkencore me qëllim që të përcaktohet identiteti i kufomës.

(4) Kontrolli dhe obduksioni i kufomës në institucion profesional kryhet së paku nga dy mjekë, nga të cilët së paku njëri është specialist i mjekësisë ligjore.

Neni 247

Kontrolli dhe obduksioni i kufomës jashtë institucionit profesional dhe përjashtimi i mjekut që e ka mjekuar të vdekurin

(1) Kur ekspertiza nuk kryhet në institucion profesional, kontrollin dhe obduksionin e kufomës e kryen një, kurse sipas nevojës dy ose më tepër mjekë nga lëmi e mjekësisë ligjore. Me ekspertizën e këtillë udhëheq prokurori publik dhe në procesverbal e shënon konstatimin dhe mendimin e ekspertit. Rrjedha e çdo kontrolli dhe obduksioni të kufomës patjetër duhet të incizohet në mënyrë vizuale-me zë, dhe procesverbalit i bashkëngjitet ekzemplari i incizimit vizuel-me zë.

(2) Për ekspert nuk mund të përcaktohet mjeku i cili e ka mjekuar të vdekurin. Gjatë obduksionit të kufomës, për shkak të dhënies së sqarimit për rrjedhën dhe rrethanat e sëmundjes, mjeku që e ka mjekuar të vdekurin mund të merret në pyetje si dëshmitar.

Neni 248

Ekspertiza psikiatrike

(1) Nëse paraqitet dyshimi se është përjashtuar ose zvogëluar vetëdija e të akuzuarit, për shkak të sëmundjes së përhershme ose të përkohshme shpirtërore, çrregullimit të përkohshëm shpirtëror ose zhvillimit të ngecur shpirtëror, do të përcaktohet ekspertizë psikiatrike për të akuzuarin.

(2) Nëse paraqitet dyshimi se është përjashtuar ose zvogëluar aftësia e të akuzuarit që të marrë pjesë në procedurë, për shkak të sëmundjes së përhershme ose të përkohshme shpirtërore, çrregullimit të përkohshëm shpirtëror ose zhvillimit të ngecur shpirtëror, do të përcaktohet ekspertizë psikiatrike për të akuzuarin, nëse me kontroll nga ana e personit profesional nuk mundet me siguri të përcaktohet aftësia.

(3) Nëse sipas mendimit të ekspertit është e nevojshme mbikëqyrje më e gjatë, i akuzuari do të dërgohet në mbikëqyrje në institucion adekuat shëndetësor. Vendim për këtë miraton gjykata Mbikëqyrja mund të zgjasë një muaj, kurse vetëm me propozim të arsyetuar të drejtorit të institucionit shëndetësor pas mendimit të marrë paraprak nga ekspertët, mund të zgjasë më së gjati dy muaj.

(4) Kundër vendimit nga paragrafi (2) të këtij neni, i akuzuari dhe avokati i tij mund të deklarojnë ankesë në afat prej 24 orëve nga ora kur vendimi i është dorëzuar të akuzuarit, respektivisht avokatit. Për ankesën në afat prej 48 orëve vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) i këtij ligji. Ankesa nuk e ndalon zbatimin e aktvendimit.

(5) Nëse ekspertët vërtetojnë se gjendja shpirtërore e të akuzuarit është e çrregulluar, do ta përcaktojnë natyrën, llojin dhe shkallën dhe afatin e çrregullimit dhe do ta japin mendimin e tyre për atë se çfarë ndikimi ka pasur gjendja e tillë shpirtërore dhe çfarë ka ende ndaj mendimit dhe veprimeve të

të akuzuarit, si dhe nëse dhe në çfarë mase ka ekzistuar çrregullimi i gjendjes shpirtërore gjatë kryerjes së veprës penale.

(6) Nëse në institucionin shëndetësor dërgohet i akuzuari i cili gjendet në paraburgim, gjykatësi i procedurës paraprake do ta njoftojë institucionin për arsyet për të cilat është përcaktuar paraburgimi, që të ndërmerren masat e nevojshme për sigurimin e qëllimit të paraburgimit.

(7) Koha e kaluar në institucionin shëndetësor do t'i llogaritet të akuzuarit në paraburgim, respektivisht dënim, nëse i shqiptohet.

Neni 249

Kontrolli trupor, marrja e gjakut dhe veprime tjera mjekësore

(1) Kontroll trupor i të akuzuarit ose personave tjerë do të ndërmerret edhe pa pëlqimin e tyre nëse është e nevojshme që të përcaktohen faktet e rëndësishme për procedurën penale.

(2) Marrja e gjakut, ose veprime tjera mjekësore, të cilat sipas rregullave të shkencës mjekësore ndërmerren për shkak të analizës, identifikimit të personave përcaktimin e fakteve tjera të nevojshme për procedurën penale, mund të ndërmerren edhe pa pëlqimin e personit që kontrollohet, nëse për këtë shkak nuk do të shkaktohej ndonjë dëm ndaj shëndetit të tij.

(3) Ekzemplarë për zbatimin e analizës së ADN-së mund të merren, kur kjo është e nevojshme për shkak të identifikimit të personave ose për shkak të zbatimit me gjurmë tjera biologjike dhe profile tjera të ADN-së, dhe për këtë nuk nevojitet pëlqimi nga personi.

(4) Nuk lejohet që ndaj të akuzuarit ose dëshmitarit të zbatohen intervenime mjekësore ose t'u jepen mjete të atilla me të cilat do të ndikohej mbi vetëdijen dhe vullnetin e tyre gjatë dhënies së dëshmisë.

(5) Nëse nuk ngritet procedurë, ekzemplarët e marrë në pajtim me këtë neni mund të ruhen deri në parashkrimin e ndjekjes penale sipas dispozitave të Kodit penal.

5. Incizimi dhe dëshmia elektronike

Neni 250

Dëshmimi me incizim

(1) Fotografii, filma dhe incizime tjera audio ose vizuale të marra me mjete teknike, mund të shërbejnë si dëshmi në procedurën penale.

(2) Lidhur me të incizimit veprohet si edhe me lëndët tjera të cilat mund të përdoren si dëshmi, duke pasur kujdes që të mos dëmtohet ose shkatërrohet dhe të ruhet përmbajtja e tij në formë të pandryshuar. Sipas nevojës do të ndërmerren masa të nevojshme që të ruhet incizimi në formë të pandryshuar ose të përpunohet kopja e saj.

(3) Nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj, përmbajtja e incizimit përcaktohet me riprodhimin e tij. Incizimin e riprodhojnë persona profesionalë.

Neni 251

Dëshmia elektronike

Për sigurimin e dëshmisë elektronike zbatohen dispozitat nga nenet 198 dhe 199 të këtij ligji, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Kreu XIX MASA TË VEÇANTA HETUESE

Neni 252

Qëllimi dhe llojet e masave të veçanta hetuese

(1) Kur ka gjasa që të sigurohen të dhëna dhe prova të domosdoshme për udhëheqjen e suksesshme të procedurës penale, të cilat në mënyrë tjetër nuk mund të mblidhen, mund të ndërmerren masat e veçanta hetuese në vijim:

- 1) përcjellja dhe incizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike në procedurën e përcaktuar me ligj të veçantë;
- 2) përcjellja dhe incizimi në shtëpi, lokal të mbyllur ose të rrethuar që i takon asaj shtëpie ose lokal afarist të shënuar si privat ose në automjet dhe hyrje në ato lokale për krijimin e kushteve për përcjelljen e komunikimeve;
- 3) përcjellja dhe incizimi i fshehtë i personave dhe sendeve me mjete teknike jashtë shtëpisë ose lokalit afarist të shënuar si private;
- 4) shikimi i fshehtë dhe kontrollimi i sistemit kompjuterik;
- 5) kërkimi automatik ose në mënyrë tjetër, kërkimi dhe krahasimi i të dhënave personale;
- 6) shikimi në komunikimet telefonike ose komunikimet tjera të realizuara elektronike;
- 7) grumbullimi i simuluar i sendeve;
- 8) dhënia dhe pranimi i simuluar i mitës;
- 9) dorëzimi dhe transporti i kontrolluar i personave dhe sendeve;
- 10) përdorimi i personave me identitet të fshehur për përcjelljen dhe grumbullimin e informatave ose të dhënave;
- 11) hapja e llogarisë bankare në të cilën mund të depozitohen mjetet që rrjedhin nga vepra e kryer penale dhe
- 12) regjistrimi i simuluar i personave juridikose përdorimi i personave ekzistues juridikë për mbledhjen e të dhënave.

(2) Në rastin kur nuk disponohet me të dhëna për identitetin e kryerësit të veprës penale, masat e veçanta hetuese nga paragrafi (1) i këtij neni mund të përcaktohen dhe ndaj lëndës së veprës penale.

Neni 253

Vepra penale për të cilat mund të përcaktohen masa të veçanta hetuese

Masat e veçanta hetuese mund të përcaktohen, kur ekziston baza për dyshim:

- 1) për vepra penale për të cilat është përcaktuar dënim me burg prej së paku katër vitesh, e që përgatiten, vijon kryerja ose janë kryer nga ana e një grupi të organizuar, bande ose shoqërie kriminale, ose
- 2) për veprat penale vrasje nga neni 123; grabitje nga neni 141; ndërmjetësim në prostitucion nga neni 191 paragrafët (1), (3) dhe (4); paraqitja e materialit pornografik para të miturit nga neni 193; prodhim dhe distribuim i pornografisë së fëmijëve nga neni 193-a; mashtrim për dhunim ose veprim tjetër seksual të të miturit i cili nuk i ka mbushur 14 vjet nga neni 193-b; prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekurzorëve nga neni 215 paragrafët (1) dhe (3); dëmtim dhe ndërhyrje e paautorizuar në sistemin kompjuterik nga neni

251, paragrafët (4) dhe (6); zhvatje nga neni 258; shantazh nga neni 259, paragrafi (2); përvetësim i të mirave nën mbrojtje të përkohshme ose trashëgimisë kulturore ose rariteteve natyrore nga neni 265; eksportim, respektivisht nxjerrja jashtë shtetit të të mirave nën mbrojtje të përkohshme ose trashëgimi kulturore ose rariteteve natyrore nga neni 266 paragrafi (1); tjetërsim i trashëgimisë kulturore me rëndësi të veçantë të pronësisë shtetërore nga neni 266-a; larje e parave dhe të hyrave tjera nga veprat penale nga neni 273 paragrafët (1), (2) dhe (3) dhe nga paragrafët (5), (6), (8) dhe (12); kontrabandim nga neni 278, paragrafët (3) dhe (5); mashtrim doganor nga neni 278-a; keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar nga neni 353; vjedhje në detyrë nga neni 354; mashtrim në detyrë nga neni 355; shërbim në detyrë nga neni 356; marrje e mitës nga neni 357 paragrafët (1), (4), (5) dhe (6); dhënie e mitës nga neni 358, paragrafët (1) dhe (4); ndërmjetësim i paligjshëm nga neni 359 paragrafi (6); ndikim i paligjshëm mbi dëshmitarë nga neni 368-a, paragrafi (3); organizim kriminal nga neni 394 , paragrafi (3); organizatë terroriste nga neni 394-a, paragrafët (1), (2) dhe (3); terrorizmit nga neni 394-b, finansimi i terrorizmit nga neni 394- v, të gjitha nga Kodi penal ose

3) për vepra penale kundër shtetit (Kreu XXVIII), vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare (Kreu XXXIV) nga Kodi penal.

Neni 254

Nxitja dhe ndihma të masat e veçanta hetuese

(1) Me ndërmarrjen e masave të veçanta hetuese nga neni 252 paragrafi (1) të këtij ligji nuk guxon të nxitet kryerja e veprës penale.

(2) Kundër personit që i ndërmerr masat e veçanta hetuese nga neni 252 paragrafi (1) të këtij ligji, nuk do të ndërmirret ndjekje penale për veprimet që paraqesin ndihmë për vepra penale, e janë kryer për sigurimin e të dhënave dhe provave për udhëheqjen e suksesshme të procedurës penale.

Neni 255

Personat kundër të cilëve nuk mund të përcaktohen masa të veçanta hetuese

(1) Në pajtim me kushtet nga neni 252 paragrafi (1) i këtij ligji, urdhëresa mund të vlejë për personin:

1) që ka kryer vepër penale nga neni 253 i këtij ligji;

2) që ndërmerr veprim të kryerjes së veprës penale nga neni 253 i këtij ligji ose

3) që e përgatit kryerjen e veprës penale nga neni 253 të këtij ligji kur përgatitja është e dënueshme sipas dispozitave të Kodit penal.

(2) Urdhëresa mund të vlejë edhe për personin i cili pranon ose përcjell dërgesa nga i dyshuari ose i dyshuari përdor mjet të tij komunikues.

(3) Nëse gjatë zbatimit të masës përcillen dhe incizohen komunikimet e personave që nuk janë përfshirë me urdhëresën, prokurori publik është i obliguar që t'i ndajë dhe ta njoftojë gjykatësin e procedurës paraprake. Me propozim të prokurorit publik, gjykatësi i procedurës paraprake mund të urdhërojë që nga dokumentacioni i plotë nga zbatimi i masës të ndahen vetëm pjesët që kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën është dhënë urdhëresa.

Neni 256

Organi i autorizuar për urdhërimin e masave të veçanta hetuese

Masat nga neni 252 paragrafi (1), pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji pas kërkesës së arsyetuar të prokurorit publik, i përcakton gjykatësi i procedurës paraprake me urdhëresë me shkrim. Masat nga neni 252 paragrafi (1), pikat 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji i përcakton prokurori publik me urdhëresë me shkrim.

Neni 257

Përmbajtja e urdhëresës

(1) Urdhëresa me të cilën përcaktohet një ose më shumë masa të veçanta hetuese, i përmban:

- emrin ligjor të veprës penale,
- personin ose lëndët mbi të cilat do të zbatohen masat,
- mjetet teknike të cilat do të aplikohen,
- vëllimin dhe vendin zbatimit të masave,
- njohuritë dhe dëshmitë mbi të cilat mbështetn bazat e dyshimit dhe arsyetimi i shkaqeve për të cilat të dhënat ose dëshmitë nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër,
- organin që duhet ta zbatojë urdhëresën dhe
- kohëzgjatjen e masës.

(2) Urdhëresa për përcjelljen dhe incizimin e komunikimeve nga neni 252 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, duhet t'i përmbajë edhe llojin e sistemit telekomunikues, numrin e telefonit ose të dhënë tjetër për identifikimin e lidhjes telekomunikuese.

Neni 258

Organi i autorizuar për zbatimin e masave të veçanta hetuese

(1) Masat nga neni 252 të këtij ligji i zbaton prokurori publik ose policia e jurisprudencës nën kontroll të prokurorit publik. Gjatë zbatimit të masës policia e jurisprudencës përgatit raport të cilin e dorëzon te prokurori publik me kërkesë të tij.

(2) Pas zbatimit e masave policia e jurisprudencës përgatit raport të veçantë, të cilin e dorëzon te prokurori publik.

(3) Në raportin nga paragrafi (2) i këtij neni shënohen:

- 1) koha e fillimit dhe përfundimit të masës;
- 2) numri dhe identiteti i personave të përfshirë me masën dhe
- 3) përshkrimi i shkurtër për rrjedhën dhe rezultatet nga zbatimi i masës.

(4) Dokumentacioni i plotë i shkresës teknike dorëzohet te prokurori publik, në shtojcë të raportit të veçantë.

(5) Prokurori publik raportin e veçantë dhe dokumentacionin e plotë nga paragrafi (3) të këtij neni, i dorëzon të gjykatësi i procedurës paraprake.

Neni 259

Përdorimi i masave të veçanta hetuese si dëshmi në procedurën penale

(1) Të dhënat, njoftimet, dokumentet dhe lëndët e mbledhura me zbatimin e masave të veçanta hetuese nga neni 252 i këtij ligji, me kushte dhe

në mënyrë të përcaktuara me këtë ligj, mund të përdoren si dëshmi në procedurën penale.

(2) Deklaratat e marra me zbatimin e masave të veçanta hetuese nga persona të cilët në pajtim me këtë ligj janë të liruar nga obligimi për dëshmim, nuk mund të përdoren si dëshmi.

(3) Personat që kanë marrë pjesë në zbatimin e masave nga neni 252 paragrafi (1) pika 10 nga ky ligj, mund të merren në pyetje si dëshmitarë të mbrojtur me kushte të përcaktuara me nenin 226 deri 232 të këtij ligji.

(4) Identiteti i personave që kanë marrë pjesë në zbatimin e masave nga neni 252 paragrafi (1) pika 10 nga ky ligj, paraqesin fshehtësi zyrtare.

(5) Nëse gjatë zbatimit të masës nuk është vepruar në pajtim me dispozitat e këtij ligji, mbi të dhënat e marra nuk mund të bazohet vendimi gjyqësor.

Neni 260

Kohëzgjatja e zbatimit të masave

(1) Masat e veçanta hetuese mund të zgjasin më së gjati katër muaj.

(2) Vazhdimin e masave nga neni 252 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3 dhe 4), më së gjati për katër muaj tjerë mund ta lejojë gjykatësi i procedurës paraprake, e pas kërkesës së arsyetuar me shkrim të prokurorit publik.

(3) Për veprat penale për të cilat është përcaktuar denim me burg prej së paku katër vitesh për të cilat ekziston dyshim i bazur se janë kryer nga ana e grupit të organizuar, bandës ose shoqatës tjetër kriminale, gjykatësi i procedurës paraprake mund ta vazhdojë afatin nga paragrafi (2) të këtij neni për më së gjati 6 muaj, pas kërkesës me shkrim të prokurorit publik, e në bazë të vlerësimit të dobisë nga të dhënat e mbledhura me zbatimin e masës dhe në bazë të pritjes së arsyeshme se me masën edhe më tutje mund të fitohen të dhëna në interes për procedurën.

(4) Masat nga neni 252 paragrafi (1) pikat 9, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji, mund të vazhdohen deri në realizimin e qëllimit për të cilin është përcaktuar masa, kurse më së voni deri në përfundimin e hetimit.

(5) Kundër aktvendimit të gjykatësit me të cilin nuk lejohet vazhdimi i kohëzgjatjes së masës, pas ankesës së prokurorit publik në afat prej 24 orësh, vendos këshilli i gjykatës nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji.

Neni 261

Ndërprerja e masave të veçanta hetuese

Kur të arrihen qëllimet për të cilat janë përcaktuar masat e veçanta hetuese ose do të pushojnë së ekzistuari bazat për të cilat janë lejuar, organi që e ka dhënë ose vazhduar urdhëresën është i obliguar që menjëherë të urdhërojë ndërprerjen e masave. Nëse prokurori publik heq dorë nga ndjekja penale ose nëse të dhënat e mbledhura me masat e veçanta hetuese nuk kanë rëndësi për udhëheqjen e procedurës, do të asgjësohen nën mbikëqyrje të gjykatësit, e për këtë prokurori publik do të përgatisë procesverbal.

Neni 262

Njoftimi i personit të tanguar

Pas përfundimit të masave të veçanta hetuese, nëse kjo nuk e dëmton procedurën, me kërkesë të personit të tanguar, prokurori publik do t'ia

dorëzojë urdhëresën me shkrim. Personi i tanguar kërkesën mund ta dorëzojë edhe në gjykatë.

Neni 263

Zgjerimi i urdhëresës

Nëse gjatë zbatimit të masës do të fitohen të dhëna për veprë penale e cila nuk është përfshirë me urdhëresën, masa do të vazhdohet vetëm nëse bëhet fjalë për veprë penale nga neni 253 i këtij ligji dhe të dhënat e mbledhura në atë mënyrë mund të përdoren si dëshmi në procedurën penale.

Neni 264

Mbrojtja e të dhënave personale në lidhje me masat e veçanta hetuese

Personi i cili në cilëndo qoftë mënyrë kupton të dhëna që kanë të bëjnë ose dalin nga zbatimi i masave të veçanta hetuese, është i obliguar që t'i ruajë si sekret zyrtar.

Neni 265

Kërkimi automatik ose kërkimi dhe krahasimi në mënyrë tjetër i të dhënave personale të qytetarëve

Masa nga neni 252 paragrafi (1) pika 5 të këtij ligji, përbëhet nga kërkimi automatik ose mënyrë tjetër e kërkimit dhe krahasimit të përmbledhjeve të të dhënave personale të personave dhe të dhënave tjera të cilat drejtpërdrejt janë të lidhura me to dhe krahasimin e tyre, me karakteristika të caktuara të personit për të cilin supozohet me bazë se ka lidhje me veprën penale, me qëllim që të përjashtohen personat që nuk janë të dyshuar ose të caktohen personat që i posedojnë karakteristikat që janë të nevojshme për hetimin.

Neni 266

Detyrat e kontrollorëve të përmbledhjeve të të dhënave

(1) Personat juridikë dhe fizikë që kryejnë përpunimin e të dhënave personale, janë të obliguar që të mundësojnë kryerjen pa pengesë të urdhëresës për zbatimin e masës nga neni 252 paragrafi (1) pika 5 e këtij ligji.

(2) Për qëllimet nga paragrafi (1) të këtij neni, personat juridikë dhe fizikë janë të obliguar që t'i bëjnë të kapshme të dhënat personale që kërkohen dhe t'uadorëzojnë organeve kompetente.

Neni 267

Shlyerja ose asgjësimi i të dhënave të mbledhura personale

Nëse në afat prej pesëmbëdhjetë muajsh pas përfundimit të zbatimit të masës nga neni 252 paragrafi (1) pika 5 të këtij ligji, nuk ngritet procedura penale, të gjitha të dhënat e mbledhura personale shlyhen ose asgjësohen nën mbikëqyrje të gjykatësit të procedurës paraprake, prokurorit publik dhe përfaqësuesit të Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për çfarë prokurori publik do të përgatisë procesverbal.

Neni 268

Arsyet për kufizimin e zbatimit të masave të veçanta hetuese

(1) Masa nga neni 252 paragrafi (1) pika 2 e këtij ligji guxon që të drejtohet vetëm ndaj të dyshuarit dhe të zbatohet vetëm në shtëpinë e të

dyshuarit. Masa lejohet edhe në shtëpinë e personave tjerë, vetëm në bazë të dyshimit të bazuar se aty qëndron i dyshuari.

(2) Incizimi do të ndërpritet nëse gjatë incizimit ekzistojnë tregues se do të ndeshen dëshmitë që bëjnë pjesë në sferën themelore të jetës private dhe familjare. Dokumentacioni për dëshmitë e atilla duhet menjëherë të asgjësohet.

Neni 269

Personat për hetim me identitet të fshehur dhe autorizimet e tyre

(1) Personat me identitet të fshehur nga neni 252 paragrafi (1) pika 10 të këtij ligji, janë pjesëtarët e policisë gjyqësore ose ekskluzivisht persona tjerë të cilët me leje nga prokurori publik, kryejnë hetim me identitet të fshehur ose të ndryshuar.

(2) Për nevojat e personave për hetim me identitet të fshehur, mund të përgatiten, ndryshohen ose përdoren dokumente personale dhe dokumente tjera.

(3) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni, kanë të drejtë që me identitetin e ndryshuar të marrin pjesë në qarkullimin juridik.

(4) Organet kompetente shtetërore ose persona tjerë juridikë janë të obliguar që të mundësojnë të përgatiten dokumentet nga paragrafi (2) i këtij neni.

(5) Të punësuarit në organet shtetërore dhe personat juridikë nga paragrafi (4) i këtij neni, janë të obliguar që t'i ruajnë si informatë e klasifikuar të gjitha të dhënat dhe informatat në lidhje me përgatitjen e dokumenteve nga paragrafi (2) i këtij neni.

Neni 270

Mbrojtja e fshehtësisë së identitetit të personave për hetim me identitet të fshehur

Identiteti i personave për hetim me identitet të fshehur ruhet në fshehtësi edhe pas përfundimit të procedurës, për shkak të mbrojtjes së jetës, integritetit fizik ose lirisë së këtyre personave dhe të afërmeve të tyre.

Neni 271

Njoftimi për zbatimin e masave të veçanta hetuese

(1) Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë një herë në vit dorëzon raport për masat e veçanta hetuese, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë që janë kërkuar në vitin paraprak kalendarik.

(2) Në raportin nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të shënohen:

1) numri i procedurave në të cilat janë të urdhëruara masat e veçanta hetuese në pajtim me nenin 252 të këtij ligji;

2) veprat penale që kanë shërbyer si shkak, në pajtim me ndarjen në nenin 253 të këtij ligji;

3) vallë procedura është e lidhur me ndjekjen e krimit të organizuar;

4) numri i objekteve të mbikëqyrura dhe numri i personave të mbikëqyrur për çdo procedurë sipas personave të akuzuar dhe të paakuzuar;

5) kohëzgjatja e masës së veçantë hetuese;

6) vallë nga përcjellja kanë dalë rezultate që janë relevante për procedurën, ose ekziston probabiliteti se mund të jenë relevante për procedurën;

7) nëse nga përcjellja nuk kanë dale rezultate relevante, cilat janë arsyet për këtë, në mënyrë të diferencuar, sipas shkaqeve teknike dhe shkaqeve tjera dhe

8) shpenzimet që dalin nga zbatimi i masës së veçantë hetuese.

PJESA E DYTË RRJEDHA E PROCEDURËS

SEKSIONI A: PROCEDURA PARAPRAKE

Kreu XX PROCEDURA PARAHETUESE

1. Shkaqet

Neni 272

Shkaqet për ngritjen e procedurës penale

Prokurori publik dhe policia e jurisprudence për veprën e kryer penale njoftohen nga vërejtja e drejtpërdrejtë, nga zëri i arritur ose pas marrjes së kallëzimit penal.

Neni 273

Paraqitja e veprave penale

(1) Të gjitha organet shtetërore, ndërmarrjet publike dhe institucionet janë të obliguara që t'i paraqesin veprat penale për të cilat ndiqet me detyrë zyrtare, për të cilat janë njoftuar ose për to kanë marrë vesh në mënyrë tjetër.

(2) Duke e parashtruar kallëzimin, paraqitësit nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i theksojnë edhe argumentet që u janë të njohura dhe do të ndërmarrin masa që të ruhen gjurmët nga vepra penale, lëndët që janë përdorur në kryerjen e saj ose janë shkaktuar nga kryerja dhe argumente tjera.

(3) Secili mund të paraqesë vepër penale që ndiqet me detyrë zyrtare.

Neni 274

Parashtrimi i kallëzimit

(1) Kallëzimi penal parashtrohet te prokurori publik me shkrim ose me gojë, me telefon, në formë elektronike ose me përdorimin e mjeteve dhe mënyrave tjera teknike.

(2) Nëse kallëzimi është parashtruar nëpërmjet aparaturës elektronike sigurohet shkresa e saj elektronike dhe përpilohet fletëshënim zyrtar.

(3) Nëse kallëzimi penal parashtrohet me gojë, paraqitësi do të paralajmërohet për pasojat e kallëzimit të rremë. Për kallëzimin gojor do të përpilohet procesverbal, e nëse kallëzimi penal është kumtuar nëpërmjet telefonit do të përpilohet shënim zyrtar.

(4) Nëse kallëzimi penal është parashtruar në polici, në gjykatë ose te prokuror jokompetent publik, ata do ta marrin kallëzimin dhe menjëherë do ta dorëzojnë te prokurori kompetent publik.

Neni 275

Afati për vendimmarrje për kallëzimin penal

(1) Nëse prokurori publik në afat prej tre muajve nga dita e pranimit të kallëzimit penal nuk vendos për kallëzimin, është i obliguar që menjëherë me shkrim t'i njoftojë parashtruesin e kallëzimit penal dhe prokurorin më të lartë publik.

(2) Në njoftimit nga paragrafi (1) të këtij neni te prokurori më i lartë publik, paraqiten edhe arsyet për mosvendosje për kallëzimin penal.

2. Vëzhgimet policore

Neni 276

Autorizimet e policisë

(1) Pas pranimit të kallëzimit penal ose njoftimit të marrë për veprë të kryer penale për të cilën ndiqet me detyrë zyrtare, policia është e obliguar që t'i ndërmarrë masat e nevojshme për gjetjen e kryerësit të veprës penale, që të zbulohen dhe sigurohen gjurmët e veprës penale dhe lëndëve që mund të shërbejnë si argument, si dhe t'i mbledhë të gjitha njoftimet që do të mund të jenë në dobi të udhëheqjes së suksesshme të procedurës penale.

(2) Për kryerjen e detyrave nga paragrafi (1) i këtij neni, policia mundet:

1) të kërkojë njoftime të nevojshme nga qytetarët;

2) të ndalojë, legjitimojë dhe të kryejë kontroll të nevojshëm të personave, mjeteve transportuese dhe bagazhit nëse ekziston dyshim i bazuar se te ata do të gjenden gjurmë të veprës penale ose sende që mund të shërbejnë si argument. Koha e mbajtjes së tyre nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtë orë. Polica mund të përdorë forcë në masë të arsyeshme vetëm si mjet i fundit nëse ajo është e domosdoshme që të kryhet kontrolli i personit, mjetit transportues ose bagazhit;

3) ta riorientojë ose kufizojë lëvizjen e personave dhe mjeteve transportuese në hapësirë të caktuar për kohë të nevojshme, por jo më gjatë se gjashtë orë;

4) të ndërmarrë masa të nevojshme për përcaktimin e identitetit të personave dhe sendeve;

5) të zbatojë hetim, të shpallë urdhëresë për personin dhe shpallje për pronën dhe dobinë pronësore ose për sendet për të cilat gjurmohet;

6) në prani të presonit zyrtar ose përgjegjës që të kryejë kontroll të objekteve të caktuara dhe lokalave të organeve shtetërore, institucioneve që kryejnë autorizime publike dhe personave tjerë juridik dhe të realizojë kontroll në dokumentacionin e tyre dhe

7) të ndërmarrë masa tjera të nevojshme dhe veprime të parapara me ligj.

(3) Për faktet dhe rrethanat që janë të përcaktuara gjatë ndërmarrjes të veprimeve të caktuara të cilat mund të jenë në interes të procedurës penale, si dhe për lëndët që janë gjetur ose janë marrë, do të përpilohet procesverbal. Personat dhe udhëtarët e mjetit transportues të cilët kontrollohen ose bastisen, duhet të njoftohen se për veprimet e ndërmarra do të përpilohet procesverbal.

(4) Prokurori publik ka të drejtë dhe detyrë të kontrollit të përhershëm mbi policinë gjatë zbatimit të këtyre veprimeve. Prokurori publik mundet edhe vet t'i zbatojë këto masa.

Neni 277

Marrja e shenjave të gishtërinjve për analizën e ADN-së dhe fotografimi

(1) Kur nevojitet për përcaktimin e identitetit të personave dhe sendeve ose në raste tjera me interes për udhëheqjen e suksesshme të procedurës, policia e jursprudencës mund ta fotografojë të dyshuarin, të marrë shenja nga vijat papilare të gishtave dhe pëllëmbëve, të marrë material biologjik për analizë të ADN-së, e me leje paraprake të prokurorit publik ta paublikojë edhe fotografinë e tij. Policia e jursprudencës mundet që nga i dyshuari të marrë edhe ekzemplarë për analizën e ADN-së, në pajtim me nenin 249 paragrafi (3) nga ky ligj.

(2) Nëse nevojitet që të përcaktohet se nga kush rrjedhin gjurmët e lëna mbi sende të caktuara, policia mund të marrë shenja nga vijat papilare të gishtërinjve dhe pëllëmbëve, si dhe material biologjik për analizën ADN-së nga persona për të cilët ekziston probabilitet se kanë mundur të vijnë në kontakt me këto lëndë.

Neni 278

Identifikimi

1) Në rast kur bëhet fjalë për të dyshuar, identiteti i të cilit i është i njohur policisë së jursprudencës dhe i cili është i kapshëm, mund të zbatohen këto metoda për identifikim nga ana e dëshmitarëve:

- a) me vëzhgim;
- b) me identifikim grupor;
- v) me videofilm dhe
- g) me përballje.

(2) Zbatimi i këtyre llojeve të identifikimit kryhet në prezencë të prokurorit publik.

(3) Para se të shkohet në identifikim, dëshmitari do ta përshkruajë personin që është i dyshuar dhe për atë do të përpilohet procesverbal.

(4) Gjatë identifikimit ka të drejtë të marrë pjesë mbrojtësi i të akuzuarit.

(5) Vëzhgimi nuk do të kryhet nëse për shkak të pamjes së parëndomtë të të dyshuarit ose për ndonjë arsye tjetër, praktikisht nuk mund të mblidhen mjaft njerëz që i përngajnë atij që procedura të jetë e drejtë.

(6) Nga çdo vëzhgim do të incizohet videoincizim ose fotografi.

(7) Mënyrën e identifikimit e përcakton ministri i Punëve të Brendshme.

Neni 279

Thirrja e qytetarëve nga ana e policisë së jursprudencës për mbledhjen e njoftimeve

(1) Policia e jursprudencës mund të thirrë qytetar për mbledhjen e njoftimeve për veprën penale dhe kryerësin, pse për rrethana tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me veprën penale.

(2) Thirrja kryhet me ftesë me shkrim, në të cilën patjetër duhet të theksohen arsyet e thirrjes së tij dhe njoftimi për të drejtat nga neni 69 i këtij ligji.

(3) Nëse personi i cili do të paraqitet në thirrje refuzon të japë njoftim, ai nuk mund të thirret përsëri për të njëjtën arsye.

(4) Mbledhja e njoftimeve nga i njëjti person mund të zgjasë aq kohë sa është e nevojshme që të merret njoftimi i nevojshëm, e më së gjati katër orë.

(5) Njoftimet nga qytetarët nuk guxojnë të mblidhen me forcë e as me mashtrim ose maltretim, kurse policia është e obliguar që ta respektojë personin dhe dinjitetin e qytetarit.

(6) Qytetari mundet të thirret përsëri për mbledhjen e njoftimeve për veprë tjetër penale ose kryerës, e për mbledhjen e njoftimeve për të njëjtën veprë penale mundet nga arsye të rëndësishme të thirret vetëm edhe njëherë.

(7) Policia e jurisprudencës qytetarin e thirrur nuk mund ta marrë në pyetje në cilësinë e të akuzuarit, dëshmitarit ose ekspertit.

(8) Në rast kur policia gjyqësore do të vlerësojë se qytetari i thirrur mund të paraqitet në cilësinë e të dyshuarit, menjëherë e njofton prokurorin publik.

Neni 280

Parashtrimi i kallëzimit penal për vëzhgimet policore

Në bazë të njohurive të mbledhura policia gjyqësore përpilon kallëzim penal për veprimet e kryera në të cilin i thekson edhe argumentet që i ka zbuluar. Me kallëzim parashtrihen edhe sende, skica, fotografi, shkresa për veprimet e ndërmarra, vërejtje zyrtare, deklaratat dhe materiali tjetër që mund të jetë i dobishëm për udhëheqjen e suksesshme të procedurës. Nëse policia e jurisprudencës në mënyrë plotësuese njoftohen për rrethana të reja, argumente ose gjurmë nga vepra penale, është e obliguar që të mbledhë njoftime të nevojshme dhe për atë menjëherë ta njoftojë prokurorin publik.

Neni 281

Mbajtja e personave të ndodhur në vendin e kryerjes

Policia ka të drejtë që personat e ndodhur në vendin e kryerjes së veprës penale t'i dërgojë te prokurori publik ose t'i mbajë deri në ardhjen e tij, nëse ata persona do të mund të japin të dhëna të rëndësishme për procedurën penale dhe nëse është e sigurt se marrja e tyre në pyetje më vonë nuk do të mund të realizohet ose do të jetë e lidhur me zvarritjen e rëndësishme ose vështirësi tjera. Për arsyet e mbajtjes njoftohet personi i mbajtur. Mbajtja e këtyre personave në vendin e kryerjes së veprës penale, nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë orë.

3. Mbledhja e njoftimeve të nevojshme

Neni 282

Informimi i prokurorit publik

(1) Pas marrjes së kallëzimit penal ose njoftimit të marrë për ekzistimin e bazës së dyshimit se është kryer veprë penale për të cilën ndiqet me detyrë zyrtare, policia pa shtyrje me shkrim e njofton prokurorin publik.

(2) Nëse ekzistojnë bazë dyshimi për veprë penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg prej së paku katër vitesh ose ekzistojnë arsye për urgjencë, policia, respektivisht policia e jurisprudencës njoftimin prokurorit publik do t'ia japë menjëherë me gojë. Njoftimit me gojë pa prolongim i pason njoftimi me shkrim, në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

Neni 283

Udhëheqja e procedurës parahetuese

(1) Pas pranimit të kallëzimit penal ose pas njoftimit të marrë nga policia, me procedurën udhëheq prokurori publik.

(2) Policia e jurisprudenceës është e obliguar që të veprojë sipas urdhrave dhe udhëzimeve të prokurorit publik në pajtim me neni 284 të këtij ligji.

(3) Policia e jurisprudenceës vazhdon me hetimet edhe atëherë kur nuk do të ketë urdhër të veçantë ose udhëzime nga prokurori publik dhe për masat dhe veprimet e realizuara e njofton prokurorin publik.

Neni 284

Mbledhja paraprake e njoftimeve

(1) Prokurori publik vet ose nëpërmjet policisë së jurisprudenceës, respektivisht persona tjerë të punësuar në qendrat hetuese të prokurorisë publike, do të mbledhin njoftime të nevojshme për vendimmarrje për kallëzimin penal, kurse sipas nevojës atë do ta kryejë edhe përmes policisë ose organeve tjera kompetente për zbulim.

(2) Për masat dhe kontrollet e ndërmarra me urdhëresë ose udhëzime të prokurorit publik, policia dhe organet tjera nga paragrafi (1) i këtij neni, janë të obliguar që të japin njoftime më së voni në afat prej 30 ditësh nga pranimi i urdhëresës.

(3) Në urdhëresë prokurorit publik mundet më afërsisht t'i përcaktojë veprimet e nevojshme dhe t'i urdhërojë policisë që pa prolongim ta njoftojë për masat e ndërmarra. Nëse prokurori publik kërkon të marrë pjesë në këto veprime, policia do t'i ndërmarrë në mënyrë me të cilën ajo do t'i mundësohet.

(4) Vetëm në raste tejet të ndërlikuara për vepra të rënda penale të kryera nga më shumë persona ose nga banda e organizuar kriminale, policia e jurisprudenceës mund të kërkojë leje nga prokurori publik për vazhdimin e afatit nga paragrafi (2) i këtij neni. Në afatin e dhënë plotësues që nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë, policia e jurisprudenceës është e obliguar që ta njoftojë prokurorin publik për veprimet e ndërmarra deri atëherë dhe për rezultatet nga ato.

Neni 285

Autorizimi i prokurorit publik që të thirrë persona

(1) Për mbledhjen e njoftimeve të nevojshme, prokurori publik mund ta thirrë parashtruesin e kallëzimit penal, si dhe persona tjerë për njohuritë e të cilëve konsideron se mund të kontribuojnë për vlerësimin e besueshmërisë së konstatimeve në kallëzim ose për të cilët konsideron se mund të jenë dëshmitarë në procedurë, me ç'rast i njofton për shkqet e thirrjes. Me këtë rast, në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat për thirrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve.

(2) Prokurori publik mund ta thirrë edhe të dyshuarin, me ç'rast në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat nga nenet 205 , 206, 207, 208, 209, 210 dhe 211 të këtij ligji.

(3) Për njoftimet e mbledhura nga paragrafi (1) i këtij neni, prokurori publik përpilon procesverbal.

(4) Me vendim të gjykatës me detyrim mund të sillet vetëm personi i cili nuk i është përgjigjur thirrjes së dorëzuar ose personi i cili dukshëm i shmanget pranimit të thirrjes, nëse prezenca e tij është e domosdoshme për qartësimin e rrethanave të rëndësishme për vendimin se a do të ngritet

procedurë hetuese për vepër për të cilën ndiqet me detyrë zyrtare dhe për të cilën është paraparë dënim me burgim më shumë se pesë vite.

Neni 286

Mbledhja e njoftimeve nga personat në paraburgim

(1) Prokurori publik ose policia, kur këtë do t'ia ngarkojë prokurori publik, me leje të gjykatës mund të mbledhin njoftime nga persona të cilët janë në paraburgim, nëse kjo është e nevojshme për sqarimin e veprave tjera penale dhe kryerësve.

(2) Gjatë mbledhjes së njoftimeve nga personi në paraburgim do të zbatohet dispozita nga neni 210 të këtij ligji.

Neni 287

Obligimi për dorëzimin e të dhënave të kërkuara te prokurori publik

(1) Me kërkesë të prokurorit publik, organet shtetërore, organet e njësive të vetadministrimit lokal, organizatat, personat juridikë dhe fizikë që kryejnë autorizime ose personat tjerë juridikë do t'ia dorëzojnë të dhënat të cilat i ka kërkuar nga ata. Prokurori publik nga këto subjekte mund të kërkojë kontroll në punën e personit juridik dhe fizik dhe konfiskimin e përkohshëm deri në sjelljen e aktgjykimit të plotfuqishëm, të parave, letrave me vlerë, sendeve dhe dokumenteve të cilat mund të shërbejnë si argument, të kërkojë kryerjen e kontrollit tatimor dhe t'i dorëzohen të dhëna të cilat mund të shërbejnë si argument për veprën e kryer penale, ose pronën e marrë me kryerjen e veprës penale, kryerjen e kontrollit inspektues dhe të kërkojë njoftime për të dhëna që kanë lidhje me transaksione të pazakonshme dhe të dyshimta të parave.

(2) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të obliguar që prokurorit publik t'i dorëzojnë të dhëna, njoftime, dokumente, sende, llogari bankare ose shkresa të cilat janë të nevojshme gjatë procedurës. Prokurori publik ka të drejtë të kërkojë të dhëna, njoftime, dokumente, sende, llogari bankare ose shkresa edhe nga persona tjerë juridikë dhe nga qytetarët për të cilët mundet të konsiderojë se disponojnë me të dhëna dhe informata të atilla.

(3) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, janë të obliguar që t'i ndërmarrin masat e nevojshme dhe pa prolongim, por më së shumti në afat prej 30 ditësh t'ia dorëzojnë prokurorit publik të dhënat e kërkuara, njoftimet, dokumentet, sendet, llogaritë bankare ose shkresat.

(4) Nëse subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk veprojnë në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, prokurori publik mund t'i propozojë gjykatës që të shqiptojë dënim në para në shumë prej 2 500 deri në 5 000 euro në kundërvlerë me denarë për personin përgjegjës, respektivisht personin zyrtar në subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Prokurori publik ka të drejtë që vet t'i sigurojë dhe të kryej kontroll në të dhënat e kërkuara, njoftimet, dokumentet, sendet, llogaritë bankare ose shkresat, e për mosdorëzimin e tyre do ta njoftojë personin përgjegjës, respektivisht personin zyrtar në subjektin të cili është drejtuar dhe mund të propozojë ndërmarrjen e masave adekuate të përcaktuara me ligj.

(6) Nëse prokurori publik në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni ka propozuar ndërmarrjen e masave adekuate, personi përgjegjës, respektivisht personi zyrtar në organin ose personin të cili është drejtuar, është i obliguar që në afat prej 30 ditëve ta njoftojnë për masat të cilat janë ndërmarrë.

(7) Kontrolli në llogaritë bankare në pajtim me paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni nuk paraqet shkelje të sekretit bankar.

(8) Me kërkesë të prokurorit publik, operatorët e rrjeteve publike të komunikimit dhe dhënësit e shërbimeve publike të komunikimit, janë të obliguar që të dorëzojnë të dhëna për kontaktet e realizuara në qarkullimin e komunikeve.

Neni 288

Hedhja poshtë e kallëzimit penal

(1) Prokurori publik me aktvendim do ta hedh poshtë kallëzimin penal nëse nga vet kallëzim rezulton se vepra e paraqitur nuk është vepër penale për të cilën ndiqet me detyrë zyrtare, nëse ka ndodhur parashkrimi ose vepra është përfshirë me amnisti ose falje, nëse ekzistojnë rrethana tjera që e përjashtojnë ndjekjen ose nuk ekziston dyshim i bazuar se i paraqituri e ka kryer veprën penale.

(2) Aktvendimi për hedhjen poshtë të padisë penale i dorëzohet të dëmtuarit me këshillë se mundet që në afat prej tetë ditësh të parashtrojë ankesë drejtpërdrejt te prokurori më i lartë publik, kurse parashtuesi i kallëzimit njoftohet për arsyet e hedhjes poshtë.

(3) Nëse ankesa është e palejuar lejohet ose jo me kohë, prokurori më i lartë publik me shkrim do ta njoftojë të dëmtuarin.

(4) Prokurori më i lartë publik në afat prej 30 ditëve pas pranimit, është i obliguar që të vendosë për ankesën e të dëmtuarit.

(5) Duke vepruar për ankesën, prokurori më i lartë publik mundrt me aktvendim ta vërtetojë aktvendimin për hedhjen poshtë të kallëzimit penal ose ankesën ta pranojë ose ta obligojë prokurorin më të ulët publik që ta vazhdojë procedurën.

4. Fshehtësia dhe kontrolli gjyqësor

Neni 289

Fshehtësia e procedurës parahetuese

Të gjitha veprimet e ndërmarra në procedurën parahetuese nga ana e prokurorit publik ose policisë konsiderohen si sekret.

Neni 290

Kontrolli gjyqësor mbi ligjshmërinë

(1) Personi i cili mendon se me ndërmarrjen e ndonjë nga veprimet është shkelur ndonjë e drejtë e tij, mundet në afat prej tetë ditëve nga njoftimi për ndërmarrjen e veprimit që të parashtrojë ankesë te gjykatësi i procedurës paraprake, i cili është i obliguar që me aktvendim të vendosë për ligjshmërinë e veprimit ose masës, me çfarë personi nuk kufizohet në të drejtën që të parashtrojë kallëzim penal dhe në të drejtën mbrojtjen e tij juridike ta realizojë në mënyrë tjetër.

(2) Pas hetimit të ligjshmërisë së këtyre veprimeve, gjykatësi i procedurës paraprake miratonaktvendim, i cili dorëzohet te prokurori publik dhe parashtuesi i ankesës. Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesë te këshilli nga neni 25 paragrafi (5) i këtij ligji, i cili është i obliguar që të veprojë në lidhje me ankesën në afat prej tri ditësh.

Kreu XXI PROCEDURA HETUESE

1. Procedura hetuese e prokurorit publik

Neni 291

Qëllimi i procedurës hetuese

(1) Procedura hetuese ngritët kundër një personi të caktuar kur ekziston dyshim i bazuar se ka kryer veprë penale për të cilën ndiqet me detyrë ose me propozim zyrtar.

(2) Procedurën hetuese e zbaton organi kompetent publik, me ç'rast në dispozicion e ka policinë e jurisprudencës.

(3) Në procedurën hetuese:

- mblidhen argumente dhe të dhëna që janë të nevojshme për prokurorin publik që të mund të vendos nëse do të parashtrojë akuzë ose do të heq dorë nga ndjekja penale dhe

- nxirren argumentet për të cilat ekziston rrezik se nuk do të mund të nxirren në debatin kryesor ose se nxjerrja e tyre do të lidhej me vështirësitë sipas neneve 312, 313, 314, 315, 316, 317 dhe 318 të këtij ligji.

(4) Gjatë procedurës hetuese prokurori publik është i obliguar që të mbledhë argumente të cilat ashtu siç e ngarkojnë të dyshuarin, janë edhe në dobi të tij.

Neni 292

Urdhëresa për zbatimin e procedurës hetuese

(1) Prokurori publik lëshon urdhëresë për zbatimin e procedurës hetuese.

(2) Urdhëresa për zbatimin e procedurës hetuese i përmban të dhënat personale të të dyshuarit, përshkrimin dhe kualifikimin ligjor të veprës. Në urdhëresën për zbatimin e procedurës hetuese prokurori publik përcakton që të kontrollohen rrethana të caktuara, të ndërmerren veprime të caktuara hetuese dhe për çështje të caktuara të hetohen persona të caktuar.

(3) Para se ta miratojë urdhëresën për zbatimin e procedurës hetuese, prokurori publik mund ta marrë në pyetje personin kundër të cilit kërkohet zbatimi i procedurës hetuese.

Neni 293

Propozimet e të dyshuarit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit

Gjatë procedurës hetuese i dyshuari, mbrojtësi i tij dhe i dëmtuari mund t'i japin propozime prokurorit publik për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara dhe realizimin e të drejtave të tyre.

Neni 294

Kompetenca e gjykatësit të procedurës paraprake

(1) Pas miratimit të urdhëresës për zbatimin e procedurës hetuese të gjykatësi i procedurës paraprake prokurori publik mund të paraqesë propozim të arsyetuar për përcaktimin e masës së paraburgimit ose masa tjera për sigurimin e prezencës së të akuzuarit. Gjykatësi i procedurës paraprake është i obliguar që pa prolongim ta shqyrtojë propozimin e këtillë dhe menjëherë të vendos për të. Nëse gjykatësi i procedurës paraprake nuk pajtohet me propozimin e prokurorit publik, për atë do të miratojë aktvendim të veçantë të arsyetuar. Kundër këtij aktvendimin prokurori publik ka të drejtë ankese në afat prej 24 orëve të këshilli nga neni 25 paragrafi (5) i këtij ligji.

(2) Për propozimin e prokurorit publik, gjykatësi i procedurës paraprake gjatë procedurës hetuese jep urdhër për bastisjen e shtëpisë, lokaleve dhe personave tjerë. Nëse gjykatësi nuk pajtohet me propozimin e këtillë të prokurorit publik, do të kërkojë që për këtë miratojë vendim, këshilli nga neni 25 paragrafi (5) i këtij ligji në afat prej 24 orëve.

(3) Në rastet e përcaktuara me ligj, për propozimin e prokurorit publik, gjykatësi i procedurës paraprake lëshon urdhëresë për zbatimin e masave të veçanta hetuese.

(4) Nëse ekziston dyshim i bazuar se me veprën e kryer penale është fituar dobi pronësore, prokurori publik mund t'i propozojë gjykatësit të procedurës paraprake, që prona ose sendet të vendosen në mbikëqyrje të gjykatës dhe të marrë ndonjë nga masat për sigurimin e përkohshëm të pronës ose mjeteve që kanë lidhje me veprën penale.

(6) Në raste të përcaktuara me këtë ligj, me kërkesë të prokurorit publik ose të të dyshuarit, gjykatësi i procedurës paraprake do të zbatojë seancë të provave.

(7) Gjykatësi i procedurës paraprake vepron me procedurë për bashkëpunim ndërkombëtar në materien penale sipas autorizimeve të përcaktuara me ligj të veçantë.

Neni 295

Veprime hetuese

(1) Gjatë procedurës hetuese, prokurori publik mundet që në pajtim me dispozitat e këtij ligji, t'i ndërmarrë këto veprime hetuese:

- bastisje,
- sigurimi i përkohshëm dhe marrja e sendeve ose pronës,
- marrje në pyetje e të dyshuarit,
- marrje në pyetje e dëshmitarëve,
- përcaktim i ekspertizës,
- kontroll dhe rikonstrukcion dhe
- masa të veçanta hetuese.

(2) Veprimet hetuese mund të ndërmerren edhe para ngritjes së procedurës hetuese nëse ekziston rrezik nga prolongimi, me kushte dhe në procedurë të rregulluar më këtë ligj.

Neni 296

Pjesëmarrja e të dyshuarit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit në procedurën hetuese

(1) Prokurori publik është i obliguar që në mënyrë adekuate ta njoftojë mbrojtësin, të dëmtuarin dhe të dyshuarin për kohën dhe vendin e kryerjes së veprimeve hetuese në të cilat ata mund të marrin pjesë, përveç kur ekziston

rrezik nga prolongimi. Nëse i dyshuari ka mbrojtës, prokurori publik sipas rregullës, do ta njoftojë vetëm mbrojtësin.

(2) Nëse personi të cilin e ka dërguar njoftimin për veprim hetues nuk është prezent, veprimi mund të kryhet edhe në mungesë të tij.

(3) Personat që marrin pjesë në veprimet hetuese mund t'i propozojnë organit që e udhëheq procedurën, për qartësimin e punëve t'u parashtrojë pyetje të veçanta të dyshuarit dhe ekspertit, kurse me leje të organit që e udhëheq procedurën mundet që edhe ata drejtpërdrejt të parashtrojnë pyetje. Këto persona kanë të drejtë të kërkojnë që në procesverbal të futen edhe vërejtjet e tyre në aspekt të zbatimit të veprimeve të veçanta.

Neni 297

Kompetenca për veprimet hetuese

(1) Prokurori publik i ndërmerr veprimet hetuese në rajonin për të cilin është kompetent të veprojë.

(2) Nëse interesat e procedurës hetuese këtë e kërkojnë, veprimet e veçanta hetuese mund t'i ndërmarrë edhe jashtë rajonit të kompetencës së tij, por për këtë patjetër duhet ta njoftojë prokurorin publik në rajonin e të cilit ndërmerret veprimi hetues.

Neni 298

Ndihma profesionale dhe teknike

(1) Për qartësimin e çështjeve të caktuara teknike dhe çështjeve tjera profesionale që parashtrohen në lidhje me provat e mbledhura ose gjatë ndërmarrjes së veprimeve të caktuara hetuese, prokurori publik mund të kërkojë nga personi profesional ose institucion adekuat, që t'i japë shpjegime të nevojshme profesionale për ato çështje.

(2) Për shpjegimet e mara profesionale prokurori publik do të përpilojë procesverbal i cili mund të shfrytëzohet gjatë procedurës.

Neni 299

Fshehtësia e procedurës hetuese

(1) Nëse këtë e kërkojnë interesat e procedurës penale, nevoja që të ruhet fshehtësia ose të mbrohet jeta personale ose familjare e të dëmtuarit ose të dyshuarit, prokurori publik do t'i urdhërojë personit të cilin e dëgjon, i cili merr pjesë në veprimin hetues ose i cili i shqyrton shkresat, që t'i ruajë si fshehtësi të dhënat e caktuara dhe do ta paralajmërojë për pasojat e dhënies së fshehtësisë.

(2) Urdhëresa nga paragrafi (1) e këtij neni në veçanti futet në procesverbal, respektivisht shënohet në shkresat që shqyrtohen, me nënshkrimin e personit i cili është paralajmëruar për detyrën e ruajtjes së sekretit.

Neni 300

Ndërprerja e procedurës hetuese

(1) Prokurori publik me urdhëresë do ta ndërpresë procedurën hetuese:

- nëse i dyshuari është në arrati ose është i pakapshëm për organet shtetërore,

- nëse te i dyshuari pas veprës së kryer penale, ka ndodhur sëmundja shpirtërore, çrregullimi psikik ose sëmundja tjetër e rëndë për çfarë nuk mund të marrë pjesë në procedurë ose

- nëse krijohen rrethana të cilat përkohësisht e pengojnë ndjekjen penale.

(2) Para ndërprerjes së procedurës hetuese, prokurori publik do t'i mbledhë të gjitha argumentet për veprën penale dhe të dyshuarin te të cilat mund të arrijë.

(3) Nëse gjatë ndërprerjes së procedurës hetuese ka ndodhur parashkrimi i ndjekjes penale, prokurori publik do të japë deklaratë për heqje dorë nga ndjekja.

(4) Kur të pushojnë arsyet që kanë sjellë te ndërprerja, prokurori publik do ta vazhdojë procedurën hetuese.

Neni 301

Përfundimi i procedurës hetuese

(1) Prokurori publik e mbaron procedurën hetuese kur do të vlerësojë se gjendja e punëve është mjaftë e qartësuar që të mund të ngritet akuzë ose të ndërpritet ose ta ndërpresë procedurë hetuese.

(2) Nëse procedura hetuese nuk kryhet në afat prej gjashtë muajve nga dita e miratimit të urdhëresës për zbatimin e procedurës hetuese, prokurori publik është i obliguar që për këtë ta njoftojë prokurorin e lartë publik, i cili për lëndë të komplikuar mundet që këtë afat ta vazhdojë për edhe gjashtë muaj. Me përjashtim, ky afat mund të vazhdohet për edhe tre muaj nga ana e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë.

(3) Për vepra penale nga sfera e krimit të organizuar afati nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të vazhdohet edhe për gjashtë muaj tjerë nga ana e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë.

(4) Për shkak të parregullsive ose prolongimit të procedurës hetuese, i dyshuari, mbrojtësi i tij ose i dëmtuari munden me ankesë të drejtohen te prokurori i lartë publik. Në këtë rast, prokurori i lartë publik do t'i analizojë të dhënat nga ankesa dhe nëse vlerëson se ato kanë bazë, do të ndërmarrë masa adekuate për përfundimin e procedurës hetuese ose për mënjanimin e parregullsive.

Neni 302

Njoftimi i të dyshuarit për përfundimin e procedurës hetuese

(1) Para skadimit të afatit të paraparë në nenin 301 të këtij ligji, prokurori publik është i detyruar që të dyshuarit dhe mbrojtësit t'u paraqesë njoftim për përfundimin e procedurës hetuese nga ana e prokurorit publik.

(2) Para përfundimit të procedurës hetuese prokurori publik, nëse atë nuk e ka bërë më përpara, është i detyruar që ta pyesë të dyshuarin.

(3) Njoftimi i përmban përshkrimin e shkurtër të veprës penale për të cilën është vepruar, kualifikimin juridik, me shënimin se të gjitha shkresat nga procedura e zbatuar hetuese janë dhënë për t'u ruajtur në arkivin e prokurorit publik dhe se i dyshuari dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtë t'i kontrollojnë shkresat dhe dëshmitë dhe të hartojnë përshkrim.

(4) Njoftimi përmban këshillë se i dyshuari ka të drejtë që në afat prej prej 15 ditësh nga pranimi i njoftimit të parashtrojël dokumente ose dëshmi

tjera, shkresa nga veprimet e mbrojtjes, ose të kërkojë nga prokurori publik që të grumbullojë dëshmi të caktuara.

(5) Prokurori publik është i detyruar që ta njoftojë të akuzuarin me dëshmitë që në procedurën hetuese i ka siguruar kundër tij, si dhe t'ia zbulojë dëshmitë për të cilat është njoftuar, e të cilat mund të jenë në favor për mbrojtjen.

(6) Në rast kur prokurori publik me kërkesë të të dyshuarit ose mbrojtësit të tij grumbullon dëshmi të caktuara, detyrohet që këtë ta kryejë në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Neni 303

Afat për parashtrimin e aktakuzës pas përfundimit të procedurës hetuese

(1) Pas përfundimit të procedurës hetuese dhe skadimit të afateve nga neni 302 të këtij ligji, prokurori publik është i detyruar që në afat prej 15 ditësh të parashtojë akuzë ose procedurën hetuese ta ndërpresë.

(2) Ky afat për vepra penale nga fusha e krimit të organizuar mund të zgjasë deri në 30 ditë.

Neni 304

Ndërprerja e procedurës hetuese

(1) Prokurori publik me urdhër do ta ndërpresë procedurën hetuese, nëse konstaton se:

- vepra që i ngarkohet të dyshuarit nuk është vepër penale e cila ndiqet me detyrë zyrtare,

- ka ndodhur parashkrimi i ndjekjes penale ose vepra është përfshirë me akt të amnistisë ose faljes,

- janë krijuar rrethana tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale ose

- nuk ka dëshmi se i dyshuari e ka kryer veprën penale.

(2) Nëse i dyshuari është në paraburgim, menjëherë lëshohet në liri

(3) Urdhri për ndërprerjen e procedurës hetuese i dorëzohet të dyshuarit dhe të dëmtuarit, me këshillë se i dëmtuari mundet që në afat prej tetë ditësh të parashtojë kundërshtim te prokurori publik më i lartë i drejtpërdrejtë.

(4) Nëse kundërshtimi është i palejueshëm ose jo me kohë, prokurori publik me shkrim do ta njoftojë të dëmtuarin.

(5) Prokurori më i lartë publik në afat prej 30 ditësh pas pranimit është i detyruar që të vendosë për kundërshtimin e të dyshuarit.

(6) Duke vepruar për kundërshtimin, prokurori më i lartë publik mundet me aktvendim ta vërtetojë urdhrin për ndërprerjen e procedurës hetuese ose kundërshtimin ta pranojë dhe ta ngarkojë prokurorin më të ulët publik që ta vazhdojë procedurën.

2. Veprimet e mbrojtjes

Neni 305

Propozimet e mbrojtësit për grumbullimin e fakteve

Mbrojtësi mund gjatë procedurës t'i japë propozime prokurorit publik për marrjen e veprimeve të caktuara hetuese, për grumbullimin e dëshmive të veçanta.

Neni 306

Grumbullimi i dëshmive nga ana e mbrojtjes

(1) Mbrojtësi mund të ndërmarrë veprime për gjetjen dhe grumbullimin e dëshmive në dobi të mbrojtjes.

(2) Autorizimin nga paragrafi (1) i këtij neni, mbrojtësi mund ta shfrytëzojë gjatë gjithë procedurës.

(3) Veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni mund të zbatohen nga ana e mbrojtësit, zëvendësit të tij, detektivët privatë të autorizuar dhe kur nevojitet profesionalizëm i veçantë, nga ana e këshilltarëve teknikë.

Neni 307

Biseda, pranimi i deklaratave dhe grumbullimi i njoftimeve nga ana e mbrojtësit

(1) Për grumbullimin e njoftimeve, mbrojtësi mund të bisedojë me persona të cilët mund të nxjerrin rrethana të dobishme për mbrojtje, përveç me viktimën dhe të dëmtuarin.

(2) Mbrojtësi do të mundet nga personi me të cilin bisedon të kërkojë deklaratë me shkrim ose njoftim, i cili do të shënohet në mënyrën e theksuar në nenet 91 dhe 92 të këtij ligji.

(3) Mbrojtësi i informon personat nga paragrafi (1) i këtij neni:

- për cilësinë personale dhe për llojin e bisedës,
- nëse ka për qëllim vetëm të bisedojë ose të marrë deklaratë ose njoftime, atëherë t'i theksojë mënyrat dhe formën e shënimit të tyre,
- për të drejtën që fare të mos përgjigjen ose të mos japin deklaratë të caktuar dhe
- për ndalimin e zbulimit të pyetjeve të parashtruara nga policia ose nga prokurori publik dhe për përgjigjet e dhëna.

(4) Nga personi i cili tanimë ka biseduar ose është pyetur nga policia e jurispruencës ose nga prokurori publik, nuk mund të kërkojen njoftime për pyetjet e parashtruara dhe përgjigjet e dhëna.

(5) Deklaratat ose njoftimet e mbledhura me shkeljen e paragrafëve (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni, nuk mund të shfrytëzohen.

(6) Për marrjen e deklaratave ose njoftimeve të personit i cili është në paraburgim, mbrojtësi patjetër duhet të marrë pëlqim të veçantë nga gjykatësi i procedurës paraprakr, pasi që personi i mëparshëm ka biseduar me mbrojtësin e tij dhe është pyetur nga prokurori publik.

(7) Mbrojtësi do ta ndërpresë grumbullimin e të dhënave nga personi i paditur ose nga personi që nuk është i paditur, nëse nga deklaratat e tij del se e ngarkon vetveten, ose do të ekspozohet në ndjekje penale. Këto deklaratat nuk mund të shfrytëzohen kundër personit që i ka dhënë.

(8) Kur personi i cili mund të japë njoftime të favorshme për mbrojtjen nuk do të japë njoftime, mbrojtësi mund të kërkojë nga prokurori publik që ta ftojë personin për ta pyetur. Kjo nuk zbatohet ndaj të dyshuarve ose të akuzuarve në të njëjtën procedurë. Marrja në pyetje zbatohet në prezencë të mbrojtësit i cili i pari parashtron pyetje.

(9) Mbrojtësi mund të kërkojë të zbatohet edhe seancë dëshmuese.

Neni 308

Shënimi i deklaratave dhe njoftimeve

(1) Deklaratën nga neni 307 paragrafi (2) të këtij ligji, i cili është nënshkruar nga personi që e ka dhënë, e vërteton mbrojtësi. Mbrojtësi përpilon shënim në të cilën i paraqet:

- datën kur e ka pranuar deklaratën,
- të dhënat personale për vete dhe të dhënat personale për personin që e ka dhënë deklaratën,

- vërtetimin se i ka kushtuar kujdes parandalimit nga neni 314 paragrafi (3) të këtij ligji dhe

- faktet që janë shënuar në deklaratë.

(2) Deklarata i bashkëngjitet akteve të mbrojtësit.

(3) Njoftimet nga neni 307 të këtij ligji i shënon mbrojtësi ose personi që e zëvendëson.

Neni 309

Qasja në lokale private ose lokale që nuk janë të hapura për publikun

Nëse është e nevojshme qasje në lokalet private ose në lokalet të cilat nuk janë të hapura për publikun, në shtëpi dhe lokale të lidhura me shtëpinë, kurse personat që disponojnë me ato nuk japin leje për qasje, me kërkesë të mbrojtësit, qasjen e miraton gjykata me urdhër të arsyetuar me të cilin përcaktohet dhe zbatimi i tij konkret.

Neni 310

Akte të mbrojtësit

Prokurorit publik dhe gjykatësit të procedurës paraprake, mbrojtësi drejtpërdrejt mund t'ua prezantojë informacionet dhe dëshmitë që janë në dobinë e të akuzuarit.

Neni 311

Mundësi për përgatitjen e mbrojtjes

(1) Mbrojtësi për nevojat e mbrojtjes mundet në pajtim me ligjin të kërkojë të dhëna dhe njoftime nga organe shtetërore, nga organet e njësisë së vetadministrimit lokal, nga persona juridikë dhe fizikë që kryejnë autorizime publike dhe nga persona tjerë juridikë dhe të kërkojë t'i dorëzohen dokumente, akte dhe njoftime.

(2) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni veprojnë me kërkesën e mbrojtësit në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, e nëse në procedurë është caktuar masa paraburgim, në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Nëse subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk përgjigjen në afatin e paraparë në paragrafin (2) të këtij neni, mbrojtësi mund të kërkojë nga gjykatësi i procedurës paraprake të urdhërojë që t'i dorëzohen të dhënat e kërkuara, përkatësisht nga gjykata gjatë shqyrtimit kryesor.

(4) Nëse gjykatësi, përkatësisht gjykata, vepron sipas kërkesës së mbrojtësit nga paragrafi (3) i këtij neni, e subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk i përgjigjen kërkesës së gjykatës në afatin e paraparë në paragrafin (2) i këtij neni, gjykata do të kumtojë dënim me para personit përgjegjës,

përkatësisht zyrtar në subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, në lartësi prej 2 500 deri në 5 000 euro në kundërvlerë me denarë.

3. Seanca dëshmuese

Neni 312

Rastet kur mund të kërkohet mbajtja e seancës dëshmuese

(1) Gjatë procedurës hetuese me kërkesës të të dyshuarit dhe prokurorit publik, mund të mbahet seancë dëshmuese. Me kërkesë të palëve për mbajtjen e seancës dëshmuese, me aktvendim vendos gjykatësi i procedurës paraprake në afat prej tri ditësh.

(2) Seanca dëshmuese mund të mbahet në rastet vijuese:

1) nëse është e mundur se dëshmitari për shkak të sëmundjes ose vdekjes nuk mund të pyetet në seancën kryesore;

2) nëse është e nevojshme ekspertiza, kurse dëshmitë kanë të bëjnë me personin, sendin ose vendin, gjendja e të cilit i është nënshtruar ndryshimeve të domosdoshme ose

3) nëse ekzistojnë rrethana konkrete që tregojnë se dëshmitari i është ekspozuar dhunës, kërcënimit, premtimit të parave ose dobisë tjetër për të mos dëshmuar ose për të dëshmuar rrejshëm.

Neni 313

Kërkesa për mbajtjen e seancës dëshmuese

Mbajtjen e seancës dëshmuese palët mund ta propozojnë gjatë procedurës hetuese. Në kërkesën për mbajtjen e seancës dëshmuese theksohen dëshmitë të cilat propozohen që të nxirren në seancën dëshmuese dhe shkakun për të cilin dëshmitë nuk mund të nxirren në seancën kryesore.

Neni 314

Vendime pas kërkesës për mbajtje të seancës dëshmuese

Gjykatësi i procedurës paraprake në afat prej tri ditësh nga pranimi i kërkesës për mbajtjen e seancës dëshmuese, me aktvendim vendos nëse do ta refuzojë ose do ta pranojë kërkesën. Në aktvendimin me të cilin pranohet kërkesa, gjykatësi i procedurës paraprake i thekson dëshmitë që do të nxirren në seancën dëshmuese dhe datën në të cilën do të mbahet seanca, e cila patjetër duhet të jetë në afat prej dhjetë ditësh nga dita kur është marrë aktvendimi për pranimin e kërkesës.

Neni 315

Mbajtje e seancës dëshmuese

(1) Seancën dëshmuese e realizon gjykatësi i procedurës paraprake. Për seancën do të njoftohen i dyshuari dhe mbrojtësi i tij, prokurori publik dhe i dëmtuari

(2) Mosardhja e njërës nga palët e cila është e njoftuar me rregull, e cila nuk e ka arsyetuar mungesën e vet nuk e pengon mbajtjen e seancës dëshmuese. Në seancë mund të marrë pjesë edhe përfaqësuesi, përkatësisht i autorizuari i të dëmtuarit.

(3) Në rast të mosparaqitjes të mbrojtësit të të dyshuarit, gjykatësi do t'i caktojë mbrojtës tjetër në pajtim me nenin 74 i këtij ligji.

(4) Dëshmitë nxirren sipas rregullave për nxjerrjen e dëshmive në seancën kryesore.

(5) Nxjerrja e dëshmive nuk mund të zgjerohet në fakte që kanë të bëjnë me të dyshuarin, mbrojtësi i të cilit nuk është i pranishëm në seancën dëshmuese.

(6) Nëse nxjerrja e fakteve nuk përfundohet në një seancë, gjykatësi do të caktojë seancë të radhës në afat jo më të gjatë se shtatë ditë.

Neni 316

Prolongimi i seancës dëshmuese

(1) Prokurori publik dhe i dyshuari mund të kërkojë nga gjykatësi i procedurës paraprake prolongimin e seancës dëshmuese, nëse me mbajtjen e saj do të rrezikoheshin një ose më shumë veprime që ndërmerren në procedurën hetuese.

(2) Nëse gjykatësi i procedurës paraprake e pranon kërkesën për prolongimin e seancës dëshmuese, do ta caktojë edhe datën kur do të mbahet ajo, por në afat jo më të gjatë nga ai i cili është i domosdoshëm për përfundim të veprimeve hetuese.

(3) Prokurori publik dhe i dyshuari mund të kërkojnë prolongimin e seancës së dëshmive vetëm një herë.

Neni 317

Sjellja e detyrueshme e të dyshuarit

(1) Nëse i dyshuari në seancën dëshmuese nuk paraqitet, kurse mungesën e tij nuk e arsyeton, gjykatësi mund të urdhërojë sjelljen e detyrueshme të tij.

(2) Nëse i dyshuari është në arrati do të zbatohet neni 391 paragrafi (3) i këtij ligji. Aktvendimin për mbajtjen e seancës dëshmuese në mungesë, e merr gjykatësi i procedurës paraprake.

Neni 318

Përdorimi i dëshmive të nxjerra në seancën dëshmuese

Dëshmitë e nxjerra në seancën dëshmuese mund të përdoren në seancën kryesore, vetëm për atë të akuzuar mbrojtësi i të cilit ka qenë i pranishëm gjatë nxjerrjes së dëshmive në seancën dëshmuese, përveç nëse është në mënyrë të prerë e ka refuzuar të drejtën e mbrojtësit.

SEKSIONI B. AKUZIMI

Kreu XXII

AKTPADIA DHE VLERËSIMI I AKTPADISË

Neni 319

Parashtrimi i aktakuzës

(1) Pas përfundimit të procedurës hetuese kur prokurori publik do të konstatojë; se ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme nga të cilat mund të pritët miratim i aktgjykimit dënues, e përgatit dhe parashtron aktakuzën në gjykatën kompetente.

(2) Aktakuza dorëzohet në gjykatën kompetente në aq kopje sa ka të dyshuar kundër të cilëve parashtrohet aktakuza dhe te mbrojtësit e tyre dhe një kopje për gjykatën.

Neni 320

Kompetenca për vlerësimin e aktakuzës

(1) Në rastet kur prokurori publik do të konstatojë se ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme nga të cilat mund të pritët miratimi i aktgjykimit dënues për veprën e kryer penale për të cilën është paraparë dënim me burg deri në dhjetë vjet, kompetent për kryerjen e vlerësimit të aktakuzës është gjykatësi për vlerësim të aktakuzës (gjykatës individual).

(2) Në rastet kur plotësohen kushtet nga neni 319 paragrafi (1) të këtij ligji, e ka të bëjë për veprën e kryer penale për të cilën është paraparë dënim me burg prej dhjetë vitesh, kompetent për vlerësimin e aktakuzës është këshilli për vlerësim e aktakuzës.

Neni 321

Përmbajtja e aktakuzës

(1) Aktakuza i përmban:

1) emrin dhe mbiemrin e të dyshuarit me të dhënat personale (neni 205 i këtij ligji) dhe me të dhënat për atë nëse dhe prej kur gjendet në paraburgim ose gjendet në liri, e nëse është lëshuar në liri para se të parashtrohet aktakuza, atëherë sa ka kaluar në paraburgim;

2) përshkrimin i veprës nga i cili dalin karakteristikat ligjore të veprës penale, kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, lëndën në të cilin është kryer vepra penale dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të nevojshme për përcaktimin preciz të veprës penale;

3) emrin ligjor të veprës penale, me shënimin e dispozitave nga Kodi penal që duhet të zbatohen me propozimin e paditësit;

4) shënimin e gjykatës para të cilës do të mbahet seanca kryesore dhe

5) dëshmitë në të cilat bazohet aktakuza.

(2) Në shtojcë të aktakuzës prokurori publik i dorëzon dëshmitë materiale, procesverbalet dhe incizimet nga marrja në pyetje e personave dhe e bashkëngjit listën e dëshmive që propozon që të nxirren në seancën kryesore.

(3) Nëse i dyshuari gjendet në liri, në aktakuzë mund të propozohet të caktohen masa për sigurimin e pranisë. Nëse i dyshuari gjendet në paraburgim ose arrest shtëpiak, prokurori është i detyruar të propozojë që paraburgimi ose arresti shtëpiak të vazhdohet ose të anulohet:

(4) Me një aktakuzë mund të përfshihen më shumë vepra penale ose më shumë të dyshuar, vetëm nëse sipas dispozitave të nenit 28 nga ky ligj mund të zbatohet procedurë e vetme dhe të merret një aktgjykim.

Neni 322

Paraburgimi kundër të dyshuarit

(1) Nëse në aktakuzë është parashtruar propozim që kundër të dyshuarit të caktohet paraburgim, ose paraburgim i përcaktuar paraprakisht të vazhdohet ose i dyshuari të lëshohet në liri, ose të caktohet ndonjë masë për sigurimin e prezencës, për këtë vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji menjëherë kurse më së voni në afat prej 24 orësh.

(2) Nëse i dyshuari gjendet në paraburgim, këshilli për vlerësim të aktakuzës me propozim të prokurorit publik në afat prej 24 orësh nga dita e pranimit të aktakuzës, e dërgon aktakuzën në këshillin nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji, që të shqyrtohet nëse ekzistojnë ende arsye për paraburgim dhe të marrë vendim për vazhdimin ose anulimin e paraburgimit. Ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon zbatimin e aktvendimit.

Neni 323

Gabime teknike në aktakuzë

(1) Nëse pas pranimit të aktakuzës, gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës konstaton se aktakuza përmban gabime të dukshme teknike, do ta kthejë aktakuzën te prokurori publik.

(2) Prokurori publik është i detyruar që në afat prej tri ditësh t'i përmirësojë gabimet.

Neni 324

Jokompetenca

Nëse gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës konstaton se për veprën penale që është lëndë e akuzimit, kompetent real ose vendor është ndonjë gjykatë tjetër, do të shpallet për jokompetent dhe pas plotfuqishmërisë së aktvendimit e dorëzon lëndën në gjykatën kompetente.

Neni 325

Dorëzimi i aktakuzës

(1) Gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës ia dorëzon aktakuzën pa prolongim të dyshuarit i cili është në liri, e nëse gjendet në paraburgim në afat prej 24 orësh nga pranimi i aktakuzës te gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës.

(2) Nëse kundër të dyshuarit është caktuar paraburgim me aktvendim të gjykatësit të procedurës paraprake ose këshillit nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji, aktakuza i dorëzohet të dyshuarit gjatë paraburgimit të tij bashkë me aktvendimin me të cilin përcaktohet paraburgimi.

(3) Gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës ia dorëzon aktakuzën të dyshuarit me këshillë për të drejtën e kundërshtimit kundër aktakuzës.

Neni 326

Veprimi i të dyshuarit pas pranimit të aktakuzës

(1) Pas pranimit të aktakuzës i dyshuari :

1) mund të parashtrorë kundërshtim kundër aktakuzës në pajtim me nenin 327 të këtij ligji ose

2) mund të parashtrojë deklaratë për pranimin e fajit në pajtim me nenin 329 të këtij ligji ose

3) parashton listë të dëshmive të cilat propozon që të nxirren në seancën kryesore.

(2) Lista nga paragrafi (1) pika 3 të këtij neni, gjykata pa prolongim ia dorëzon prokurorit publik.

Neni 327

Kundërshtimi kundër aktakuzës

(1) I dyshuari ka të drejtë të parashtrojë kundërshtim të shkruar kundër aktakuzës në afat prej tetë ditësh nga pranimi i aktakuzës.

(2) Kundërshtim ndaj aktakuzës mund të parashtrojë edhe mbrojtësi i të dyshuarit pa autorizim të prerë nga i dyshuari, por jo edhe kundër vullnetit të tij.

Neni 328

Vlerësimi i kundërshtimit

(1) Pas pranimet të kundërshtimit, gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës vlerëson nëse kundërshtimi është me kohë dhe nëse është parashtruar nga personi i autorizuar.

(2) Kundërshtimi jo me kohë dhe i palejueshëm do të refuzohet me aktvendim.

(3) Nëse gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës nuk merr aktvendim sipas paragrafit (2) të këtij neni, i qaset vlerësimin të aktakuzës.

Neni 329

Deklarata për pranimin e fajit

I akuzuari mund të parashtrojë deklaratë për pranimin e fajit në lidhje me të gjitha ose veprave të veçanta penale të përfshira në aktakuzë, në afat prej tetë ditësh nga pranimi i aktakuzës.

Neni 330

Mënyra e veprimit gjatë vlerësimit të aktakuzës

(1) Vlerësimin e aktakuzës gjykatësi për vlerësim të aktakuzës e kryen në mënyrë të pavarur, kurse këshilli për vlerësim të aktakuzës e kryen në seancën e këshillit.

(2) Gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës, kontrollin e aktakuzës mund ta kryejnë edhe në seancë.

(3) Seanca për vlerësim të aktakuzës mbahet kur gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës do të vlerësojë se kjo është e nevojshme ose kur në kundërshtimet e parashtruara kundër aktakuzës i akuzuari ka shprehur gatishmëri për dhënien e deklaratës për pranimin e fajit në lidhje me të gjitha ose veprave penale të veçanta nga aktakuza.

Neni 331

Seanca e këshillit për vlerësim të aktakuzës

(1) Këshilli cakton seancë, në afat prej tetë ditësh nga pranimi i kundërshtimit kundër aktakuzës, përkatësisht pas kalimit të afatit për parashtrimin e kundërshtimit kundër aktakuzës.

(2) Në seancë këshilli i vlerëson propozimet e shënuara në kundërshtim kundër aktakuzës dhe bazueshmërinë e aktakuzës në lidhje me shkresat dhe dëshmitë e bashkangjitura nga ana e prokurorit publik.

(3) Pas seancës së mbajtur këshilli mund të marrë njërin nga vendimet e shënuara në nenet 336 dhe 337 të këtij ligji.

Neni 332

Seanca për vlerësimin e aktakuzës

(1) Nëse gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës konsideron se është e nevojshme mbajtja e seancës për vlerësimin e aktakuzës, cakton seancë në afat jo më të gjatë se 15 ditë nga pranimi i kundërshtimit kundër aktakuzës, përkatësisht pas kalimit të afatit për parashtrimin e kundërshtimit kundër aktakuzës.

(2) Në seancë ftohet prokurori publik, i dyshuari dhe mbrojtësi, nëse i dyshuari ka mbrojtës. Të ftuarit paralajmërohen se mosardhja kur janë të thirrur në mënyrë të rregullt nuk e prolongon mbajtjen e seancës. Nëse të ftuarit nuk janë ftuar në mënyrë të rregullt, seanca prolongohet për 15 ditë.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) të këtij neni, nëse ftesa të dyshuarit nuk mund t'i dërgohet për shkak të ndryshimit të adresës, seanca do të mbahet në mungesë të tij.

Neni 333

Rrjedha e seancës

(1) Prokurori publik shkurtimisht i paraqet rezultatet nga procedura hetuese, dëshmitë në të cilat bazohet aktakuza dhe të cilat e arsyetojnë parashtrimin e tij.

(2) I dyshuari dhe mbrojtësi i tij e arsyetojnë kundërshtimin e parashtruar kundër aktakuzës, e nëse kundërshtimi nuk është parashtruar mund të japin vërejtje për dëshmitë që i shkojnë në dobi të dyshuarit, në lëshimet e mundshme në procedurën hetuese ose në dëshmitë e marra në mënyrë joligjore, me ç'rast tregojnë në cilën pjesë e kundërshtojnë aktakuzën. Në seancë mbrojtja mund ta propozojë listën e dënimeve që kërkon të nxirren në shqyrtimin kryesor.

(3) Në seancë i dyshuari mund të japë deklaratë se ndjehet fajtor për të gjitha ose për vepra të veçanta penale nga aktakuza. Në këtë rast seanca vazhdon në pajtim me dispozitat nga neni 334 të këtij ligji.

(4) Prokurori publik dhe mbrojtësi munden në konstatimet e palës kundërshtare të kthehen vetëm një herë.

(6) Kur gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës konstaton se mund të marrë aktvendim në lidhje me bazueshmërinë e aktakuzës e shpall seancën të përfunduar.

Neni 334

Rrjedha e seancës kur ka deklaratë për pranimin e fajit

(1) Nëse i dyshuari i cili ka mbrojtës parashtron deklaratë për pranimin e fajit në lidhje me të gjitha ose veprave të veçanta penale të përfshira në

aktakuzë, përkatësisht ka dhënë deklaratë të këtillë në seancë, gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës kontrollon:

1) nëse deklarata për pranimin e fajit është dhënë në mënyrë vullnetare, me vetëdije dhe me marrëveshje për pasojat nga kjo, duke i përfshirë edhe pasojat e lidhura me kërkesën juridiko-pronësore dhe shpenzimet e procedurës penale dhe

2) nëse ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme për fajin e të dyshuarit.

(2) Deklarata për pranimin e fajit futet në procesverbal.

(3) Nëse gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës e pranon deklaratën për pranimin e fajit, me propozim nga i dyshuari dhe mbrojtësi i tij ose me propozimit nga prokurori publik mund të kërkohet prolongim të seancës për zbatimin e procedurës për marrëveshjen dhe dorëzimin e propozim-marrëveshje në pajtim me dispozitat nga neni 483 deri te neni 490 të këtij ligji.

(4) Në rast të propozimit nga paragrafi (3) të këtij neni, gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës e anulon seancën për periudhën prej 15 ditësh dhe cakton datë për seancën e ardhshme.

(5) Nëse gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës nuk e pranon deklaratën për pranimin e fajit atë e konstaton në procesverbal, i njofton palët e pranishme dhe seanca për vlerësimin e aktakuzës vazhdon.

(6) Deklarata e parashtruar për pranimin e fajit, përkatësisht procesverbali në të cilin është përmbajtur deklarata për pranimin e fajit të cilën gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës nuk e ka pranuar, nuk mund të shfrytëzohen si dëshmi në procedurën e mëtutjeshme penale. Gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës do të sigurojë që parashtrësia përkatësisht procesverbali me deklaratën për pranimin e fajit, të mbyllet në mbështjellëse të posaçme dhe të ndahet nga shkresat e lëndës.

Neni 335

Parashtrimi i propozim-marrëveshjes

(1) Nëse në seancë për parashtrimin e propozim-marrëveshjes, prokurori publik dhe i dyshuari dhe mbrojtësi i tij parashtrojnë propozim-marrëveshje me elemente të parapara në nenin 485 të këtij ligji, gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës e vlerëson propozim-marrëveshjen.

(2) Nëse e pranon propozim-marrëveshjen, gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës miraton aktgjykim në pajtim me nenin 490 të këtij ligji.

(3) Nëse nuk e pranon propozim-marrëveshjen, gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës merr aktvendim për mospranimin e propozim-marrëveshjes dhe vendos në lidhje me aktakuzën.

(4) Propozim-marrëveshja e cila nuk pranohet nuk mund të shfrytëzohet si dëshmi në procedurën e mëtutjeshme penale. Gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës do të sigurojë që procesverbali me deklaratën për pranimin e fajit dhe propozim-marrëveshja të mbyllet në mbështjellëse të posaçme e cila do të ndahet nga shkresat e lëndës, sipas nenit 334 paragrafi (6) të këtij ligji.

Neni 336

Vlerësimi i aktakuzës

(1) Gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës e vlerëson bazueshmërinë e aktakuzës në lidhje me të gjitha veprat penale kur në kundërshtimin kundër aktakuzës i dyshuari nuk jep deklaratë për pranimin e fajit ose nëse deklarata e dhënë për faj nuk është pranuar.

(2) Gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës i vlerëson vet disa vepra penale nga aktakuza nëse në bazë të propozim-marrëveshjes se pranuar këshilli për vlerësim të aktakuzës për disa vepra penale nga aktakuza ka miratuar aktgjykim sipas nenit 490 të këtij ligji.

(3) Para vlerësimit të aktakuzës, gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës e vlerëson aktakuzën nga aspekti i propozimeve të shënuara në kundërshtimin kundër aktakuzës, shkresat e lëndës dhe dëshmitë të parashtruara në shtojcë të aktakuzës.

(4) Nëse gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës, me detyrë zyrtare ose me propozim nga mbrojtja konstaton se në shkresa gjenden dëshmi sipas nenit 12 paragrafi (2) të këtij ligji, merr aktvendim për ndarjen e tyre nga shkresat e lëndës. Gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës do të sigurojë që dëshmitë e ndara të mbyllën në mbështjellëse të posaçme dhe të ruhen te gjykatësi i procedurës paraprake. Dëshmitë e ndara nuk mund të shqyrtohen, e as nuk mund të shfrytëzohen në procedurë.

(5) Kundër aktvendimit për ndarjen e dëshmive lejohet ankesë për këshillin e gjykatës më të lartë.

(6) Kur aktakuza është miratuar në lidhje me disa vepra penale, gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës do të marrë aktvendim për ndarjen e procedurës në lidhje me atë vepër penale ose atë të dyshuar në lidhje me të cilët aktakuza është verifikuar.

(7) Gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës gjatë miratimit të të gjitha ose veprave të veçanta penale nga aktakuza, me aktvendim të posaçëm do të vendosë edhe në lidhje me propozimet për bashkimin ose ndarjen e procedurës. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e posaçme.

Neni 337

Baza për refuzimin e aktakuzës si të pabazë

(1) Gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës me aktvendim të posaçëm do ta refuzojë aktakuzën si të pabazë në lidhje me të gjitha ose disa vepra penale nëse konstaton, se:

1) vepra që është lëndë e aktakuzës nuk është vepër penale;

2) ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale, kurse nuk ka bazë për zbatimin e masave të sigurisë;

3) nuk ka kërkesë nga paditës i autorizuar, propozim të të dëmtuarit ose pëlqim nga organi kompetent shtetëror, nëse kjo është e nevojshme sipas ligjit, ose se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë ndjekjen ose

4) nuk ka dëshmi të mjaftueshme në dobi të akuzës.

(2) Kur gjykatësi apo këshilli për vlerësimin e aktakuzës do të marrë aktvendim sipas paragrafi (1) të këtij neni, i dorëzon dokumentet te prokurori publik.

Neni 338

Arsyetimi i aktvendimit për miratimin e aktakuzës

(1) Vendimin me të cilin gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës e miraton aktakuzën në tërësi ose pjesërisht, patjetër duhet të jetë i arsyetuar. Me arsyetimin nuk guxon të paragjykohet zgjidhja e pyetjeve që do të jenë lëndë e marrjes në pyetje dhe vlerësimit në seancën kryesore.

(2) Gjatë marrjes së aktvendimit për miratimin e aktakuzës, gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës nuk lidhet me kualifikimin juridik të veprës që prokurori publik e ka shënuar në aktakuzë.

Neni 339

Klauzola për miratimin e aktakuzës

Kur nuk është parashtruar kundërshtimi kundër aktakuzës kurse gjykatësi, përkatësisht këshilli për vlerësim të aktakuzës nuk vlerëson se ka nevojë për mbajtjen e seancës, pas kalimit të afatit prej tetë ditësh nga parashtrimi i aktakuzës të dyshuarit, e miraton aktakuzën me klauzolë për miratim.

Neni 340

E drejta për ankesë nga prokurori publik

Kundër aktvendimit të gjykatësit ose këshillit për vlerësim të aktakuzës me të cilën janë shpallur për jokompetentë dhe kundër aktvendimit me të cilin aktakuza është vlerësuar si e pabazë në lidhje me të gjitha ose disa vepra penale, lejohet ankesë e prokurorit publik në këshillin e gjykatës më të lartë.

Neni 341

Heqja dorë nga aktakuza

(1) Prokurori publik mund të heqë dorë nga aktakuza, para marrjes së aktvendimit për miratimin e saj.

(2) Pas heqjes dorë të prokurorit publik sipas paragrafit (1) të këtij neni, gjykatësi, përkatësisht këshilli për vlerësim të aktakuzës merr aktvendim për ndërprerje të procedurës, për çfarë menjëherë njoftohet i dyshuari dhe mbrojtësi i tij.

(3) Vendimi për ndërprerjen e procedurës nga paragrafi (2) të këtij neni i dorëzohet të dëmtuarit, me këshillë se mundet në afat prej tetë ditësh të parashtojë ankesë te prokurori publik më i lartë i drejtpërdrejtë.

Neni 342

Privilegji i shoqërimit (*Beneficium cohaesionis*)

Nëse nga më shumë të dyshuar vetëm disa parashtrajnë kundërshtim kundër aktakuzës, kurse arsyet për të cilat gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës ka konstatuar se aktakuza është e pabazë, janë në dobi edhe të disa të dyshuarve që nuk kanë parashtruar ankesë, gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës me detyrë zyrtare do të veprojnë sikur edhe ata të kishin parashtruar kundërshtime.

Neni 343

Hyrja e aktakuzës në fuqi juridike

Aktakuza hyn në fuqi juridike me ditën e marrjes së aktvendimit për miratimin e saj, përkatësisht me regjistrimin e klauzolës për miratimin e aktakuzës.

Neni 344

Dërgimi në gjykim

(1) Aktakuza, aktvendimi për miratimin e saj, dëshmitë e dorëzuara materiale dhe lista e dëshmive të cilat palët propozojnë që të nxirren, dorëzohen në gjykatën kompetente.

(2) Procesverbalet dhe incizimet nga marrja në pyetje e personave kthehen te prokurori publik.

Seksioni V. SEANCA KRYESORE DHE AKTGJYKIMI

Kreu XXIII

PËRGADITJA PËR SEANCËN KRYESORE

Neni 345

Caktimi i seancës kryesore

(1) Kryetari i këshillit me urdhër e cakton ditën, orën dhe vendin e seancës kryesore.

(2) Kryetari i këshillit do ta caktojë seancën kryesore më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktakuzës në gjykatë, ndërsa për veprat e krimit të organizuar më së voni në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të aktakuzës në gjykatë. Nëse në këtë afat nuk e cakton seancën kryesore, kryetari i këshillit me shkrim do ta njoftojë kryetarin gjykatës për shkaqet për të cilat seanca kryesore nuk është caktuar. Kryetari i gjykatës sipas nevojës do të ndërmarrë masa që seanca kryesore të caktohet.

(3) Nëse kryetari i këshillit vërteton se në shkresa gjenden procesverbale ose njoftime nga neni 94 të këtij ligji, do të marrë aktvendim për ndarjen e tyre para caktimit të seancës kryesore, ndërsa pas plotfuqishmërisë së aktvendimit do t'i ndajë në mbështjellës të veçantë dhe do t'ia dorëzojë prokurorit publik kompetent, për ruajtje ndaras nga shkresat tjera.

Neni 346

Vendi i mbajtjes së seancës kryesore

(1) Seanca kryesore mbahet në selinë e gjykatës dhe në ndërtesën e gjykatës.

(2) Nëse në raste të veçanta lokalet e ndërtesës së gjykatës nuk janë të përshtatshme për mbajtjen e seancës kryesore, kryetari i gjykatës mund të caktojë që debati të mbahet në ndërtesë tjetër.

(3) Seanca kryesore mund të mbahet dhe në vend tjetër në rajonin e gjykatës kompetente, nëse këtë me propozim të arsyetuar nga kryetari i gjykatës e lejon kryetari gjykatës më të lartë.

Neni 347

Refuzimi i dëshmive të propozuara

- (1) Kryetari i këshillit mund t'i refuzojë dëshmitë e propozuara, nëse:
- 1) propozimi ka të bëjë me mënyrën e ndaluar me ligj të grumbullimit të dëshmitëve, dëshminë përdorimi i së cilës me ligj nuk është i lejuar ose faktin i cili sipas ligjit nuk mund të dëshmohet (propozim i paligjshëm);
 - 2) janë të paqarta, jo të plota ose qartazi janë për prolongimin e konsiderueshëm të procedurës ose
 - (3) faktet që sipas propozimit do të duhej të vërtetohen nuk janë relevante për vendosje, përkatësisht nuk ekziston lidhshmëri ndërmjet fakteve që duhet të vërtetohen dhe fakteve që vendosin, ose kjo lidhshmëri për shkaqe juridike nuk mund të konstatohet (propozim i pavlefshëm).
- (2) Kryetari i këshillit mund t'i ftojë palët që të vijnë në ditë të caktuar në gjykatë që t'i arsyetojnë propozimet e veta, përkatësisht kundërshtimet lidhur me dëshmitë e propozuara.
- (3) Aktvendimi me të cilin refuzohet propozimi për nxjerrjen e provave, doemos duhet të jetë i arsyetuar. Me propozim të palëve këshilli mund ta ndryshojë ose ta revokojë këtë aktvendim në rrjedhën e mëvonshme të procedurës.

Neni 348

Thirrja e personave në seancën kryesore

- (1) Në seancën kryesore do të thirren i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, paditësi dhe i dëmtuari dhe përfaqësuesit e tij ligjorë dhe i autorizuari, si dhe interpretuesi. Në seancën kryesore do të ftohen edhe dëshmitarët, ekspertët dhe këshilltarët teknikë të cilët janë propozuar nga paditësi në aktakuzë, përkatësisht i padituri në kundërshtimin kundër aktakuzës, ose në parashtresën e veçantë nga neni 326 të këtij ligji, përveç atyre që kryetari i këshillit do t'i refuzojë sipas nenit 347 të këtij ligji. Paditësi dhe i akuzuari mundën në seancën kryesore t'i përsërisin propozimet që kryetari i këshillit nuk i ka miratuar.
- (2) Në pikëpamje të përmbajtjes së ftesave për personat nga paragrafi (1) të këtij neni, do të zbatohen dispozitat e neneve 11 dhe 145 të këtij ligji. Kur mbrojtja nuk është e detyrueshme i akuzuari në ftesë do të këshillohet se ka të drejtë të marrë mbrojtës, ndërsa seanca kryesore nuk do të mund të prolongohet për arsye se mbrojtësi nuk ka ardhur në seancën kryesore, ose për shkak të asaj që i akuzuari ka marr mbrojtës vetëm në seancën kryesore.
- (3) Ftesa të i akuzuari doemos duhet të dërgohet ashtu që ndërmjet dorëzimit të ftesës dhe ditës së seancës kryesore, që të mbetet kohë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, e së paku tetë ditë. Me kërkesë të akuzuarit ose paditësit, e me pëlqim të të akuzuarit, ky afat mund të shkurtohet.
- (4) Të dëmtuarin që nuk thirret si dëshmitar gjykata do ta njoftojë në ftesë se seanca kryesore do të mbahet edhe pa të, ndërsa do të lexohet deklarata e tij për kërkesën pronësore-juridike.
- (5) Paditësi privat do të paralajmërohet në ftesë se do të konsiderohet se ka heq dorë nga akuza nëse nuk vjen në seancën kryesore, as nuk dërgon të autorizuar.
- (6) Në ftesë i akuzuari, mbrojtësi, dëshmitari dhe eksperti do të paralajmërohen për pasojat e mosardhjes në seancën kryesore (nenet 365 dhe 368 të këtij ligji).

Neni 349

Gjykatës plotësues dhe gjykatës - porotë

Nëse është e mundur që seanca kryesore të zgjat më shumë, kryetari i këshillit mund të kërkojë nga kryetari i gjykatës që të caktojë një ose dy gjykatës, përkatësisht gjykatës-porotë, të marrin pjesë në seancën kryesore, që t'i zëvendësojnë anëtarët e këshillit në rast të pengesës së tyre.

Neni 350

Marrja në pyetje e dëshmitarëve jashtë gjykatës

(1) Nëse njoftohet se ndonjë dëshmitar që është thirrur në seancën kryesore ndërsa ende nuk është marrë në pyetje, nuk do të mund të vijë në seancën kryesore për shkak të sëmurjes afatgjate ose palëvizshmërisë, mund të merret në pyetje në vendin të cilit gjendet.

(2) Dëshmitarin, përkatësisht ekspertin do ta marrë në pyetje, ndërsa sipas nevojës edhe do ta betojë, kryetari i këshillit ose gjykatësi-anëtar i këshillit, ose marrja e tij në pyetje do të bëhet nëpërmjet gjykatësit të procedurës paraprake në gjykatën në rajonin e të cilit gjendet dëshmitari.

(3) Për kohën dhe vendin e marrjes në pyetje detyrimisht do të njoftohen palët dhe mbrojtësi, ndërsa i dëmtuari nëse kjo është e mundur duke marrë parasysh urgjencën e procedurës. Nëse i akuzuari është në paraburgim, për nevojën e pranisë së tij të marrjes në pyetje vendos kryetari i këshillit. Kur palët dhe i dëmtuari marrin pjesë në pyetje i kanë të drejtat nga neni 219 paragrafi (7) i këtij ligji.

Neni 351

Prolongimi i mbajtjes së seancës kryesore

(1) Kryetari i këshillit mundet me urdhër me propozim të arsyetuar të palëve ta prolongojë ditën e mbajtjes së seancës kryesore.

(2) Seanca kryesore mund të prolongohet dhe sipas detyrës zyrtare për shkaqe shëndetësore ose shkaqe tjera të arsyeshme.

(3) Shkaqet për prolongimin dhe arsyetimi për to, futen në urdhrin për prolongim përkatësisht në procesverbal.

Neni 352

Ndërprerja e procedurës për arsye të heqjes dorë të paditësit para fillimit të seancës kryesore

Nëse paditësi heq dorë nga aktakuza para fillimit të seancës kryesore, kryetari i këshillit do ta ndërpresë me aktvendim procedurën penale dhe do t'ua dorëzojë aktvendimin palëve dhe të dëmtuarit, e për këtë do t'i njoftojë personat që janë thirrur në seancën kryesore, nëse është caktuar.

Kreu XXIV

SEANCA KRYESORE

1. Parimi i transparencës së seancës kryesore

Neni 353

Transparenca e seancës kryesore

- (1) Seanca kryesore është publike.
- (2) Në seancën kryesore mund të marrin pjesë vetëm persona të moshuar.
- (3) Personat të cilët marrin pjesë në seancën kryesore nuk guxojnë të mbajnë armë ose vegla të rrezikshme, përveç policisë gjyqësore, policisë dhe shërbimit për përcjelljen dhe sigurimin e të akuzuarit në institucionet ndëshkimore- përmirësuese.

Neni 354

Përrjashtimi i publikut

Nga hapja e seancës e deri në përfundimin e seancës kryesore këshilli mundet në çdo kohë me detyrë zyrtare ose me propozim të palëve ose të dëmtuarit, ta përjashtojë publikun nga një pjesë e seancës kryesore ose nga tërë seanca kryesore, nëse kjo është e nevojshme për ruajtjen e fshehtësisë shtetërore, ushtarake, zyrtare ose fshehtësisë së rëndësishme afariste, ruajtjen e rendit publik, mbrojtjen e jetës private të të akuzuarit, dëshmitarit ose të dëmtuarit, mbrojtjen e sigurisë së dëshmitarit ose viktimës dhe/ose mbrojtjen e interesave të personit të mitur.

Neni 355

Për kë nuk ka të bëjë përrjashtimi i publikut

- (1) Përrjashtimi i publikut nuk ka të bëjë për palët, të dëmtuarin, përfaqësuesit e tyre ligjorë dhe të autorizuarit, si dhe mbrojtësin, përveç në raste të përcaktuara me ligj.
- (2) Këshilli mund të lejojë që në seancën kryesore në të cilin është përrjashtuar publiku të marrin pjesë persona të caktuar zyrtarë, punëtorë shkencorë dhe publikë, ndërsa me kërkesë të të akuzuarit këtë mund t'ia lejojë edhe shokut martesor përkatësisht jashtëmartesor dhe familjarëve të tyre më të afërt nga neni 353 paragrafi (2) i këtij ligji.
- (3) Kryetari i këshillit do t'i paralajmërojë personat të cilët marrin pjesë në seancën kryesore në të cilën është përrjashtuar publiku, se janë të detyruar ta ruajnë si fshehtësi gjithë atë që e kanë dëgjuar në seancë dhe do t'u tregojnë se dhënia e fshehtësisë paraqet vepër penale.

Neni 356

Vendimi për përrjashtimin e publikut

Vendimin për përrjashtimin e publikut e merr këshilli me aktvendim që doemos duhet të arsyetohet dhe shpallet publikisht.

2. Udhëheqja me seancën kryesore

Neni 357

Prania e detyrueshme në seancën kryesore

(1) Kryetari dhe anëtarët e këshillit, si dhe gjykatësit dhe gjykatësit – porotë nga neni 26 të këtij ligji, detyrimisht pandërprerë marrin pjesë në seancën kryesore.

(2) Detyrë e kryetarit të këshillit është që të vërtetojë se vallë këshilli është i përbërë sipas ligjit dhe se a ekzistojnë arsye për të cilat anëtarët e këshillit dhe mbajtësi i procesverbalit duhet të përjashtohen (neni 33 pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji).

Neni 358

Detyrat e kryetarit të këshillit

(1) Kryetari i këshillit udhëheq me seancën kryesore.

(2) Detyra e kryetarit të këshillit është që të kujdeset për shqyrtim të gjithanshëm të lëndës dhe për mënjanimin e gjithë asaj që e prolongon procedurën dhe nuk shërben për sqarimin e punëve.

(3) Kryetari i këshillit vendos për propozimet e palëve nëse për to nuk vendos këshilli.

(4) Për propozimin për të cilin ekziston pëlqim nga palët dhe për propozimet me pajtim të palëve që nuk do t'i miratojë kryetari, vendos këshilli.

(5) Aktvendimet e këshillit çdoherë shpallen dhe me arsyetim të shkurtër futen në procesverbalin e seancës kryesore.

Neni 359

Rrjedha e seancës kryesore

(1) Seanca kryesore mbahet dhe vijon pandërprerë sipas rendit që është përcaktuar në këtë ligj. Në rastet kur nuk mundet seanca kryesore të mbarojë në një seancë, kryetari vendos që seanca kryesore të vazhdoj në ditën e ardhshme të punës.

(2) Kryetari i këshillit mund të përcaktojë që të shmanget nga rrjedha e rregullt e shqyrtimit për shkak të rrethanave të veçanta, e veçanërisht për shkak të numrit të akuzuarve, numrit të veprave penale dhe vëllimit të materialit provues.

Neni 360

Mbajta e rendit në gjykatë

(1) Detyra e kryetarit të këshillit është që të kujdeset për mbajtjen e rendit në gjykatë dhe për dinjitetin e gjykatës. Ai mundet menjëherë pas hapjes së seancës t'i paralajmërojë personat që marrin pjesë në seancën kryesore që të sillen mirë dhe të mos e prishin punën e gjykatës. Kryetari i këshillit mund të përcaktojë kontroll të personave që marrin pjesë në seancën kryesore.

(2) Këshilli mund të urdhërojë që nga seanca të largohen personat të cilët si dëgjues marrin pjesë në seancën kryesore, nëse ata edhe pas vërejtjes e prishin mbajtjen e shqyrtimit kryesor.

(3) Në gjykatë nuk mund të kryhen incizime filmike dhe televizive. Me përjashtim, kryetari i Gjykatës së Lartë të Republikës së Maqedonisë mund të lejojë incizim të atillë të shqyrtimit të veçantë kryesor. Nëse incizimi është lejuar, këshilli i seancës kryesore mundet për shkaqe të arsyeshme të vendosë që pjesë të veçanta të seancës kryesore të mos incizohen.

Neni 361

Ndëshkimi për shkak të prishjes së rendit dhe disiplinës

(1) Nëse prokurori publik, i akuzuari, mbrojtësi, i dëmtuari, përfaqësuesi ligjor, i autorizuari, eksperti, përkthyesi përkatësisht interpretuesi ose personi tjetër i cili merr pjesë në seancën kryesore, e prish rendin ose nuk i përmbahet urdhrave nga kryetari i këshillit për mirëmbajtjen e rendit, kryetari i këshillit do t'i japë vërejtje. Nëse vërejtja është e pasuksesshme, këshilli mund të urdhërojë që ta largojë nga gjykata, ndërsa personat tjerë mundet jo vetëm t'i largojë por edhe t'i dënojnë me dënim në para të paraparë në nenin 88 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Pas vendimit të këshillit i akuzuari mund të largohet nga gjykata për afat të caktuar, e nëse përsëri e prish rendin në seancën kryesore, atëherë edhe gjatë gjithë kohës sa zgjatë procedura e provave. Para se të mbarojë procedura e provave kryetari i këshillit do ta ftojë të akuzuarin dhe do ta njoftojë për rrjedhën e seancës kryesore. Nëse i akuzuari vazhdon ta prishë rendin dhe ta ofendojë dinjitetin e gjykatës, këshilli mundet përsëri ta largojë nga seanca. Në këtë rast, seanca kryesore do të mbarojë pa praninë e të akuzuarit, ndërsa aktgjykimin do t'ia kumtojë kryetari ose gjykatësi-anëtar i këshillit në prani të mbajtësit të procesverbalit.

(3) Mbrojtësit ose të autorizuarit, i cili pas dënimit do të vazhdojë ta prishë rendin, këshilli mund t'ia shkurtojë mbrojtjen e mëtutjeshme, përkatësisht përfaqësimin në seancën kryesore dhe në atë rast pala do të thirret që të marrë mbrojtës, përkatësisht të autorizuar tjetër. Nëse është e pamundur që i akuzuari ose i dëmtuari këtë ta bëjnë menjëherë pa dëm për interesat e veta, ose në rast të mbrojtjes së detyrueshme nuk mundet menjëherë të vendoset mbrojtës ose i autorizuar i ri, seanca kryesore do të ndërpritet ose prolongohet, ndërsa mbrojtësit përkatësisht të autorizuarit do t'i urdhërohet që t'i paguajë shpenzimet që janë bërë nga ndërprerja ose prolongimi.

(4) Nëse gjykata e largon nga gjykata paditësin privat ose përfaqësuesin e tij ligjor, seanca kryesore do të vazhdojë edhe në mungesë të tyre, por gjykata do t'i paralajmërojë se mundet të marrin të autorizuar.

(5) Nëse prokurori publik e prish rendin, kryetari i këshillit për këtë do ta njoftojë prokurorin themelor publik, ndërsa mundet edhe ta ndërpresë seancën kryesore dhe nga prokurori themelor publik të kërkojë ta caktojë personin tjetër që ta përfaqësojë aktakuzën.

(6) Kur gjykata do ta dënojë avokatin i cili e prish rendin, për këtë do ta njoftojë Odën e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë.

(7) Kundër aktvendimit për dënimin lejohet ankesë në gjykatën më të lartë.

(8) Kundër aktvendimeve tjera që kanë të bëjnë me mbajtjen e rendit dhe udhëheqjen e seancës kryesore nuk lejohet ankesë e veçantë.

Neni 362

Vepra penale e kryer në seancën kryesore

(1) Nëse i akuzuari në seancën kryesore kryen veprë penale do të veprohet në bazë të dispozitave të nenit 393 të këtij ligji.

(2) Nëse dikush tjetër gjatë seancës kryesore kryen veprë penale, këshilli mund ta ndërpresë seancën kryesore dhe pas akuzës në formë gojore të paditësit, të gjykojë për veprën e kryer penale menjëherë, ndërsa mundet për atë veprë penale ta gjykojë pas përfundimit të shqyrtimit të filluar kryesor.

(3) Nëse ekzistojnë baza për dyshim se dëshmitari ose eksperti ka dhënë dëshmi të rrejshme në shqyrtimin kryesor, për këtë vepër penale nuk mund të gjykohet menjëherë. Në këtë rast kryetari i këshillit mund të urdhërojë që për dëshminë e dëshmitarit, përkatësisht të ekspertit të përpilohet procesverbal i posaçëm, që do t'ia dërgojë prokurorit publik. Këtë procesverbal do ta nënshkruajë edhe dëshmitari përkatësisht eksperti që është marrë në pyetje.

(4) Nëse nuk mundet menjëherë t'i gjykohet kryerësit të veprës penale për të cilët ndiqet sipas detyrës zyrtare, për këtë do ta njoftojë prokurorin publik kompetent për procedurën e mëtejme.

3. Parakushte për mbajtjen e shqyrtimit kryesor

Neni 363

Hapja e seancës

Kryetari i këshillit e hap seancën dhe e shpall lëndën e shqyrtimit kryesor dhe përbërjen e këshillit. Me këtë rast, vërteton se a kanë ardhur të gjithë personat e thirrur, e nëse nuk kanë ardhur kontrollon nëse u janë dorëzuar ftesat dhe nëse e kanë arsyetuar mungesën e tyre.

Neni 364

Mosardhja e paditësit në shqyrtimin kryesor

(1) Nëse në seancën kryesore që është caktuar në bazë të aktakuzës nga prokurori publik nuk vjen prokurori publik, i cili është i thirrur në mënyrë të rregullt, ndërsa nuk e ka njoftuar gjykatën për shkaqet e pengesës së tij, do të dënohet me dënim në para të paraparë në nenin 89 të këtij ligji, ndërsa seanca kryesore do të prolongohet.

(2) Nëse në seancën kryesore nuk vjen paditësi privat, edhe pse është thirrur në mënyrë të rregullt, as i autorizuari i tij, kryetari i këshillit ose gjykatësi individual do ta ndërpresë procedurën me aktvendim.

Neni 365

Mosardhja e të paditurit në shqyrtimin kryesor

(1) Nëse i akuzuari është thirrur në mënyrë të rregullt, ndërsa nuk vjen në shqyrtimin kryesor dhe as nuk e arsyeton mungesën tij ose nuk mund t'i dorëzohet ftesa, ndërsa nga rrethanat duket qartë se i shmanget pranimit të ftesës, këshilli do të urdhërojë që të silltet me forcë, sipas nenit 157 të këtij ligji. Nëse sjellja nuk do të mund të kryhet menjëherë, këshilli do të vendosë që shqyrtimi kryesor të mos mbahet dhe do të urdhërojë i akuzuari të silltet me detyrim në seancën e ardhshme. Nëse deri në sjellje i akuzuari e arsyeton mungesën, kryetari i këshillit do ta revokojë urdhrin për sjellje me detyrim.

(2) Nëse i akuzuari i thirrur në mënyrë të rregullt haptazi i ikën ardhjes në shqyrtimin kryesor, ose nëse gjykata ka bërë dy tentime që me rregull ta thirrë të akuzuarin, e të gjitha rrethanat tregojnë se i akuzuari haptazi i ikën pranimit të thirrjes, këshilli mundet të përcaktojë paraburgim sipas nenit 165 paragrafi (1) pika 4 të këtij ligji.

(3) Të akuzuarit mundet t'i gjykohet në mungesë vetëm nëse është në arrati ose nuk është i kapshëm për organet e shtetit, ndërsa ekzistojnë shkaqe të vërteta që t'i gjykohet edhe pse mungon.

(4) Aktvendimin për gjykim në mungesë të akuzuarit e miraton këshilli me propozim të paditësit. Ankesa nuk e ndalon zbatimin e aktvendimit.

Neni 366

Mosardhja e mbrojtësit në shqyrtimin kryesor

Nëse në shqyrtimin kryesor nuk vjen mbrojtësi i cili është thirrur në mënyrë të rregullt, ndërsa nuk e njofton gjykatën për shkaqet e pengesës kur për këtë shkak ka kuptuar, ose nëse mbrojtësi pa leje e lëshon shqyrtimin kryesor, ndërsa nuk ekziston mundësia që menjëherë të merret mbrojtës tjetër pa dëm për mbrojtjen, shqyrtimi kryesor me propozim të të akuzuarit do të prolongohet, e mundet të mbahet edhe pa praninë e mbrojtësit, nëse mbrojtja nuk është e detyrueshme. Në rast të prolongimit, këshilli me aktvendim do të vendosë që mbrojtësi t'i bartë shpenzimet që janë shkaktuar për shkak të prolongimit nëse kjo mund t'i ngarkohet fajit të tij.

Neni 367

Mbajta e shqyrtimit kryesor edhe përkundër mosardhjes së të akuzuarit, përkatësisht për shkak të mungesës së mbrojtësit

Nëse sipas dispozitave të neneve 70, 71 dhe 77 të këtij ligji ekzistojnë kushte për prolongimin e shqyrtimit kryesor për shkak të mosardhjes së të akuzuarit përkatësisht për shkak të mungesës së mbrojtësit, këshilli mund të vendosë që shqyrtimi kryesor të mbahet nëse sipas dëshmive që gjenden në shkresa, duket qartë se doemos do të duhet të merret aktgjykim me të cilin refuzohet aktakuza.

Neni 368

Mosardhja e dëshmitarit ose ekspertit në shqyrtimin kryesor

(1) Nëse dëshmitari ose eksperti mungon edhe përkundër ftesës së rregullt ose qartazi i shmanget ardhjes në shqyrtimin kryesor, këshilli mund të urdhërojë që të sillet menjëherë me detyrim.

(2) Shqyrtimi kryesor mundet të fillojë edhe pa praninë e dëshmitarit ose ekspertit të thirrur dhe në këtë rast këshilli do të vendosë që gjatë shqyrtimit kryesor, nëse për shkak të mungesës së dëshmitarit ose ekspertit shqyrtimi kryesor duhet të ndërpritet ose prolongohet.

(3) Dëshmitari ose eksperti i cili është i thirrur në mënyrë të rregullt, nuk e ka arsyetuar mungesën, këshilli mund ta dënojë me dënim në para të përcaktuar në nenet 224 dhe 237 të këtij ligji, e mund të urdhërojë që në shqyrtimin e ri kryesor të sillet me detyrim. Këshilli mundet në rast të arsyeshëm ta tërheqë vendimin për dënim.

Neni 369

Marrja në pyetje e dëshmitarit ose ekspertit nëpërmjet telefonit ose video konferencës

Dëshmitari ose eksperti mund të merret në pyetje nëpërmjet telefonit ose video konferencës kur gjendet në territorin e shtetit tjetër.

4. Prolongimi dhe ndërprerja e shqyrtimit kryesor

Neni 370

Shkaqet e prolongimit të shqyrtimit kryesor

(1) Gjykata vendos për prolongimin dhe ndërprerjen e shqyrtimit kryesor.

(2) Jashtë rasteve të veçanta të parapara në këtë ligj, me kërkesë të palëve, mbrojtësi ose sipas detyrës zyrtare, shqyrtimi kryesor do të prolongohet me aktvendim të kryetarit të këshillit nëse është e nevojshme për kohë më të gjatë për grumbullimin e provave të reja, ose nëse gjatë shqyrtimit kryesor vërtetohet se te i akuzuari pas kryerjes së veprës penale është shkaktuar sëmundje shpirtërore ose çrregullim shpirtëror ose nëse ekzistojnë pengesa tjera serioze për mbajtjen e shqyrtimit kryesor.

(3) Shqyrtimi kryesor prolongohet vetëm gjatë kohës sa zgjat pengesa, përkatësisht shkaqet që kanë sjellë te prolongimi, ndërsa kryetari i këshillit është i detyruar që çdo muaj të ardhshëm ta njoftojë kryetarin e gjykatës për atë se a ekzistojnë ende shkaqet për prolongim. Kryetari i gjykatës do të ndërmarrë masa të nevojshme për shpejtimin e procedurës.

(4) Në aktvendimin me të cilën prolongohet shqyrtimi kryesor sipas rregullës do të caktohet dita dhe ora kur do të vazhdojë shqyrtimi kryesor. Me të njëjtin aktvendim kryetari i këshillit do të urdhërojë që të sigurohen dëshmitë të cilat mund të humben ose zhduken për arsye të prolongimit të shqyrtimit kryesor.

(5) Kundër aktvendimit nga paragrafi (4) i këtij neni nuk lejohet ankesë.

Neni 371

Vazhdimi i shqyrtimit të prolonguar kryesor

(1) Nëse shqyrtimi kryesor i cili është i prolonguar mbahet para gjykatësit të njëjtë, përkatësisht këshillit, debati do të vazhdojë. Kryetari i këshillit mund të përcaktojë që seanca kryesore të fillojë përsëri.

(2) Shqyrtimi kryesor që është prolonguar fillon përsëri nëse është ndërruar përbërja e këshillit ose gjykatësi individual. Me pëlqim të palëve, këshilli mund të vendosë që dëshmitarë dhe ekspertë të caktuar të mos dëgjohen përsëri, por të lexohen dëshmitë e tyre të futura në procesverbalet nga shqyrtimi kryesor i mëparshëm.

(3) Nëse prolongimi ka zgjatur më shumë se 90 ditë, shqyrtimi kryesor doemos duhet të fillojë dhe të gjitha dëshmitë doemos duhen të nxirren. Me marrjen në pyetje të palëve, gjykatësi përkatësisht këshilli mund të vendosë që dëshmitarë dhe ekspertë të caktuar të mos dëgjohen përsëri, por të lexohen dëshmitë e tyre të futura në procesverbalet nga shqyrtimi kryesor i mëparshëm.

(4) Nëse në rast kur është e detyrueshme prania e mbrojtësit, ndërsa i akuzuari gjatë shqyrtimit kryesor e ka revokuar autorizimin ose mbrojtësi e ka refuzuar autorizimin ose pa arsye nuk vjen në shqyrtimin kryesor ose para kohe e ka lëshuar shqyrtimin kryesor, kryetari i këshillit menjëherë do ta detyrojë të akuzuarin që të caktoj mbrojtës tjetër dhe t'i paraqesë afat prej së paku 15 ditësh për përgatitjen e mbrojtjes, e pastaj shqyrtimi kryesor vazhdon. Gjatë rrjedhës së mëtejme të shqyrtimit kryesor revokimi ose anulimi i përsëritur i autorizimit mundet të lejohet vetëm me vendim të këshillit, nëse kjo nuk është bërë me qëllim të prolongimit të procedurës.

(5) Nëse jashtë rasteve nga paragrafi (4) i këtij neni i akuzuari autorizon mbrojtës të ri, shqyrtimi kryesor do të vazhdojë pa prolongim.

Neni 372

Ndërprerja e shqyrtimit kryesor

(1) Gjykatësi përkatësisht, kryetari i këshillit mund ta ndërpresë shqyrtimin kryesor për shkak të pushimit ose për shkak të skadimit të orarit të punës, ose për shkak të marrjes së dëshmime në kohë të shkurtër ose për shkak të përgatitjes së aktakuzës ose mbrojtjes, përveç në rastet e parapara me këtë ligj.

(2) Ndërprerja e shqyrtimit kryesor vazhdon çdoherë para gjykatësit përkatësisht këshillit të njëjtë.

(3) Nëse shqyrtimi kryesor nuk mund të vazhdojë para gjykatësit përkatësisht këshillit të njëjtë ose nëse ndërprerja e shqyrtimit kryesor ka zgjatur më shumë se tetë ditë, do të vepohet sipas dispozitave nga neni 371 të këtij ligji.

Neni 373

Rifillimi i shqyrtimit kryesor në rast të ndryshimit të aktakuzës

(1) Nëse gjatë shqyrtimit kryesor para këshillit të përbërë nga një gjykatës dhe dy gjykatës porotë në rast të ndryshimit të aktakuzës për vepër penale për gjykimin e së cilës është kompetent këshilli i përbërë nga dy gjykatës dhe tre gjykatës-porotë, këshilli do të plotësohet dhe shqyrtimi kryesor do të rifillojë.

(2) Këshilli mundet edhe pa pëlqimin e palëve përkatësisht mbrojtësit, por pas marrjes së tyre në pyetje, të vendosë që dëshmitarë dhe ekspertë të caktuar të mos merren në pyetje, por të lexohen procesverbalet për marrje në pyetje të atyre dëshmitarëve dhe ekspertëve.

5. Procesverbali për shqyrtimin kryesor

Neni 374

Mënyra e udhëheqjes së shqyrtimit kryesor

(1) Rrjedha e shqyrtimi kryesor incizohet me zë ose në mënyrë vizuale-me zë.

(2) Në fillim të debatit, kryetari i këshillit i njofton palët e pranishme dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë për atë se debati incizohet, dhe se incizimi paraqet shënim vizuel-me zë nga debati i mbajtur.

(3) Kur nuk ekzistojnë kushte teknike për incizim të zërit ose vizuel-të zërit gjatë seancës kryesore, kryetari i këshillit mund të urdhërojë që për rrjedhën e shqyrtimit kryesor të mbahet procesverbal stenografik.

(4) Procesverbali stenografik, në afat prej 48 orësh nga mbajtja e shqyrtimit kryesor do të deshifrohet dhe shqyrtohet, do të nënshkruhet nga personi i cili e përpilon, palët, gjykatësi individual, përkatësisht kryetari i këshillit dhe do të përfshihet në lëndë.

(5) Incizimi i zërit ose vizuel-i zërit nga shqyrtimi i mbajtur është pjesë e lëndës gjyqësore, e cila mbahet në sistemin e automatizuar kompjuterik për udhëheqje me lëndët gjyqësore (AKMIS).

(6) Incizimi i zërit ose vizuel-i zërit nuk guxon të publikohet, emitohet ose shfrytëzohet për dedikim dhe qëllime jashtë procedurës penale.

(7) Palët dhe mbrojtësi kanë të drejtë që pas mbajtës së shqyrtimit kryesor të marrin kopje nga incizimi i zërit ose vizuel i zërit në afat prej tri ditësh përshkrim nga procesverbali stenografik, në formë të shtypur ose

elektronike. Kopja e incizimit dorëzohet menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej 24 orësh.

Neni 375

Përfshirja e kumtimit të aktgjykimit në procesverbal

(1) Në procesverbal të shqyrtimit kryesor futet kumtimi i plotë i aktgjykimit, me shënimin se aktgjykimi është shpallur publikisht. Kumtimi i aktgjykimit, i përmbajtur në procesverbal paraqet burim për shqyrtimin kryesor.

(2) Nëse është marrë aktvendim për paraburgim dhe kjo përfshihet në procesverbal për shqyrtimin kryesor.

6. Fillimi i shqyrtimit kryesor

Neni 376

Hyrja e gjykatësit, përkatësisht këshillit në gjykatë

(1) Palët dhe të gjithë të pranishmit në gjykatë e presin këshillin duke qëndruar në këmbë.

(2) Palët dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë janë të detyruar që të ngriten në këmbë kur u drejtohen gjykatës, përveç nëse për këtë ekzistojnë pengesa të arsyeshme.

(3) Në gjykatë në të cilën mbahet shqyrtimi kryesor, palët qëndrojnë përballë kryetarit të këshillit, dhe atë: nga ana e tij e majtë i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, ndërsa nga ana e tij e djathtë prokurori publik ose paditësi i autorizuar, i dëmtuari dhe i autorizuari i tij.

(4) I akuzuari, dëshmitarët dhe ekspertët dëgjojnë në vendin e caktuar nga ana e djathtë e kryetarit të këshillit, të kthyer drejt prokurorit dhe të akuzuarit.

Neni 377

Kushtet për mbajtjen e shqyrtimit kryesor

Pasi që kryetari i këshillit do të vërtetojë se në shqyrtimin kryesor kanë ardhur të gjithë personat e ftuar, ose kur këshilli do të vendosë se shqyrtimi kryesor mund të mbahet dhe në mungesë të ndonjë prej personave të thirrur, do ta thirrë të akuzuarin dhe nga ai do të marrë të dhëna personale për vërtetimin e identitetit.

Neni 378

Vërtetimi i identitetit të akuzuarit dhe dhënia e udhëzimeve

(1) Pasi që të vërtetohet identiteti i akuzuarit kryetari i këshillit do t'i udhëzojë dëshmitarët në vendin që është i caktuar për ta ku do të presin derisa nuk ftohen për marrje në pyetje. Ekspertët mund të mbeten dhe ta përcjellin shqyrtimin kryesor.

(2) Të gjithë të akuzuarit mbeten në gjykatë gjatë gjithë shqyrtimit kryesor.

(3) Nëse paditësi privat duhet të merret në pyetje si dëshmitar nuk do të largohet nga gjykata.

(4) Kryetari i këshillit mund të ndërmarrë masa të nevojshme që të pengohet marrëveshja ndërmjet dëshmitarëve, ekspertëve dhe palëve.

Neni 379

Fjalime hyrëse të palëve

(1) Shqyrtimi kryesor fillon me mbajtjen e fjalimeve hyrëse. Së pari flet paditësi, pastaj mbrojtësi ose i akuzuari.

(2) I akuzuari ka të drejtë që të mos mbajë fjalim hyrës.

(3) Në fjalimet e tyre palët mund t'i paraqesin cilat fakte vendimtare kanë për qëllim t'i argumentojnë, t'i paraqesin provat që do t'i nxjerrin dhe t'i përcaktojnë çështjet juridike për të cilat do të debatojnë. Në fjalimet nuk guxojnë të nxirren fakte për gjykimin e mëparshëm të të akuzuarit.

(4) Palët në fjalinë hyrëse nuk mund të deklarohen për konstatimet dhe provat e ofruara të palës kundërshtarë.

(5) Nëse i dëmtuari ose i autorizuari i tij janë të pranishëm, paralajmërojnë kërkesë juridiko-pronësore.

(6) Kryetari i këshillit mundet fjalimet hyrëse të palëve t'i kufizojë në kohë të caktuar.

Neni 380

Këshilla për të drejtat dhe deklarimi për fajin e të akuzuarit

(1) Pas fjalës hyrëse të paditësit, kryetari i këshillit do ta pyes të akuzuarin a kupton se për çka është i akuzuar dhe nëse bindet se i akuzuari nuk ka kuptuar për çka është i akuzuar, shkurtimisht do ta nxjerrë përmbajtjen e akuzës në mënyrë më të kuptueshme për të akuzuarin.

(2) Kryetari i këshillit do ta këshillojë të akuzuarin për të drejtën që të hesht ose të japë dëshmi të tijën dhe do ta këshillojë që me kujdes ta përcjellë rrjedhën e shqyrtimit kryesor, me ç'rast do t'i tregojë se mund të japë prova në mbrojtje të tij, t'u parashtrojë pyetje të bashkakuzuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve, dhe të japë vërejtje lidhur me deklaratat e tyre.

(3) Pastaj kryetari i këshillit do ta thirrë të akuzuarin që të prononcohet lidhur me të gjitha veprat penale të akuzës, nëse ndjehet fajtor apo jo.

Neni 381

Miratimi i aktgjykimit në bazë të pranimit të fajit gjatë shqyrtimit kryesor

(1) Pas këshillës për të drejtat e të akuzuarit pa marrë parasysh natyrën dhe rëndësinë e veprës penale për të cilën mbahet procedura, i akuzuari mundet vullnetarisht ta pranojë fajin lidhur me një ose më tepër vepra penale nga aktakuza.

(2) Pas pranimit të fajit, gjykatësi individual, përkatësisht kryetari i këshillit është i detyruar që të provojë nëse pranimi i fajit është bërë vullnetarisht, nëse i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat juridike nga pranimi i fajit, për pasojat lidhur me kërkesën juridike pronësore dhe shpenzimet e procedurës penale.

(3) Pas realizimit të veprimtarive nga paragrafi (2) të këtij neni nga ana e gjykatës, gjykata në procedurën provuese do t'i nxjerrë vetëm ato dëshmi që kanë të bëjnë me vendimin për sanksionin.

(4) Lidhur me aktgjykimin ose pjesën e aktgjykimit që është marrë si rezultat i pranimit të fajit të të akuzuarit gjatë shqyrtimit kryesor, i akuzuari nuk mund të parashtrojë ankesë për shkak të gjendjes faktike të vërtetuar gabimisht.

7. Procedura e provave

Neni 382

Nxjerrja e provave

- (1) Provat nxirren sipas radhës si vijon:
 - 1) prova të akuzës dhe prova lidhur me kërkesën pronësore juridike;
 - 2) prova të mbrojtjes;
 - 3) prova të akuzës për përgënjeshttrimin e provave të mbrojtjes (replika) dhe
 - 4) prova të mbrojtjes si përgjigje të përgënjeshttrimit (duplika).
- (2) Gjatë shqyrtimit kryesor çdonjëra prej palëve mundet, me pëlqimin e palës tjetër, të heq dorë nga nxjerrja e provës e cila ka qenë e propozuar.

Neni 383

Mënyra e marrjes në pyetje

- (1) Gjatë realizimit të provave lejohet marrja në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë, të kryqëzuar dhe plotësuese.
- (2) Marrjen në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë e bën pala e cila e ka propozuar dëshmitarin, përkatësisht ekspertin ose këshilltarin teknik.
- (3) Marrjen në pyetje në mënyrë të kryqëzuar e bën pala e kundërt.
- (4) Marrjen në pyetje në mënyrë plotësuese e bën përsëri pala e cila e thirr dëshmitarin, përkatësisht ekspertin dhe pyetjet që parashtrohen gjatë kësaj marrje në pyetje janë të kufizuara në pyetjet e parashtruara gjatë marrjes në pyetje të palës së kundërt.
- (5) Pas përfundimit të marrjes në pyetje të palëve, kryetari dhe anëtarët e këshillit mund t'i parashtrojnë pyetje dëshmitarit përkatësisht ekspertit.

Neni 384

Marrja në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë, të kryqëzuar dhe plotësuese të dëshmitarëve

- (1) Dëshmitari e merr në pyetje palën e cila e ka propozuar në pajtim me nenin 383 paragrafi (2) të këtij ligji. Pyetjet për dëshmitarin e palës kundërshtare janë të kufizuara dhe kanë të bëjnë me pyetjet të cilat paraprakisht janë parashtruar gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit nga pala e cila e ka propozuar. Pyetjet e marrjes përsëri në pyetje të dëshmitarit nga pala e cila e ka propozuar janë të kufizuara dhe kanë të bëjnë me pyetjet e parashtruara gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit nga pala e kundërt.
- (2) Pyetjet që sugjerojnë përgjigje nuk mund të parashtrohen gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç në rastet kur ka nevojë që të qartësohen deklaratat e dëshmitarëve. Sipas rregullës, pyetjet që sugjerojnë përgjigje lejohen vetëm gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të kryqëzuar.

Neni 385

Rregullat e gjykatës në procesin e nxjerrjes së provave

- (1) Kryetari i këshillit do ta kontrolloj mënyrën dhe renditjen e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe nxjerrjen e provave duke mbajtur llogari për efikasitetin, aspektin ekonomik të procedurës dhe sipas nevojës për përcaktimin e lartësisë.

(2) Kryetari i këshillit pas kundërshtimit nga palët do të ndalojë pyetje dhe përgjigje të pyetjes që është parashtruar më herët, nëse e vlerëson si të palejueshme ose irelevante për lëndën.

(3) Kryetari i këshillit, do ta refuzojë nxjerrjen e provës për të cilën konsideron se është e panevojshme dhe pa rëndësi për lëndën dhe për këtë do të paraqesë arsyetim të shkurtër.

(4) Kryetari i këshillit pas kundërshtimit nga palët do ta ndalojë parashtrimin e pyetjeve të cilat në vete përmbajnë edhe pyetje dhe përgjigje, përveç gjatë marrjes në pyetje të kryqëzuara.

(5) Kryetari i këshillit me propozim të palës që e ka propozuar dëshmitari do të lejojë marrjen në pyetje në mënyrë të kryqëzuar, nëse për shkak të deklaratës që e ka dhënë dëshmitari në shqyrtimin kryesor nuk mund më të konsiderohet si dëshmitar i palës që e ka propozuar.

(6) Kryetari i këshillit gjatë kohës së nxjerrjes së provave kujdeset për dinjitetin e palëve, të akuzuarit, dëshmitarëve dhe ekspertëve.

(7) Gjatë gjithë procedurës së provave kryetari i këshillit kujdeset për lejimin e pyetjeve, validitetin e përgjigjeve, marrja në pyetje në mënyrë të rregullt dhe arsyeshmërinë e kundërshtimeve.

(8) Për bisedimet e paraqitura në formë gojore në shqyrtimin kryesor në procesin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, ekspertëve dhe të dëmtuarit, gjykatësi vendos menjëherë me aktvendim.

Neni 386

Marrja në pyetje e dëshmitarit

(1) Para marrjes në pyetje të dëshmitarit, kryetari i këshillit do paralajmërojë për detyrën që t'ia paraqesë gjykatës gjithçka që i është e njohur për lëndën dhe do ta paralajmëroj se dëshmia e rrejshme është vepër penale.

(2) Dëshmitari jep betimin para dëshmimit, si vijon: "Betohe në nderin tim se për gjithçka që do të pyetem do ta flas të vërtetën dhe asgjë që kam parë dhe dëgjuar nuk do ta heshti".

(3) Kryetari i këshillit do ta paralajmërojë ose do ta dënojë me para pjesëmarrësin në procedurë ose cilindo person tjetër që i kanoset, e fyen ose e sjell në pikëpyetje sigurinë e dëshmitarit. Me propozimit të palëve, gjykata mund t'i urdhërojë organeve policore që të ndërmarrin masa të domosdoshme për ruajtjen e dëshmitarit.

(4) Nëse gjatë veprimeve nga paragrafi (3) të këtij neni është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, gjykata e njofton prokurorin kompetent.

Neni 387

Marrja në pyetje e ekspertit dhe këshilltarit teknik

(1) Para marrjes në pyetje të ekspertit, gjykata do t'i bëjë vërejtje për detyrën që ta shprehë mendimin në mënyrë të qartë dhe në përputhje me rregullat e profesionit, dhe do ta paralajmërojë se dëshmia e dhënë rrejshëm për konstatimin dhe mendimin paraqet vepër penale.

(2) Eksperti para marrjes në pyetje e jep betimin, si vijon: "Betohe në nderin tim se ekspertizën e kam kryer me ndërgjegjshmëri dhe sipas rregullave të profesionit tim dhe gjithçka që do të deklaroj lidhur me të njëjtën është e saktë."

(3) Nëse ndonjë nga palët kërkon që personi eksperti të merret në pyetje në shqyrtimin kryesor, konstatimi dhe mendimi me shkrim do të pranohet si material provues vetëm nëse personi ekspert që e ka përgatitur konstatimin dhe mendimin e ekspertizës ka dhënë dëshmi të veten në shqyrtimin kryesor dhe i është dhënë mundësia që të pyetet në mënyrë të kryqëzuar.

(4) Dispozitat për marrjen në pyetje të ekspertit në mënyrë përkatëse do të zbatohen edhe për marrjen në pyetje të këshilltarëve teknikë.

Neni 388

Përrjashtim nga nxjerrja e drejtpërdrejtë e provave

(1) Nëse të provuarit e një fakti bazohet mbi shënimin e ndonjë personi, ai duhet personalisht të merret në pyetje në shqyrtimin kryesor, përveç në rastet kur merret në pyetje dëshmitari i mbrojtur në pajtim me nenin 228 të këtij ligji. Marrja në pyetje nuk mund të zëvendësohet me leximin e procesverbalit nga dëshmia e tij e dhënë paraprakisht, dhe as me deklaratën me shkrim.

(2) Dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna në procedurën hetimore, dhe dëshmitë e mbledhura në kuadër të veprimeve të mbrojtjen gjatë procedurës hetimore, mund të shfrytëzohen gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të kryqëzuar ose gjatë përgënjeshtimit të konstatimeve të dhëna ose në përgjigje të përgënjeshtimit, për arsye të vlerësimit të besueshmërisë së deklaratave të dhëna në shqyrtimin kryesor.

(3) Procesverbalet për dëshmitë e dhëna në seancën e provave mundet me vendim të gjykatës të nxirren si provë me lexim ose riprodhim.

(4) Nëse pas fillimit të shqyrtimit kryesor shfaqen indikacione në bazë të cilave mund të konkludohet se dëshmitari i është ekspozuar dhunës, kërcënimit, premtimit të parave ose interesit tjetër, që të mos dëshmojë ose të dëshmojë rrejshëm në shqyrtimin kryesor, dëshmitë e dëshmitarit të dhëna para prokurorit publik në procedurën paraprake, mundet me vendim të gjykatës të nxirren si provë.

(5) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, procesverbalet për deklaratat e dhëna para prokurorit publik, mundet me vendim të gjykatës të nxirren si dëshmi me lexim ose riprodhim, nëse personi i cili e ka dhanë dëshminë ka vdekur, është sëmurë shpirtërisht ose edhe përkundër të gjitha mjete të parapara me ligj për gjetjen e tij mbetet i pakapshëm.

Neni 389

Procedura me dëshmitarë dhe ekspertë të pyetur

(1) Dëshmitarët dhe ekspertët e marrë në pyetje mbeten në gjykatë, nëse kryetari i këshillit nuk vendos t'i lëshojë ose përkohësisht largojë nga gjykata.

(2) Me propozim të palëve ose sipas detyrës zyrtare, gjykata mund të urdhërojë që dëshmitarët dhe ekspertët e marrë në pyetje të largohen nga gjykata dhe më vonë përsëri të thirren dhe të merren në pyetje në prani ose mungesë të dëshmitarëve ose ekspertëve tjerë.

Neni 390

Marrja në pyetje e dëshmitarit i cili nuk mund të vijë në gjykatë

(1) Nëse në shqyrtimin kryesor merret vesh se dëshmitari nuk mund të vijë në gjykatë ose ardhja në mënyrë të konsiderueshme i është vështirësuar, këshilli mundet nëse konsideron se dëshmia e tij është e rëndësishme të urdhërojë që dëshmitari të merret në pyetje nëpërmjet lidhjes së videokonferencës në pajtim me nenet 82 dhe 83 të këtij ligji, ose ta marr në pyetje jashtë shqyrtimit kryesor, kryetari i këshillit ose gjykatësi anëtar i këshillit.

(2) Nëse është e nevojshme që të kryhet inspektim ose rekonstruktiv jashtë shqyrtimit kryesor, do t'i kryejë kryetari i këshillit ose gjykatësi anëtar i këshillit.

(3) Palët dhe i dëmtuari do të njoftohen çdoherë, kur dhe në cilin vend do të merret në pyetje dëshmitari, përkatësisht do të kryhet inspektimi ose rekonstruktivi me prani të detyrueshme të palëve të atyre veprimeve.

Neni 391

Marrja në pyetje e të akuzuarit

(1) Me propozim të mbrojtjes kryhet marrja në pyetje e të akuzuarit.

(2) Marrja në pyetje fillon me pyetje të mbrojtësit, e pastaj pyetje parashtrajnë prokurori, i dëmtuari dhe të bashkakuzuarit, në pajtim me nenin 384 të këtij ligji.

(3) Nëse në shqyrtimin kryesor i akuzuari nuk jep dëshmi ose nuk jep dëshmi të ndryshme për fakte ose rrethana të caktuara, prokurori publik mund të kërkojë që të lexohet ose riprodhohet dëshmia e prokurorit e dhënë paraprakisht në procedurë në pajtim me nenin 207 të këtij ligji.

(4) Këshilli mundet me përjashtimit të vendosë që i akuzuari përkohësisht të largohet nga gjykata, nëse i bashkakuzuari ose dëshmitari refuzon të japë dëshmi në prani të tij ose nëse rrethanat tregojnë se në prani të tij nuk do ta flasë të vërtetën. Pasi që të kthehet në gjykatë, të akuzuarit do t'i lexohet dëshmia e të bashkakuzuarit, përkatësisht dëshmitarit.

Neni 392

Procesverbale për materialin e provave

(1) Provat materiale për si procesverbali për shqyrtim për mbikëqyrje, vërtetimi për sendet e marra dhe të kthyer, librat, shkresat etj., të cilat nuk janë të përsëritshme në shqyrtimin kryesor, do të futen në procesverbal për shqyrtimin kryesor.

(2) Provat nga paragrafi 1 i këtij neni dorëzohen në origjinal.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) të këtij neni mund të shfrytëzohet si dëshmi dhe përshkrim i vërtetuar ose kopje e vërtetuar.

(4) Materiali i provave nga paragrafi (1) të këtij neni, lexohen nëse palët nuk merren vesh ndryshe.

Neni 393

Ndryshimi dhe zgjerimi i aktakuzës

(1) Nëse i akuzuari vlerëson se provat e realizuara tregojnë se është ndryshuar gjendja faktike e deklaruar në aktakuzë, mundet në shqyrtimin kryesor ta ndryshojë aktakuzën. Për shkak të përgatitjes së mbrojtjes, shqyrtimi kryesor mund të prolongohet. Në këtë rast, nuk kryhet përcaktimi i aktakuzës.

(2) Nëse i akuzuari gjatë shqyrtimit kryesor në seancën kryen veprë penale ose nëse gjatë shqyrtimit kryesor zbulohet ndonjë veprë penale e kryer më herët e të akuzuarit, këshilli sipas rregullës, me akuzë të paditësit të autorizuar, e cila mund të jetë e deklaruar në formë gojore, do ta zgjerojë shqyrtimin kryesor dhe në atë veprë. Kundër kësaj akuze nuk lejohet kundërshtim.

(3) Që të përgatitet mbrojtja, gjykata në rast të paragrafit (2) të këtij neni mund ta ndërpresë shqyrtimin kryesor, ndërsa mundet pas marrjes në pyetje të palëve të vendosë që për veprën nga paragrafi (2) të këtij neni të gjykohet veças.

Neni 394

Plotësimi i procedurës së provave

(1) Pas procedurës së mbaruar të provave palët dhe i dëmtuari mund të paraqesin propozime për plotësimin e procedurës së provave për rrethana të reja që janë paraqitur gjatë shqyrtimit kryesor.

(2) Për mënjanimin e kundërshtimeve në konstatimet dhe mendimet të personave ekspertë ose profesionalë, gjykata sipas propozimit të palëve ose sipas detyrës zyrtare mund të përcaktojë edhe superekspertizë. Superekspertizën gjykata e përcakton në mënyrë elektronike me zbatimin e rregullës së zgjedhjes së rastësishme nga regjistri i ekspertëve, në prani të të dyja palëve përkatësisht të paditësit dhe mbrojtësit.

(3) Nëse nuk parashtrohen propozime për plotësimin e procedurës së provave ose nëse propozimi refuzohet, këshilli përkatësisht kryetari i këshillit do të shpallë se procedura e provave ka përfunduar.

Neni 395

Fjala përfundimtare

(1) Pas mbarimit të procedurës së provave, gjykata do t'i thirrë paditësin, të dëmtuarin, mbrojtësin dhe të akuzuarin që ta japin fjalën e vet përfundimtare.

(2) Nëse aktakuzën e përfaqësojnë më tepër të prokurorë, ose i akuzuari ka më tepër mbrojtës, të gjithë mund të japin fjalë përfundimtare, por nuk guxojnë të përsëriten dhe munden të jenë të kufizuar në kohë gjatë prononcimit.

Neni 396

Përfundimi i shqyrtimit kryesor

(1) Pas fjalëve përfundimtare, kryetari i këshillit do të njoftojë se shqyrtimi kryesor ka përfunduar dhe në procesverbal do të shënojë në sa ora shqyrtimi ka përfunduar.

(2) Pastaj këshilli do të tërhiqet në këshillim dhe votim për miratimin e aktgjykimit.

Kreu XXV AKTGJYKIMI

1. Shqiptimi i aktgjykimit

Neni 397

Shqiptimi i aktgjykimit

(1) Nëse gjykata gjatë këshillimit nuk konstaton se duhet përsëri të hapet shqyrtimi kryesor për plotësimin e procedurës ose sqarimin e pyetjeve të veçanta, do të shqiptojë aktgjykim.

(2) Aktgjykimi shqiptohet dhe shpallet publikisht në emër të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Neni 398

Lidhshmëria e aktgjykimit me aktakuzën (identiteti objektiv dhe subjektiv)

(1) Aktgjykimi ka të bëjë vetëm me personin që është i akuzuar dhe vetëm për veprën që është lëndë e aktakuzës së përmbajtur në parashtresë, përkatësisht e shqyrtimit kryesor, aktakuzës së ndryshuar ose zgjeruar.

(2) Gjkata nuk është e lidhur për propozimet e paditësit lidhur me vlerësimin juridik të veprës.

Neni 399

Provat mbi të cilat bazohet aktgjykimi

(1) Gjkata e bazon aktgjykimin vetëm mbi faktet dhe provat që janë paraqitur në shqyrtimin kryesor.

(2) Gjkata është e detyruar që me ndërgjegje ta vlerësojë çdo provë veç e veç edhe lidhur me provat e tjera dhe në bazë të këtij vlerësimi të nxjerrë konkluzion nëse ndonjë fakt është dëshmuar.

Neni 400

Provat mbi të cilat nuk mund të bazohet aktgjykimi

(1) Aktgjykimi nuk mund të mbështetet vetëm në bazë të dëshmisë së dëshmitarit të rrezikuar të marrë me zbatimin e dispozitave për mbulimin e identitetit ose pamjes së tyre, për mbrojtjen e tij dhe mbrojtjen e personave të tij të afërt.

(2) Aktgjykimi nuk mund mbështetet vetëm në bazë të dëshmisë së nxjerrë në pajtim me nenin 388 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji.

2. Llojet e aktgjykimeve

Neni 401

Llojet e aktgjykimeve

(1) Me aktgjykim aktakuza refuzohet ose i akuzuari lirohet nga aktakuza ose shpallet fajtor.

(2) Nëse aktakuza përfshin më tepër vepra penale, në aktgjykim do të kumtohet për cilën vepër refuzohet aktakuza ose i akuzuari lirohet nga aktakuza ose shpallet fajtor.

Neni 402

Aktgjykimi refuzues

Aktgjykim me të cilin refuzohet aktakuza gjykata do të kumtojë, nëse:

- 1) për aktgjykim gjykata nuk është kompetente reale;
- 2) procedura është mbajtur pa kërkesën e paditësit të autorizuar;
- 3) paditësi nga fillimi e deri në mbarim të shqyrtimit kryesor ka heq dorë nga aktakuza;
- 4) nuk ka pasur propozim të nevojshëm, leje ose nëse organi kompetent shtetëror ka heq dorë nga propozimi, përkatësisht leja ose nëse i dëmtuari ka heq dorë nga propozimi;
- 5) i akuzuari për të njëjtën vepër është tanimë i gjykuar në mënyrë të plotfuqishme, i liruar nga aktakuza ose procedura kundër tij është ndërprerë në mënyrë të plotfuqishme me aktvendim dhe
- 6) i akuzuari me akt të amnistisë ose faljes është liruar nga ndjekja, ose ndjekja penale nuk mund të ndërmerret për arsye të parashkrimit, ose nëse ekzistojnë rrethana tjera që e përjashtojnë ndjekjen penale.

Neni 403

Aktgjykimi lirues

Aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga aktakuza gjykata do të kumtojë, nëse:

- 1) vepra për të cilën akuzohet nuk është vepër penale në bazë të ligjit;
- 2) ka rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale dhe
- 3) prokurori publik ose paditësi nuk ka dëshmuar jashtë dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet.

Neni 404

Aktgjykimi dënues

(1) Në aktgjykimin në të cilën i akuzuari shpallet fajtor gjykata do të kumtojë:

- 1) për cilën vepër shpallet fajtor, me shënimin e fakteve dhe rrethanave që paraqesin karakteristikë të veprës penale, si dhe të atyre nga të cilët varet zbatimi i dispozitës së përcaktuar nga Kodi penal;
- 2) emrin ligjor i veprës penale dhe cilat dispozita nga Kodi penal janë zbatuar;
- 3) me çfarë dënimi dënohet i akuzuari ose lirohet nga dënimi në bazë të dispozitave të Kodit penal;
- 4) vendimin për masën alternative;
- 5) vendimin për masat e sigurisë, konfiskimit të pronës dhe dobisë pronësore dhe marrjen e sendeve;
- 6) vendimin për llogaritjen e privimit nga lira, paraburgimit ose të dënimit tanimë të mbajtur dhe
- 7) vendimin për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pronësore juridike, si dhe për atë se aktgjykimi i plotfuqishëm duhet të shpallet nëpërmjet shtypit, radios ose televizionit.

(2) Nëse i akuzuari është gjykuar me dënim në para, në aktgjykim do të shëndohet afati në të cilën duhet të paguhet dënimi me para dhe mënyra në të cilën kryhet zëvendësimi i dënimit në para në rast se dënimi me para nuk mund të arkëtohet as në mënyrë të detyrueshme.

3. Shpallja e aktgjyqimit

Neni 405

Shpallja e aktgjykimit

(1) Pasi që gjykata ta kumtojë aktgjykimin, kryetari i këshillit menjëherë do ta shpallë. Nëse gjykata nuk ka mundësi ta kumtojë aktgjykimin në ditën e njëjtë pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, do ta prolongojë shpalljen e aktgjykimit së paku për tri ditë dhe do ta caktojë kohën dhe vendin e shpalljes së aktgjykimit.

(2) Kryetari i këshillit në prani të palëve, përfaqësuesve të tij ligjorë, të autorizuarve dhe mbrojtësve, publikisht do ta lexojë shqiptimin dhe shkurtimisht do t'i kumtojë shkaqet e aktgjykimit .

(3) Shpallja do të kryhet dhe kur pala, përfaqësuesi ligjor, i autorizuar ose mbrojtësi nuk është i pranueshëm. Këshilli mund t'i urdhërojë që të akuzuarit nëse mungon, aktgjykimin t'ia kumtojë me gojë kryetari i këshillit ose aktgjykimin vetëm t'i dorëzohet.

(4) Nëse publiku në shqyrtimin kryesor ka qenë i përjashtuar, kumtimi i aktgjykimit çdoherë do të lexohet në seancën publike. Këshilli do të vendosë nëse dhe sa do ta përjashtojë publikun gjatë shpalljes së shkaqeve të aktgjykimit.

(5) Të gjithë të pranishmit leximin e kumtimit të aktgjykimit do ta dëgjojnë në këmbë.

Neni 406

Këshilla dhe paralajmërime

(1) Pas shpalljes së aktgjykimit, kryetari i këshillit do t'i këshillojë palët për të drejtën e ankesës, si dhe për të drejtën e përgjigjes së ankesës.

(2) Nëse të akuzuarit i është kumtuar dënimi me kusht, do të paralajmërohet nga kryetari për rëndësinë e dënimit me kusht dhe kushtet të cilëve doemos duhet t'u përmbahet.

(3) Kryetari i këshillit do t'i paralajmërojë palët që deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës për çdo ndryshim të adresës ta njoftojnë gjykatën.

4. Përpilimi me shkrim dhe dorëzimi i aktgjykimit

Neni 407

Përpilimi dhe dorëzimi i aktgjykimit

(1) Aktgjykimi që është shpallur doemos duhet të përpilohet në afat prej 15 ditësh pas shpalljes, ndërsa për lëndë të ndërlikuara me përjashtim në afat prej 60 ditësh, afate që nuk mund të tejkalohen.

(2) Aktgjykimin e nënshkruajnë kryetari i këshillit dhe mbajtësi i procesverbalit.

(3) Kopja e vërtetuar nga aktgjykimi do t'i dorëzohet paditësit, ndërsa të akuzuarit dhe mbrojtësit në pajtim me nenin 130 të këtij ligji. Nëse i akuzuari gjendet në paraburgim, kopjet e vërtetuara të aktgjykimit doemos duhen të dorëzohen në afatet e parapara në paragrafin (1) të këtij neni.

(4) Të akuzuarit, paditësit privat dhe të dëmtuarit do t'i dorëzohet edhe udhëzimi për të drejtën e ankesës.

(5) Kopjen e vërtetuar nga aktgjykimi, me udhëzim për të drejtën e ankesës, gjykata do të dorëzojë te dëmtuari, nëse ka të drejtë ankese, te personi lënda e të cilit është marrë me atë aktgjykim, si dhe te personi juridik

ndaj të cilit është kumtuar marrja e dobisë pronësore. Të dëmtuarit i cili nuk ka të drejtë ankese kopja nga aktgjykimit do t'i dorëzohet në rastin nga neni 63 paragrafi (2) të këtij ligji, me udhëzim për të drejtën që të kërkojë kthim në gjendjen e mëparshme. Aktgjykimi i plotfuqishëm do t'i dorëzohet të dëmtuarit nëse këtë ai e kërkon.

(6) Nëse gjykata me zbatimin e dispozitave për matjen e dënimit unik për vepra penale në varg ka kumtuar dënim, duke marrë parasysh edhe aktgjykimet që i kanë miratuar edhe gjykatat tjera, do të dorëzojë përshkrim të vërtetuar nga aktgjykimi i plotfuqishëm të ato gjykata.

Neni 408

Përmbajta e aktgjykimit të përpiluar me shkrim

(1) Aktgjykimi i përpiluar me shkrim doemos duhet plotësisht t'i përgjigjet aktgjykimit që është shpallur. Aktgjykimi doemos duhet të ketë hyrje, kumtim dhe arsyetim.

(2) Hyrja e aktgjykimit i përmban: shënimin se aktgjykimi kumtohet në emër të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, emërtimin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit dhe të mbajtësit të procesverbalit, emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit, veprën penale për të cilën është dënuar dhe a ka marrë pjesë në shqyrtimin kryesor, ditën e shqyrtimit kryesor dhe vallë shqyrtimi kryesor ka qenë publik, emrin dhe mbiemrin e paditësit, mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe të autorizuarit të cilët kanë qenë në shqyrtimin kryesor dhe ditën e shpalljes së aktgjykimit të kumtuar.

(3) Kumtimi i aktgjykimit i përmban të dhënat personale të të akuzuarit (neni 205 paragrafi (1)) dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për veprën për të cilën është akuzuar, ose me të cilin lirohet nga aktakuza për atë vepër ose me të cilin refuzohet aktakuza.

(4) Nëse i akuzuari është shpallur fajtor, kumtimi i aktgjykimit doemos duhet t'i përfshijë të dhënat e nevojshme të theksuara në nenin 404 të këtij ligji, nëse është liruar nga aktakuza ose nëse aktakuza është refuzuar, kumtimi i aktgjykimit doemos duhet ta përfshijë përshkrimin e veprës për të cilën është i akuzuar dhe vendimin për shpenzimet e procedurës penale dhe për kërkesën pronësore-juridike, nëse është paraqitur.

(5) Në rast të bashkimit të veprave penale gjykata në kumtimin e aktvendimit do t'i fusë dënimet e përcaktuara për çdo vepër penale veças, e pastaj dënimin që është kumtuar për të gjitha veprat në varg.

(6) Në arsyetim të aktgjykimit gjykata do t'i nxjerrë shkaqet për çdo pikë nga kumtimi, e veçanërisht faktet që i vlerëson si të dëshmuara ose jo të dëshmuara, nga cilat prova i ka vërtetuar ato fakte, nga cilat shkaqe nuk i ka pranuar propozimet e caktuara të palëve, nga cilat shkaqet është udhëhequr gjatë zgjidhjes së çështjeve juridike dhe cilat rrethana i ka marrë parasysh gjatë përcaktimit të dënimit.

(7) Nëse i akuzuari lirohet nga akuzat, në arsyetim veçanërisht do të theksohet nga cilat shkaqe të parapara në nenin 403 të këtij ligji bëhet kjo.

(8) Në arsyetimin e aktgjykimit me të cilin refuzohet aktakuza, gjykata nuk do të lëshohet në vlerësimin e punës kryesore, por do të kufizohet vetëm në shkaqet për refuzimin e aktakuzës.

(9) Palët dhe i dëmtuari mundën ta mohojnë të drejtën e ankesës menjëherë pas shpalljes së aktvendimit. Në këtë rast përshkrimi i aktgjykimit do t'i dorëzohet palës dhe të dëmtuarit vetëm nëse këtë e kërkojnë. Nëse të

dyja palët dhe i dëmtuari pas shpalljes së aktgjykimit kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës dhe nëse asnjëri prej tyre nuk ka e kërkuar dorëzimin e aktgjykimit, aktgjykimi i përpiluar me shkrim nuk është e domosdoshme që të përmbajë arsyetim.

Neni 409

Gabime në aktgjykim

(1) Gabimet në emrat dhe numrat, si dhe gabime tjera të dukshme në shkrim dhe llogaritje, mungesat në formë dhe mospërputhja e aktgjykimit të përpiluar me shkrim me origjinalin, do t'i përmirësojë me aktvendim të posaçëm kryetari i këshillit, me kërkesë nga palët ose sipas detyrës zyrtare.

(2) Nëse ekziston mospërputhshmëri ndërmjet aktgjykimit të përpiluar me shkrim dhe origjinalit të tij në pikëpamje të të dhënave nga neni 404 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7 të këtij ligji, aktvendimi për përmirësimin do t'u dorëzohet personave të përmendur në nenin 407 të këtij ligji. Në këtë rast afati për ankesë kundër aktgjykimit rrjedh nga dita e dorëzimit të atij aktvendimi kundër të cilit nuk lejohet ankesë e posaçme.

SEKSIONI G. KËSHILLA JURIDIKE

Kreu XXVI

KËSHILLA TË RREGULLTA JURIDIKE

1. Ankesa në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë

Neni 410

E drejta e ankesës dhe afati për parashtrim

(1) Kundër aktgjykimit të miratuar në shkallë të parë, personat e autorizuar mund të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes nga aktgjykimi.

(2) Ankesa e parashtruar në kohë nga personi i autorizuar e prolongon zbatimin e aktgjykimit.

Neni 411

Subjekte të cilat mund të parashtrojnë ankesë

(1) Ankesë mund të parashtrojnë palët, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit dhe të dëmtuarit.

(2) Në interes të të akuzuarit ankesë mund të parashtrojnë bashkëshorti, përkatësisht bashkëshorti jashtëmartesor, farefisi nga gjaku në vijë të drejt, adaptuesi, i adoptuari, vëllai, motra dhe mbajtësi. Afati për ankesë edhe në këtë rast rrjedh nga dita kur të akuzuarit, përkatësisht mbrojtësit të tij i është dorëzuar kopja e aktgjykimit.

(3) Prokurori publik mund të parashtrojë ankesë si në dëm ashtu edhe në dobi të të akuzuarit.

(4) I dëmtuari mund ta përgënjeshtrojë aktgjykimin lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës penale, e nëse gjykuar kërkesa pronësore-juridike dhe në atë pjesë.

(5) Ankesë mund të parashtrojë edhe personi sendi i të cilit është marrë ose nga i cili është konfiskuar prona ose interesi pronësor i fituar me

vepër penale, si dhe personi juridik të cilit i është kumtuar konfiskimi i përfitimit pronësor.

(6) Mbrojtësi dhe personat nga paragrafi (2) i këtij neni, mundën të parashtrorjnë ankesë dhe pa autorizim të veçantë nga i akuzuari, por jo edhe kundër vullnetin të tij.

Neni 412

Tërheqja dhe heqja dorë nga e drejta e ankesës

(1) I akuzuari mund të heq dorë nga drejta e ankesës vetëm pas dorëzimit të aktgjykimit. I akuzuari edhe para kësaj mund të heq dorë nga e drejta e ankesës, nëse paditësi dhe i dëmtuari kur kanë të drejtë të parashtrorjnë ankesë nga të gjitha bazat (neni 407 paragrafi (4)) kanë heqë dorë nga e drejta e ankesës, vetëm nëse i akuzuari në bazë të aktgjykimit do të duhet të vuajë dënimin me burgim. Deri në miratimin e vendimit të gjykatës së shkallës së dytë, i akuzuari mund të heq dorë nga ankesa tanimë e parashtruar. I akuzuari mund të heq dorë edhe nga ankesa që e ka parashtruar mbrojtësi i tij ose personat e theksuar në nenin 411 paragrafi (2) i këtij ligji.

(2) Paditësi dhe i dëmtuari mundën të heqin dorë nga e drejta e ankesës në momentin e shpalljes së aktgjykimit e deri në skadimin e afatit për parashtrimin e ankesës, ndërsa mundën deri në miratimin e vendimit të shkallës së dytë të heqin dorë nga ankesa tanimë e deklaruar.

(3) Tërheqja dhe heqja dorë nga ankesa nuk mund të revokohen.

Neni 413

Përmbajtja e ankesës

(1) Ankesa duhet të përmbajë:

- 1) shënimin e aktgjykimit kundër të së cilit parashtrorhet ankesa;
- 2) bazën për përgënjeshttrimin e aktgjykimit;
- 3) arsyetimin e ankesës;
- 4) propozimi përgënjeshttrimin e aktgjykimit që plotësisht ose pjesërisht të abrogohet ose ndryshohet dhe
- 5) nënshkrimin e personit që parashtron ankesë.

(2) Nëse ankesë ka deklaruar i akuzuari ose personi tjetër nga neni 411 paragrafi (2) të këtij ligji, ndërsa i akuzuari nuk ka mbrojtës, ose nëse ankesë ka deklaruar i dëmtuari, ose paditësi privat i cili nuk ka të autorizuar, e ankesa nuk është e përpiluar në pajtim me dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni, gjykata e shkallës së parë do ta thirrë ankuesin ta plotësojë ankesën në afat të caktuar me parashtrësë me shkrim ose në procesverbal në atë gjykatë. Nëse ankuesi nuk lajmërohet në këtë ftesë, gjykata do ta hedh poshtë anesën kur nuk i mban të dhënat nga paragrafi (1) pikat 2, 3 dhe 5 të këtij neni, e nëse ankesa nuk i përmban të dhënat nga paragrafi (1) pika 1, të këtij neni do të hidhet poshtë kur nuk mund të përcaktohet për cilin aktgjykim ka të bëjë. Nëse ankesa është deklaruar në interes të akuzuarit gjykata do t'ia dorëzoj gjykatës së shkallës së dytë kur mund të vërtetohet për cilin aktgjykim ka të bëjë, ndërsa nëse ajo nuk mund të vërtetohet do ta hedh poshtë ankesën.

(3) Nëse ankesë ka parashtruar i dëmtuari ose paditësi privat i cili ka të autorizuar ose prokurori publik, e ankesa nuk i përmban të dhënat nga paragrafi (1) pikat 2, 3 dhe 5 të këtij neni ose nëse ankesa nuk e përmban të dhënën nga paragrafi (1) pika 1, të këtij neni, e nuk mund të vërtetohet për

cilin aktgjykim ka të bëjë, gjykata do ta hedhë poshtë ankesën. Ankesën me këto mungesa e parashtruar në interes të të akuzuarit i cili ka mbrojtës, gjykata do t'ia dorëzojë gjykatës së shkallës së dytë nëse mund të vërtetohet për cilin aktgjykim ka të bëjë, e nëse kjo nuk mund të vërtetohet gjykata do ta hedhë poshtë ankesën.

(4) Në ankesë nuk guxon të përmenden fakte të reja ose prova të reja përveç atyre për të cilat palët do të dëshmojnë se nuk kanë mundur t'i nxjerrin deri në përfundimin e procedurës së provave gjatë shqyrtimit kryesor meqenëse nuk i kanë mundur t'i dijnë apo t'i marrin.

Neni 414

Baza për ankesë

Aktgjykimi mund të përgënjeshtrohet, për shkak të:

- 1) cenimit thelbësor të dispozitave të procedurës penale;
- 2) gjendjes faktike të përcaktuar gabimisht;
- 3) cenimit të Kodit penal dhe
- 4) vendimit për sanksione ndëshkuese, për konfiskimin e përfitimit pronësor, për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesat pronësore juridike, si dhe për shkak të vendimit për shpalljen e aktgjykimit nëpërmjet shtypit, radios ose televizionit.

Neni 415

Cenimi thelbësor i dispozitave të procedurës penale

Cenim thelbësor i dispozitave të procedurës penale, ekziston nëse:

- 1) gjykata ka qenë i përbërë në mënyrë të parregullt, ose nëse në kumtimin e aktgjykimit ka marrë pjesë gjykatësi ose gjykatësi-porotë i cili nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin kryesor ose i cili me vendim të plotfuqishëm është përjashtuar nga gjykimi;
- 2) në seancën kryesore ka marrë pjesë gjykatësi ose gjykatësi-porotë i cili doemos është dashur të përjashtohet (neni 33 pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5);
- 3) shqyrtimi kryesor është mbajtur pa personin prania e të cilit në shqyrtimin kryesor është e detyrueshme sipas ligjit;
- 4) në kundërshtim me ligjin, publiku ka qenë i përjashtuar në shqyrtimin kryesor;
- 5) janë cenuar dispozitat e procedurës penale për çështjen nëse ekziston aktakuzë nga paditësi i autorizuar ose propozim nga i dëmtuari, përkatësisht leje nga organi kompetent;
- 6) aktgjykimin e ka miratuar gjykata e cila sipas kompetencës reale nuk ka mundur të gjykojë në atë lëndë ose nëse gjykata në mënyrë të parregullt e ka refuzuar aktakuzën për arsye të jokompetencës reale;
- 7) gjykata me aktgjykimin e vet nuk e ka zgjidhur plotësisht lëndën e aktakuzës;
- 8) aktgjykimi mbështetet në dëshmi në të cilën sipas dispozitave të këtij ligji nuk mund të bazohet aktgjykimi, përveç nëse duke pasur parasysh provat e tjera është e qartë se edhe pa atë provë do të ishte miratuar aktgjykimi i njëjtë;
- 9) aktakuza është tejkaluar (neni 398 paragrafi (1));
- 10) me aktgjykimin është cenuar dispozita e nenit 428 të këtij ligji;

11) aktgjykimi është i paqartë dhe kundërthënës me vet atë ose në të nuk janë përmendur shkaqet për faktet ose provat vendimtare të nxjerra në shqyrtimin kryesor, ose

12) gjykata i ka cenuar i ka cenuar dispozitat për përdorimin e gjuhës në procedurën e përcaktuar me këtë ligj.

(2) Cenim thelbësor i dispozitave të procedurës penale ekziston edhe kur gjykata derisa e ka përgatitur shqyrtimin kryesor ose gjatë shqyrtimit kryesor ose gjatë marrjes së aktgjykimit, nuk e ka zbatuar ose ka zbatuar në mënyrë të parregullt ndonjë dispozitë të këtij ligji, nëse kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë mbi ligjshmërinë dhe rregullsinë e marrjes së aktgjykimit.

(3) Cenim thelbësor i dispozitave të procedurës penale ekziston edhe nëse janë të shkelura të drejtat e mbrojtjes, dhe ajo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë mbi ligjshmërinë dhe miratimin e rregullt të aktgjykimit ose të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë.

Neni 416

Cenimi i Kodit penal

Cenimi i Kodit penal ekziston, nëse:

1) vepra për të cilën ndiqet i akuzuari nuk është vepër penale;
2) ka rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
3) ka rrethana që e përjashtojnë ndjekjen penale, e veçanërisht nëse ndodh parashkrimi i ndjekjes penale ose ndjekja është përjashtuar për arsye të amnistisë ose faljes, ose puna tanimë është gjykuar në mënyrë të plotfuqishme;

4) lidhur me veprën penale që është lëndë e aktakuzës është zbatuar ligji që nuk mund të zbatohet;

5) me vendimin për dënim, për dënim me kusht ose vërejtje gjyqësore, përkatësisht me vendimin për masën e sigurisë, ose për konfiskimin e dobisë pronësore, është tejkalluar autorizimi që e posedon gjykata sipas ligjit dhe

6) janë cenuar dispozitat për llogaritjen e paraburgimit, si dhe të çdo privimi nga lira lidhur me veprën penale dhe të dënimit të mbajtur.

Neni 417

Gjendja faktike e vërtetuar gabimisht

(1) Aktgjykimi mund të përgënjeshtrohet për shkak të gjendjes faktike të vërtetuar gabimisht, kur ndonjë fakt vendimtar gabimisht është vërtetuar, ose nuk është vërtetuar.

(2) Gjendja faktike e vërtetuar gabimisht ekziston edhe kur në atë tregojnë faktet e reja ose dëshmitë e reja sipas nenit 413 paragrafi (4) i këtij ligji.

Neni 418

Vendimi për dënimin, gjykimi i kushtëzuar dhe vërejtja gjyqësore, për masën e sigurisë ose konfiskimin e dobisë pronësore dhe shpallja e aktgjykimit

(1) Aktgjykimi përkatësisht aktvendimi për vërejte gjyqësore mund të përgënjeshtrohet për shkak të vendimit për dënim, dënimin me kusht dhe vërejtjes gjyqësore, kur me këtë vendim nuk është tejkaluar autorizimi ligjor (neni 416 pika 5), por gjykata nuk e ka matur drejt dënimin duke pasur parasysh rrethanat që ndikojnë dënimin të jetë më i madh ose më i vogël dhe për shkak se gjykata i ka zbatuar ose nuk i ka zbatuar dispozitat për lehtësimin e dënimin, për lirimin nga dënimin, për dënim me kusht, ose për vërejtje gjyqësore, edhe pse për këtë kanë ekzistuar kushte ligjore.

(2) Vendimi për masën e sigurisë ose konfiskimin e dobisë pronësore mund të përgënjeshtrohet nëse nuk ekziston cenim i ligjit nga neni 416 pika 5, të këtij ligji, por gjykata në mënyrë të padrejtë e ka marrë këtë vendim ose nuk e ka kumtuar masën e sigurisë, përkatësisht konfiskimin e dobisë pronësore, edhe pse për këtë kanë ekzistuar kushte ligjore. Nga të njëjtat arsye mund të përgënjeshtrohet vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

(3) Vendimi për shpalljen e aktgjykimit nëpërmjet shtypit, radios ose televizionit mund të përgënjeshtrohet, kur gjykata për këto çështje ka miratuar vendim në kundërshtim me dispozitat ligjore.

2. Procedura ndaj ankesës

Neni 419

Parashtrimi i ankesës

(1) Ankesa parashtrohet te gjykata që e ka kumtuar aktgjykimin e shkallës së parë në ekzemplarë të mjaftueshëm për gjykatën, si dhe për palën kundërshtare dhe për mbrojtësin për dhënien e përgjigjes.

(2) Ankesën jo me kohë (neni 410) dhe të palejuar (neni 411) do ta hedh poshtë me aktvendim kryetari i këshillit të gjykatës së shkallës së parë.

Neni 420

Përgjigjja ndaj ankesës

(1) Një ekzemplar nga ankesa, gjykata e shkallës së parë pa prolongim e dorëzon te pala e kundërshtare (nenet 130 dhe 131), e cila në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të ankesës, mund të parashtrorë te gjykata përgjigje ndaj ankesës.

(2) Ankesën dhe përgjigjen ndaj ankesës me të gjitha shkresat, gjykata e shkallës së parë në afat prej tri ditësh nga pranimit i përgjigjes ndaj ankesës, përkatësisht pas skadimit të afatit për parashtrimin e përgjigjes ndaj ankesës, do t'i dorëzojë te gjykata e shkallës së dytë.

Neni 421

Gjykatësi referues

(1) Kur shkresat e ankesës do të arrijnë në gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej tri ditësh nga pranimit i shkresave caktohet gjykatësi referues. Nëse është fjala vepër penale për të cilën ndiqet me kërkesë nga prokurori publik, gjykatësi referues pa prolongim do t'i dërgojë shkresat te prokurori publik kompetent, i cili është i obliguar që t'i shqyrtojë dhe pa prolongim ose më së voni në afat prej 15 ditëve, e të lëndët më të ndërlikuara më së voni në afat prej 30 ditëve, t'ia kthejë gjykatës.

(2) Prokurori publik, duke i kthyer shkresat, do të dorëzoj propozim me shkrim në gjykatë ose do ta njoftoj gjykatën se do të paraqesë propozim me shkrim në seancën këshillit.

(3) Për seancën e këshillit do të njoftohet prokurori publik dhe ai i akuzuar dhe mbrojtësi i tij, ose paditësi privat i cili në afatin e paraparë për ankesë ose për përgjigje ndaj ankesës, ka kërkuar që të njoftohet për seancën ose të propozojë mbajtjen e debatit para gjykatës së shkallës së dytë.

(4) Seanca e këshillit në gjykatën e shkallës së dytë është publike, me kërkesë të palëve për vepër penale për të cilën mund të kumtohet dënim me burgim mbi pesë vite.

(5) Gjykatësi referues mundet sipas nevojës nga gjykata e shkallës së parë të marrë raport për shkeljen e dispozitave të procedurës penale, ndërsa mundet përmes asaj gjykate ose përmes gjykatësit të procedurës paraprake të gjykatës në rajonin e të cilit duhet të kryhet veprimi ose në mënyrë tjetër t'i kontrollojë konstatimet në ankesë lidhur me provat dhe faktet e reja, ose nga organet tjera ose persona juridikë të marrë raporte ose shkresa të nevojshme. Gjykata e shkallës së parë, përkatësisht prokurori publik kompetent që e ka udhëhequr procedurën hetimore nga i cili gjykatësi referues kërkon raporte ose ndërmarrjen e veprimeve, janë të detyruar që të veprojnë për kërkesën e atillë në afat i cili nuk i tejkalon 30 ditë.

(6) Nëse gjykatësi referues vërteton se në shkresat gjenden procesverbalet dhe njoftimet e parapara në nenin 93 të këtij ligji, shkresat pa prolongim do t'i dorëzojë deri në gjykatën e shkallës së parë para mbajtjes së seancës në këshillin e shkallës së dytë, që kryetari i shkallës së parë të marrë aktvendim për ndarjen e tyre nga shkresat dhe pas plotfuqishmërisë së aktvendimit, në mbështjellës të mbyllur t'ia dorëzojë gjykatësit të procedurës paraprake për ruajtje ndaras nga shkresat tjera.

Neni 422

Mbledhja e Këshillit

(1) Nëse i akuzuari është në paraburgim ose në vuajtjen e dënimit, e ka mbrojtës, do të sigurohet prania e të akuzuarit vetëm nëse kryetari i këshillit ose këshilli konstaton se ajo është në përputhje të plotë.

(2) Seanca e këshillit fillon me raportin e gjykatësit referues për gjendjen e punës. Pastaj parashtruesi i ankesës e arsyetoi ankesën, ndërsa pas tij fjalën e merr pala e kundërt që t'i përgjigjet konstatimeve në ankesë, përkatësisht në përgjigjen e ankesës, duke mos e përsëritur atë që është përmbajtur në raport, e për plotësimin e raportit mund të kërkohej që të lexohen shkresa të veçanta.

(3) Mosardhja e palëve që janë njoftuar në mënyrë të rregullt nuk e pengon mbajtjen e seancës së këshillit. Nëse i akuzuari nuk e njofton gjykatën për ndryshimin e vendbanimit përkatësisht vendqëndrimit, seanca e këshillit mund të mbahet edhe pse i akuzuari është njoftuar për seancën.

(4) Në seancë të këshillit në të cilën marrin pjesë palët, publiku mund të përjashtohet vetëm nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj, në pajtim me nenet 353, 354, 355 dhe 356 të këtij ligji.

(5) Procesverbali i seancës së këshillit i bashkëngjitet shkresave të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë.

(6) Aktvendimet nga nenet 432 dhe 433 të këtij ligji, mund të miratohen edhe pa njoftimin e palëve për seancën e këshillit.

Neni 423

Vendimmarrja në gjykatën e shkallës së dytë

(1) Gjykata e shkallës së dytë merr vendim në seancën e këshillit ose në bazë të debatit të mbajtur.

(2) Në mbledhje të këshillit të mbajtur sipas nenit 422 të këtij ligji, nëse këshilli vlerëson se do të mbahet debati, ajo caktohet më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita kur është mbajtur seanca e këshillit.

Neni 424

Mbajtja e shqyrtimit para këshillit të gjykatës së shkallës së dytë

(1) Debati para këshillit të gjykatës së shkallës së dytë do të mbahet, nëse:

1) vërtetohet se ekziston shkelje thelbësore e dispozitave të procedurës penale nga neni 415 paragrafi (1) i këtij ligji, që sipas vlerësimit të këshillit mund të tejkalohet me mbajtjen e seancës kryesore, ose

2) vërtetohet se ekziston gjendja faktike e vërtetuar gabimisht gjatë procedurës së shkallës së parë, ose kur faktet dhe provat e reja për herë të parë të deklaruar në ankesë janë vlerësuar si të lejueshme.

(2) Dispozitat që kanë të bëjnë me seancën kryesore në procedurën e shkallës së parë në mënyrë përkatëse zbatohen dhe në debatin para këshillit të gjykatës së shkallës së dytë, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Në shqyrtimin para gjykatës së shkallës së dytë thirren i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, paditësi, i dëmtuari, përfaqësuesit ligjorë dhe të autorizuarit e të dëmtuarit dhe paditësit privat, si dhe dëshmitarët dhe ekspertët për të cilët gjykata do të vendosë që të merren në pyetje.

(4) Në seancë nxirren prova të cilat nuk kanë qenë të njohura ose të kapshme gjatë procedurës së shkallës së parë, si dhe të ato për të cilat këshilli do të vlerësojë se janë të nevojshme të nxirren për arsye të përcaktimit të gjendjes faktike.

Neni 425

Rrjedha e shqyrtimit para këshillit të gjykatës së shkallës së dytë

(1) Shqyrtimi para gjykatës së shkallës së dytë fillon me raportin e gjykatësit referues i cili i ekspozon gjendjen e punëve, pa dhënë mendim të vetin për bazueshmërinë e ankesës.

(2) Pas propozimit ose me detyrë zyrtare do të lexohet aktgjykimi ose pjesa e aktgjykimit për të cilin ka të bëjë ankesa, e sipas nevojës edhe procesverbali për seancën kryesore.

(3) Pastaj thirret parashtruesi i ankesës që ta arsyetojë ankesën, e pas tij e merr fjalën pala e kundërt, që t'i përgjigjet konstatimeve të ankesës. I akuzuari dhe mbrojtësi i tij çdoherë e mbajnë fjalën e fundit.

(4) Paditësi mundet, duke pasur parasysh rezultatin nga seanca, në tërësi ose pjesërisht të heq dorë nga aktakuza ose ta ndryshojë aktakuzën në interes të të akuzuarit.

Neni 426

Miratimi i aktgjykimit nga këshilli i shkallës së dytë

(1) Pas seancës së mbajtur, këshilli i gjykatës së shkallës së dytë do të marrë aktgjykim sipas dispozitave nga nenet 434 deri në 437 të këtij ligji.

(2) Lidhur me përpilimin me shkrim të aktgjykimit, këshilli i gjykatës së shkallës së dytë lidhet me afatet e parapara në nenin 407 të këtij ligji.

(3) Gjatë kumtimit të aktgjykimit këshilli lidhet me ndalimin e përcaktuar në nenin 430 të këtij ligji.

(4) Nëse i akuzuari është në paraburgim, këshilli detyrohet që të veprojë sipas nenit 438 paragrafi (3) të këtij ligji.

Neni 427

Kufijtë e marrjes në pyetje në aktgjykimin e shkallës së parë

(1) Gjykata e shkallës së dytë e shqyrton aktgjykimin në atë pjesë në të cilën hidhet poshtë me ankesë, por çdoherë doemos duhet që sipas detyrës zyrtare të hetojë:

1) nëse ekziston shkelje të dispozitave në procedurën penale nga neni 415 paragrafi (1) pikat 1, 5, 6, 8, 9, 10 dhe 11 të këtij ligji dhe nëse seanca kryesore në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, është mbajtur në mungesë të të akuzuarit, e në rast të mbrojtjes së detyrueshme edhe në mungesë të mbrojtësit të të akuzuarit dhe

2) nëse në dëm të të akuzuarit është shkelur Kodi penal (neni 416).

(2) Nëse ankesa e parashtruar në interes të të akuzuarit nuk i përmban të dhënat nga neni 413 paragrafi (1) pikat 2 dhe 3 të këtij ligji, gjykata e shkallës së dytë do të kufizohet me marrjen në pyetje të shkeljeve nga paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij neni, si dhe shqyrtimin e vendimit për dënimin, për masat e sigurisë dhe për konfiskimin e dobisë pronësore (neni 418 i këtij ligji).

(3) Për shkeljen e ligjit nga neni 415 paragrafi (1) pika 2 e këtij ligji, ankuesi mund të thirret në ankesë vetëm nëse atë shkelje nuk ka mundur ta nxjerrë në seancën kryesore ose e ka nxjerrë, por gjykata e shkallës së dytë nuk e ka marrë parasysh.

Neni 428

Ndalimi për ndryshim në të keq

Nëse është paraqitur ankesë vetëm në interes të të akuzuarit, aktgjykimi nuk guxon të ndryshohet në dëm të tij, lidhur me vlerësimin juridik të veprës dhe sanksionin kundërvajtës.

Neni 429

Veprimi i zgjeruar i ankesës

Ankesa për shkak të gjendjes faktike të vërtetuar gabimisht ose për shkak të shkeljes së Kodit penal e paraqitur në interes të të akuzuarit, përmban në vete edhe ankesë për shkak të vendimit për sanksion kundërvajtës dhe për konfiskimin e dobisë pronësore (neni 418).

Neni 430

Privilegji i bashkimit (*Benefixium cohaesionis*)

Nëse gjykata e shkallës së dytë me rastin e cilësdo ankesë vërteton se shkaqet për të cilat e ka marrë vendimin në interes të të akuzuarit janë të interes dhe për ndonjë nga të bashkakuzuarit që nuk ka parashtruar ankesë ose nuk e ka parashtruar në atë drejtim, do të veprojë sipas detyrës zyrtare sikur të ekzistojë ankesë e atillë.

Neni 431

Vendime të gjykatës së shkallës së dytë ndaj ankesës

(1) Gjukata e shkallës së dytë në seancën e këshillit mund ta hedh poshtë ankesën si jo me kohë ose si të palejueshme, ose ta refuzojë ankesën si të pabazë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e shkallës së parë, ose ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë, ose ta anulojë për shkak të shkeljeve thelbësore dhe ta kthejë lëndën për vendimmarrje të sërishme ose ta abrogojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe të mbajë seancë.

(2) Për të gjitha ankesat kundër të njëjtit aktgjykim, gjykata e shkallës së parë vendos me një vendim.

(3) Në arsyetimin e aktgjykimit përkatësisht aktvendimit, gjykata e shkallës së dytë doemos duhet t'i vlerësojë konstatimet e ankesës dhe t'i paraqesë shkeljet e ligjit që i ka marrë parasysh sipas detyrës zyrtare.

Neni 432

Hedhja poshtë e ankesës si jo me kohë

Ankesa do të hidhet poshtë me aktvendim si jo me kohë nëse vërtetohet se nuk është parashtruar në afatin ligjor.

Neni 433

Hedhja poshtë e ankesës si e palejueshme

Ankesa do të hidhet poshtë me aktvendim si e palejueshme nëse vërtetohet se ankesën e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar që të parashtrorë ankesë, ose personi i cili ka heq dorë nga ankesa, ose nëse vërtetohet se ka heq dorë nga ankesa ose pas heqjes dorë nga ankesa përsëri ka paraqitur ankesë, ose nëse sipas ligjit nuk lejohet ankesë.

Neni 434

Refuzimi i ankesës si e pabazë

Gjukata e shkallës së dytë me aktgjykim do ta refuzojë ankesën si të pabazë dhe do ta vërtetojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës e parë, kur do të vërtetojë se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat aktgjykimi përgënjeshtrohet, as që ekzistojnë shkelje të ligjit nga neni 427 paragrafi (1) të këtij ligji.

Neni 435

Ndryshimi i aktgjykimit

(1) Gjukata e shkallës së dytë duke e pranuar ankesën ose sipas detyrës zyrtare me aktgjykim do ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë, nëse vërteton se faktet vendimtare në aktgjykimin e shkallës së parë në mënyrë të drejtë janë përcaktuar dhe se duke e marrë parasysh gjendjen e përcaktuar faktike, me zbatimin e rregullt të ligjit duhet të miratohet aktgjykim

më ndryshe, e sipas gjendjes së punëve dhe në rast të shkeljeve nga neni 415 paragrafi (1) pikat 5, 9 dhe 10 të këtij ligji.

(2) Nëse gjykata e shkallës së dytë konstaton se ekzistojnë kushte ligjore për kumtimin e vërejtjes gjyqësore, me aktvendim do ta ndryshojë aktgjykimin shkallës së parë dhe do të kumtojë vërejtje gjyqësore.

(3) Nëse për arsye të ndryshimit të aktgjyimit të shkallës së parë janë arritur kushtet që të përcaktohet, përkatësisht të anulohet paraburgimi në bazë të nenit 174 paragrafi (1) pika 5 dhe nenit 175 paragrafët (1) dhe (5) të këtij ligji, gjykata e shkallës së dytë për këtë do të marrë aktvendim të veçantë kundër të cilit nuk lejohet ankesë.

Neni 436

Anulimi për shkak të shkeljeve thelbësore

(1) Gjukata e shkallës së dytë, duke e miratuar ankesën ose sipas detyrës zyrtare me aktvendim do ta abrogojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe do ta kthejë lëndën në rigjykim, nëse vërtetohet se ekziston shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, përveç nëse nuk vendos të mbajë shqyrtim para gjykatës së shkallës së dytë.

(2) Gjukata e shkallës së dytë mund të urdhërojë që të mbahet seancë kryesore e re para gjykatës së shkallës së parë, para këshillit të ndryshuar plotësisht.

(3) Gjukata e shkallës së dytë mundet edhe vetëm pjesërisht ta abrogojë aktgjykimin e shkallës së parë, nëse pjesë të veçanta nga aktgjykimi mund të ndahen pa dëm për aktgjykimin e drejtë.

(4) Kur aktgjykimi i shkallës së parë abrogohet për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave në procedurën penale, në arsyetim duhet të përmendet cilat dispozita janë shkelur dhe në çfarë përbëhen shkeljet.

(5) Nëse i akuzuari gjendet në paraburgim, gjykata e shkallës së dytë do të hetojë nëse ekzistojnë ende shkaqet për paraburgim dhe do të marrë aktvendim për vazhdimin ose heqjen e paraburgimit. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

Neni 437

Abrogimi i aktgjyimit të shkallës së parë dhe mbajta e seancës

(1) Gjukata e shkallës së dytë, duke marrë parasysh ankesën ose sipas detyrës zyrtare me aktvendim do ta abrogojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe do të urdhërojë mbajtjen e shqyrtimit nëse nuk janë plotësuar rastet nga neni 424 të këtij ligji.

(2) Gjukata e shkallës së dytë mundet edhe vetëm pjesërisht ta abrogojë aktgjykimin e shkallës së parë, nëse pjesë të veçanta nga aktgjykimi mund të ndahen pa dëm për aktgjykimin e drejtë dhe lidhur me atë pjesë të mbajë shqyrtim.

(3) Nëse i akuzuari gjendet në paraburgim, gjykata e shkallës së dytë do të hetojë nëse ekzistojnë ende shkaqet për paraburgim dhe do të marrë aktvendim për vazhdimin ose abrogimin e paraburgimit. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

(4) Nëse aktgjykimi i ankimuar tanimë është abroguar, atëherë gjykata e shkallës së dytë do të mbajë shqyrtim dhe në mënyrë meritore do të vendosë për lëndën.

Neni 438

Kthimi i shkresave në gjykatën e shkallës së parë

(1) Gjykata e shkallës së dytë do t'ia kthejë të gjitha shkresat gjykatës së shkallës së parë me vendimin e tij në numër të mjaftueshëm të shkresave të vërtetuara, për t'ua dorëzuar palëve dhe personave tjerë të interesuar.

(2) Nëse i akuzuari është në paraburgim, gjykata e shkallës së dytë është e detyruar që vendimin me shkresat t'ia dorëzojë gjykatës së shkallës së parë më së voni në afat prej 45 ditëve, e në raste më specifike në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të shkresave nga prokurori publik.

3. Ankesa ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë

Neni 439

Lejueshmëria e ankesës

(1) Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë është e lejuar ankesë te gjykata që vendos në shkallë të tretë vetëm në këto raste:

1) nëse gjykata e shkallës së dytë ka kumtuar dënim me burgim të përjetshëm, ose nëse e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë me të cilin është kumtuar dënim i atillë;

2) nëse gjykata e shkallës së dytë ka miratuar aktgjykim në bazë të seancës së mbajtur dhe

3) nëse gjykata e shkallës së dytë e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë me të cilin i akuzuari është liruar nga aktakuza dhe ka kumtuar aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor.

(2) Për ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së dytë vendos gjykata e shkallës së tretë në seancë të këshillit, në pajtim me dispozitat që vlejné për procedurën e shkallës së dytë. Para kësaj gjykate nuk mund të mbahet shqyrtim.

(3) Dispozitat e nenit 435 të këtij ligji, do të zbatohen edhe ndaj të akuzuarit i cili nuk ka pasur të drejtë të paraqesë ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së dytë.

4. Ankesa ndaj aktvendimit

Neni 440

Lejueshmëria e ankesës kundër aktvendimit

(1) Kundër aktvendimit të gjykatës për procedurën paraprake dhe kundër aktvendimeve tjera të gjykatës të miratuara në shkallë të parë, palët dhe personat të drejtat e të cilëve janë shkelur, mund të parashtrajnë ankesë çdoherë kur në këtë ligj në mënyrë të prerë nuk është përcaktuar se ankesë e veçantë nuk është e lejuar.

(2) Kundër aktvendimit të këshillit nga neni 25 paragrafi (5) i këtij ligji, i miratuar para dhe gjatë hetimit, nuk është e lejuar ankesë e veçantë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Kur me këtë ligj është përcaktuar se nuk është e lejuar ankesë e veçantë, aktvendimi mund të hidhet poshtë me ankesë ndaj aktgjykimit.

(3) Aktvendimet që miratohen për përgatitjene seancës kryesore dhe aktgjykimet mund të hidhen poshtë vetëm nëse në ankesën e aktgjykimit.

Neni 441

Parashtrimi i ankesës

- (1) Ankesë parashtrohet te gjykata që e ka dorëzuar aktvendimin.
- (2) Ankesë ndaj aktvendimit parashtrohet në afat prej tri ditësh nga dita e parashtrimit të aktvendimit, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 442

Veprimi suspendues i ankesës

Nëse në këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, me parashtrimin e ankesës ndaj aktvendimit prolongohet zbatimi i aktvendimit kundër të cilit është parashtruar ankesë.

Neni 443

Organi kompetent për vendosje ndaj ankesës

- (1) Për ankesën kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë vendos gjykata e shkallës së dytë në seancën e këshillit, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.
- (2) Për ankesën kundër aktvendimit të gjykatësit për procedurën paraprake, vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) i këtij ligji, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.
- (3) Duke vendosur për ankesën gjykata mundet me aktvendim ta hedh poshtë ankesën si jo me kohë ose si të palejueshme, ta refuzojë ankesën si të pabazë, ose ta pranojë ankesën dhe aktvendimin ta ndryshojë ose shfuqizojë dhe sipas nevojës lëndën ta dërgojë për rivendosje.

Neni 444

Zbatimi përkatës i dispozitave për ankesë ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë

- (1) Në procedurë për ankesë ndaj aktvendimit në mënyrë përkatëse do të zbatohen dispozitat e neneve 411, 413, 419, 421 paragrafët (1), (4) dhe (5), nenit 427 paragrafi (1) pika 1, nenet 428 dhe 430 të këtij ligji.
- (2) Nëse ankesa është parashtruar kundër aktvendimit nga neni 522 të këtij ligji, për seancë të këshillit njoftohet prokurori publik, ndërsa personat e tjerë në kushtet e parapara në nenin 422 të këtij ligji.

Neni 445

Zbatimi përkatës i dispozitave ndaj ankesës së aktvendimit

Dispozitat e neneve 440 dhe 445 të këtij ligji, në mënyrë përkatëse do të zbatohen edhe ndaj të gjitha aktvendimeve tjera që miratohen sipas këtij ligji, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Kreu XXVII
MJETET E JASHTËZAKONSHME JURIDIKE

1. Përsëritja e procedurës penale

Neni 446

Dispozita e përgjithshme

Procedura penale që është kryer me aktvendim të plotfuqishëm ose me aktgjykim të plotfuqishëm, mundet me kërkesë të personit të autorizuar të përsëritet vetëm në rastet dhe kushtet e parapara me këtë ligj.

Neni 447

Ndryshimi i aktgjykimi të plotfuqishëm pa përsëritjen e procedurës

(1) Aktgjykimi i plotfuqishëm mund të ndryshojë pa përsëritjen e procedurës penale, nëse:

1) në dy apo në tepër aktgjykime kundër të njëjtit të dënuar në mënyrë të plotfuqishme janë kumtuar më tepër dënime, ndërsa nuk janë zbatuar dispozitat për matjen e dënimit të vetëm për vepra radhazi;

2) gjatë kumtimit të dënimit të vetëm me zbatimin e dispozitave për vepra radhazi është marrë si i përcaktuar dënimi që është përfshirë në dënimin e kumtuar sipas dispozitave për vepra radhazi në ndonjë aktgjykim të mëparshëm;

3) pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit do të paraqiten rrethana që nuk i kanë qenë kur është kumtuar aktgjykimi ose nuk kanë qenë të njohura edhe pse kanë ekzistuar, e ato qartazi do të sillnin në dënim më të butë;

4) aktgjykimi i plotfuqishëm me të cilin për më tepër vepra penale është kumtuar dënim i vetëm nuk do të mund të zbatohet në një pjesë për shkak të amnistisë, faljes ose shkaqeve tjera dhe

5) pas aktgjyimit të plotfuqishëm me të cilën i akuzuari është shpallur fajtor për veprën e vazhdueshme penale paraqiten persona tjerë të dëmtuar, gjykata e shkallës së parë do ta ndryshojë aktgjykimin në pjesën për kërkesën pronësore juridike, ndërsa procedura fillon me propozim të të dëmtuarve në afat prej tre muajsh nga dita e njoftimit për aktgjykimin.

(2) Në rastin nga paragrafi (1) pika 1 e këtij neni gjykata me aktgjykimin e ri do t'i ndryshojë aktgjykimet e mëparshme lidhur me vendimet për dënimin dhe do të kumtojë dënim të vetëm. Për miratimin e aktgjyimit të ri është kompetente gjykata e shkallës së parë që ka gjykuar në lëndën në të cilën është kumtuar lloji më i ashpër i dënimit, ndërsa të dënimet e llojit të njëjtë - gjykata që ka kumtuar dënim më të madh, e nëse dënimet janë të barabarta - gjykata që e fundit e ka kumtuar dënimin.

(3) Në rastin nga paragrafi (1) pika 2 e këtij neni do ta ndryshojë aktgjykimin e vet gjykata që gjatë kumtimit të dënimit të vetëm gabimisht e ka marrë parasysh dënimin që tanimë është përfshirë në ndonjë aktgjykim të mëparshëm.

(4) Në rastin nga paragrafi (1) pika 3 dhe 4 të këtij neni, gjykata që ka gjykuar në shkallën e parë do ta ndryshojë aktgjykimin e mëparshëm lidhur me dënimin dhe do të kumtojë dënim të ri ose do të përcaktojë sa do të vuhet nga dënimi i kumtuar me aktgjykim të mëparshëm.

(5) Aktgjykimin e ri e merr gjykata në seancën e këshillit, me propozim të prokurorit publik ose të të dënuarit, e pas marrjes në pyetje të palës së kundërt.

(6) Nëse në rastin nga paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij neni gjatë kumtimit të dënimit janë marrë parasysht edhe aktgjykime të gjykatave tjera, kopje e vërtetuar të aktgjykimit të ri të plotfuqishëm do të dorëzohet edhe te ato gjykata.

Neni 448

Vazhdimi i procedurës penale

(1) Nëse gjykata ka refuzuar që ta konfirmojë aktakuzën, kur para fillimit të seancës kryesore aktakuza është hedhur ose në mënyrë të plotfuqishme është refuzuar ose me aktvendim procedura është ndërprerë në mënyrë të plotfuqishme, me kërkesë të paditësit të autorizuar, mund të lejohet përsëritja e procedurës penale (neni 453 paragrafi (3)), nëse parashtrohen dëshmi të reja në bazë të cilave gjykata mund të bindet se janë arritur kushtet për ngritjen e sërishme të procedurës penale.

(2) Procedura penale në mënyrë të plotfuqishme e ndërprerë deri në fillimin seancës kryesore mund të përsëritet kur prokurori publik ka heq dorë nga ndjekja, nëse dëshmohet se heqja dorë ka ndodhur për shkak të kryerjes së veprës penale. Në pikëpamje të dëshmimit të veprës penale të prokurorit publik do të zbatohen dispozitat nga neni 450 paragrafi (2) i këtij ligji.

Neni 449

Përsëritja e procedurës në interes të të dënuarit

(1) Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm mund të përsëritet në interes të të dënuarit, nëse:

1) dëshmohet se aktgjykimi është bazuar në dokument të rrejshëm, incizimi vizuel-të zërit ose në dëshminë e rrejshme të dëshmitarit, ekspertit, interpretuesit ose përthyesit, përkatësisht interpretuesit;

2) nëse dëshmohet se te aktgjykimi ka ardhur për shkak të veprës penale të gjykatësit, të gjykatësit-porotë ose të personit i cili i ka kryer veprimet dëshmuese.

3) paraqiten fakte të reja ose parashtrohen dëshmi të reja që vetvetiu ose lidhur me provat e mëparshme janë të volitshme ta shkaktojnë lirimin e personit që ka qenë i dënuar ose dënimin e në bazë të ligjit më të butë penal;

4) ndonjë personi për vepër të njëjtë është dënuar më shumë herë, ose nëse më tepër persona të dënuar për vepër të njëjtë që ka mund ta kryejë vetëm një person ose ndonjëri prej tyre;

5) në rast të dënimit për vepër të vazhdueshme penale ose për vepër tjetër penale që sipas ligjit përfshin më tepër veprime të njëllota ose të ndryshme, nxirren fakte të reja ose parashtrohen dëshmi të reja që tregojnë se i dënuari nuk e ka kryer veprën që është përfshirë me veprën nga dënimi, ndërsa ekzistimi i këtyre fakteve do të ishte me ndikim qenësor mbi përcaktimin e dënimit;

6) me vendim të plotfuqishëm të gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut vërtetohet shkelja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore gjatë procedurës.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij neni me aktgjykim të plotfuqishëm duhet të dëshmohet se personat e përmendur janë shpallur

fajtorë për veprat përkatëse penale. Nëse procedura kundër këtyre personave nuk mund të zbatohet për arsye se kanë vdekur ose për shkak se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë ndjekjen penale, faktet nga paragrafi (1) pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni mund të vërtetohen edhe me dëshmi të tjera.

Neni 450

Përsëritja e procedurës në dëm të të dënuarit

Procedura penale në raste të veçanta mund të përsëritet në dëm të të dënuarit nëse aktgjykimi me të cilin aktakuza refuzohet është marrë për shkak të jokompetencës reale të gjykatës, ndërsa prokurori publik ka ngritur procedurë para gjykatës kompetente dhe me këtë rast e ka kërkuar përsëritjen e procedurës.

Neni 451

Personat e autorizuar që të parashtrijnë kërkesë për përsëritjen e procedurës

(1) Kërkesë për përsëritjen e procedurës penale mund të parashtrijnë palët dhe mbrojtësi, ndërsa pas vdekjes së të dënuarit kërkesë mund të parashtrijnë prokurori publik nëse procedura është mbajtur me kërkesë të tij ose të personat të përmendur në nenin 411 paragrafi (2) i këtij ligji.

(2) Kërkesë për përsëritjen e procedurës penale mund të parashtrihet edhe pasi që i dënuari e ka vuajtur dënimin pa marrë parasysh parashkrimin, amnistinë ose faljen.

(3) Nëse gjykata që do të ishte kompetente për vendosje për përsëritjen e procedurës penale (neni 452) njoftohet se ekziston arsye për përsëritjen e procedurës penale, do ta njoftojë për këtë të dënuarin, përkatësisht personin i cili është i autorizuar që ta parashtrijë kërkesën.

Neni 452

Gjykata e cila vendos për kërkesën dhe përmbajtja e kërkesës

(1) Për kërkesën për përsëritjen e procedurës penale vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) i këtij ligji, i gjykatës që në procedurën e mëparshme ka gjykuar në shkallën e parë.

(2) Në kërkesë doemos duhet të theksohet sipas cilës bazë ligjore kërkohet përsëritja dhe me cilat dëshmi mbështeten faktet në të cilat bazohet kërkesa. Nëse kërkesa nuk i përmban edhe këto të dhëna, gjykata do ta thirrë parashtruesin që në afatin e caktuar ta plotësojë kërkesën .

(3) Gjatë zgjidhjes së kërkesës, në këshill nuk do të marrë pjesë gjykatësi që ka marrë pjesë në miratimin e aktgjykimit në procedurën e mëparshme.

Neni 453

Vendosja për kërkesën për përsëritjen e procedurës

(1) Gjykata me aktvendim do ta hedh kërkesën nëse në bazë të vet kërkesës dhe të shkresave nga procedura e mëparshme, vërteton se kërkesën e ka parashtruar personi i paautorizuar ose nuk ka kushte ligjore për përsëritjen e procedurës, ose faktet dhe provat mbi të cilat bazohet kërkesa tanimë janë të paraqitur në kërkesën e mëparshme për përsëritjen e procedurës që është refuzuar me aktvendimin e plotfuqishëm të gjykatës, ose faktet dhe provat shihen qartë se nuk janë të përshtatshme që në bazë të tyre

që të lejohet përsëritja ose vërtetohet se bëhet fjalë për dokument të rrejshëm ose dëshmi të rrejshme të dëshmitarit ose ekspertit, ose parashtruesi i kërkesës nuk ka vepruar sipas nenit 452 paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Nëse gjykata nuk e hedh poshtë kërkesën, do të dorëzohet kopje e kërkesës te pala e kundërt e cila ka të drejtë që në afat prej tetë ditësh t'i përgjigjet kërkesës. Kur gjykatës do t'i arrijë përgjigjja ndaj kërkesës ose kur do të kalojë afati për dhënien e përgjigjes, kryetari i këshillit do të caktojë që të hetohen faktet dhe të grumbullohen provat në të cilat thirret në kërkesën dhe në përgjigjen ndaj kërkesës.

(3) Pas hetimeve të realizuara gjykata me aktvendim menjëherë do të vendosë për kërkesën për përsëritjen e procedurës sipas nenit 448 të këtij ligji. Në raste tjera, kur janë në pyetje vepra penale për të cilat ndiqet sipas detyrës zyrtare, kryetari i këshillit do të përcaktojë që shkresat të dërgohen te prokurori publik i cili pa prolongim do t'i kthejë shkresat me mendimin e vet.

Neni 454

Leja për përsëritjen e procedurës ose refuzimi i kërkesës për përsëritjen e procedurës

(1) Kur prokurori publik do t'i kthejë shkresat, nëse nuk përcakton që hetimi të plotësohet në bazë të rezultateve nga hetimi, gjykata do ta pranojë kërkesën dhe do ta lejojë përsëritjen e procedurës penale, ose do ta refuzojë kërkesën nëse provat e reja nuk janë të përshtatshme që të shpien në përsëritjen e procedurës penale.

(2) Nëse gjykata konstaton se shkaqet për të cilat ka lejuar përsëritjen e procedurës ekzistojnë edhe për ndonjë prej të bashkakuarve që nuk ka parashtruar kërkesë për përsëritjen e procedurës, do të veprojë sipas detyrës zyrtare sikur të ekzistojë kërkesë e atillë.

(3) Në aktvendim me të cilin lejohet përsëritja e procedurës penale gjykata do të vendos menjëherë që të caktohet seancë e re kryesore, ose lënda të kthehet në gjendje në procedurën hetimore, përkatësisht të zbatohet procedura hetimore nëse nuk ka pasur.

(4) Nëse gjykata konsideron, duke marrë parasysh provat e parashtruara, se i dënuari në procedurën e përsëritur mund dënohet me dënim të atillë që me llogaritjen e dënimit tanimë të mbajtur do të duhej të lëshohej në liri, ose mund të lirohet nga aktakuza ose aktakuza mund të refuzohet, do të përcaktojë që zbatimi i aktgjykimit të prolongohet përkatësisht të ndërpritet.

(5) Kur aktvendimi me të cilin lejohet përsëritja e procedurës penale do të bëhet i plotfuqishëm, do të ndërpritet zbatimi i dënimit, por gjykata me propozim të prokurorit publik do të përcaktojë paraburgim nëse ekzistojnë kushtet nga neni 165 të këtij ligji.

Neni 455

Rregullat për procedurën e re

(1) Për procedurën e re që udhëhiqet në bazë të aktvendimit me të cilin lejohet përsëritja e procedurës penale, vlejné dispozitat e njëjta si edhe për procedurën e parë. Në procedurën e re gjykata nuk është e lidhur për aktvendimet e miratuara në procedurën e mëparshme.

(2) Nëse procedura e re ndërpritet deri në fillimin e debatit kryesor, gjykata me aktvendimin për ndërprerjen e procedurës do ta anulojë edhe aktgjykimin e mëparshëm.

(3) Kur gjykata në procedurën e re miraton aktgjykim, do të shqiptojë se aktgjykimi i mëhershëm pjesërisht ose në tërësi shfuqizohet ose mbetet në fuqi. Në dënimin që do ta përcaktojë me aktgjykimin e ri gjykata të akuzuarit do t'ia llogarisë dënimin e mbajtur, e kur përsëritja është përcaktuar vetëm për ndonjërin nga veprat për të cilat i akuzuari ka qenë i dënuar, gjykata do të shqiptojë dënim të ri të vetëm sipas dispozitave të Kodit penal.

(4) Gjkata në procedurën e re lidhet për ndalimin e përcaktuar në nenin 428 të këtij ligji.

Neni 456

Përsëritja e procedurës së personit të dënuar në mungesë

(1) Procedura penale në të cilën ndonjë person është dënuar në mungesë (neni 365 të këtij ligji), e është krijuar mundësia që përsëri t'i gjykohet në prani të tij, do të përsëritet edhe jashtë kushteve të parapara në nenin 364 të këtij ligji, nëse i dënuari ose mbrojtësi i tij parashtron kërkesë për përsëritjen e procedurës në afat prej një viti nga dita kur i akuzuari është noftuar për aktgjykimin me të cilin është dënuar në mungesë.

(2) Jashtë rasteve të parapara në paragrafin (1) të këtij neni, gjykata në çdo rast do ta lejojë përsëritjen e procedurës nëse kundër personit të dënuar në mungesë rrjedh procedura për ekstradim dhe nëse shteti në të cilin gjendet personi, kërkon garanci se personit do t'i lejohet e drejta e rigjyimit në prani të tij.

(3) Në aktvendimin me të cilin lejohet përsëritja e procedurës penale sipas dispozitës nga paragrafi (1) të këtij neni gjykata do të përcaktojë që të akuzuarit t'i dorëzohet aktakuza, nëse më parë nuk i është dorëzuar, e mund të përcaktojë që lënda të kthehet në gjendjen e procedurës hetimore, përkatësisht të zbatohet procedurë hetuese nëse nuk e ka pasur.

(4) Gjkata nuk do të lejojë gjykim të përsëritur në mungesë të të akuzuarit të cilit i është pranuar kërkesa për përsëritje të procedurës për shkak të gjyimit në mungesë, nëse gjatë procedurës së përsëritur bëhet e pakapshëm për organet e ndjekjes.

2. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

Neni 457

Bazat për parashtrim

Kundër vendimeve të plotfuqishme gjyqësore Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë mund të parashtrorë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë nëse është shkelur Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, ligji ose marrëveshja e ratifikuar ndërkombëtare, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Neni 458

Vendosja për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimeve të plotfuqishme gjyqësore

(1) Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruar nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë sipas nenit 457 të këtij ligji, parashtrohet te Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë.

(2) Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë vendos në mbledhje.

(3) Para se lënda të paraqitet për zgjidhje, gjykatësi i përcaktuar për referues mundet, sipas nevojës, të marrë njoftim për shkeljet e theksuara të ligjit.

(4) Për mbledhjen përherë do të njoftohet prokurori publik.

Neni 459

Privilegji i shoqërimit (*Beneficium cohaesionis*) dhe ndalimi i ndryshimit për më keq

(1) Gjatë zgjidhjes për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjykata do të kufizohet vetëm në hetimin e shkeljes së ligjit në të cilën thirret parashtruesi në kërkesën e vet.

(2) Nëse gjykata konstaton se shkaqet për të cilat e ka miratuar vendimin në dobi të të akuzuarit ekzistojnë edhe për ndonjë nga të bashkëgjykuarit për të cilët nuk është ngritur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, do të veprojë me detyrë zyrtare sikur të ekzistojë kërkesë e atillë.

(3) Nëse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është ngritur në dobi të të akuzuarit, gjykata gjatë miratimit të vendimit lidhet me ndalimin e përcaktuar në nenin 428 të këtij ligji.

Neni 460

Hedhja poshtë përkatësisht refuzimi i kërkesës

(1) Nëse prokurori publik e tërheq kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjykata me aktvendim do ta hedh poshtë kërkesën.

(2) Gjykata me aktgjykim do ta refuzojë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazë, nëse vërteton se nuk ekziston shkelje e ligjit në të cilin thirret prokurori publik në kërkesën e vet.

Neni 461

Vlerësimi i kërkesës si e bazuar

(1) Kur gjykata do të përcaktojë se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, do të miratojë aktgjykim me të cilin sipas natyrës së shkeljes, ose do ta ndryshojë vendimin e plotfuqishëm, ose do t'i abrogojë në tërësi ose pjesërisht vendimet e shkallës së parë dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më të lartë dhe lëndën do ta kthejë në vendim ose gjykim të sërishëm në gjykatën e shkallës së parë ose te gjykata më e lartë, ose do të kufizohet vetëm në atë që ta përcaktojë shkeljen e ligjit.

(2) Nëse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është parashtruar në dëm të të dënuarit, e gjykata do të konstatojë se është e bazuar, do të përcaktojë vetëm se ekziston shkelje e ligjit, duke mos prekur në vendimin e plotfuqishëm.

(3) Nëse gjykata e shkallës së dytë sipas dispozitave të këtij ligji nuk ka qenë e autorizuar që ta mënjojë shkeljen e ligjit që është kryer në vendimin

e shkallës së parë ose në procedurën gjyqësore që i ka paraprirë, e gjykata që vendos për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ngritur në dobi të të akuzuarit do të konstatojë se kërkesa është e bazuar dhe se për mënjanimin e shkëljes së bërë të ligjit duhet të anulohet ose të ndryshohet vendimi i shkallës së parë, do ta anulojë ose do ta ndryshojë edhe vendimin e shkallës së dytë edhe pse me të nuk është shkelur ligji.

Neni 462

Rregullat e procedurës së re

(1) Nëse aktgjykimi i plotfuqishëm është anuluar dhe lënda është kthyer në gjykim të sërishëm, për bazë do të merret aktakuza e mëparshme ose ajo pjesë e saj që i përket pjesës së anuluar nga aktgjykimi.

(2) Para gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të ofrojnë fakte të reja dhe të parashtrojnë dëshmi të reja dhe të propozojnë realizimin e veprimeve të procesit për shpjegimin e çështjeve për të cilat ka sugjeruar Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë në vendimin e vet.

(3) Gjykata gjatë miratimit të procedurës së re është e lidhur me ndalimin e përcaktuar në nenin 428 të këtij ligji.

(4) Nëse krahas vendimit të gjykatës më të ulët është anuluar edhe vendimi i gjykatës më të lartë, lënda dorëzohet te gjykata më e ulët përmes gjykatës më të lartë.

3. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotfuqishëm

Neni 463

Kushtet për parashtrimin e kërkesës

(1) Personi i cili në mënyrë të plotfuqishme është dënuar me dënim pa kusht me burg ose burg për të mitur prej së paku një viti dhe mbrojtësi i tij, mund të parashtrojnë kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotfuqishëm për shkak të shkëljes së ligjit në rastet e parapara me këtë ligj.

(2) Kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotfuqishëm parashtrohet në afat prej 30 ditëve, nga dita kur i akuzuari e ka pranuar aktgjykimin e plotfuqishëm.

(3) I dënuari që nuk ka shfrytëzuar mjet të rregullt juridik kundër aktgjykimit, nuk mund të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotfuqishëm vetëm nëse me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë në vend të lirimit nga dënimi, vërejtjes gjyqësore, dënimit me kusht ose dënimit me para është shqiptuar dënim me burg, përkatësisht në vend të masës edukative - dënim me burg për të mitur.

(4) Kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit nuk mund të parashtrohet kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë.

Neni 464

Gjykata kompetente

Për kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotfuqishëm vendos Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë.

Neni 465

Bazat për parashtrimin e kërkesës

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotfuqishëm mund të parashtrohet, për shkak të shkeljes së:

1) Kodit Penal në dëm të të dënuarit nga neni 416 pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji ose për shkak të shkeljes nga neni 416 pika 5 nëse tejkalimi i autorizimit i përket vendimit për dënimin, masës alternative ose konfiskimit të pronës dhe dobisë pronësore dhe marrjes së lëndëve ose marrjes së dobisë pronësore;

2) dispozitave të procedurës penale të parapara në nenin 415 paragrafi (1) pikat 1, 5, 8, 9 dhe 10 të këtij ligji dhe

3) të drejtës mbrojtjes ose për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale në procedurën për ankesë, nëse kjo shkelje ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e drejtë dhe të ligjshme të aktgjykimit ose në të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë.

Neni 466

Vendosja për kërkesën

(1) Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotfuqishëm, i dorëzohet gjykatës që e ka miratuar aktgjykimin në shkallë të parë.

(2) Kërkesa që është parashtruar jo me kohë ose e ka parashtruar personi i paautorizuar ose është parashtruar në rast të gjykimit të sanksionit penal për shkak të cilit kërkesa nuk mund të parashtrohet (neni 463 paragrafi (1)) ose sipas ligjit nuk është e lejuar ose kur parashtruesi heq dorë nga kërkesa, do ta hedh poshtë me aktvendim kryetari i këshillit të gjykatës së shkallës së parë kompetent për vendimmarrje për kërkesën.

(3) Gjykata kompetente për vendimmarrje për kërkesën i dorëzon ekzemplarë nga kërkesa me dokumente, paditësit që vepron para kësaj gjykate, i cili mundet në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës të parashtojë përgjigje.

(4) Gjykata e shkallës së parë ose gjykata kompetente për vendimmarrje për kërkesën, duke marrë parasysh përmbajtjen e kërkesës mundet të përcaktojë që të anulohet përkatësisht të ndërpritet zbatimi i aktgjykimit të plotfuqishëm.

Neni 467

Zbatimi përkatës i dispozitave tjera nga ky ligj

Lidhur me kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotfuqishëm në mënyrë përkatëse do të zbatohen dispozitat e nenit 458 paragrafët (1), (2) dhe (3), 459, 460 dhe 461 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, Gjatë zbatimit të nenit 461 paragrafi (1) të këtij ligji, gjykata nuk mundet të kufizohet vetëm në përcaktimin e shkeljes së ligjit, kurse dispozita nga neni 461 paragrafi (2) të këtij ligji, do të zbatohet vetëm në pjesën e shqiptimit të dënimit.

SEKSIONI D: PROCEDURAT E SHPEJTUARA

Kreu XXVIII PROCEDURA E SHKURTUAR

Neni 468

Veprat për të cilat udhëhiqet procedura e shkurtuar

Në procedurën para gjykatës që gjykon në shkallë të parë për vepra penale për të cilat si dënim kryesor është përcaktuar dënim me para ose burgim deri në pesë vjet, do të zbatohen dispozitat e neneve 469, 470, 471, 472, 473, 474, 475, 476, 477, 478, 479, 480 dhe 481 të këtij ligji, e nëse në këto dispozita nuk është paraparë diçka e veçantë, në mënyrë përkatëse do të zbatohen dispozitat tjera të këtij ligji.

Neni 469

Ngritja e procedurës së shkurtuar

(1) Procedura penale ngritet në bazë të propozimakuзës së prokurorit publik ose në bazë të padisë private.

(2) Propozimakuza dhe padia private parashtrohen në numër të nevojshëm të ekzemplarëve për gjykatën dhe të dyshuarin.

Neni 470

Përcaktimi i paraburgimit

(1) Paraburgimi mund të përcaktohet kundër personit për të cilin ekziston dyshim i bazuar se ka kryer vepër penale, nëse:

1) fshihet ose nëse nuk mund të përcaktohet identiteti i tij ose nëse ekzistojnë rrethana tjera që dukshëm e sugjerojnë rrezikun nga ikja dhe

2) është bëhet fjalë për vepër penale kundër rendit publik ose moralit, e rrethanat e veçanta e arsyetojnë frikën se i dyshuari do ta përsëritë atë vepër penale ose do ta kryejë veprën penale me të cilën kërcënohet.

(2) Para parashtrimit të propozimakuзës paraburgimin e përcakton gjykatësi i procedurës paraprake, ndërsa pas parashtrimit të propozimakuзës, gjykatësi kompetent-individual.

(3) Para parashtrimit të propozimakuзës paraburgimi nuk mundet të zgjasë më gjatë se tetë ditë. Për ankesën kundër aktvendimit për paraburgim vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji.

(4) Paraburgimi nga parashtrimi i propozimakuзës deri në kryerjen e seancës kryesore mundet të zgjatë më së shumti 60 ditë.

(5) Kur i akuzuari gjendet në paraburgim, gjykata është e obliguar që të veprojnë me urgjencë të veçantë.

Neni 471

Elementet e propozimakuзës

(1) Propozimakuza, përkatësisht padia private duhet t'i përmbajnë: emrin dhe mbiemrin e të dyshuarit ose të dhënat personale, nëse janë të njohura, përshkrim i shkurtër i veprës penale, përcaktimi i gjykatës para të cilës do të mbahet seanca kryesore, propozim cilat dëshmi duhet të nxjerrën në seancën kryesore dhe propozimi që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

(2) Në propozimakuZën mund të propozohet që kundër të dyshuarit të përcaktohet masa për sigurimin e pranisë. Nëse i dyshuari gjendet në paraburgim ose në arrest shtëpiak, do të shënohet në propozimakuZë dita dhe ora prej kur i dyshuari është në paraburgim përkatësisht në arrest shtëpiak.

Neni 472

Pranimi i akuzës në gjykatë

(1) Kur gjykata do ta pranojë propozimakuZën ose padinë private, gjykatësi më parë do të hetojë nëse gjykata është kompetente dhe nëse ekzistojnë kushte për anulimin e propozimakuZës, përkatësisht të padisë private.

(2) Nëse gjykatësi nuk miraton aktvendim nga paragrafi (1) të këtij neni, cakton seancë kryesore.

Neni 473

Jokompetenca

(1) Nëse gjykatësi konstaton se për gjykimin është kompetente gjykatë tjetër, do t'ia kalojë lëndën për aktvendimin e plotfuqishëm, asaj gjykate.

(2) Pas caktimit të seancës kryesore, gjykata nuk mundet sipas detyrës zyrtare të shpallet për jokompetente vendore.

Neni 474

Hedhja poshtë e akuzës

(1) Gjykatësi do ta hedh poshtë propozimakuZën ose padinë private nëse konstaton se ekziston ndonjëra nga bazat e parapara në nenin 337 të këtij ligji.

(2) Aktvendimi dorëzohet te prokurori publik ose te paditësi privat.

Neni 475

Seanca gjyqësore për pajtim

(1) Para caktimit të seancës kryesore për vepra penale nga kompetenca e gjykatësit individual për të cilët ndiqet për padinë private, gjykatësi individual mundet ta thirrë vetëm paditësin privat dhe të akuzuarin që në ditën e caktuar të vijnë në gjykatë për sqarimin paraprakisht të punëve, nëse konsideron se kjo do të jetë në përputhshmëri të plotë për kryerjen më të shpejtë të procedurës. Të akuzuarit së bashku me thirrjen i dorëzohet kopje nga padia private.

(2) Në këtë seancë gjyqësore, gjykatësi individual mund propozojë që paditësi privat dhe i akuzuari të drejtohen në procedurë për ndërmjetësim nëse ekziston pajtim te të dyja palët.

(3) Nëse palët pajtohen që të shkojnë në procedurë për ndërmjetësim, gjykatësi individual merr aktvendim për dërgim në ndërmjetësimi dhe veprimi vazhdon sipas dispozitave nga nenet 491, 492, 493, 494, 495 dhe 496 të këtij ligji.

(4) Nëse palët nuk janë të pajtimit që të shkojnë në ndërmjetësim, e as bëhet pajtimi i tyre edhe deri në tërheqjen e padisë private gjatë seancës gjyqësore për pajtim, gjykatësi do të marrë deklarata nga palët dhe do t'i thirrë që të parashtrijnë propozime të veta për marrjen e dëshmive.

(5) Nëse gjykatësi individual nuk konstaton se ekzistojnë kushte për refuzimin e padisë, sipas rregullës do të caktojë menjëherë seancë kryesore dhe këtë do t'ua kumtojë palëve.

(6) Gjykatësi individual mundet menjëherë ta hapë seancën kryesore dhe pas nxjerrjes së dëshmive të miratojë vendim me rastin e padisë penale. Për këtë posaçërisht do të paralajmërohen paditësi privat dhe i akuzuari gjatë dorëzimit të thirrjes.

(7) Për mosparaqitjen e paditësit privat në thirrjen nga paragrafi (1) të këtij neni, vlen dispozita e nenit 63 të këtij ligji.

(8) Në rast të mosardhjes së të akuzuarit nëse gjykatësi ka vendosur ta hapë seancë kryesore, do të zbatohet dispozita e nenit 366 paragrafi (4) të këtij ligji.

Neni 476

Personat të cilët thirren në seancën kryesore

(1) Gjykatësi i thirrë në seancë kryesore të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij, paditësin, të dëmtuarin dhe përfaqësuesit dhe të autorizuarit e tyre ligjorë, dëshmitarët, ekspertët dhe interpretuesin.

(2) Të akuzuarit në thirrje do t'i theksohet se në seancën kryesore mund të vijë me dëshmi për mbrojtjen e vet. Në thirrje i akuzuari do të paralajmërohet se seanca kryesore do të mbahet edhe në mungesë të tij nëse për atë ekzistojnë kushte ligjore (neni 365). Për të akuzuarin së bashku me thirrjen do të dorëzohet edhe kopje nga propozimakuza, përkatësisht nga padia private dhe do të këshillohet se ka të drejtë të marrë mbrojtës, por në rast kur mbrojtja nuk është e detyruar, për shkak të mos ardhjes së mbrojtësit në seancën kryesore ose marrjes së mbrojtësit në seancën kryesore, nuk është e domosdoshme të prolongohet seanca kryesore.

(3) Thirrja të i akuzuari duhet të dorëzohet ashtu që ndërmjet dorëzimit të thirrjes dhe ditës së seancës kryesore të mbetet kohë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, e më së paku tetë ditë. Me pajtim të të akuzuarit ky afat mund të shkurtohet.

Neni 477

Vendi ku mbahet seanca kryesore

Seanca kryesore mbahet në vendin e gjykatës. Në raste urgjente, posaçërisht kur duhet të kryhet inspektim ose kur kjo është në interes për zbatim më të lehtë të procedurës për dëshmi, mundet me leje të kryetarit të gjykatës seanca kryesore të përcaktohet edhe në vendin ku është kryer vepra penale ose atje ku do të ndërmerret inspektimi, nëse ato vende janë në rajonin e asaj gjykate.

Neni 478

Kundërshtimi për jokompetencë vendore

Kundërshtimi për kompetencë vendore mund të paraqitet më vonë deri në fillimin e seancës kryesore.

Neni 479

Kushtet për mbajtjen e seancës kryesore

(1) Seanca kryesore mbahet në prani të prokurorit publik, përkatësisht të paditësit privat dhe të akuzuarit.

(2) Për vepra penale për të cilat është përcaktuar dënim me para ose dënim me burg deri tre vjet, nëse i akuzuari nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse rregullisht është thirrur ose thirrja nuk ka mundur të dorëzohet për shkak se duket qartë se i akuzuari i ikën pranimit të thirrjes, gjykata mundet të vendosë që seanca kryesore të mbahet pa praninë e tij. Për veprat tjera penale për të cilat udhëhiqet procedura e shkurtuar, prania e të akuzuarit në seancën kryesore është e detyrueshme.

Neni 480

Rrjedha e seancës kryesore

(1) Seanca kryesore fillon me paraqitjen e përmbajtjes së akuzës. Seanca kryesore e filluar do të përfundojë, mundësisht pa ndërprerje.

(2) Nëse në seancën kryesore i akuzuari jep deklaratë me të cilën e pranon fajin, veprohet në pajtim me nenin 381 të këtij ligji.

Neni 481

Shqiptimi i aktgjykimit

(1) Pas përmbylljes së seancës kryesore gjykata menjëherë do ta shqiptoj aktgjykimin dhe do ta shpallë me shkaqet thelbësore. Aktgjykimi duhet të përpilohet me shkrim në afat prej tetë ditëve nga dita e shpalljes.

(2) Kundër aktgjykimit ankesë mundet të paraqitet në afat prej tetë ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes nga aktgjykimi.

(3) Dispozitat e nenit 174 të këtij ligji, në mënyrë përkatëse do të zbatohen edhe për heqjen e paraburgimit pas shqiptimit të aktgjykimit.

(4) Kur gjykata do të shqiptojë në aktgjykim dënim me burg, mund të përcaktoj që i akuzuari të vendoset në paraburgim, përkatësisht të mbetet në paraburgim, nëse ekzistojnë arsye nga neni 165 paragrafi (1) pikat 1, 2 dhe 3 të këtij ligji. Paraburgimi në këtë rast mund të zgjasë deri në aktgjykimin e plotfuqishëm, por më së shumti 60 ditë.

Neni 482

Njoftimi për mbledhjen e këshillit të gjykatës së shkallës së dytë

(1) Kur gjykata e shkallës së dytë vendos për ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë të miratuar në procedurë të shkurtuar, të dyja palët do të njoftohen për seancën e këshillit të gjykatës së shkallës së dytë, vetëm nëse kryetari i këshillit ose këshilli konstaton se prania e palëve do të jetë e dobishme për shpjegimin e punëve.

(2) Nëse bëhet fjalë për vepër penale për të cilën procedura udhëhiqet me kërkesë të prokurorit publik, kryetari i këshillit para seancës së këshillit do t'i dorëzojë dokumentet te prokurori publik, i cili mund të paraqesë propozim të vet me shkrim në afat prej tetë ditëve.

Kreu XXIX
MIRATIMI I AKTGJYKIMIT NË BAZË TË MARRËVESHJES SË
PROKURORIT PUBLIK DHE TË DYSHUARIT

Neni 483

Parashtrimi i propozimmarrëveshjes

(1) Deri në parashtrimin e akuzës prokurori publik dhe i dyshuari mund të parashtrojnë propozimmarrëveshje me të cilën kërkojnë nga gjykatësi i procedurës paraprake, që të zbatojë saksion penal e të prcaktuar sipas llojit dhe lartësisë, në korniza të përcaktuara ligjore për veprën konkrete penale, por jo nën kufijtë për zbutjen e dënimit të përcaktuara me Kodin Penal.

(2) Prokurori publik është i obliguar që me propozimmarrëveshjen, së bashku me të gjitha dëshmitë ta bashkangjisë edhe deklaratën me shkrim të nënshkruar nga i dëmtuari në lidhje me llojin dhe lartësinë e kërkesës pronësore juridike.

(3) Marrëveshja bëhet ndërmjet prokurorit kompetent publik dhe të dyshuarit në prani të mbrojtësit të tij.

Neni 484

Lëndë e marrëveshjes

Lëndë e marrëveshjes është lloji dhe lartësia e sanksionit penal që do të propozohet në propozimmarrëveshjen, e nëse ekziston pajtim nga i dyshuari lëndë e marrëveshjes mund të jetë edhe kërkesa pronësore juridike nga i dëmtuari.

Neni 485

Elementet e propozimmarrëveshjes

(1) Propozimmarrëveshja e parashtruar sipas nenit 483 të këtij ligji doemos duhet të përmbajë:

- 1) të dhënat për prokurorin publik, të dyshuarin dhe mbrojtësin e tij;
- 2) përshkrimin dhe kualifikimin juridik të veprave penale të përfshira me propozimmarrëveshjen;
- 3) sanksionin e propozuar penal sipas llojit dhe lartësisë;
- 4) llojin dhe lartësinë e kërkesës pronësore-juridike dhe mënyrën e realizimit të saj, nëse i dyshuari ka dhënë pajtim sipas nenit 484 të këtij ligji;
- 5) deklaratën e të dyshuarit se me vetëdije dhe vullnetarisht e pranon propozimmarrëveshjen dhe pasojat që dalin nga ajo;
- 6) deklaratën nga prokurori publik dhe i dyshuari se tërhiqen nga drejta e ankesës, nëse miratohet aktgjykim me të cilin pranohet propozimmarrëveshja;
- 7) shpenzimet e procedurës;
- 8) nënshkrimin e prokurorit publik, të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij dhe
- 9) datën dhe vendin e lidhjes së propozimmarrëveshjes.

Neni 486

Pjesëmarrja e mbrojtësit të të dyshuarit në marrëveshje

(1) I dyshuari duhet të ketë mbrojtës nga momenti i fillimit të procedurës për marrëveshje.

(2) i dyshuari zgjedh mbrojtës sipas zgjedhjes së vet. Nëse vet nuk zgjedh mbrojtës, kryetari i gjykatës kompetente i cakton mbrojtës sipas detyrës zyrtare.

Neni 487

Mospjesëmarrja e gjykatës në marrëveshje për fajin

Gjykatësi i procedurës paraprake nuk guxon të marrë pjesë në procedurën për marrëveshje ndërmjet prokurorit publik dhe të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij.

Neni 488

Veprimi pas propozimmarrëveshjes

(1) Në afat prej tri ditëve nga marrja e propozimmarrëveshjes, gjykatësi i procedurës paraprake cakton seancë gjyqësore për vlerësimin e propozimmarrëveshjes.

(2) Në seancë gjyqësore i thirr parashtruesit e propozimmarrëveshjes dhe është i obliguar të hetojë nëse kjo është parashtruar vullnetarisht, nëse i dyshuari është i vetëdijsëm për pasojat juridike nga pranimi i saj, për pasojat lidhur me kërkesat pronësore-juridike dhe shpenzimet e procedurës penale.

(3) Prokurori publik, i dyshuari dhe mbrojtësi i tij gjatë seancës gjyqësore nuk guxojnë të parashtrojnë kërkesë për vërtetimin e sanksionit penal të ndryshëm nga sanksioni penal në propozimmarrëveshje. Nëse prokurori publik ose i dyshuari dhe mbrojtësi i tij parashtrojnë kërkesë të këtillë, konsiderohet se kanë hequr dorë nga propozimmarrëveshja dhe gjykatësi i procedurës paraprake merr aktvendim në sipas nenit 489 paragrafi (1) të këtij ligji.

(4) Gjykatësi i procedurës paraprake i këshillon prokurorin publik dhe të dyshuarin dhe mbrojtësin e tij se kanë të drejtë deri në miratimin e aktvendimit të heqin dorë nga propozimmarrëveshja.

(5) Gjykatësi i procedurës paraprake i njofton prokurorin publik dhe të dyshuarin dhe mbrojtësin e tij, se pranimi i propozimmarrëveshjes konsiderohet si heqje dorë nga e drejta e ankesës ndaj aktgjykimit të miratuar në bazë të propozimmarrëveshjes.

Neni 489

Refuzimi i propozimmarrëveshjes

(1) Nëse gjykatësi i procedurës paraprake përcakton se dëshmitë e grumbulluara për faktet me rëndësi për zgjedhjen dhe përcaktimin e sanksionit penal nuk e arsyetojnë shqiptimin e sanksionit të propozuar penal, përkatësisht nëse prokurori publik, i dyshuari dhe mbrojtësi i tij gjatë seancës gjyqësore kanë parashtruar kërkesë për përcaktimin e sanksionit penal të ndryshëm nga sanksioni penal i përmbajtur në propozimmarrëveshjen, merr aktvendim me të cilin e refuzon propozimmarrëveshjen dhe dokumentet i dorëzon te prokurori publik.

(2) Në rast të miratimit të aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij neni, procesverbali nga seanca e mbajtur gjyqësore dhe propozimmarrëveshja nuk mund të shfrytëzohen në rrjedhën e mëtejme të procedurës dhe me to do të veprohet në mënyrën e rregulluar në nenin 336 paragrafi (4) të këtij ligji.

(3) Kundër aktvendimit të miratuar sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk lejohet ankesë.

Neni 490

Aktgjykimi në bazë të propozimmarrëveshjes

(1) Nëse gjykatësi i procedurës paraprake e pranon propozimmarrëveshjen, shqipton aktgjykim me të cilin nuk guxon të shqiptojë saksion penal të ndryshëm nga sanksioni penal i pëmbajtur në propozimmarrëveshje.

(2) Aktgjykimi i përmban elementet e aktgjykimit të gjykuar në pajtim me nenin 404 të këtij ligji.

(3) Aktgjykimi shpallet menjëherë, ndërsa përgatitet me shkrim në afat prej tri ditësh nga dita e shpalljes. Aktgjykimi pa prolongim i dorëzohet prokurorit publik, të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij.

(4) Ekzemplari nga aktgjykimi pa prolongim i dorëzohet edhe të dëmtuarit. Nëse i dëmtuari nuk është i kënaqur nga vendimi për llojin dhe lartësinë e kërkesës së gjykuar pronësore-juridike, të drejtën e vet i dëmtuari mund ta realizojë në procedurë kontestimore.

Kreu XXX PROCEDURA PËR NDËRMJETËSIM

Neni 491

Kushtet për ndërmjetësim

(1) Në rast kur vepra ndiqet me padi private gjykatësi kompetent individual i seancës gjyqësore për pajtim për shkak të përshtatshmërisë së plotë, mund t'u propozojë palëve për dhënien e pajtimit për dërgim në ndërmjetësim.

(2) Palë në procedurën për ndërmjetësim janë i dyshuari, mbrojtësi i tij dhe i dëmtuari dhe i autorizuari i tij.

(3) Pajtimi mund të jepet në procesverbal para gjykatësit individual ose me shkrim, bashkërisht ose secila palë veç e veç. Pajtimi jepet më së voni në afat prej tri ditëve nga dita kur është propozuar dërgimi në ndërmjetësim.

(4) Pas pajtimit të dhënë nga palët gjykatësi - individual merr aktvendim për udhëzimet e palëve për ndërmjetësim.

(5) Nëse në afatin e përcaktuar palët nuk japin pajtim, gjykatësi individual merr aktvendim se propozimi për dërgimin në ndërmjetësim nuk është i pranuar dhe cakton seancë kryesore sipas dispozitave për procedurë të shkurtuar.

Neni 492

Përcaktimi i ndërmjetësuesit

Në afat prej tri ditëve nga pajtimi i dhënë, palët me marrëveshje përcaktojnë një ose më shumë ndërmjetësues nga Lista emërore e ndërmjetësuesve dhe për këtë e njoftojnë gjykatësin individual.

Neni 493

Kohëzgjatja e procedurës për ndërmjetësim

Procedura për ndërmjetësim mund të zgjasë më së shumti deri në 45 ditë nga dita e pajtimit të dhënë nga palët te gjykatësi kompetent individual.

Neni 494

Zbatimi i procedurës për ndërmjetësim deri në arritjen e marrëveshjes

(1) Procedurën për ndërmjetësim deri në nënshkrimin e marrëveshjes me shkrim, ndërmjetësuesi e zbaton në pajtim me dispozitat e Ligjit për ndërmjetësim.

(2) Ndërmjetësuesi në marrëveshje me palët do t'i përcaktojë afatet për mbajtjen e ndërmjetësimi. Ndërmjetësuesi komunikon me palët së bashku ose ndaras. Prania e palëve gjatë procedurës për ndërmjetësim është e detyrueshme.

(3) Para fillimit të procedurës për ndërmjetësim, ndërmjetësuesi është i detyruar që t'i njoftojë palët me principet, rregullat dhe shpenzimet e procedurës.

Neni 495

Mbarimi i procedurës për ndërmjetësim

(1) Procedura për ndërmjetësim mund të mbarojë me nënshkrimin e marrëveshjes me shkrim dhe zbatohen dispozitat nga nenet 495 dhe 496 të këtij ligji.

(2) Procedura për ndërmjetësim, përveç nënshkrimit të marrëveshjes me shkrim, mund të mbarojë:

1) me deklaratë me shkrim të ndërmjetësuesit, pas konsultimeve të bëra me palët se nuk janë të arsyeshme tentimet e mëtejme për ndërmjetësim, në ditën e parashtrimit të deklaratës;

2) me skadimin e afatit prej 45 ditëve, i konstatuar me njoftim nga ana e ndërmjetësuesit;

3) me tërheqjen e palëve në çfarëdo kohe nga procedura për ndërmjetësim pa i cekur me këtë rast shkaqet për atë. Tërheqja do të konsiderohet nga dita e parashtrimit të deklaratës për tërhiqje dhe

4) kur ndërmjetësuesi me aktvendim do ta ndërpresë procedurën për ndërmjetësim nëse konsideron se është arritur marrëveshje që është joligjore ose e papërshtatshme për zbatim.

(3) Deklarata me shkrim, njoftimi ose aktvendim i miratuar nga ana e ndërmjetësuesit, përkatësisht deklarata për tërheqjen e palëve sipas paragrafit (2) të këtij neni, pa prolongim dorëzohen te gjykatësi individual i cili cakton seancë kryesore sipas dispozitave për procedurë të shkurtuar.

Neni 496

Nënshkrimi i marrëveshjes me shkrim

(1) Nëse procedura për ndërmjetësim mbaron me nënshkrimin e marrëveshjes me shkrim të ndërmjetësuesit dhe palëve, marrëveshja duhet t'i përmbaj së paku elementet në vijim:

1) të dhënat për të dyshuarin, përkatësisht të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij;

2) të dhënat për të dëmtuarin, përkatësisht për paditësin privat;

3) përshkrimin e ngjarjes dhe kualifikimin juridik të veprës;

4) ditën kur ka filluar procedura për ndërmjetësim;

5) të dhënat për numrin e përgjithshëm të mbledhjeve të mbajtura me palët, së bashku ose veç e veç;

6) lëndën e marrëveshjes - kompensimi i dëmit, kryerja e detyrave të përcaktuara nga ana e kryerësit, përkatësisht të akuzuarit në dobi të të

dëmtuarit, kërkimi i faljes nga kryerësi, përkatësisht i akuzuari prej të dëmtuarit, kthimi i sendeve ose bazës tjetër për të cilën palët kanë arritur marrëveshje;

7) afatin për përmbushjen e obligimeve që nuk mund të jetë më të i gjatë se tre muaj;

8) vendimin për kompensim të shpenzimeve nga procedura;

9) datën e përpilimit të marrëveshjes me shkrim;

10) nënshkrimin nga palët në ndërmjetësimin dhe

11) vërtetimin e marrëveshjes nga ana e ndërmjetësuesit me nënshkrim dhe vulës katrore të lëshuar nga Oda e Ndërmjetësuesve.

(2) Marrëveshja e nënshkruar me shkrim pa prolongim dorëzohet te gjykata kompetente.

(3) Deri në skadimin e afatit për përmbushjen e obligimeve, i dyshuari është i detyruar që të bashkëngjijë prova për përmbushje të obligimeve dhe për kompensim të shpenzimeve të procedurës te gjykatësi kompetent individual.

(4) Pas marrjes së provave dhe vërtetimit për kompensim të shpenzimeve të procedurës sipas paragrafit (3) të këtij neni, gjykatësi individual merr aktvendim për ndërprerjen e procedurës.

(5) Aktvendimi i miratuar sipas paragrafit (4) të këtij neni, dorëzohet deri i dyshuari dhe te i dëmtuari.

(6) Nëse pas skadimit të afatit për përmbushjen e obligimeve i dyshuari nuk bashkëngjijë prova se i ka përmbushur obligimet e përcaktuara me marrëveshjen me shkrim, gjykatësi individual cakton seancë kryesore sipas dispozitave për procedurën e shkurtuar.

Kreu XXXI

PROCEDURA PËR LËSHIMIN E URDHËRDËNIMIT

Neni 497

Kushtet për lëshimin e urdhërdënimit

(1) Për vepra penale nga kompetenca e gjykatësit individual kur për këtë disponohet me prova të mjaftueshme, prokurori publik mund të parashtrijë propozim për lëshimin e urdhërdënimit.

(2) Propozimi për lëshimin e urdhër dënimit i përmban:

1) të dhënat personale për të akuzuarin;

2) përshkrimin e veprës penale që i ngarkohet;

3) kualifikimin juridik i veprës;

4) provat me të cilat disponon prokuroria dhe

5) llojin dhe lartësinë e sanksionit penal ose masës tjetër e cila i propozohet gjykatësit.

(3) Me propozimin për lëshimin e urdhërdënimit prokurori publik i propozon gjykatës shqiptimin e një ose më shumë sanksioneve penale ose masave në vijim:

1) dënim në para në lartësi prej 10 deri në 100 gjoba ditore;

2) dënim me kusht me dënim të përcaktuar me burgim deri në tre muaj ose dënim në para;

3) ndalim për drejtim të automjetit deri në dy vjet dhe

4) konfiskimi i pronës dhe dobisë pronësore të fituar me vepër penale dhe marrje e sendeve.

(4) Propozimin për shqiptimin e urdhërdënimit mundet ta parashtrojë edhe paditësi privat me padi private.

Neni 498

Refuzimi i propozimit për lëshimin e urdhërdënimit

(1) Gjykatësi individual do ta refuzojë propozimin për lëshimin e urdhërdënimit nëse bëhet fjalë për vepër penale për të cilën nuk mundet të parashtrohet propozim i atillë. Për ankesën e prokurorit publik kundër aktvendimit për refuzimin vendos këshilli (neni 25 paragrafi (5)) në afat prej 48 orëve.

(2) Nëse gjykatësi individual konsideron se të dhënat në propozimin për lëshimin e urdhërdënimit nuk japin bazë të mjaftueshme për lëshimin e urdhërdënimit, ose sipas atyre të dhënave mund të pritët shqiptimi i ndonjë sanksioni tjetër penal ose mase, e jo atë që e ka propozuar prokurori publik, pas pranimit të propozimkuzës do të caktojë seancë kryesore sipas dispozitave për procedurë të shkurtuar.

Neni 499

Lëshimi i urdhërdënimit me aktgjykim

(1) Nëse pajtohet me propozimin nga neni 497 të këtij ligji, gjykatësi individual do të lëshoj urdhërdënim me aktgjykim me të cilin do t'i shqiptojë sanksionet penale ose masat tjera të propozuara nga prokurori publik.

(2) Shqiptimin e aktgjykimit nga paragrafi (1) të këtij neni, e përmban edhe vendimi për kërkesën pronësore juridike, nëse ekziston propozim i atillë. Në arsyetim do të theksohen vetëm provat të cilat e arsyetojnë lëshimin e urdhërdënimit.

(3) Aktgjykimi e përmban këshillën për të akuzuarin, sipas nenit 501 paragrafi (2) të këtij ligji, se pas skadimit të afatit për kundërshtim, nëse kundërshtimi nuk është parashtruar, aktgjykimi do të bëhet i plotfuqishëm.

Neni 500

Dorëzimi i urdhërdënimit dhe e drejta e ankesës

(1) Aktgjykimi me të cilin është lëshuar urdhërdënimi i dorëzohet të akuzuarit dhe mbrojtësi i tij nëse ka.

(2) I akuzuari dhe mbrojtësi i tij mundën në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit të parashtrojnë kundërshtim kundër aktgjykimit në formë të shkruar ose me gojë ose me procesverbal në gjykatë. Kundërshtimi nuk ka nevojë të arsyetohet, por mund të përmbajë prova në dobi të mbrojtjes. I akuzuari mund të heq dorë nga e drejta e kundërshtimit deri në caktimin e seancës kryesore. Pagesa e dënimit në para para skadimit të afatit për kundërshtim nuk konsiderohet për heqje dorë nga e drejta e kundërshtimit.

(3) Të akuzuarit, kur nga shkaqe të arsyeshme do ta lëshoj afatin për parashtrimin e kundërshtimit, gjykatësi individual do t'i lejojë kthimin në gjendjen e mëparshme me zbatimin e dispozitave nga nenet 99, 100 dhe 101 të këtij ligji.

(4) Nëse gjykatësi individual e refuzon kundërshtimin si jo me kohë ose i parashtruar nga personi i paautorizuar, i akuzuari ose personi i cili e ka

parashtruar kundërshtimin ka të drejtë ankese, në afat prej tri ditësh te këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji.

(5) Nëse gjykatësi individual nuk e refuzon kundërshtimin, do të caktojë seancë kryesore sipas dispozitave për procedurë të shkurtuar (nenet 468, 469, 470, 471, 472, 473, 474, 475, 476, 477, 478, 479, 480, 481, dhe 482) Me këtë rast, gjykatësi individual nuk është i lidhur për sanksionet e propozuara penale ose masat tjera të përmbajtura në propozimin e prokurorit publik për lëshimin e urdhërdënimit.

(6) Me caktimin e seancës kryesore, konsiderohet se aktgjykimi për lëshimin e urdhërdënimit fare nuk është e miratuar.

PJESA E TRETË PROCEDURAT E VEÇANTA

Kreu XXXII PROCEDURA PËR SHQIPTIMIN E MASAVE ALTERNATIVE

Neni 501

Shqiptimi i vërejtjes gjyqësore

(1) Vërejtja gjyqësore shqiptohet me aktvendim.

(2) Nëse në këtë kaptinë nuk është paraparë diçka tjetër, dispozitat nga ky ligj që i përkasin aktgjykimit me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, në mënyrë përkatëse zbatohen edhe në aktvendimin për vërejtje gjyqësore.

Neni 502

Aktvendimi për vërejtje gjyqësore

(1) Aktvendimi për vërejtje gjyqësore shpallet menjëherë pas mbarimit të seancës kryesore me arsye thelbësore. Në këtë rast kryetari i këshillit do ta paralajmërojë të akuzuarin se për veprën penale që e ka kryer nuk i shqiptohet dënim, pasi pritet se edhe vërejtja gjyqësore do të ndikojë mjaftueshëm në të, që më tutje të mos kryejë vepra penale. Nëse aktvendimi për vërejtjen gjyqësore shpallet në mungesë të të akuzuarit, gjykata paralajmërimin e atillë do ta shënojë në arsyetimin e aktvendimit. Për heqjen dorë nga e drejta e ankesës ose për përpunimin me shkrim të aktvendimit në mënyrë përkatëse zbatohet dispozita e nenit 486 paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Në shqiptimin e aktvendimit për vërejtje gjyqësore krahas të dhënave personale për të akuzuarin, do të ceket vetëm se të akuzuarit i shqiptohet vërejtja gjyqësore për veprën që është lëndë e akuzës dhe emri ligjor i veprës penale. Shqiptimi i aktvendimit për vërejtje gjyqësore i përfshin edhe të dhënat e nevojshme nga neni 404 paragrafi (1) pikat 5 dhe 7 të këtij ligji.

(3) Në arsyetimin e aktvendimit gjykata do të paraqesë prej cilave shkaqe është udhëhequr gjatë shqiptimit të vërejtjes gjyqësore.

Neni 503

Përgënjeshtrimi i aktvendimit për vërejtjen gjyqësore

(1) Aktvendimi për vërejtje gjyqësore mund të përgënjeshtrohet për shkak të bazave të cekura në nenin 414 pikat 1, 2 dhe 3 të këtij ligji, si dhe

për shkak se nuk kanë ekzistuar rrethana që e arsyetojnë shqiptimin e vërejtjes gjyqësore.

(2) Nëse aktvendimi për vërejte gjyqësore përmban vendim për masa të sigurisë, konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore dhe marrjen e sendeve, për shpenzime të procedurës penale ose për kërkesat pronësore-juridike, ky vendim mund të përgënjeshtrohet nga shkaku që gjykata me rregull nuk e ka zbatuar masën e sigurisë ose për marrjen e dobisë pronësore, përkatësisht që vendimi për shpenzimet e procedurës penale ose të kërkesës pronësore juridike e ka miratuar në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Neni 504

Shkelja e Kodit penal gjatë shqiptimit të vërejtjes gjyqësore

Shkelja e Kodit penal në rast të shqiptimit të vërejtjes gjyqësore ekziston, vetëm për çështjet e cekura në nenin 416 pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij ligji, edhe kur me vendim për vërejte gjyqësore, për masën e sigurisë ose për konfiskimin e pronës dhe dobisë pronësore dhe marrjen e sendeve është tejkaluar autorizimi që gjykata e ka sipas ligjit.

Neni 505

Ankesa kundër aktvendimit për vërejte gjyqësore

(1) Nëse ankesën kundër aktvendimit për vërejte gjyqësore e ka parashtruar paditësi në dëm të të akuzuarit, gjykata e shkallës së dytë mund të miratojë aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor dhe gjykohet me dënim ose me të cilin shqiptohet dënim me kusht, nëse konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të rregullt i ka përcaktuar faktet vendimtare, por që sipas zbatimit të rregullt të ligjit parashihet shqiptimi i dënimit.

(2) Me rastin e cilësdo ankesë kundër aktvendimit për vërejte gjyqësore gjykata e shkallës së dytë mund të miratojë aktgjykim me të cilin i akuzuari refuzohet ose i akuzuari lirohet nga akuza, konstaton se gjykata e shkallës së parë i ka përcaktuar me rregull faktet vendimtare dhe se me zbatimin e drejtë të ligjit parashihet shqiptimi i njërit nga këto aktgjykime.

(3) Kur ekzistojnë kushtet nga neni 434 të këtij ligji, gjykata e shkallës së dytë do të miratojë aktvendim me të cilin refuzohet ankesa si e pabazë dhe vërtetohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë për vërejte gjyqësore.

Neni 506

Shqiptimi i masave alternative

(1) Për vepra penale për të cilët mund të shqiptohen masat alternative: ppunë me dobi të përgjithshme, ndërprerje me kusht e mbajtjes së procedurës penale dhe burg shtëpiak, me propozim të prokurorit publik nëse janë plotësuar kushtet në Kodin penal për zbatimin e këtyre sanksioneve penale, gjykata mund t'i shqiptojë pa mbajtjen e seancës kryesore.

(2) Propozimi për shqiptimin e masave alternative mund të parashtrohet edhe paditësi privat.

(3) Para shqiptimit të aktgjykimit, gjykatësi individual i thirr palët. Nëse i akuzuari para gjykatës e kundërshton miratimin e aktgjykimit për shqiptimin e masave alternative, gjykata do të hapë seancë kryesore dhe procedura do të vazhdojë sipas dispozitave për seancën kryesore në pajtim me këtë ligj.

(4) Kur i akuzuari pajtohet me propozimin, gjykata do të miratojë aktgjykim me të cilin do ta shqiptojë masën e propozuar alternative.

(5) Në aktgjykim me të cilin shqiptohet punë me dobi të përgjithshme si sanksion primar penal, gjykata do të përcaktojë:

a) për cilën vepër shpallet fajtor, me shënimin e fakteve dhe rrethanave që supozojnë karakteristikë të veprës penale, si dhe të atyre prej të cilave varet zbatimi i dispozitës së caktuar të Kodit penal.

b) emri ligjor i veprës penale dhe cilat dispozita të Kodit penal janë zbatuar;

v) numri i përgjithshëm i orëve të punës në dobi të përgjithshme;

g) numri i përgjithshëm i orëve që duhet të kryhen gjatë një jave;

d) vendi i kryerjes së punës me dobi të përgjithshme dhe

gj) pasojat në rast të mospërmbajtjes ndaj masave dhe mënyrës së zëvendësimit të punës me dobi të përgjithshme me dënim me burg.

(6) Nëse me aktgjykimin gjykata ka shqiptuar dënim me para deri në 90 gjoba ditore ose dënim me burg në kohëzgjatje deri tre muajsh kurse i akuzuari ka parashtruar kërkesë për zëvendësim me masën alternative puna me dobi të përgjithshme nga neni 58-a paragrafi (3) të Kodit penal, gjykata miraton aktvendim për mënyrën e zëvendësimit të dënimit me para, përkatësisht dënimit me burg me punë në dobi të përgjithshme.

(7) Krahas masave alternative në aktgjykim sipas paragrafit (4) të këtij neni, gjykata mund të përcaktojë masë të konfiskimit të pronës dhe dobisë pronësore dhe marrjes së sendëve kur janë përmbushur kushtet ligjore për shqiptimin e atyre masave dhe të vendosë për kërkesat pronësore-juridike të të dëmtuarit.

(8) Nëse është miratuar aktgjykimi nga paragrafi (4) i këtij neni, konsiderohet se palët kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës.

Neni 507

Aktvendim për ndërprerjen e procedurës

1) Kur janë plotësuar kushtet ligjore për ndërprerje me kusht të mbajtjes së procedurës penale (neni 58-a i Kodit penal), gjykata me propozim të paditësit të autorizuar do të miratojë aktvendim për ndërprerjen e procedurës në të cilën do ta përcaktojë afatin e ndërprerjes së procedurës dhe obligimin e kryerësit që brenda atij afati të mos kryejë vepër të re penale dhe t'i përmbushë detyrat tjera të parashikuara.

2) Pas skadimit të afatit për ndërprerje, gjykata merr aktvendim për ndërprerjen e procedurës nëse kryerësi i është përmbajtur kushteve dhe detyrave të përcaktuara me aktvendim për ndërprerjen e procedurës.

3) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij neni, palët kanë të drejtë ankese në afat prej tetë ditësh.

Kreu XXXIII

PROCEDURA NDAJ PERSONAVE JURIDIKË

1. Dispozitat e përgjithshme

Neni 508

Zbatimi i procedurës

1) Dispozitat e këtij kreu zbatohen në procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë penale dhe shqiptimin e dënimeve dhe masave tjera ndaj personave juridikë si kryerës të veprave penale.

2) Nëse me dispozitat nga ky kapitull nuk është përcaktuar ndryshe, në procedurën ndaj personave juridikë, në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat e këtij ligji: për parimet themelore; për kompetencën vendore; për pasojat nga jokompetenca dhe ndeshja e kompetencave; për përjashtimin; për të akuzuarin; për mbrojtësin; për parashtresat; për procesverbalet; për afatet; për kthimin në gjendjen e mëparshme; për shpenzimet; për kërkesën pronësore juridike; për miratimin dhe kumtimin e vendimeve; për dorëzimin e dokumenteve; për thirrje; për mbajtjen e personave, për garanci dhe marrjen e dokumentit të udhëtimit; për paraburgim; për dëshmim; për procedurë të shkurtuar; për shqiptimin e masave për konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore dhe për marrjen e sendeve; për mjete të rregullta dhe të jashtëzakonshëm juridike dhe për procedurë për kompensim të dëmit të personave të dënuar padrejtësisht.

Neni 509

Përputhshmëria e udhëheqjes së procedurës penale

(1) Kur është parashtruar kallëzimi penal kundër personit përgjegjës ose përfaqësuesit të personit juridik, nëse ekzistojnë baza të dyshimit se janë përmbushur kushtet për përgjegjësi penale të personave juridikë të përcaktuar me Kodin penal, prokurori publik mundet sipas detyrës zyrtare të kërkojë ngritjen e procedurës penale për të njëjtën vepër penale edhe kundër personit juridik.

(2) Prokurori publik mund të vendosë të mos ndërmarrë ndjekje ose të heq dorë nga ndjekja penale në bazë të nenit 45 të këtij ligji, nëse personi juridik nuk ka asnjë pronë ose prona është shumë e vogël, që nuk mund t'i mbulojë as shpenzimet e procedurës penale, ose nëse kundër personit juridik dhëhiqet procedura e falimentimit.

(3) Për veprën penale të personit juridik dhe të personit përgjegjës në personin juridik zbatohet procedura e vetme, e nëse për atë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme procedura mund të ndahet.

Neni 510

Kompetenca e gjykatës

(1) Për mbajtjen e procedurës penale kundër personit juridik kompetente është gjykata në të cilën gjendet selia e personit juridik, përkatësisht përfaqësia e personit të huaj juridik.

(2) Nëse personi i huaj juridik nuk ka përfaqësi në territorin e Republikës së Maqedonisë, ose nëse mbahet procedurë e vetme kundër personit juridik dhe personit përgjegjës në personin juridik, kompetenca e gjykatës përcaktohet sipas dispozitave të përgjithshme për kompetencën vendore, të këtij ligji.

Neni 511

Përfaqësuesi i personit juridik në procedurën penale

(1) Në procedurën kundër personit juridik merr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i personit juridik i cili i ka të gjitha të drejtat dhe mundet t'i ndërmarrë të gjitha veprimet që është i autorizuar t'i ndërmarrë i akuzuari në procedurën penale,

(2) Përfaqësues i autorizuar i personit juridik është personi përgjegjës në personin juridik i përcaktuar me ligj, vendim të bazuar në ligj, statut ose akt tjetër të përgjithshëm të udhëheqjes të personit juridik. Nëse përfaqësuesi i autorizuar është i akuzuar edhe vet për veprën penale për të cilën mbahet procedura edhe kundër personit juridik, ose është thirrur si dëshmitar në procedurë, ose ekzistojnë pengesa faktike ose juridike që ai ta përfaqësojë personin juridik, personi juridik është i obliguar që të përcaktojë me autorizim me shkrim përfaqësues tjetër nga radhët e personave përgjegjës ose të punësuarit në personat juridikë. Autorizimi me shkrim mund të jepet edhe në procesverbal para gjykatës para të cilës mbahet procedura.

(3) Personi juridik është i obliguar që t'i dorëzojë gjykatës parashtresë për autorizimin e përfaqësuesit të tij, si dhe dëshmi për autorizimin e tij. Gjykata para fillimit të seancës kryesore do ta konfirmojë identitetin e përfaqësuesit të personit juridik dhe autorizimin e tij për pjesëmarrje në procedurë.

(4) Personi juridik është i obliguar që të përcaktojë përfaqësues në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të thirrjes për seancën kryesore. Nëse personi juridik në këtë afat nuk përcakton përfaqësues dhe për atë nuk e njofton gjykatën, përfaqësuesi të personit juridik do të përcaktojë gjykata para të cilës mbahet procedura sipas detyrës zyrtare dhe për atë do ta njoftojë personin juridik.

(5) Përfaqësuesin sipas detyrës zyrtare gjykata do të përcaktojë nga personat përgjegjës ose të punësuarit në personin juridik, e nëse kjo nuk është e mundur nga radhët e avokatëve.

(6) Përfaqësues sipas detyrës zyrtare gjykata do të përcaktojë edhe kur personi juridik ka pushuar së ekzistuari para mbarimit të plotfuqishëm të procedurës penale, nëse në afat prej tetë ditësh nga pushimi i personit juridik, përfaqësuesi nuk e ka përcaktuar pasardhësin e tij juridik.

(7) Nëse personi juridik e përcakton personin për përfaqësues i cili nuk mund ta ketë rol të atillë sipas dispozitës nga paragrafi (2) të këtij neni, gjykata do ta obligojë që në afat prej tetë ditëve të përcaktojë përfaqësues tjetër. Nëse në afat prej tetë ditëve personi juridik nuk përcakton përfaqësues të ri, ose nëse e tërheq autorizimin e përfaqësuesit tanimë të përcaktuar, gjykata do të caktojë përfaqësues sipas detyrës zyrtare.

(8) Përfaqësuesin sipas detyrës zyrtare gjykata e përcakton me aktvendim, kundër të cilit personi juridik dhe përfaqësuesi i përcaktuar nga ai kanë të drejtë ankese, e cila nuk e ndalon zbatimin e tij.

(9) Shpenzimet e nevojshme për përfaqësuesin e personit juridik, si dhe shpërblymimi për përfaqësuesin e përcaktuar sipas detyrës zyrtare, hyjnë në shpenzimet e procedurës penale.

Neni 512

Mbrojtësi i personit juridik në procedurën penale

(1) Personi juridik i akuzuar mund të ketë mbrojtës që e përcakton përfaqësuesi i autorizuar i personit juridik. Kur si përfaqësues i personit juridik sipas detyrës zyrtare nga ana e gjykatës është përcaktuar avokat, ai e kryen edhe funksionin e mbrojtjes së personit të akuzuar juridik.

(2) Personi juridik dhe personi përgjegjës kundër të cilëve mbahet procedurë e vetme për veprën e njëjtë penale, mund të kenë mbrojtës të

përbashkët nëse kjo nuk është në kundërshtim me interesat e mbrojtjes së tyre.

Neni 513

Dorëzimi i dokumenteve

(1) Ftesat dhe dokumentet tjera, si dhe vendimet dorëzohen në adresën në të cilën është regjistruar selia e personit juridik, përkatësisht në adresën e përfaqësuesit të personit juridik. Nëse gjatë procedurës penale personi juridik e ka ndryshuar selinë, është i obliguar që më së voni në afat prej tre ditësh ta njoftojë gjykatën për selinë dhe adresën e re, në të kundërtën do të konsiderohet si e rregullt çdo dërgesë e kryer në adresën paraprake.

(2) Aktvendimi me të cilin personit juridik i shqiptohet dënimi, dorëzohet te përfaqësuesi i personit juridik personalisht. Nëse dërgesa personale mbetet e pasuksesshme, si e rregullt konsiderohet dërgesa e kryer me postë rekomanduese në adresë të personit juridik në të cilën është regjistruar selia e personit juridik ose në adresën e përfaqësuesit të tij.

Neni 514

Arrestimi

Nëse përfaqësuesi i ftuar me rregull i personit juridik nuk lajmërohet në thirrje dhe nuk e arsyeton mungesën e tij, gjykata mundet të urdhërojë arrestimin e tij.

2. Akuzimi dhe seanca kryesore

Neni 515

Përmbajtja e akuzës

Akuza kundër personit juridik duhet ta përmbajë edhe emrin e personit të akuzuar juridik, selinë e tij sipas të dhënave në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, numrin amë, emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit të tij dhe adresën e tij, si dhe shtetësinë dhe numrin e pasaportës së të huajit i përcaktuar si përfaqësues i personit juridik.

Neni 516

Hetimi dhe fjalët përfundimtare

(1) Në seancën kryesore në procedurën e vetme kundër personit juridik dhe personit përgjegjës së pari kryhet marrja në pyetje e personit përgjegjës për secilën pikë nga akuza, e pastaj edhe përfaqësuesi i personit juridik.

(2) Radhitjen e paraqitjes së provave, e përcakton gjykata duke u nisur së pari nga provat që i përkasin personit përgjegjës.

(3) Pas fjalës përfundimtare të mbrojtësit dhe përfaqësuesit të personit të akuzuar juridik, fjalën përfundimtare e ka mbrojtësi i personit përgjegjës dhe personi përgjegjës.

(4) Dispozitat për miratimin e aktgjykimit pa seancë kryesore (neni 497 i këtij ligji) zbatohen edhe në procedurën penale kundër personit juridik.

(5) Gjukata mund të vendosë që nëse është siguruar mbrojtës, seanca kryesore të mbahet edhe pa praninë e përfaqësuesit të personit juridik, nëse është thirrur me rregull e nuk e ka arsyetuar mosardhjen e vet, nëse vlerëson se prania e tij nuk është e domosdoshme.

Neni 517

Masat e sigurisë

(1) Gjatë procedurës gjykata mundet sipas propozimit të prokurorit publik të përcaktojë një ose më shumë masa të përkohshme në pajtim me dispozitat për sigurimin dhe marrjen e përkohshme të sendeve ose pronës nga nenet 194, 195, 196, 197, 198, 199, 200, 201, 202, 203 dhe 204 të këtij ligji, si dhe ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar ose të gjitha veprimtarive të personit juridik deri në mbarimin e procedurës dhe ndalimit për ndryshime statusore në personin juridik. Për ndalimet e shqiptuara kryhet regjistrimi në regjistrin gjyqësor ose në regjistër tjetër.

(2) Ndalimet nga paragrafi (1) të këtij neni, shqiptohen me aktvendim kundër të cilit përfaqësuesi i personit juridik ka të drejtë ankese në afat prej tri ditëve të këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji. Ankesa nuk e ndalon zbatimin e aktvendimit.

3. Aktgjykimi dhe mjetet juridike

Neni 518

Përmbajtja e aktgjykimit të shqiptuar për personin juridik

Aktgjykimi i shqiptuar ndaj personit juridik duhet të përmbajë emrin e personit juridik dhe selinë e tij, numrin amë, emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit të tij dhe adresën e banimit, si dhe shtetësinë dhe numrin e dokumentit të udhëtimit të të huajit të përcaktuar si përfaqësues i personit juridik.

Neni 519

Ndërprerja e procedurës

Gjykata me aktvendim do ta ndërpresë procedurën nëse gjatë procedurës personi juridik ka pushuar së ekzistuari, e nuk ekzistojnë kushte për shqiptimin e dënimit ose masës së konfiskimit të pronës dhe dobisë pronësore ose marrjes së sendeve.

Neni 520

Regjistrimi dhe dorëzimi i ndalimit të shqiptuar të përkohshëm ose të përhershëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar

(1) Aktgjykimi i plotfuqishëm me të cilin personit juridik i shqiptohet ndalim i përkohshëm ose i përhershëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar sipas detyrës zyrtare, gjykata e shkallës së parë e dorëzon pa prolongim te Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë për regjistrimin e dënimit të shqiptuar.

(2) Kur me aktgjykimin është shqiptuar dënimi shuarje e personit juridik, pas plotfuqishmërisë së tij ai pa prolongim i dorëzohet gjykatës kompetente për procedurë të shuarjes së personit juridik.

Neni 521

Mjetet e jashtëzakonshme juridike

Në procedurën penale kundër personit juridik mund të shfrytëzohen mjetet e jashtëzakonshme juridike, kërkesa për përsëritjen e procedurës dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Kreu XXXIV
PROCEDURA PËR ZBATIMIN E MASAVE PËR SIGURI, KONFISKIM TË
PRONËS DHE DOBISË PRONËSORE, MARRJES SË SENDEVE DHE
REVOKIMIN E DËNIMIT ME KUSHT

1.Procedura për zbatimin e masave të sigurisë

Neni 522

Dispozitat e përgjithshme për shqiptimin e masave të sigurisë

(1) Nëse i akuzuari ka kryer veprë penale në gjendje të pavetëdijshme, prokurori publik do të parashtrijë te gjykata propozim që të shqiptojë masë të sigurisë mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtjen e kryerësit në institucionin shëndetësor, përkatësisht propozim për mjekim të detyrueshëm psikiatrik të kryerësit në liri nëse për shqiptimin e masës së atillë ekzistojnë kushtet e parapara me Kodin penal.

(2) Në këtë rast të akuzuarit, nëse gjendet në paraburgim, me aktvendim do t'i ndërpritet paraburgimi, por nuk do të lirohet në liri por deri në mbarimin e procedurës për zbatimin e masave të sigurisë përkohësisht do të vendoset në institucion adekuat shëndetësor ose në ndonjë lokal tjetër të përshtatshëm.

(3) Me masën nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata mund të përcaktojë ndalim të përkohshme të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës ose ndalim të drejtimit të automjetit. Vendimi i gjykatës dorëzohet te organet kompetente ose organizatat në të cilat kryerësi është punësuar ose e cila është kompetente për kryerjen e mbikëqyrjes mbi zbatimin e ndalimit.

(4) Pas parashtrimit të propozimit nga paragrafi (1) të këtij neni, i akuzuari patjetër duhet të ketë mbrojtës.

Neni 523

Shqiptimi i masës së sigurisë dhe ndërprerja e procedurës për zbatimin e saj

(1) Për zbatimin e masave të sigurisë mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtjen në institucion shëndetësor ose mjekim të detyrueshëm psikiatrik në liri, pas seancës së mbajtur kryesore, vendos gjykata që është kompetente për gjykim në shkallë të parë.

(2) Krahas personave që duhet të thirren në seancën kryesore do të thirren si ekspertë edhe mjekë psikiatër nga institucioni shëndetësor të cilit i është ngarkuar ekspertiza në lidhje me vlerësimin e të akuzuarit. I akuzuari do të thirret nëse gjendja e tij është e atillë që të mundet të marrë pjesë në seancën kryesore. Për seancën kryesore do të njoftohet shoku martesor përkatësisht shoku jashtëmartesor i të akuzuarit dhe prindërit e tij, përkatësisht kujdestari, e sipas rrethanave edhe të afërmit tjerë të afërt.

(3) Nëse gjykata, në bazë të provave të bëra vërteton se i akuzuari ka kryer veprë të caktuar penale dhe se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i vetëdijshëm, do të vendosë nëse të akuzuarin, në bazë të hetimit të personave të thirrur dhe konstatimeve dhe mendimeve të ekspertëve, do t'ia shqiptojë masën e sigurisë mjekim të detyruar psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor, përkatësisht mjekim të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Gjatë vendosjes se cilën nga masat e sigurisë do ta shqiptojë, gjykata nuk është e lidhur për propozimin e prokurorit publik.

(4) Nëse gjykata konstaton se i akuzuari nuk ka qenë i vetëdijshëm, do ta ndërpresë procedurën për zbatimin e masave të sigurisë.

5) Kundër aktvendimit të gjykatës në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, mund të paraqesin ankesë të gjithë personat që kanë të drejtë ankese kundër aktgjykimit (neni 411), përveç të dëmtuarit.

Neni 524

Propozimi për shqiptimin e masave të sigurisë për ndryshimin e aktakuzës

Masat e sigurisë nga neni 522 paragrafi (1) të këtij ligji, mund të shqiptohen edhe kur prokurori publik në seancën kryesore do ta ndryshojë aktakuzën përkatësisht propozim�akuzën me parashtrimin e propozimit për shqiptimin e atyre masave.

Neni 525

Shqiptimi i masave të sigurisë në rast të vetëdijes së ulët

Kur gjykata do t'i shqiptojë dënim personit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të konsiderueshme të ulët të vetëdijes, me aktgjykimin e njëjtë do ta shqiptojë edhe masën e sigurisë të mjekimit të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtjen në institucionin shëndetësor ose mjekim të detyrueshëm psikiatrik në liri ose mjekim detyrueshëm të alkoolistëve ose narkomanëve, nëse vërteton se për këtë ekzistojnë kushte ligjore.

Neni 526

Dërgimi i vendimit të plotfuqishëm te gjykata që është kompetente të vendosë për heqjen e aftësisë për punë

Vendimi i plotfuqishëm me të cilin është shqiptuar masa e sigurisë mjekim i detyruar psikiatrik dhe ruajtje në institucionin shëndetësor, përkatësisht mjekim i detyruar psikiatrik në liri në pajtim me nenet 523 dhe 525 të këtij ligji, do të dërgohet te gjykata që është kompetente të vendosë për heqjen e aftësisë për punë. Për vendimin do të njoftohet edhe organi për kujdestari.

Neni 527

Mbikëqyrja e realizimit të masës së sigurisë mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucionin shëndetësor dhe lëshimit të kryerësit

(1) Sipas detyrës zyrtare ose me propozim nga institucioni shëndetësor ose nga organi për kujdestari, e sipas hetimit të prokurorit publik, gjykata që në shkallë të parë ka shqiptuar masë të sigurisë mjekim të detyruar psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor, do ta ndërpresë këtë masë dhe do të përcaktojë lëshim të kryerësit nga institucioni shëndetësor nëse në bazë të mendimit të mjekut përcakton se është ndërprerë nevoja e mjekimit dhe ruajtjes së kryerësit në atë institucion, e mund të përcaktojë mjekim të detyruar të tij psikiatrik në liri.

(2) Kur nga institucioni shëndetësor lëshohet kryerësi vetëdija e të cilit ka qenë tejet e ulët, e në atë institucion ka kaluar më pak kohë se sa që është dënimi me burg në të cilin është dënuar, gjykata me aktvendim për lëshim do

të vendosë nëse ai person do ta mbajë mbetjen e dënimit ose do të lëshohet në lëshim me kusht. Kryerësit i cili lëshohet në lëshim me kusht mundet t'i shqiptohet edhe masë e sigurisë mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri nëse për këtë ekzistojnë kushte ligjore.

(3) Sipas detyrës zyrtare ose me propozim nga drejtoria e institucionit shëndetësor në të cilin i akuzuari është mjekuar ose është dashur të mjekohet, ndërsa me hetimin e prokurorit publik, gjykata mundet kryerësit kundër të cilit është zbatuar masa e sigurisë së mjekimit të detyruar psikiatrik në liri t'i shqiptojë masë të sigurisë së mjekimit të detyruar psikiatrik dhe ruajtjes në institucionin shëndetësor, nëse përcakton se kryerësi nuk i është nënshtruar mjekimit ose e ka lëshuar vullnetarisht ose nëse edhe krahas mjekimit ka mbetur i rrezikshëm për rrethin e tij e është e nevojshme ruajta e tij dhe mjekimi në institucion shëndetësor. Para miratimit të vendimit gjykata sipas nevojës do të sigurojë edhe mendim nga mjeku, ndërsa i akuzuari do të merret në pyetje nëse gjendja e tij këtë e lejon.

Neni 528

Zbatimi i masës së sigurisë mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve

(1) Për zbatimin e masës së sigurisë mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve, gjykata vendos pasi që të sigurojë konstatim dhe mendim nga eksperti. Eksperti duhet të shprehet edhe për mundësitë për mjekim të të akzuarit.

(2) Nëse gjatë shqiptimit të dënimit me kusht të kryerësit i është urdhëruar mjekim në liri, ndërsa ai nuk i është nënshtruar mjekimit ose me vet dëshirë e ka lëshuar, gjykata mundet sipas detyrës zyrtare ose me propozim të institucionit në të cilin kryerësi është mjekuar ose është dashur të mjekohet, e pas hetimit të prokurorit publik dhe të kryerësit ta përcaktojë revokimin e dënimit me kusht ose kryerjen e detyrueshme të masës së shqiptuar mjekim të detyrueshëm të alkoolistëve ose narkomanëve në institucionin shëndetësor ose në institucion tjetër të specializuar. Para miratimit të vendimit gjykata sipas nevojës do të sigurojë edhe mendim prej mjekut.

2. Procedura për marrjen e sendeve dhe konfiskimin e pronës dhe dobisë pronësore të fituar me vepër penale

Neni 529

Marrja e sendeve

(1) Sendet që sipas Kodit penal duhen të merren, do të merren edhe kur procedura penale nuk do të mbarojë me aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor.

(2) Aktvendim të posaçëm për këtë miraton organi para të cilit është mbajtur procedura në momentin kur procedura është kryer, përkatësisht kur është ndërprerë.

(3) Aktvendimin për marrjen e sendeve nga paragrafi (1) të këtij neni e miraton gjykata edhe kur në aktgjykimin me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor, është lëshuar marrja e vendimit të atillë.

(4) Kopjave vërtetuar e vendimit për marrjen e sendeve do të dorëzohet te pronari i sendeve nëse pronari është i njohur.

(5) Kundër vendimit nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, pronari i sendeve ka të drejtë ankese për shkak të mosekzistimit të bazës ligjore për marrjen e sendeve. Nëse aktvendimin nga paragrafi (2) i këtij neni nuk e ka miratuar gjykata, për ankesën vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji i gjykatës që ka qenë kompetente për gjykimin në shkallë të parë.

Neni 530

Dispozitat e përgjithshme për konfiskimin e pronës dhe dobisë pronësore

(1) Prona dhe dobia pronësore të siguruara me kryerjen e veprës penale përcaktohen në procedurën penale sipas detyrës zyrtare.

(2) Prokurori publik është i obliguar që gjatë procedurës të grumbullojë prova dhe t'i vëzhgojë rrethanat që janë me rëndësi për përcaktimin e pronës dhe dobisë pronësore dhe të propozojë masa nga neni 202 paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Nëse i dëmtuar ka paraqitur kërkesë pronësore-juridike në lidhje me kthimin e sendeve të siguruara me vepër penale, përkatësisht në lidhje me shumën që i përgjigjet vlerës së sendeve, dobia pronësore do të përcaktohet vetëm në atë pjesë që nuk është përfshirë me kërkesën pronësore-juridike.

Neni 531

Procedura për konfiskimin e pronës dhe dobisë pronësore të fituar me vepër penale

(1) Gjatë konfiskimit të pronës dhe dobisë pronësore të siguar me vepër penale personi mbi të cilin është bartur dobia pronësore, si dhe përfaqësuesi i personit juridik, do të thirren për marrje në pyetje në procedurën paraprake dhe në seancën kryesore. Në thirrje do të paralajmërohen se procedura do të zbatohet edhe pa praninë e tyre.

(2) Përfaqësuesi i personit juridik do të merret në pyetje në seancën kryesore pas të akuzuarit. Në të njëjtën mënyrë do të veprohet në lidhje me personin mbi të cilin është bartur dobia pronësore nëse nuk është thirrur si dëshmitar.

(3) Personi mbi të cilin është bartur dobia pronësore si dhe përfaqësuesi i personit juridik, janë të autorizuar që në lidhje me përcaktimin e dobisë pronësore të propozojnë prova edhe pas autorizimit të kryetarit të këshillit t'i parashirojnë pyetje të akuzuarit, dëshmitarëve dhe ekspertëve.

(4) Përshtimi i publikut në seancën kryesore nuk ka të bëjë me personin mbi të cilin janë bartur prona dhe dobia pronësore dhe përfaqësuesit të personit juridik.

(5) Kur gjatë seancës kryesore konstatohet se ekzistojnë kushte për zbatimin e masës konfiskimi i pronës dhe dobisë pronësore, prokuroro publik do të propozojë që seanca kryesore të ndërpritet dhe të thirret personi mbi të cilin janë bartur prona dhe dobia pronësore si dhe përfaqësuesi i personit juridik.

Neni 532

Përcaktimi i lartësisë së shumës së pronës dhe dobisë pronësore

(1) Prokurorim publik në grumbullimin e provave të nevojshme për përcaktimin e lartësisë së shumës së pronës dhe dobisë pronësore të fituara me veper penale, mund të kërkojë njoftime të nevojshme nga organe tjera

shtetërore, institucione financiare, persona tjerë juridikë dhe qytetarë, të cilët detyrohen që pa prolongim të njëjtat t'i ofrojnë.

(2) Kur ekziston dyshim se prona gjendet jashtë vendit, gjykata është e obliguar që të lëshojë urdhërarresti ose shpallje ndërkombëtare.

Neni 533

Konfiskimi i zgjeruar

(1) Gjkata do të shqiptojë masë të konfiskimit të zgjeruar nën kushtet e përcaktuara në Kodin penal, nëse i akuzuari në afat prej një viti nga dita e fillimit të seancës kryesore nuk mund të dëshmojë se prona ose dobia pronësore janë të fituara me ligj.

(2) Nëse në afatin më të shkurtër se afati nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata miraton aktgjykim të shkallës së parë për veprën penale, kur ekzistojnë kushte ligjore për shqiptimin e masës konfiskim i zgjeruar, gjykata atë masë do ta shqiptojë me aktgjykim plotësues kundër të cilit lejohet ankesë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 534

Shqiptimi i masës konfiskim i zgjeruar ndaj personit të tretë

(1) Gjkata me aktvendim do të shqiptojë masë konfiskim të zgjeruar me kushtet e përcaktuara në Kodin penal edhe kundër personit të tretë, nëse në afat prej dy vjetësh nga dita e fillimit të procedurës së posaçme për konfiskim, nuk dëshmon se për pronën ose dobinë pronësore ka dhënë kundërkompensim që i përgjigjet vlerës së tyre.

(2) Procedura për shqiptimin e masës konfiskim i zgjeruar mbahet sipas propozimit të prokurorit publik.

(3) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij neni, personi ka të drejtë ankese drejtpërdrejt te gjykata më e lartë në afat prej tetë ditësh.

Neni 535

Caktimi i masave të përkohshme të sigurisë

1) Kur janë plotësuar kushtet për konfiskim ose konfiskim të zgjeruar të pronës dhe dobisë pronësore, gjykata sipas detyrës zyrtare do të urdhërojë masa të përkohshme të sigurimisë të përcaktuara me nenin 194 të këtij ligji.

(2) Masat nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata mundet t'i caktojë kundër personave të tretë për të cilët ekziston dyshim se mbi ta janë bartur prona dhe dobia pronësore, të siguruara me veprën penale pa kompensim adekuat.

(3) Kundër aktvendimit me të cilin gjykata cakton masa të përkohshme të sigurisë, mund të parashtrohet ankesë në afat prej tetë ditëve.

(4) Vendimi sipas ankesës gjykata drejtpërdrejt më e lartë do ta miratojë në afat prej tetë ditëve.

Neni 536

Përmbajta e vendimit me të cilin është shqiptuar konfiskimi i pronës dhe dobisë pronësore

(1) Konfiskim të dobisë pronësore gjykata mund të shqiptojë në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, me aktvendimin për vërejtje

gjyqësore ose aktvendimin për zbatimin e masës edukative, si dhe aktvendimin me të cilin shqiptohet masa e sigurisë.

(2) Në shqiptimin e aktgjykimit ose të aktvendimit gjykata do të theksojë cila pronë ose send, përkatësisht shumë në para konfiskohet.

(3) Kopja e vërtetuar e aktgjykimit, përkatësisht e aktvendimit i dorëzohet edhe personit mbi të cilin është bartur dobia pronësore, si edhe përfaqësuesit të personit juridik, nëse gjykata ka shqiptuar konfiskim të pronës ose dobisë pronësore nga ai person, përkatësisht nga personi juridik.

Neni 537

Kërkesa për përsëritjen e procedurës në lidhje me vendimin për konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore

Personi nga neni 531 të këtij ligji, mund të parashtrojë kërkesë për përsëritjen e procedurës penale sipas nenit 449 të këtij ligji, në pikëpamje të vendimit për konfiskimin e pronës dhe dobisë pronësore.

Neni 538

Zbatimi përkatës i dispozitave të këtij ligji në lidhje me ankesën

Dispozitat e nenit 412 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji dhe neneve 420 dhe 424 të këtij ligji, në mënyrë përkatëse do të zbatohen në ankesën kundër vendimit për konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore.

Neni 539

Zbatimi përkatës i dispozitave tjera të këtij ligji

Nëse në dispozitën e këtij kapitulli nuk është paraparë diçka tjetër në lidhje me procedurën për zbatimin e masave të sigurisë ose për konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore, në mënyrë përkatëse do të zbatohen dispozitat tjera të këtij ligji, nëse me dispozitat e këtij ligji nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 540

Procedura e veçantë për konfiskimin e pronës dhe dobisë pronësore dhe marrjen e sendeve

(1) Kur ekzistojnë pengesa faktike ose juridike për mbajtjen e procedurës penale kundër kryerësit të veprës penale, gjykata sipas propozimit të prokurorit publik do të zbatojë procedurë të veçantë për konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore dhe marrjen e sendeve, nëse janë përmbushur kushtet për zbatimin e këtyre masave të veçanta nga Kodi penal.

(2) Në procedurën nga paragrafi (1) të këtij neni, me propozim të prokurorit publik do të nxirren provat e nevojshme. Gjkata me aktvendim do të shqiptojë masë konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore dhe marrjen e sendeve, nëse dëshmohet se bëhet fjalë për pronë ose dobi pronësore të fituara me veprën penale, ose për sende të cilat janë përdorur ose janë krijuar me kryerjen e veprës penale ose duhet të konfiskohen sipas dispozitave të Kodit penal.

(3) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) të këtij neni, personi prej të cilit konfiskohet prona ose dobia pronësore ose merren sendet, ka të drejtë ankese te gjykata drejtpërdrejt më e lartë në afat prej tetë ditësh.

Neni 541

Realizimi i konfiskimit të pronës dhe dobisë pronësore

(1) Konfiskimi i pronës dhe dobisë pronësore realizohet në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

(2) Urdhër për zbatim e lëshon gjykata që e ka miratuar aktgjykimin e plotfuqishëm.

(3) Realizimi zbatohet mbi pronën dhe dobinë pronësore të përcaktuara me vendim gjyqësor, e nëse kjo është pjesërisht ose plotësisht nuk është e mundur, realizimi zbatohet nga prona e mbetur e personit të cilit i është shqiptuar masa e atillë.

(4) Kundërshtimi ndaj zbatueshmërisë nuk lejohet, ndërsa realizimi me detyrim do të ndërpritet vetëm nëse personi vullnetarisht e kthen pronën ose e paguan lartësinë e dobisë pronësore në llogari të gjykatës. Bankat dhe institucionet tjera financiare në të cilat është llogaria në të cilën është realizuar kjo masë, janë të obliguara që ta kryejnë pa asnjë prolongim dhe të pengojnë bartjen eventuale ose transaksionet financiare.

(5) Veprat juridike të lidhura pas kryerjes së veprës penale, e me qëllim të zvogëlimit të vlerës së pronës që është lëndë e konfiskimit, janë të pavlefshme.

(6) Kundërshtimi është i lejuar vetëm për urdhrin me të cilin përcaktohet përmbarimi mbi pronën e mbetur.

(7) Kundërshtimi parashtrohet në afat prej tetë ditëve të gjykata drejtpërdrejt më e lartë, i cili vendimin e miraton në afat prej tetë ditëve.

3. Procedura për revokimin e dënimit me kusht

Neni 542

Dispozita e përgjithshme

(1) Kur në dënimin me kusht është përcaktuar se dënimi do të zbatohet nëse i dënuari nuk e kthen dobinë pronësore, nuk e kompenzon dënimin ose nuk plotëson kushte tjera, e i dënuari në afatin e përcaktuar nuk i përmbush këto kushte, gjykata që ka gjykuar në shkallë të parë do të zbatojë procedurë për revokimin e akuzës me kusht me propozim nga paditësi i autorizuar, e mundet edhe sipas detyrës zyrtare.

(2) Gjykatësi i cili do të përcaktohet për këtë do ta marrë në pyetje të dënuarin nëse është i kapshëm dhe do t'i zbatojë kontrollet e nevojshme për vërtetimin e fakteve dhe grumbullimin e provave të rëndësishme për vendimin.

(3) Pastaj kryetari i këshillit do të caktojë seancë të këshillit për të cilën do t'i njoftojë paditësin, të dënuarin dhe të dëmtuarin. Mosardhja e palëve dhe të dëmtuarit nëse janë të njoftuar me rregull, nuk e pengon mbajtjen e seancës së këshillit.

(4) Nëse gjykata vërteton se i dënuari nuk e ka përmbushur obligimin që i është përcaktuar me aktgjykim, do të miratojë aktgjykim me të cilin do ta vazhdojë afatin për përmbushjen e obligimit, do ta lirojë nga përmbushja e atij obligimi ose do ta zëvendësojë me detyrë tjetër adekuate të paraparë me ligj, ose do ta revokojë dënimin me kusht dhe do të përcaktojë dënimi i përcaktuar të zbatohet. Nëse gjykata konstaton se nuk ka bazë për miratimin e ndonjë prej këtyre vendimeve, me aktvendim do ta ndërpresë procedurën për revokimin e dënimit me kusht.

Kreu XXXV
PROCEDURA PËR MIRATIMIN E VENDIMIT PËR KOHËZGJATJE MË TË
SHKURTËR TË DËNIMIT TË NDALIMIT, NDËRPRERJEN E PASOJAVE
JURIDIKE NGA DËNIMI DHE SHLYERJEN E DËNIMIT

Neni 543

Aktvendimi për shlyerjen e dënimit

(1) Kur sipas ligjit shlyerja e dënimit paraqitet me kalimin e kohës së caktuar dhe me kusht që i dënuari në atë kohë të mos kryejë vepër të re penale, aktvendim për shlyerjen e dënimit miraton sipas detyrës zyrtare gjykata si organ kompetent për mbajtjen e evidencës ndëshkuese.

(2) Para miratimit të aktvendimit për shlyerjen e dënimit do të realizohen kontrollet e nevojshme, e posaçërisht do të grumbullohen të dhëna për atë nëse kundër të dënuarit është në vazhdim procedura penale për ndonjë vepër të re penale, të kryer para skadimit të afatit të paraparë për shlyerjen e akuzës.

Neni 544

Kërkesa për të vërtetuar se shlyerja e dënimit ka ndodhur sipas ligjit

(1) Nëse gjykata nuk miraton aktvendim për shlyerjen e dënimit, personi i dënuar mund të kërkojë që të përcaktohet se shlyerja e dënimit ka ndodhur sipas ligjit.

(2) Për këtë kërkesë vendos gjykata pas hetimit të prokurorit publik, nëse procedura është mbajtur me kërkesë të tij.

Neni 545

Aktvendimi me të cilin vërtetohet shlyerja e dënimit me kusht

Nëse dënimi me kusht nuk revokohet as pas një viti nga dita e ndërprerjes së kohës për kontroll, gjykata që ka gjykuar në shkallë të parë do të miratojë aktvendim me të cilin vërtetohet shlyerja e dënimit me kusht. Ky aktvendim do të dorëzohet te i dënuari dhe te prokurori publik, nëse procedura është mbajtur me kërkesë të tij.

Neni 546

Procedura për shlyerjen e dënimit

(1) Procedurë për shlyerjen e dënimit në bazë të vendimit gjyqësor, ngritët me kërkesë të të dënuarit.

(2) Kërkesa parashtrohet te gjykata që ka gjykuar në shkallë të parë.

(3) Gjykatësi i cili do të përcaktohet për këtë, paraprakisht do të hetojë nëse ka kaluar koha e nevojshme sipas ligjit, e pastaj do t'i zbatojë kontrollet e nevojshme, do t'i vërtetojë faktet në të cilat thirret kërkuesi dhe do të sigurojë prova për të gjitha rrethanat që janë të vlefshme për vendimin.

(4) Gjkata mundet për sjelljen e të dënuarit të kërkojë raport nga gjykatat në rajonin e të cilave i dënuari ka qëndruar pas vuajtjes së dënimit, e mundet raport të atillë të kërkojë edhe nga drejtoria e institucionit në të cilin i dënuari e ka vuajtur dënimin.

(5) Pas kontrolleve të bëra dhe pas hetimit të prokurorit publik, nëse procedura është mbajtur me kërkesë të tij, gjykatësi do t'i dorëzojë

dokumentet me propozimin e arsyetuar te këshilli që ka gjykuar në shkallë të parë.

(6) Kundër vendimit të gjykatës pas kërkesës për shlyerjen e dënimit, ankesë mund të parashtrojë lutësi dhe prokurori publik.

(7) Nëse gjykata e refuzon kërkesën pasi që i dënuari me sjelljen e tij nuk ka merituar shlyerje të dënimit, i dënuari mundet kërkesën ta përsërisë pas skadimit të dy viteve nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për refuzim të lutjes.

(8) Në vërtetimin që i lëshohet qytetarëve për shlyerje të dënimit në bazë të evidencës ndëshkuese, për realizimin e të drejtave të tyre në shtetet tjera, dënimi i shlyer nuk guxon të përmendet.

Neni 547

Procedura për kohëzgjatje më të shkurtër të dënimeve për ndalimin e kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës, ndalimin e drejtimit të automjetit ose për ndërprerjen e pasojave juridike të dënimit dhe për shlyerjen e dënimit

(1) Kërkesa për kohëzgjatje më të shkurtër të dënimeve për ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës, ndalim të drejtimit me automjet ose për ndërprerjen e pasojave juridike të dënimit dhe për shlyerjen e dënimit, parashtrohet te gjykata që ka gjykuar në shkallë të parë.

(2) Gjykatësi i cili do të përcaktohet për këtë, paraprakisht do të hetojë nëse ka kaluar koha e nevojshme sipas ligjit, ndërsa do t'i realizojë kontrollet e nevojshme, do t'i vërtetojë faktet në të cilat thirret kërkuesi dhe do të sigurojë prova për të gjitha rrethanat që janë të vlefshme për vendimin.

(3) Për sjelljen e të dënuarit gjykatësi mund të kërkojë raport nga gjykatat në rajonin e të cilit i dënuari ka qëndruar pas vuajtjes, faljes ose dënimit të parashkruar kryesor, ndërsa mundet raport të atillë të kërkojë edhe nga institucioni në të cilin i dënuari e ka vuajtur dënimin.

(4) Pas kontrolleve të zbatuara, e pas hetimit të prokurorit publik, nëse procedura është mbajtur me kërkesë të tij, gjykatësi do t'i dorëzojë dokumentet me propozim të arsyetuar, te gjykata kompetente për miratimin e aktvendimit për kërkesën nga paragrafi (1) të këtij neni.

(5) Gjykata nga paragrafi (4) të këtij neni, më parë do të sigurojë mendim nga prokurori publik nëse procedura është mbajtur me kërkesë të tij, i cili vepron para asaj gjykate.

Neni 548

Refuzimi i lutjes

Në rast të refuzimit të kërkesës, kërkesë e re nuk mund të parashtrohet para skadimit të një viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për refuzimin e kërkesës së mëparshme.

Kreu XXXVI
PROCEDURA PËR KOMPENSIM TË DËMIT, REHABILITIM DHE PËR
REALIZIMIN E TË DREJTAVE TJERA TË PERSONAVE TË DËNUAR
PADREJTËSISHT DHE TË PRIVUAR NGA LIRIA NË MËNYRË TË PABAZË
DHE TË PALIGJSHME

Neni 549

Personat të cilët kanë të drejtë kompensimi të dëmit për shkak të dënimit të pabazë

(1) Të drejtë kompensimi për shkak të dënimit të paarsyeshëm ka personi kundër të cilit është shqiptuar sanksion penal i plotfuqishëm ose i cili është shpallur fajtor e është liruar nga dënimi, kurse më vonë pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik procedura e re është ndërprerë në mënyrë të plotfuqishme ose me aktgjykim të plotfuqishëm është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, vetëm në rastet nëse:

1) deri në ndërprerjen e procedurës ose aktgjykimit me të cilin akuza refuzohet ka ardhur për shkak se në procedurën e re paditësi privat ka heq dorë nga ndjekja, ose i dëmtuari ka heq dorë nga propozimi e në heqjen dorë ka ardhur në bazë të marrëveshjes me të akuzuarin dhe

2) me aktvendim në procedurën e re aktakuza është hedhur posht për shkak se gjykata nuk ka qenë kompetente, ndërsa paditësi i autorizuar e ka filluar ndjekjen para gjykatës kompetente.

(2) I dënuari nuk ka të drejtë kompensimi të dëmit nëse me pranimin e tij të rrejshëm ose në mënyrë tjetër me qëllim e ka shkaktuar akuzës e vet, përveç nëse në atë ka qenë i detyruar.

(3) Në rast të akuzës për vepra penale në varg, e drejta e kompensimit të dëmit mund t'i përkasë edhe veprave penale të veçanta, në lidhje me të cilat janë përmbushur kushtet për pranimin e kompensimit.

Neni 550

Parashtrimi i kërkesës për kompensim të dëmit

(1) E drejta e kompensimit të dëmit parashkruhet për tre vjet nga dita e aktgjykimit të plotfuqishëm me të cilin i akuzuari është liruar nga akuza ose me të cilën akuza është refuzuar, përkatësisht në afat prej tre vjetëve nga plotfuqishmëria e aktvendimit me të cilin aktakuza ka qenë e refuzuar ose procedura është ndërprerë, e nëse në rast ankese ka vendosur gjykata më e lartë, në afat prej tre vjetëve nga dita e pranimin të vendimit të gjykatës më të lartë.

(2) Para parashtrimit të ankesës për kompensim të dëmit në gjykatë, i dëmtuari është e obliguar që me kërkesë të tij të drejtohet te Ministria e Drejtësisë për arritjen e marrëveshjes për ekzistimin e dëmit dhe për llojin dhe lartësinë e kompensimit.

(3) Në rastin nga neni 549 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji, për kërkesën mund të vendoset vetëm nëse paditësi i autorizuar nuk ka ndërmarrë ndjekje para gjykatës kompetente në afat prej tre muajve nga dita e pranimin të vendimit të plotfuqishëm. Nëse pas skadimit të këtij afati paditësi i autorizuar e ndërmerr ndjekjen para gjykatës kompetente pas skadimit të këtij afati, do të ndërpritet procedura për kompensim të dëmit deri në përfundimin e procedurës penale.

Neni 551

Parashtrimi i padisë për kompensim të dëmit

(1) Nëse ërkesa për kompensim të dëmit nuk miratohet ose për të Ministria e Drejtësisë nuk miraton vendim në afat prej tre muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës, i dëmtuari mundet te gjykata kopmetente të parashtrojë padi për kompensim të dëmit. Nëse është arritur marrëveshje vetëm në pikëpamje të një pjese të kërkesës, i dëmtuari mund të parashtrojë padi në lidhje me mbetjen tjetër të kërkesës.

(2) Derisa zgjat procedura nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk rrjedh parashkrimi i paraparë në nenin 551 paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Padia për kompensim të dëmit parashtrohet kundër Republikës së Maqedonisë.

Neni 552

Të drejtat e trashëgimtarëve të personit të dëmtuar

(1) Trashëgimtarët e trashëgojnë vetëm të drejtën e personit të dëmtuar në kompensimin e dëmit të pronës. Nëse i dëmtuari tanimë ka parashtruar kërkesë, trashëgimtarët mund ta vazhdojnë procedurën vetëm në kufijtë e kërkesës tanimë të parashtruar për kompensimin e dëmit të pronës.

(2) Trashëgimtarët e personit të dëmtuar munden pas vdekjes së tij ta vazhdojnë procedurën për kompensim të dëmit, përkatësisht të ngritin procedurë nëse personi i dënuar ka vdekur para skadimit të afatit të parashkrimit dhe nga kërkesa nuk ka heq dorë.

Neni 553

E drejta e kompensimit të dëmit personave të cilët janë privuar nga liria në mënyrë të pabazë

(1) E drejta e kompensimit të dëmit i takon personit, i cili:

1) ka qenë në paraburgim e nuk ka ardhur deri në ngritjen e procedurës penale ose procedura është ndërprerë ne aktvendim të plotfuqishëm, ose me aktgjykim të plotfuqishëm është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar;

2) e ka vuajtur dënimin privim nga liria, e me rastin e përsëritjes së procedurës penale, kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë ose kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotfuqishëm, i është shqiptuar dënimi privim nga liria në kohëzgjatje më të shkurtër nga dënimi që e ka vuajtur, ose i është shqiptuar sanksion penal i cili nuk ka të bëjë me privimin nga liria ose është shpallur fajtor, ndërsa është liruar nga dënimi;

3) për shkak të gabimit ose punës së paligjshme të organit në mënyrë të pabazë ose paligjshme është privuar nga liria, ose është mbajtur më gjatë në paraburgim ose në institucionin për vuajtjen e dënimit ose masës dhe

4) në paraburgim ka kaluar kohë më të gjatë se sa zgjat dënimi me burg me të cilën është dënuar.

(2) Personit të cilit sipas nenit 158 të këtij ligji është privuar nga liria pa bazë ligjore, i takon e drejta e kompensimit të dëmit nëse kundër tij nuk është përcaktuar paraburgimi as që koha për të cilën është privuar nga liria i është llogaritur në dënimin e shqiptuar për veprën penale ose për kundërvajtjen.

(3) Kompensim i dëmit nuk i takon personit i cili me veprimet e tija të palejuara ka shkaktuar privim nga liria. Në rastet nga paragrafi (1) pika 1 të këtij neni, përjashtohet e drejta e kompensimit të dëmit edhe pse kanë

ekzistuar rrethanat nga neni 549 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, ose nëse procedura është ndërprerë në bazë të nenit 304 të këtij ligji.

(4) Në procedurën për kompensim të dëmit në rastet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, në mënyrë përkatëse do të zbatohen dispozitat nga ky kapitull.

Neni 554

Shpallja e vendimit për pabazueshmërinë e dënimit paraprak në mjetet publike dhe dorëzimi i vendimit te personat tjerë

(1) Nëse rasti të cilit i përket dënimi i paarsyeshëm ose privimi i pabazë ose i paligjshëm nga liria i ndonjë personi është publikuar në mjet publik për informim dhe me këtë është cenuar autoriteti i atij personi, gjykata me kërkesë të tij do të publikojë në gazeta ose në mjete tjera publike për informim, njoftim për vendimin nga i cili rrjedh paarsyeshmëria e dënimit të mëparshëm përkatësisht pabazueshmëria ose e paligjshmëria e privimit nga liria. Nëse rasti nuk është publikuar në mjetet për informim publik, njoftimi i këtillë me kërkesë të atij personi, do të dorëzohet te punëdhënësi i tij. Pas vdekjes së personit të dënuar e drejta e parashtrimit të kësaj kërkesë i takon shokut martesor, përkatësisht jashtëmartesor, fëmijëve, prindërve, vëllezërve dhe motrave.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) të këtij neni mund të parashtrohet edhe nëse nuk është parashtruar kërkesë për kompensim të dëmit.

(3) Pavarësisht nga kushtet e parapara në nenin 549 të këtij ligji, kërkesa nga paragrafi (1) të këtij neni mund të parashtrohet edhe kur me rastin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik është ndryshuar kualifikimi juridik i veprës, nëse për shkak të kualifikimit juridik në aktgjykimin e mëparshëm është shkelur rëndë autoriteti i personit të dënuar.

(4) Kërkesa nga paragrafi (1) të këtij neni, parashtrohet në afat prej gjashtë muajve (neni 550 paragrafi (1) të këtij ligji) te gjykata që në procedurën penale ka gjykuar në shkallë të parë. Për kërkesën vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji. Gjatë vendosjes për kërkesën në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e nenit 549 paragrafët (2) dhe (3) dhe të nenit 553 paragrafi (3) të këtij ligji.

Neni 555

Abrogimi i dënimit të padrejtë nga evidenca ndëshkuese

(1) Gjykata që në procedurën penale ka gjykuar në shkallë të parë do të miratojë sipas detyrës zyrtare aktvendim me të cilin abrogohet regjistrimi i akuzës së padrejtë në evidencën ndëshkuese. Aktvendimi dorëzohet te Ministria e Drejtësisë.

(2) Për regjistrimin e abroguar nuk guxohet askujt t'i jepen të dhënat nga evidenca ndëshkuese.

Neni 556

Kufizimi i shqyrtimit dhe kopjimit të dokumenteve

Personit të cilit i është lejuar shqyrtimi dhe kopjimi i dokumenteve (neni 123) që i përkasin dënimi të padrejtë ose privimit të pabazë ose të paligjshëm nga liria, nuk mund të shfrytëzojë të dhëna nga ato dokumente në mënyrë që do të jetë e dëmshme për rehabilitimin e personit kundër të cilit është mbajtur procedurë penale. Kryetari i gjykatës është i obliguar që për këtë ta

paralajmërojnë personin të cilit i është lejuar shqyrtimi, dhe kjo do të shënohet në dokument, me nënshkrimin e atij personi.

Neni 557

Kthimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës dhe sigurimit social

(1) Personit të cilit për shkak të kauzës së padrejtë ose privimit të pabazë nga liria i ka pushuar marrëdhënia e punës ose roli i personit të siguruar të sigurimit social, i pranohet stazhi i punës, përkatësisht stazhi i sigurimit sikur të kishte qenë në punë gjatë kohës për të cilën për shkak të akuzës së padrejtë ose privimit të pabazë nga liria e ka humbur stazhin. Në stazh llogaritet edhe koha e papunësisë që ka ndodhur për shkat të dënimit të padrejtë ose privimit të pabazë nga liria, e cila nuk ka ndodhur me fajin e atij personi.

(2) Gjatë secilës vendimmarrje për të drejtën në të cilën ndikon kohëzgjatja e stazhit të punës, përkatësisht të stazhit të sigurimit, organi kompetent ose personi juridik do ta marrë parasysh stazhin e pranuar me dispozitën e paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Nëse organi ose personi juridik nga paragrafi (2) të këtij neni nuk e merr parasysh stazhin e pranuar me dispozitën e paragrafit (1) të këtij neni, personi i dëmtuar mund të kërkojë që gjykata në nenin 551 paragrafi (1) të këtij ligji të përcaktojë se pranimi i kësaj kohe ka ndodhur sipas ligjit. Padia parashtrohet kundër organit ose personit juridik i cili e konteston stazhin e pranuar dhe kundër Republikës së Maqedonisë (neni 551 paragrafi (3)).

(4) Me kërkesë të organit, përkatësisht personit juridik të cili e drejta nga paragrafi (2) të këtij neni realizohet, do të paguhet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë kontributi i përcaktuar për kohën për të cilën me dispozitën e paragrafit (1) të këtij neni stazhi është pranuar.

(5) Stazhi i sigurimit i pranuar me dispozitën e paragrafit (1) të këtij neni, në tërësi llogaritet në stazhin e pensionit.

Kreu XXXVII

FLETARRESTIMI DHE SHPALLJA

Neni 558

Njoftimi për adresën e personit të cilit nuk i dihet vendbanimi ose vendqëndrimi

Nëse nuk dihet vendbanimi përkatësisht vendqëndrimi i të dyshuarit, përkatësisht të dënuarit ose dëshmitarit kur kjo sipas dispozitave të këtij ligji është e domosdoshme, organi që e mban procedurën do të kërkojë nga Ministria e Punëve të Brendshme që të dyshuarin, përkatësisht të akuzuarin ose dëshmitarin ta kërkojë dhe ta njoftojë për adresën e tij.

Neni 559

Lëshimi i fletarrestimit

(1) Lëshimi i fletarrestimit mund të urdhërohet kur ekziston urdhër për arrestim të personit i cili gjendet në arrati, dhe atë:

1) të dyshuarit i cili kërkohet për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer vepër penale i cila ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe për të cilën sipas ligjit mund të shqiptohet dënim me burg prej tre vjetësh ose më i rëndë, ose

2) të akuzuarit kundër të cilit është ngritur procedurë penale për vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe për të cilën sipas ligjit mund të shqiptojë dënim me burgim prej tre vjetësh ose dënim më i rëndë, ose

3) personit të dënuar që me aktgjykim të plotfuqishëm është dënuar me dënim me burg.

(2) Lëshimin e fletarrestimit urdhëron organi që e udhëheq procedurën.

(3) Lëshimi i fletarrestimit do të urdhërohet edhe në rast të arratisë së të akuzuarit, përkatësisht të dënuarit nga institucioni në të cilin e vuan dënimin pa marrë parasysh lartësinë e dënimit, ose arratisë nga institucioni në të cilin gjendet personi i privuar nga liria. Urdhër në këtë rast lëshon personi udhëheqës i institucionit.

(4) Lëshimi i fletarrestimit do të urdhërohet edhe në rast të arratisë së të akuzuarit, përkatësisht të dënuarit nga institucioni në të cilin është dërguar me akt gjyqësor në institucionin shëndetësor me masën mjekim të detyrueshme psikiatrik dhe ruajtje në institucionin shëndetësor. Urdhrin e lëshon gjykata me urdhrin e së cilës personi është dërguar në institucionin pas njoftimit të marrë paraprakisht për ikje nga institucioni.

(5) Urdhri i organit që e udhëheq procedurën ose personit udhëheqës të institucionit për lëshimin e fletarrestimit, dorëzohet te Ministria e Punëve të Brendshme për zbatim.

(6) Ministria e Punëve të Brendshme mban evidencë për fletarrestimet e lëshuara. Të dhënat për personat kundër të cilëve është lëshuar fletarrestimi shlyhen nga evidenca kur fletarrestimi shfuqizohet.

Neni 560

Lëshimi i shpalljes për përcaktimin e të dhënave për pronën dhe dobinë pronësore

Nëse nevojiten të dhëna për pronën dhe dobinë pronësore për të cilat ekziston dyshim se janë siguruar me vepër penale ose për sende të veçanta që janë në lidhje me veprën penale, ose pronën dhe dobinë pronësore të atillë ose sendet që duhet të gjenden, organi që e mban procedurën sipas detyrës zyrtare do të urdhëroj lëshim të shpalljes në të cilën do të kërkohet që të dhënat ose njoftimet të dorëzohen te organi që e mban procedurën.

Neni 561

Lëshimi i shpalljes për vërtetimin e identitetit

(1) Ministria e Punëve të Brendshme lëshon shpallje për vërtetimin e identitetit të kufomave të panjohura dhe të personave identiteti i të cilëve nuk është i njohur.

(2) Ministria e Punëve të Brendshme mund të publikojë edhe fotografi të trupave edhe të personave të zhdukur, nëse ekzistojnë baza të dyshimit se në vdekjen, përkatësisht në zhdukjen e atyre personave ka ardhur për shkak të veprës penale.

Neni 562

Tërheqja e fletarrestimit ose shpalljes

Organi që e ka urdhëruar lëshimin e fletarrestimit, ose shpalljes është i detyruar që menjëherë ta tërheqë kur të gjendet personi i kërkuar ose prona dhe dobia pronësore ose sendi, ose kur të ndodhin parashkrimi i ndjekjes

penale ose i zbatimit të dënimit ose shkaqe tjera për të cilat fletarrestimi ose shpallja tanimë nuk janë të nevojshme.

Neni 563

Lëshimi i fletarrestimit dhe shpalljes

(1) Fletarrestimin dhe shpalljen i lëshon Ministria e Punëve të Brendshme.

(2) Për njoftimin e publikut për fletarrestimin ose shpalljen, mund të shfrytëzohen mjetet për informim publik.

Neni 564

Lëshimi i fletarrestimit dhe shpalljes ndërkombëtare dhe lëshimi i fletarrestimit dhe shpalljes me kërkesë të organit të huaj

(1) Nëse është e mundur që personi për të cilin është lëshuar fletarrestimi të gjendet jashtë vendit, Ministria e Punëve të Brendshme mund të lëshojë edhe fletarrestim ndërkombëtar pas deklaratës së marrë paraprakisht nga organi që e ka lëshuar urdhrin për lëshimin e fletarrestimit se në rast të gjetjes së atij personi do të kërkohet ekstradim.

(2) Nëse është e mundur që prona dhe dobia pronësore ose sendet të gjenden jashtë vendit, lëshohet shpallje ndërkombëtare të cilës i bashkëngjitet deklarata se në rast të gjetjes së tyre do të kërkohen masa të përkohshme për ngrirje ose konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore ose marrje të sendeve.

(3) Me kërkesë nga organi i huaj, Ministria e Punëve të Brendshme mund të lëshojë fletarrestim edhe për personin për të cilin ekziston dyshim se gjendet në Republikën e Maqedonisë nëse në kërkesë është dhënë deklaratë se në rast të gjetjes së atij personi do të kërkohet ekstradim.

Kreu XXXVIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 565

Miratimi i akteve nënligjore

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 12 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 566

Përfundimi i procedurave të filluara para zbatimit të këtij ligji

Procedurat e filluara deri në fillimin e zbatimit të këtij ligji do të përfundohen sipas dispozitave të Ligjit për procedurë penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 15/97, 44/2002, 74/2004, 83/2008 dhe 67/2009).

Neni 567

Pasoja nga fillimi i zbatimit të këtij ligji

Me ditën e fillimit me zbatimin e këtij ligji, shfuqizohet Ligji për procedurë penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 15/97, 44/2002, 74/2004, 83/2008 dhe 67/2009), përveç për procedurat që udhëhiqen në pajtim me nenin 566 të këtij ligji.

Neni 568

Hyrja në fuqi dhe zbatimi i këtij ligji

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet pas kalimit të dy viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e dërgesës në formë elektronike, të cilat do të fillojnë të zbatohen pas skadimit të një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.